

Dr. Zihni Osmani - Fejzi Bojku

GJUHA SHQIPE
DHE LEXIMI
PËR KLASËN VII

Sbkup, 2010

Recensentë:

Qani Memeti - kryetar

Ibe Mustafa - anëtare

Izeir Mustafai - anëtar

Lektor:

Islam Karanfilii

Redaktor teknik dhe disenji:

Naser Fera

Botues:

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË Rr. Mito Haxhi - Vasilev Jasmin p.n. Shkup

U shtyp në shtypshkronjën:

Arbëria Design - Tetovë

Tirazhi:

1.251

Me vendim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të R. të Maqedonisë nr.
10-1617/ 1 të datës 19.06.2009, ky liber lejohet në përdorim.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент

Охридски”, Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

OSMANI, Zihni

Gjuha shqipe dhe leximi për klasën VII / Zihni Osmani, Fejzi Bojku.

- [2. изд.]. - Shkup : Ministria e arsimit dhe shkencës e Republika e

Maqedonisë së Veriut, 2020. - 254 стр. : илустр. ; 24 см

ISBN 978-608-226-829-3

1. Bojku, Fejzi [автор]

COBISS.MK-ID 51551237

Dr. Zihni Osmani - Fejzi Bojku

GJUHA SHQIPE DHE LEXIMI
PËR KLASËN VII

ATDHEU

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka
Më je nënë, më je motër, më je vlla.
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.
Ty përditë të pat parë ime nënë,
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.
Nëmëruar t'i pat lulet syri i saj.
Të ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.
Ti i ke parë gjysh stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtërat tretur ua ke po ti.
Nga ti, o shpirt-o kurrë s'qenë ndarë.
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.
Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë,
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!
Gas përjetë paçin zotërit e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë plot me lumturi!

Naim Frashëri



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

begatoje – bëje më të pasur
mbrodhësi – mbarësi, përparim
eshtërat – kockat
shend-i – gëzim i madh
u bë hi – u dogj krejt
eshtërat – kockat



Bisedë rreth vjershës

Përse bëhet fjalë në këtë vjershë (poezi)?
Ç'është atdheu për poetin?
Si i kuptoni vargjet e fundit të kësaj vjershe?
Me kë e krahason poeti atdheun?




Detyrë

Mësojeni vjershën përmendsh



Naim Frashëri
(1846-1900)

Naim Frashëri është poeti më i madh i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, atdhetar e mendimtar i shquar. Lindi në Frashër, fshat i Përmetit, ku kreu dhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Janinë. Jetoj në Stamboll, ku krijoi e punoi për çlirimin e atdheut nga zgjedha osmane. Botoi shumë vepra të shquara me poezi, si: “Lulet e Verës”, “Bagëti e bujqësia”, “Historia e Skënderbeut”, “Vjersha për mësonjëtorët e para”, “Qerbelaja” etj.



"SHQIPTARJA": K. KORO

NINULLA

Nano-nano, djalënë,
Se na zgjoi mëhallënë!
Kush e ka kush e do;
Kush e përkëdhel kur do!
Djal' i vogël këto do:
Lodrat dhe vallet' o!
O nana, o nana,
Nënua t'u bëftë kurban!
Që të ka e të mban.
Ririri, ririri,
Kush të ka more flori?
Tyj të ka nënkua në gji!
Oh, oh, flej, moj mollë,
M'u rritsh nanës me shkue në shkollë.
Për me marrë një dije të hollë,
Për me pasë kshtu nafakë,
M'u ba msuese e m'u plakë!
Nana ty ditë për ditë
Të ven me fjetë e të don me të rritë,
Hajde gjumë, hajde pëllumb,
S'të don kush ma fort se unë.

Këngët e djepit apo ninullat janë këngë lirike, të cilat gjysbet e nënat ua këndojnë foshnjave në djep. Në këto këngë shprebet gëzimi i madh i familjes për lindjen e foshnjës. Nënat shprehin dëshirat më të mira që sa më shpejt të rritet i shëndoshë e i gëzuar fëmija.



Detyrë

Gjeni këngë djepi të kënduara nga gjyshja, nëna, halla, tezja etj., dhe shënoni në fletore.



TI JE YLL E TI JE DRITË

Ti je yll e ti je dritë
yll që del ndaj të gdhirë,
Zot' ynë të dhëntë dritë!
Flasën bukurinë tënde, o shpirt!
Edhe zoqtë kur këndojnë,
shoq me shoq po ligjërojnë,
me gjuhë të tyre thonë;
flasën bukurinë tënde, o shpirt!
M'atë përçe fije-fije,
seç m'i mban gushes hije,
porsi dielli kur bie.
Flasën bukurinë tënde, o shpirt!
me atë përçe laqe-laqe,
kur ma derdh, ma hedh mbi faqe,
posi lule manushaqe.
Flasën bukurinë tënde, o shpirt!

Popullore



Bisedë rreth këngës

Këngëtari në këtë këngë dashurie flet për bukurinë e vajzës duke bërë portretizmin e saj.

Gjeni elementet shprehëse në bazë të cilave konstatooni se në këtë këngë i këndon i dashuri së dashurës.

Si e përshkruan ai disponimin e vet?
Me çka e krahason bukurinë e vajzës.

BUKURINË E BALLIT

Bukurinë e ballit,
Moj, do të ta marr
Dhe gushën e bardhë,
si margaritar.
Se ç'ta pashë faqen,
Në dritë të kandilit,
Më të vinin lotët
Sumbulla pas gjirit.
Bukurinë e ballit,
Moj, do të ta marr
Dhe gushën e bardhë,
Si margaritar.

Popullore



Poezia lirike e dashurisë

Poezia lirike e dashurisë nëpërmjet figurave poetike shpreh ndjenjat më intime lidhur me dashurinë e dy të dashuruarve. Këto poezi mund të flasin për hollësitë e ndjenjave, gëzimin, bukurinë, por edhe për pikëllimin, i cili haste shpesh kur dy të rinjtë pengohen në dashuri.



Bisedë rreth këngës

Cilit lloj të lirikës popullore i përket kjo këngë?
Në këto pak vargje poeti popullor ka përdorur disa krahasime mjaft të qëlluara.
Cilat janë ato? Si ju duket gjuha e kësaj kënge?

p.sh.: ulu mal të dalë hëna

ULU MAL TE DALE HENA

Ulu mal të dalë hëna,
sa të stoliset Kadëna,
të vishet ndë të holla,
të lulëzojë si molla,
të vishet ndë të bardha,
të lulëzojë si dardha,
të vishet ndë të zeza,
të lulëzojë si pjeshka.

KËNGËT E DASMËS

Martesa është një nga momentet shumë të rëndësishme për jetën e njeriut, sepse prej saj varet lumturia, shtimi dhe mbarëvajtja e familjes, prandaj edhe i kushtohet një kujdes i madh dasmës.

Fejesa është akti i parë i dasmës, kur dy familje miren vesh për lidhjen e fatit të djalit dhe vajzës.

MËMA

Fjal' e bukur, fjal' e shenjtë,
thellë zemrës që tingëllon

s'ka në botë gjë m'e shtrenjtë,
s'ka si mëmë kur kujton!

Mëmë, mëmë, frym' e lartë
rreze drite, yll qjellor.
plot mëshir' e mall të zjarrtë
ëngjëllroje madhështor.

Që nga gjinjt e saj të dli­rë,
vilet jeta pa shterim.
Që nga zemr' e saj ka mbirë,
dashuri dhe mallëngjim.

Si nër gaz dhe për vajtje,
veç një mëme të lartion.
Sa ka frym' e sa ka rrojtje,
mendjes kurrë s'të harrion.

Çdo rreziku rri të ruan,
bën detyrë si luftar,
si dëshmorë heq e vuan,
për të zemrës' saj thesar.

Kush s'di vlerën e njëj mëme,
është pa ndjenj' e shpirt mizor,
bir skëterre e frymë nëme,
është' i vetes tradhëtor!

Asdreni



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

i dli­rë – i pastër, i qëruar
vilet jeta – këtu: buron jeta
shpirtmizor – zemërkeq, i keq
skëterrë-a – ferr-i
nëmë-a – mallkim-i



Bisedë rreth vjershës

Ç'ndjenja për nënën na ngjall në zemër kjo vjershë?
Si i kuptoni metaforat që përdor vjershëtori për nënën: rreze drite, yll
qiel­lor, ëngjëllroje?
Në ç'kuptim poeti e krahason nënën me një luftëtare?
Si duhet ta tregojmë ne mirënjohjen ndaj nënës?



Detyrë

Gjeni rimat e strofës I, II dhe shpjegoni se si është formuar rima në çdo
rast (p.sh. shenjtë – shtrenjtë etj.)

Mësoni përmendsh vjershën dhe recitoheni bukur, pa u ngutur, duke respektuar pushimet, theksat, tonin etj.

*Nëna është drita e shtëpisë.
Populli*

Vjersha (poezia)

Vjersha (poezia) përbëhet nga një numër i caktuar vargjesh, ndërkaq vargjet nga një numër i caktuar rrokjesh.

Vjershat përbëhen prej strofash dhe vargjesh.

Strofa

Strofë quhet bashkimi i disa vargjeve të lidhura për nga ana kuptimore dhe shpesh me rimë ndërmjet tyre, nga të cilët përbëhet një vjershë a një poemë.

Sipas numrit të vargjeve që e përbëjnë strofën dallojmë strofë dyshe, treshe, katërshe (me katër vargje), tetëshe etj.

Vargu

Vargu është njësia poetike që përbëhet prej numri të caktuar rrokjesh dhe sipas numrit të tyre e merr edhe emrin. Kështu kemi vargje pesërrokësh (me pesë rrokje), gjashtërrrokësh, tetërrokësh, njëmbëdhjetërrokësh etj.

Secili varg ka gjatësinë e tij, e cila varet nga numri i rrokjeve që e përbëjnë atë.

Sipas gjatësisë së rrokjeve që e përbëjnë vargu ka edhe ritmin e tij.

Rima

Në një strofë vargjet edhe mund të rimojnë.

Rimë quhet përputhja e plotë e rrokjeve të fundit të dy a më shumë vargjeve duke filluar nga zanorja e theksuar. Dallojmë rimë të brendshme (e puthur, e kryqëzuar, e mbyllur).

Shembujt që shënuam më sipër i gjejmë më shumë te vjershat e rilindësve tanë, si të: Naimi, Çajupi, Ndre Mjeda, Asdreni etj.

Në kohë të fundit më shumë vjersha shkruben me vargun e lirë.

SI LINDI HIMNI KOMBËTAR “FLAMURIT PRANË TË BASHKUAR”

Si doli kjo këngë e kombit kaq e përhapur dhe kaq e kënduar, më e përhapura, e më e kënduara nga të gjitha? Doli ashtu, vetvetiu, papritur, “pa dashur”, siç del një fjalë ose një dëshirë nga zemra, kur zemra është plot. Ka lindur në mënyrë më të thjeshtë, nga gjindja e shqiptarëve të robëruar dhe të mërguar në vend të huaj. Nga kjo arsye mban, pra, më vete dhe shënjen e dyfishtë të burimit të saj: nga një anë hovin e brendshëm dhe, nga ana tjetër, shtytjen e jashtme që i pat dhënë trajtë. Dhe aq e vetvetishme, aq e pamenduar, është lidhja e saj, sa i natyrshëm dhe krejt i vetëkuptuar ishte malli për atdhe, që bëri të duhet dhe të mundur krijimin e korit. Ky kor u themelua në Bukuresht nga fundi i vitit 1907, aty si nga nëntoridhjetori, prej të rinjve dhe më të rinjve shqiptarë të kryeqytetit rumun. Ishte formuar me një qëllim të lartë kombëtar, për këngë të vendlindjes, për zbulurim të shërbesës fetare në kishën shqipe të Bukureshtit.

Mbledhja e parë që profesori Kiriak bëri për formimin e korit shqiptar ishte në Sallën Transilvania më 1907. Aty ai i ndau pjesëtarët e soprano, tenor, bas etj. Në një pushim plot gaz e kënaqësi, ai i thotë Asdrenit, i cili ndodhej midis këngëtarëve dhe ish i dëgjuar si vjershëtor kombëtar, pas shtypjes së vëllimit të tij “Reze dielli” në Bukuresht më 1904: “Ti je poet, bëj një strofë shqip që ta harmonizoj për korin dhe ta këndojmë”. Pa mbaruar fare këto fjalë mjeshtri i madh, gjithë anëtarët e korit buçitën me një zë në mes të entuziazmit “Rroftë Asdreni! Rroftë Asdreni! Asdreni! Asdreni! Marshin, Asdren! Marshin shqip! Marshin shqiptar”!

Asdreni që ishte larguar aty pranë, rrinte i tulitur në qoshe të sallës së madhe. Rrinte i thjeshtë dhe mendonte i thjeshtë dhe punonte i thjeshtë një këngë Shqipërie të thjeshtë, siç i ka hije, siç i ka pasur kurdoherë hije zemrës së tij prej njeriu dhe prej atdhetari dhe prej artisti të thjeshtë.

Pa u turbulluar aspak prej zhurmës së shokëve të korit në ushtrim e sipër solfezhesh, Asdreni krijoi aty për aty, atje, në Sallën Transilvania, atë çast, strofën patriotike që fillon me vargun:

“Ejani sot, o shqiptarë...”

Është një strofë, të cilën poeti s'e ka botuar gjer më sot në asnjë vend; ajo gjendet midis letrave dhe shkresave në bibliotekën e tij në Bukuresht. Ka qenë një poezi me rimë. Asdreni pati bërë katër strofa.

Me kësi përbënjës të flaktë përkundër punës së përditshme me të cilën ishin zënë të gjithë, kori vijonte rregullisht natën po dhe ditëve të diela, si dhe ndonjë të kremte rastore gjatë muajit.

Po kori kishëtar shqiptar i Bukureshtit nuk u pat bërë aq shumë për nevojat e kultit, sesa për qëllimin e lartë dhe të ndritur të çështjes kombëtare. Ishte një kor ku zemra regëtinte mbi krahët e lehtë të këngës dhe muzikës, dhe mbi krahët e muzikës merrte fluturimin drejt idealeve të Rilindjes së Atdheut. Dhe një ditë, kur gjithë kori së bashku këndonte i rrëmbyer siç ishte prej entuziazmit të çastit, iu lutën Asdrenit në mund të bënte edhe ca fjalë për një himn shqiptar. Veterani Asdreni nuk qiti zë atëherë sipas zakonit të natyrës së thjeshtë që ka, po pas disa ditëve, në mbledhjen e dytë ose të tretë, u paraqit me himnin e bërë shqip gati nën titullin "Rreth flamurit të përbashkuar". Nuk përshkruhet dot hovi i zjarrshëm i zemrave, me të cilin u prit ky lajm i bukur i përgatitjes së Himnit. Pa e mbaruar së recituar Asdreni, një anëtar i rrëmbyer ia hoqi vjershën nga duart me padurim, e vuri shpejt mbi një trekëmbësh në mes të sallës dhe së bashku me koristët e tjerë, me të ndodhurit e mbledhjes dhe me profesorin Jonesku në orgë, e ekzekutuan himnin... Dhe himni arriti të bëhej kësisoj Himni Kombëtar i Kolonisë së Bukureshtit, që përfaqësonte Shqipërinë në atë vend mërgimi, aq të djegur për atdhe, duke u bërë zakon të këndohet rregullisht përpara dhe pas çdo ushtrimi të korit.

Lasgush Poradeci



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

gjindje-a – shumicë njerëzish, njerëzit

i vetvetishëm – që bëhet vetëm pa ndërhyrje e shtysë nga jashtë i natyrshëm

i pamenduar – këtu: e papërgatitur që më parë

i tulitur – i mbledhur lëmsh, kruspull

përbënjës – përbërës: këtu: anëtar i korit

rastore – e rastit

kult-i – tërësia e ceremonive fetare; feja

regëtim – këtu: rreh e dridhet

veteran-i – këtu: patriot i vjetër, atdhetar

i rrëmbyer: këtu: i entuziamuar

trekëmbësh-i – këtu: pupitër, lexuese; një mobilje e thjeshtë me një

faqe të pjerrët, ku muzikantët vendosin notat
të ndodhurit – të pranishmit
orgë-a – vegël muzikore me tastiera, organo



Bisedë rreth tekstit

Ç'kërkoni këta shqiptarë në Rumani? A kishte shqiptarë të tjerë nga vende të ndryshme të botës? Ku?

Ç'lidhje mbanin mërgimtarët shqiptarë me atdheun e robëruar? Ku duket kjo në copën e mësipërme? Pse e krijojnë ata korin? Ç'pjesë muzikore luante kori? Kush merrte pjesë në këtë kor?

Ç'përshtypje bën te të pranishmit Himni Kombëtar?



Detyrë

Mësojeni përmendsh Himnin Kombëtar.

Gjeni të gjitha strofat e Himnit Kombëtar, mësojini dhe i këndojini bashkë me shokët.

“RRETH FLAMURIT TË PËRBASHKUAR”

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë, me një qëllim
Të gjithë aty duke u betuar
Të lidhim besën për shpëtim.

Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor
Kush është burrë nuk frikohet
Por vedes, por vdes si një dëshmor.

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mbrojmë atdheun në çdo kënd
Të drejtat tona ne s'i ndajmë
Këtu armiqtë s'kanë vend.

Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombe shuhen përmbi dhe
Por Shqipëria do të rrojë
Për të, luftojmë ne.

ASDRENI

Sbënim:

Himni është një këngë solemne që i kushtohet atdheut dhe mbahet si simbol i kombit – i shtetit. Çdo shtet ka himnin e vet.

Himni i Flamurit është simboli i kombit shqiptar.

Ai lidhet me një ngjarje të rëndësishme të histories sonë, me shpalljen e Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912. Atë ditë, u këndua kënga patriotike “Rreth flamurit të përbashkuar”, nga të gjithë delegatët dhe “Banda e Lirisë” së qytetit të Korçës.

“Himni i Flamurit” këndohet në këmbë dhe me qëndrimin drejt në shenjë respekti për simbolin.

Himni “Rreth flamurit të përbashkuar” u pranua si Himni Kombëtar Shqiptar. Vargjet e Himnit janë shkruar nga poeti Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni).

Muzika është kompozuar nga Ciprian Porumbesku (kompozitor rumun).

Himni ynë është regjistruar (incizuar) në disa variante.

Sot varianti zyrtar i Himnit Kombëtar është ai i orkestruar për orkestër simfonike nga “Artisti i popullit” Çesk Zadeja dhe i regjistruar në vitin 1995.



Bisedë rreth himnit

Ç'përfaqëson Himni i Flamurit?

A njihni tjetër simbol kombëtar?

Kush i ka shkruar vargjet e Himnit dhe ç'dini për të?

Çfarë duhet të bëjmë kur këndojmë Himnin e Flamurit?

Si quhet himni i Republikës së Maqedonisë?



Detyrë

Provoni të recitoni sa më bukur vargjet.

O DASHURIA IME!

(në gjubën e autorit)

Përse, o bir, gjithë të mirëtë tem ti mua më lae kështu? Ma mirë pat me kjanë në jeshe unë dekunë përpara, ti të mbëshilnje sytë mi: unë ma e motçime, e ti ndë ma të mirë mot tand': Përse deshe kështu me dekunë e mue me më lanë? E ndë të pëlqej kështu të ri me dekunë, përse nukë më mire me vetëhe? Mbasi unë ty leva iur u dashë kurraj nteje?... Deh, pra, e gjithë të dashunitë tem, përse më lae këtu? Si pra muite me më lanë kështu? Si nukë tu dhëmbti posi vetë mortja eme? Ah i ambli, biri em, përse më lae, e shkove?... nukë besonjt, o bir... tue pam mbë këtë mendyrë qi je, mudetë me bam me dekunë një mijë vet, e ma fort unë, që tjetër herë, ndryshej të kam pam ngrykë mue kërthi, gjithë të bukurë... Kush nuk mrekullohet? Kush pa syt' e tu të ndriçmitë, qi gëzojnë vetë qielltë... Ai qi pa gojën tande shenjtë, se sillet dilinë fjalë aqa të përzarshme, sa ngroheshinë së dashunit së fortit ma të ftofëta e të akulluemet zemëra të fajtorëvet: Qish kish me thanë tash me të pam gjithë gjakunë e nxim? I sillu është ai qi së dashuni nukë kish me shtim lot? Aq qi pa krifnë tand' t'artinë... kur unë ta krehinjtë, ani të mbukuronje me drandofille e vjollëza; e tash të ta shofë gjithë çprishunë, e mbë vendë lulevet rrethuem me mërqinja: kush nukë kish me u tmerruem qi të kish pam mjekërre tande dam ndrysh, e të shkëlqyeme, tash ta shofë gjithë të çprishme e plotë me gjak?... Pra kush të ka pam si të kam pam unë, e me të pam pos pasi të shofë unë, qish ngushëllim kish me pasunë? E ma fort sa të dhimptumë kam unë çkushëlluemja. Ama, jote, qi të leva?... përse ndë për tan' biri em ashtë vram. Ky kje qi më bani me mb tunë pa Hyjnë tem, një i vetëmi gazëmend më jet...

(në gjubën e sotme)

Përse, o bir, me gjithë mirësinë time, ti mua më le kështu? Më mirë do të ishte të kisha vdekur unë përpara dhe ti të mbyllje sytë e mi. Unë më e moçme e ti në të më mirin motin tënd. Përse deshe kështu të vdesësh, përse nuk më more me vete? Mbasi unë të linda, nuk ndava kurrë prej teje... Deh,

pra, o dashuria ime, përse më le këtu?... Si, pra, munde të më lësh kështu? Si nuk ndjeve dhembje, sikur të ishte vetë mortja ime? Ah i ëmbli, biri im, përse më le e shkove?... Nuk e besoj, o bir... Duke të parë në këtë mënyrë siç je, mund të bësh që të vdesin një mijë vetë, e më fort unë që tjetër herë ndryshe të kam përquafuar kërthi, gjithë bukuri... Kush nuk mrekullohet? Kush pa sytë e tu të ndritshëm, që gëzojnë vetë qiellin... Ai që pa gojën tënde të shenjtë, prej së cilës dilnin fjalë aq të përziarrshme, sa ngroheshin prej dashurisë zemrat shumë të ftohta e të akulluarat të fajtorëve. Çfarë do të thonin tani kur të të shihnin të gjithë të përgjakur e të nxirë? E kush është ai që prej dashurisë nuk do të derdhte lot? Ai që pa flokun tënd të artë... kur unë të krihja, pastaj ta zbukuroja me trëndafila e vjollca; e tani të ta shohë të gjithë të shprishur e në vend të luleve, rrethuar me mirqinja. Kush nuk do të tmerrohej po të shihte mjekrën tënde, të ndarë më dysh e gjithë shkëlqim, tash të ta shohë të shprishur e plot me gjak?... Pra, kush të ka parë si të kam parë unë, e kur të sheh si po të shoh unë, çfarë ngushëllimi do të kishte? E më fort se dhembje kam unë, e pangushëlluara nëna jote, që të linda... Përse midis të tërëve biri im është vrarë? Ky qe që më bëri të mbetem pa hyjin tim, pa gazmendin e vetëm në jetë.

Pjetër Bogdani

Shkroi në gjuhën e sotme

P.Haxhillazi

Shënim

Kjo pjesë është shkëputur nga vepra e Pjetër Bogdanit “Çeta e profetëve” (1685), një nga veprat e shquara të letërsisë shqiptare të shekullit XVI-XVII. Pjetër Bogdani e shkruan me mjeshtëri të rrallë artistike gjuhën shqipe të asaj kohe, duke zënë një vend të rëndësishëm midis autorëve shqiptarë të letërsisë sonë. Në këtë vepër gjejmë edhe monologun e brendshëm. Fjala shqipe, e shkruar mjeshtërisht nga Bogdani, të lë mbresa të thella dhe nxit imagjinatën e lexuesit. Gjuha artistike e kësaj vepre dëshmon se P.Bogdani i njeh dhe i përdor shumë mirë mjetet gjuhësore, që i japin ligjërimin ngjyrim të thellë shprehës dhe emocionues.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

mbëshel – mbyll
nteje – prej teje
dashuni-të (të) – dashuritë
kërthi-ri – fëmijë që porsa ka lindur, foshnjë
mrekullohet – habitet fort, mbetet me gojë hapur
përzjarshëm (i,e) – që ka ngrirë nga hidhërimi a frika
me shtim lot – derdh lot
krifë-a – tufë qimesh të gjata, kreshtë, këtu, flokë
mbukuronj – zbukuroj
vjollëz-a – vjollcë
mirqinjë-a – ferrëkuqe, drizë
çprishme (të) – dhembje
çkushëlluem (i,e) – i pangushëlluar
gazëmend-i – gëzim i madh, hare

Monologu i brendshëm

Monologu i brendshëm është pjesë e një vepre letrare, që përmban kuvendimin e personazhit me vetveten, duke shprehur në këtë mënyrë mendimet e ndjenjat e tij, jetën e brendshme dhe gjendjen shpirtërore. Monolog të tillë ka dhënë edhe Pjetër Bogdani. Nëpërmjet monologut të brendshëm, autori jep vajtimin në vetmi të nënës para birit të saj. Ky monolog është “një nga pjesët më të bukura e më të thella të ligjëratës artistike të veprës”. Kështu e ka përcaktuar atë studiuesi i mirënjohur i veprës së Pjetër Bogdanit, dr.Ibrahim Rugova. Edhe shkrimtari Ismail Kadare e ka përdorur monologun e brendshëm në romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, për të treguar vuajtjet e rënda shpirtërore të plakës Nicë gjatë kohës kur ajo ishte ftuar në dasmë. Kështu është rritur në një shkallë më të lartë fuqia dramatike e kësaj pjese.



Bisedë rreth tekstit

Si është dhënë dashuria e nënës për birin e saj?
Ç’ndjenjë të nënës ka theksuar P.Bogdani kur përsërit fjalën: O bir!...
Me ç’figura letrare e jep autori figurën e nënës dhe brengën e thellë të saj për të birin e vdekur?



Detyrë

Diskutoni në klasë se ç'ndjenja dhe mendime ju zgjohen duke lexuar këtë pjesë.

Krahasoni gjuhën e autorit me pjesën e kthyer në shqipen e sotme letrare. Vini në dukje dallimet në përdorimin e trajtave të fjalëve dhe fjalët që sot janë vjetruar.



Pjetër Bogdani
(1630-1689)

Është njëri ndër shkrimtarët më të shquar të Letërsisë së Vjetër Shqiptare. Lindi në Gur të Hasit, rrethi i Kuksit. Mësimet e para i kreu në vendlinje, pastaj i vazhdoi në Bullgari dhe në Itali. Studimet e larta i bëri në Kolegjin e Propagandës, ku mori titullin e Doktorit për teologji dhe filozofi. U emërua peshkop i Shkodrës dhe administrator i Tivarit. Vepra “Çeta e Profetëve” është shkruar në vitin 1675 (1685) dhe ka rëndësi jo vetëm se aty shkrimtari trajton disa çështje me karakter fetar e filozofik, por se aty gjejmë parathënien e autorit dhe disa vjersha në gjuhën shqipe, të cilat autori ua kushton bashkatdhetarëve dhe gjuhës shqipe.



GËRZHETA

Në shumë përralla popullore, njerëzit përopiqen e luftojnë për të arritur lumturinë. Kështu i ndodh edhe malësorit të ri me Gërzhetën e bukur. Por lumturia kërkon mund, përpjekje dhe durim. Ajo nuk arrihet menjëherë.

Kishin pasë qenë katër vëllezër. Tre ma të mëdhenjt merreshin me bujqësi - e i vogli ruante delet. Shkonin fort mirë njëri me tjetrin. Nuk shkoi shumë e u martua ma i madhi vëlla, mandej i dyti, mandej i treti. Kur i erdhi rendi të voglit ky s`dëgjoi kursesi. Të tjerët nuk iu vunë për do kohë tue mendue se ai s`u çilej prej turpfit.

Vëllai i vogël bluante me mend të veta çka s`ia merrte mendja kurkujt. Ai për ditë i printe deleve e i çonte me kullotë në një fushë që e kishte barin deri në gju. Në mes të asaj fushe ishte një gjol i madh. Në atë gjol jetonte një Gërzhetë që gja ma e bukur se ajo nuk ishte m`u pa mbi fytyrë të tokës. Djali, pa e hetue kush, i avitej gjolit, fshihej pas një kaçube e kënaqej tue e pa Gërzhetën që lahej në atë ujë e delte në shulla e krehej:

-Kjo - thotë vedi me vedi - asht për mue e tjetër nuk marr. E përherë e ma fort i ngulej ky mendim në krye e as ditë as natë s`gjente pushim.

Vëllzanit tue e pa ashtu të mërzitun, natë për natë e gjujshin me fjalë, deri sa e lodhën e e banë me folë.

-Mor vëllazën, -u tha, - sa herë çoj delet në kullotë, kam për të pa në një gjol të madh uji një grue të hijshme, që kurrkund shoqja nuk mund t`i gjendet. Sa e prekin gjolin rrezet e diellit, del, lahet, krehet e rrin në shulla, por s`ka burrë që i avitet, pse në dekik zhytet në ujë e humbet. Tash mue m`asht ngulë mendja në të e, ja e marr, ja vdes pa u martue.

-Mos e fol atë fjalë, - ia pret ma i madhi vëlla, se ajo asht Gërzheta e gjolit e për katërqind vjet s`mund ta prekësh me dorë. Jo ma me e prue te shtëpia.

-E, pra e unë e kam ba një mendim, - u thotë i vogli, por s`po dij a po më ndihmoni pak.

-Besa, -ia pritën tre vllaznit një zani,- për me të ndihmue të ndihmojmë gjithsesi

të na thuash, por po druhe mi se s`na del gja. Po na difto njiherë çka ke mendue.

-Kam mendue, - u thotë ma i vogli vëlla, - me vu në breg të gjolit një këmishë të bukur me grykë e mangë të qepuna, nji pasqyrë, nji sapun, e nji krahën e me çilë katër gropa për meu fshehtë të katër ndër to. Gërzhetë, kur të dalë në tokë, ka me i pa ato sende e ka m`u kujtue se për çka vlejné e kur ta veshë këmishën me mangë të qepuna ne kemi me i ndenjë gati me e kapë.

-Mirë qenke kujtue, - i përgjigjen vllaznit, - e pa ia hy kësaj pune s`po rrimë.

Të nesërmen, pa dalë mirë drita, morën shata, kazma e këmishën me mangë e grykë të qepuna e shkuan te gjoli. Këmishën, pasqyrën, sapunin e krahnin e vunë në atë vend ku pushonte Gërzhetë, mandej çelën katër gropa e u strukën brenda.

Duel drita, ra dielli mbi gjol e nisi me u nxe ujët. Kur, qe, qet kryet Gërzhetë e shikon mos asht kush. Lahet e lot në ujë, mandej del në breg për me u krehë. Pa u ulë mirë, i shkojnë sytë te këmisha e te pasqyra. Avitet, i merr në dorë nji nga nji, mandej hynë prapë në ujë e lahet me atë sapun, del prap në breg e teret; kap me njenën dorë krahnin e me tjetrën pasqyrën, e si limohet e zbukurohet, merr me veshë këmishën. Përnji që e panë vëllaznit se po rropatej me e çitë për gryke e krahë për mangësh, u lëshuan në të e me shumë mundim e lidhën e e çuan te shtëpia. Gërzhetë e pa se s`mund të shpëtonte e bani gjithë se si i thanë ata. Hoqi petkat e veta e u vesh me petka të vendit e pas pak ditësh u martue me ma të vogllin vëlla. Të gjitha punët i kryente pa mërzë, por me folë me gojë, nuk folte. Pas një viti i leu një djalë i shëndoshë e i bukur që me të kënaqë veç tue e pa, por as kësaj here nuk foli. I shoqi u mundue me ia nxjerrë nji fjalë, po s`qe punë. Atëherë kapi djalin e me shpatë në dorë i tha së shoqes:

-Ja po flet, ja e preva djalin!

Gërzhetë, tue kujtue se për nji mend po donte me e pre, çeli gojën e tha:

-Mos ma pre djalin!

U gëzue i shoqi e u gëzuen të gjithë kur foli, po Gërzhetë vijoi e tha:

-Edhe katër ditë kam pasë me ndenjë pa folë. Ju s`e batë mirë që më ngushtuet me folë para kohe.

Vëllaznit ia kishin frikën Gërzhetës e përherë e ruejshin që mos t`u ikte, por kur u ba me djalë, atëherë e lanë të lirshme. Gërzhetë iu kujtua kësaj pune e nji ditë prej ditësh e pyeti të shoqin:

-Zot, ku do të m`i kesh lanë teshat që kam pasë kur isha në gjol?

-Po pse? - e pyeti i shoqi. Çka po të duhen?

-Kurgja, - ia pret gruaja, -veç më ka shkue mendja për to.

I shoqi, që s` mendonte se mund të ndodhte gja, i dftoi arkën e duel për punë të veta.

Gërzheta i vuri syrin arkës e kur pa se s` mund ta hetonte kush, nxuri teshat, i veshi, ngau te gjoli, ra brenda e ui zhduk njiherë e për gjithmonë.

Populli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje:

Gërzheta - figurë epërrallave popullore që përfytyrohet si një vajzë e bukur, që jeton në ujërat e liqeneve. Ajo ashtu si e Bukura e Dheut, është mishërimi i lumturisë në përrallat tona.

prej - udhëheq, i çonte delet

shulla - ni - shallë - ri, vend që e zë dielli

dekik - u - çast, sekondë

drue - j - kam frikë, trembem

terem - thahem

rropatem - përpiqem, mundohem

ngushtoj - detyroj

përnjimend - me të vërtetë

Përralla

Lloji më i përhapur i epikës popullore është përralla.

Përralla është një tregim popullor, ku përshkruhen ngjarje dhe episode të trilluara, të cilat nuk mund të ndodhin në realitet, por që kanë deri diku lidhje me të. Në çdo përrallë, dallojmë elemente **reale** dhe **fantastike** dhe dy lloje personazhesh: **pozitive** dhe **negative**.



Bisedë rreth përrallës:

Ç` mësim nxjerrim nga kjo përrallë?

Pse kjo copë leximi është një përrallë e jo një tregim?

Çfarë duhet të kuptojmë me figurën e Gërzhetës?

Ndajeni përrallën në tri pjesë dhe çdo pjese i vini nga një titull sipas përmbajtjes.



Detyrë:

Gjeni personazhin pozitiv në këtë përrallë.

Përshkruani elementet reale te saj.

Në cilin dialekt është shkruar kjo përrallë?

NJERIU PREJ ARGJILE

Gjatë Nilit, në Sudan, tregojnë që Jouku (Zoti) krijoi njeriun prej argjilës.

Në veri të vendit gjeti argjilë të bardhë, me të cilën ai bëri evropianët; me argjilë kafe ai bëri arabët, ndërsa me dhe të zi afrikanët. Pastaj Jouku tha:

Do t'i bëj njeriut këmbë të gjata për të vrapuar në pellgje; do t'i jap krahë të gjatë, një gojë të madhe për të ngrënë grurë afrikan dhe një gjuhë për të kënduar; sy për të parë ato çka ha dhe veshë për të dëgjuar këngët e tij.

... dhe gjithçka u bë gati.

MITI

Miti është lloj i veçantë i krijmtarisë gojore popullore – rrëfim (rrëfenjë) që bën fjalë për qenie të mbinatyrshme për heronj legjendarë, për ngjarje edhe dukuri të çuditshme ku pasqyrohen parafytyrimet e përpjekjet e njëzëve primitivë për të shpjeguar prejardhjen e jetës dhe dukuritë e ndryshme natyrore.

Në mite gjejmë edhe figura perëndish për heronj legjendarë e personalitetesh historike.

LEGJENDA

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe tregoni përse bëhet fjalë. Cilës krijimtarie i takon?

ËNDRRA E SKËNDERBEUT

Skënderbeu kishte qenë duke fjetur në mal. E pa një ëndërr, sikur dikush po e thërriste: “O Skënderbe! Zgjohu nga gjumi dhe shiko diçka në lis” !. Skënderbeut i del gjumi në agun e mëngjesit dhe po shikon qiellin të kuq si gjaku, ende pa lindur dielli. Duke parë ashtu, e pa mbi lis shqiponjën me krahët hapur. Skënderbeu mori lapsin dhe një letër, e vizatoi qiellin e kuq dhe shqiponjën e zezë – e kështu doli flamuri kuq e zi.

E popullit

Legjenda është një kallëzim popullor që bën fjalë për një dukuri, ngjarje ose personazh historik që mund të ketë bazë të vërtetë, por duke kaluar gojë më gojë është bashkuar me elemente fantastike.



BIJ TË SULIT

Bij të Sulit, qysh e duroni,
Në beteja sot marshoni!
Nuk ju mposhtin gërxhet dot!
Burra! Burra! O suliotë!
Mundin tuaj ta kërkoní,
Atje ku ju fton zakoni!

Mbi flamur të shenjtëruar,
Po shkel hasmi i mallkuar,
Mbi flamurin malësor,
Përmbi nderin prindëror.
Ngrahuni në luftë sot!
Burra! Burra! O suliotë!

Plugje kemi pallat tona,
Korrje janë fitoret tona!
Në kështjellën që do shembet,
Mundi, djersa juaj gjendet!
Atje kemi ne lavdinë!
Zjarr për zjarr pra me stuhinë.

Xborxh GORDON BAJRONI



Pasurojmë fjalorin me fjalë dbe shprehje:

gërxh,-i - shkëmb i ashpër me thepa
hasm,-i – ai që është në gjak me dikë për shkak vrasjeje



Bisedë rreth vjershës

Për cilët burra bëhet fjalë në vjershë?

Si i përshkruan poeti bijtë e Sulit?

Cilat nga figurat që i përdor këtu poeti ju pëlqejnë më shumë?



Detyrë

Lexoni me kujdes strofën e fundit. Vëreni se si poeti luftën e suliotëve e konsideron si luftë të vetën e të gjithë patriotëve evropianë të asaj kohe. Ai thotë: “Plugje kemi pallat tona”/ “Atje kemi ne lavdinë!”

GOCA E KAÇANIKUT

Në anën e djathtë të ngushticës së Kaçanikut ishte një katund. Quhej Trimor dhe ishte i dëgjuar se kishte nxjerrë katër pashallarë dhe dy vezirë. Ky katund e ka rrjedhën që nga kohët e vjetra anike. Dhe duhej të ishte i vjetër, sepse ndërtesat kishin stil antik.

Katundi përgjithësisht kish një bukuri të rrallë: një copë fushë dhe rreth e rrotull male – male dhe male në majërat e të cilave zbardhte dëborë. Ujë kish sa të duash se gjyshërit e Trimorit kishin sjellë dy kronj me ujë të mirë. Në skajin e djathtë të katundit rronte një burrë q’ish mjaft i drobitur. Kish gruan e thinjur, tre djem në kurbet dhe një gocë që e quanin Pafikë. Djemtë kishin shumë vjet që kishin shkuar në Stamboll. Atje bënin punë të ndryshme. Shpesh merrte letra prej tyre.

Pafika e shkonte kohën pranë prindërve duke dëgjuar fjalë të ëmbla dhe duke thurur çorapë. Goca tërë ditën e shkonte në punë. I ati dhe e ëma e përgjëronin t’i gjenin një burrë të mirë, se vajza ishte rritur. Pritnin të kthehej nga kurbeti ndonjë djalë i mirë që t’ia jepnin vajzën.

Po ai që kish pëlqyer Pafika ish një djalë gjer më njëzet vjetësh i veshur me petkat e gegërisë ngjyrë bardhë me shirit të zez, me një fytyrë madhështore e të hijshme, me tipare të rregullta e të bukura: kish një sy të shpejtë si prej shqiponjeje. Ish trim dhe emri i tij ish i dëgjuar në gjithë qarkun e Kaçanikut.

Pafika ish një gocë e bukur: bisqet e zez e të gjatë i arrinin gjer në thundrat e këmbëve, e kur i hidhte prapa shpinës dukeshin porsi dy gjarpinj. Kur vinte te kroji ku lante rrobat me llërë përveshur, gjersa nuk dukej njeri. Takimet i bënin në krua.

Një ditë kur dielli ndritte me tërë bukurinë që ndrit në Malësinë e Kaçanikut, erdhi nga Stambolli një lajmëtar dhe u tha që t'i mbledhin armët e t'ia japin Pashës kur të vijë se të tillë kanun kanë pru xhonturqit. Paqetësia mbretëronte kudo në mes të shqiptarëve, po frika nuk gjente dot vend në zemrat e tyre. Pas kësaj u mblodhën gjithë pleqtë e katundit në kuvend dhe dërguan lajm në të katër anët e Malësisë. Kuvendi vendos të nxjerrin kushtrimin, të mbledhin gjithë trimat dhe të përpiqen gjer në fund për t'i ruajtur armët me të cilat i ruanin të drejtat e tyre. Pas kuvendit u mblodh ushtria që kalonte tridhjetë mijë burra dhe të gjithë ishin trima të paepur. Në mesin e tyre ishte edhe ai djalë i pashëm që e dashuronte Pafika. Ai e la gocën se e kuptoi rrezikun fatal që i kërcënohej vendit. Shkoi në luftë, sepse kështu e kërkonte atdheu dhe nuk e dinte në do të shihej ndonjëherë me Pafikën.

Shtabi ndodhej prapa Kaçanikut në bjeshkët e malit B... Atje ish e gjithë ushtria nën kryesinë e Bajram Currit me shokë, e të Isa Boletinit.

Tymi e kishte pushtuar qiellin dhe e kishte fshehë Diellin. Përleshja me turqit ishte e tmerrshme. Dëgjoheshin të zbrazura pushkësh. Shumë shpesh së bashku me to dëgjoheshin edhe "ohe" të njerëzve të vrarë. Shqiptarët dolën fitues. Turqit kishin dymijë të vrarë e të plagosur.

U dëgjua të lehurit e qenit. Shiu kish pushuar. Pafika ende nuk kishte fjetur, po mendohej dhe para syve i dilte trimi. Të lehurat e qenit i kallën dyshime, u vesh dhe doli jashtë. Jashtë nuk pa askënd. I hyri një frikë dhe pëshpëriste në vetvete: jo, nuk besoj që ta kenë vrarë. Ai duhet të jetë i gjallë se ashtu e do zemra ime. Në atë çast zëri i saj buçiti në të katër anët dhe depërtoi thellë në errësirën e natës. Fiqali nxori koburen dhe e vrau qenin e me dorën tjetër kapi Pafikën për dore. Donte ta dhunonte. Ajo i tha:

-Fiqal, unë s'jam anadollake, po jam shqiptare dhe s'kam lindur për qefin tuaj!

Nga të zbrazurit e kobures i ati i Pafikës u zgjua dhe dual në kopsht për të parë se ç'po ngjiste.

Trimi i bukur kishte shpëtuar për mrekulli nga duart e turqve. Dashuria që kish për Pafikën nuk e linte të largohej. Kishte disa net që pranë shtëpisë së saj bënte roje, meqë kishte parandjenjë mos i bënin ndonjë të keqe Fiqalit. Me të dëgjuar të zërit, kërceu në oborr nuk fliste se ndodhej si ujku në çark. Vetëm

gulçonte, i shtrëngonte dhëmbët dhe priste t'i vinte shoku në ndihmë. Fiqali nuk nxori më asnjë gulçim se dora e stërvitur e trimit e gjeti vendin ku i rrihte zemra. Tani ai po shihte Pafikën e matej t'i fliste, dëshironte të dëgjojë ndonjë fjalë prej saj. Ajo desh t'i fliste, ta falënderonte trimin, t'ia hapte zemrën. Po të gjitha mbeti pa i thënë. Plumbi i Fiqalit tjetër e shtriu për dhe trimin. Në këtë hop plaku e mblodhi veten edhe e vrau Fiqalin.

Kishin shkuar shumë muaj. Vendi ishte shkelur dhe nuk kishte mbetur nënë që të mos qante djalin, as nuse që të mos qante burrin. Qielli më nuk i hidhte drejt shkëndijat. Dita ishte shkurtër. Ngrysej shumë shpejt. Zogjtë këngëtarë që kur e kishin pushuar këngën e tyre. Drurët e kishin humbur gjelbërimin. Mali dukej si i shkretë. Vetëm lumi po këndonte këngën e tij të kahmotshme në të cilën ndihej hidhërimi. Pafika në këtë kohë ish ligur e ish tretur në mejtime për të dashurin e saj të zemrës që e vranë. Shkonte te varri i tij, që e kish në kopsht, qante dhe e sillte ndërmend kur i shkonte përpara. Nga ky mall e pikëllim ra në sëmundje. Ditë e natë vetëm atë e sillte ndërmend, atë që flijoi jetën për ta shpëtuar nderin e shqiptares.

Kishin kaluar dy muaj nga dita që Pafika po dergjej në shtrat. Sytë e bukur i ishin venitur e futur brenda. Duart iu tretën dhe i vëreheshin kockat.

Ishte vjeshtë e tretë. Drurët kishin mbetur pa gjethe dhe era ua luante degët. Pafika desh të ngrihej e t'ia shihte panoramën maleve. Me ndihmën e s'ëmës iu afrua penxheres, dhe tha:

-Nënëzo, të lutem shumë, nxirrmë pak jashtë. E ëma ia plotësoi dëshirën. Me të dalë te dera sytë e saj panë vendin fatal ku vdiq trimi. Nga sytë e saj të tharë pikuan lot.

Kroi rridhte me harmoni çërr... çërr... çërr. Çërr-i i tij ia tërhiqte vëmendjen Pafikës. Iu kujtuan gjithë ditët e kaluara në këtë krua.

Pafika vështroi edhe njëherë rreth e rrotull, vari kokën dhe shtriu trupin mbi varrin e trimit.

Milto S.Gurra

Shënim

Ky fragment i tregimit është marrë nga tregimi më i gjatë po me këtë emër. Fragmenti është marrë nga libri "Tregimet", që e botoi "Rilindja" më 1971.

Temë kryesore e këtij tregimi është qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit turk, mbrojtja e atdheut dhe e nderit të shqiptarëve kundër sunduesve. Heronjtë e tregimit janë njerëz të thjeshtë të popullit

që shquhen me trimëri e heroizëm.

Personazhet kryesore të tregimit janë Pafika dhe i dashuri i saj, trimi i ilirisi. Krahas temës së madhe për mbrojtjen e atdheut e të nderit, zhvillohet edhe një dashuri idilike në mes të dy të rinjve. Dashuria e këtyre të rinjve është përshkruar me një notë sentimentale.

I frymëzuar nga kjo ngjarje Jusuf Buxhovi e shkroi libretin për operë me titullin “Goca e Kaçanikut”, ndërsa autor i kësaj opere të parë në Kosovë është kompozitori Rauf Dhomi. Kjo operë për herë të parë u ekzekutua në Prizren, më 10 qershor të vitit 1978 me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



Bisedë rreth tekstit

Për çfarë ngjarje bën fjalë tregimi?

Cilës periudhës i përket?

Si paraqitet natyra në disa raste në këtë tregim dhe a i përshtatet kjo gjendjes shpirtërore të personazheve? Si përfundon jeta e dy personazheve kryesore të tregimit?



Detyrë

Bëni një hartim për këtë tregim.



SKËNDERBEU

Kush nuk e di Skënderbenë,
që nderojti
mëmëdhenë?...
Dhe sot nga armët e tija
Kullon fjeshtë trimërija!
E di njerëzi e tërë
Atë Zot ç'punë ka bërë:
'Kur hiq Skënderbeu
Shpatë
Trimave u jepte datë!

Burra të veshur në hekur,
Dhe luftëtarë të pjekur,
Q'ishin në luftë kaluar
Përmbi kuaj' të harbuar,
Kur hiq me kordhët të prehtë

Q'ishte si pendëz' elehtë,
Porsi pjepërin e priste,
Në vdekje pa ndjer i klliste,
Njerin' e kalin e çante,
Të dy më katër i ndante!
Mirësin' e trimërinë,
Me mendjen e urtësinë
T'ati Zoti njeri kurrë
S'e ka pasur nonjë burrë.
Vet' aty burr' e trim ishte,
Edhe shokëtë që kishte:
Si Tanushi me Uranë,
E Mojsiu me Hamzanë,

Si Maneshi e Muzaka,
Që hidheshin posi flaka,
E si Lekë Dukagjini,
Si Perlati e Mardini
Zenebisha, Araniti.

Gjon-Koka, q'ish si hastriti,
Kont, prens, mbretër e të tjerë,
Burra të vler e të ndjerë,
Qenë trima të vërtetë,
Nuk u bënë rop në jetë,
Opopo, ç'kanë lëftuar,
E ç'punë kanë punuar!
Sa mbretër e prensë qenë
Njohnë të madh Skënderbenë,
Zun' udhën e urtësisë,
Ishin larg marrëzisë...
Madhëritë nuk i donin,
Po kishin vëllazërinë,
S'e qasninë djallëzinë,

Pa lan' emërë për jetë.
Zotërinjtë e vërtetë...
S'kishin ata thash`e theme
Të këqija e të rreme,
Donin gjithë mëmëdhenë
Dhe kombin e Skënderbenë.

Naim Frashëri



Pasurojmë fjalorin me fjalë dbe shprehje

nderojti – nderoi
fjeshtë – thjeshtë
hiq' shpatë – hiqte shpatën
datë – tmerr, lemeri, u kallte datën – ua shtinte tmerrin
të pjekur – të regjur,
të harbuar – të tërbuar, që s'përmbahen.
Kur hiq me kordhët – kur qëllonte me shpatë
pa ndjer' i klliste – pa e ndier (ata fare) i fuste (në vdekje).

Princat shpiptarë që luftuan nën udhëheqjen Skënderbeut kundër turqve

Hastriti – më drejtë astriti – njëfarë gjarpëri i verdhë, fig. Trim.

Kont, Prens – Kontë, princë.

të vler' – me vlerë, të vyer, të zotët.

të ndjerë' – me vlerë, të vyer, të zotët.

të ndjerë – të dëgjuar, në zë.

madhritë – madhështinë

s'e qasninë – s'e afronin, s'e pranonin pranë vetes.



Bisedë rreth tekstit

Si e përshkruan personazhin kryesor poeti?

Pse thotë poeti Skënderbeu e nderoi mëmëdhenë?

Cilët janë shokët besnikë të Skënderbeut?

Në cilat vargje shihet fuqia e Skënderbeut?



Detyrë:

Gjeni figura letrare në këtë fragment të poemës.

Hiperbola

Hiperbola është figurë letrare që zgjon parafytyrime, emocione dhe që i zmadhon veprimet e sendet më shumë sesa janë në të vërtetë, duke përdorur krahasimin për të përforcuar një mendim. P.sh.:

Kur hiq me kordhët të prehtë

Q'ishte si pendëz' e lehtë,

Posi pjepërin e priste,

Në vdekje pa ndjer i klliste,

Njerin' e kalin e çante,

Të dy më katër i ndante!

P.sh. te vjersha “Sulltani”

Dola nga fund i Azisë

Si rrebesh i Perëndisë

Vrava, preva e shkretova

Botën me gjak e mbulova

ROBINSONI NË ISHULL DHE “PESHORJA” E TIJ...

“Këtu më nxori deti më 30 të Vjeshtës së parë...”

Në fillim u mërzita tepër, se do ta humbisja dhe kuptimin e kohës... Për këtë, në anë të një druri fillova të shënoj përditë nga një vijë; vijën e shtatë e bëja kurdoherë dy herë më të gjatë dhe ditën e parë të çdo muaji e bëja edhe më të gjatë. Me këtë sistem pata kalendarin tim të ndarë në javë, muaj e vite.

Midis gjithë atyre sendeve që mora nga anija, shtiva në dorë edhe gjëra pa ndonjë vlerë të madhe, po që më hynin shumë në punë. Këto harrova t’i përmendja më parë si, fjala vjen, pena, bojë, letër etj. që kishin gjetur në kabinat e kapitenit të parë, të kapitenit të dytë, të topçiuat dhe të marangozit; nja tri a katër busulla, që i mora si i gjeta, pa ditur nëse do të më hynin në punë apo jo.

Nuk duhet të harroj se në anije kishim një qen dhe dy mace, që kanë një histori të çuditshme, të cilën do ta tregoj. Të dyja macet i mora me vete, kurse qeni u hodh nga anija në det dhe me not më arriti në ranishte, posa solla ngarkesë e parë. Për shumë vjet me radhë ai qe shërbëtori im besnik, s’linte pa më sjellë asgjë nga ç’kishte mundësi të më sillte.

Thashë se kisha gjetur bojë, pena dhe letra; i përdora me kursimin më të madh dhe do t’jua provoj se mbajta shënim pikë për pikë mbi tërë punët e mia, po, kur m’u mbarua boja, s’munda më të shkruaja dhe, sido që bëra çmos, nuk munda të sajoja bojë tjetër. Meqë më mungonin veglat e duhura, punët shkonin shumë ngadalë dhe kështu m’u desh një vit që ta plotësoja krejt rrethimin e banesës time. Hunjtë, me të cilët e rrethova, qenë aq të rëndë, sa mezi i ngrija dhe më hëngrën një kohë të gjatë për t’i prerë, për t’i shpënë gjer në banesën time. Nganjëherë më duheshin dy ditë vetëm për të prerë dhe për të shpënë gjer në vend një nga këta hunj të trashë dhe një ditë e tërë për ta ngulur në dhe.

Për këtë punë përdorja një dru të trashë: më vonë përdora një qysqi hekuri, po edhe kjo nuk ma pakësoi mundimin tim të madh.

Duke e menduar mirë hallin ku ndodhesha, doemos nuk mund të mos isha i pikëlluar. Tërë vrerin tim e shfrevë në letër. Por sado të pikëlluara të ishin këto mendime, arsyeja ime filloi, pak nga pak, ta mposhte dëshpërimin. Me sa mundesha,

përpiqesha ta ngushëlloja veten, duke menduar se mund ta kisha pësuar edhe më keq dhe krahasoja të keqen me të mirën dhe me një paanësi të plotë.

TË KËQIJAT

Më hodhi fati në një ishull të zymtë e të pabanuar dhe nuk kam asnjë shpresë shpëtimi.

Jam i vetmuar dhe i shkëputur nga tërë bota dhe jam i dënuar të vuaj në mjerim.

Jam i mërguar nga tërë njerëzit, jam i vetmuar, i dënuar nga shoqëria e njerëzve.

Kam fare pak rroba të vishem dhe së shpejti nuk do të kem me se të mbuloj trupin.

Jam i pambrojtur nga sulmet e njerëzve ose të bishave.

TË MIRAT

Por jam gjallë, nuk u mbyta, siç u mbytën gjithë shokët e mi të udhës.

Por shpëtova nga vdekja dhe ai që më shpëtoi për mrekulli jetën, mund të më shpëtojë edhe nga gjendja ime e mjerë.

Por nuk vdiqa urie në këtë vend të shkretë, ku njeriu nuk ka me se të ushqehet.

Por po jetoj në një klimë më të nxehtë ku njeriu mund të rrijë edhe i zhveshur.

Por ishulli ku rashë, është i pabanuar dhe nuk kam parë asnjë shtazë grabitqare, siç pashë në brigjet e Afrikës. Çdo të kisha bërë sikur të kisha dalë në bregdetin e Afrikës?...

Këto shënime tregojnë qartë se zor të ketë rënë ndokush në një gjendje më të mjerë. Megjithatë, kjo kishte në vetvete si një anë pozitive, ashtu edhe një anë negative, për të cilën duhej të isha mirënjohës. Përvoja e hidhur e një njeriu që ka provuar fatkeqësinë më të madhe në botë, tregon se ne mund të gjejmë kurdoherë një ngushëllim, i cili, në bilancin e halleve dhe të të mirave tona, duhet shënuar në të ardhurat.

Kështu, shpirti zuri shpejt të më ngjallej dhe s'më lëshoi zemra. Për ta forcuar edhe më tepër veten, vura në kandar të mirat dhe të këqijat dhe arrita në përfundimin se kishte të tjerë që e kishin pësuar më keq dhe unë mund të kisha mbaruar edhe më keq.

Pra, hoqa dorë nga zakoni që t'ia ngulja sytë detit dhe të rroja me shpresën se mund të dukej ndonjë anije në horizont. Iu përvësua me mish e me shpirt punës, për ta bërë më të rehatshëm banimin tim në atë ishull.

Sbënim

Kjo pjesë është marrë nga romani “Robinson Kruzo” i shkrimtarit anglez Daniel Defo. Autori e shkroi romanin sipas një fakti të njohur, por ai e pasuroi me ngjarje nga përvoja e tij dhe libri pati sukses të madh. Ai lexohet me ëndje e vëmendje të veçantë edhe sot. Në qendër të romanit është ideja e punës krijuese, e besimit, e vullnetit dhe e mençurisë për të triumfuar edhe në rrethana tepër të vështira.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

bëj çmos – bëj çdo gjë të mundshme
qysqi-a – shufër e trashë hekuri, me majë nga njëra anë
kurnac-i – dorështrënguar
vrer-i – hidhërim i madh
shfrej – nxjerr jashtë me vrull atë që ndiej në shpirt, nxjerr mllëfin kundër dikujt
brenjë-a – vuajtje shpirtërore, hidhërim
i, e zyrtë – i errët e pa dritë
i, e mërguar – i larguar nga vendi i tij
shtaz-a – kafshë e egër
bilanc-i – përfundim (ose pasqyrë) që del nga krahasimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve.



Bisedë dhe detyrë



Ç'ndodhi me anijen?
Çka mori Robinsoni me vete?
Cilat ishin të këqijat e cilat të mirat?
Si e maste kohën Robinsoni?
Ç'mendoni: A duhet njeriu të humbë shpresën?

KUR QESHIN FËMIJËT

Kur qeshin fëmijët,
dielli na duket më i madh, më i zjarrtë;
ngjyrë e verdhë e rrezeve
bëhet ngjyrë e artë,
hëna sa një diell ndrin çdo natë.

Kur qeshin fëmijët,
ne e ndjejmë veten më pranë fitoreve;
u buzëqesh fytyra
luleve, traktorëve,
qielli përkulet
e ulet oborreve,.

Kur qeshin fëmijët,
duan të na thonë:
Ecën mirë e bukur puna jonë,
lulet qindfishohen,
shtohet forca jonë,
këngët e fëmijëve qiellin ngjatjetojnë.

Kur qeshin fëmijët,
ne e ndjejmë veten
të shumtë, të fortë.
Barikada jonë rrënjët i ka
nëpër këta fëmijë që qeshin të lumtur,
dhe s'ka rrënjë më të forta në botë.

Kur qeshin fëmijët,
prindërve një dorë u fshin shqetësimet,
Lodhjet bëhen lule,
Këngët s'kanë mbarime,
kur qeshin fëmijët e tokës sime.

Musa Vysbka

Shënim

Vjersha tregon gëzimin e fëmijëve, ajo është plot ndjenja, e shprehur me fjalë të thjeshta, të përditshme dhe me figura të bukura poetike.



Bisedë rreth vjershës

Çfarë vargu ka përdorur poeti këtu?
Në fillim të çdo strofe poeti i përsërit fjalët: “Kur qeshin fëmijët”.
Çka dëshiron të arrijë me këtë?
Është kjo vjershë lirike, epike apo epiko-lirike?
Ç'është vjersha lirike?

POEZIA LIRIKE

Çdo vepër letrare është e shkruar në njërën prej këtyre tri gjinive: lirike, epike dhe dramatike.

Poezia lirike hyn në radhën e krijimeve më të lashta letrare. Ajo u shfaq qysh atëherë kur njeriu mësoi të mendojë dhe të flasë. Ajo në fillim kishte lidhje të ngushtë me melodinë, muzikën dhe vallen. Disa nga këto veti i ka ruajtur edhe sot e kësaj dite.

Poezia lirike ka si objekt të shfaqurit e përjetimeve të vetë këngëtarit a vjershëtarit.

Fjala LIRIKË rrjedh prej greqishtes LYRA. Lyra ishte një vegël muzikore me të cilën grekët e vjetër i përcjellin këngët lirike. Më vonë emri i kësaj vegle muzikore u përdor për të treguar veprat letrare që i përkasin poezisë lirike.

Vetia themelore e poezisë lirike është se këngëtarit ose poeti shfaq përjetimet e veta, si: gëzimet, kënaqësitë, dëshirat, shpresat, dhembjet dhe vuajtjet. Për këtë arsye kjo poezi është quajtur edhe poezi subjektive. Kur poeti lirik është i pikëlluar, edhe natyrën dhe çdo gjë në përshkrimin e vet e paraqet të pikëlluar dhe anasjelltas,

kur ai është i gëzuar çdo gjë e paraqet përmes një gazmendi të pashoq.

Nëpërmjet gjendjes shpirtërore të shkrimtarit ne njohim jo vetëm shkrimtarin, por edhe shtresën, klasën, popullin të cilit ai i takon.

Si shembull poezish lirike mund të marrim cilëndo këngë popullore dashurie, djepi (nina-nëna), dasme e vaji ose një varg vjershash të poetëve tanë, p.sh. “Fjalët e qiririt” e Naimit, “Kënga e rinisë” e Migjenit, “Anës lumenjve” e Nolit. Në librin tuaj keni mjaft këngë lirike, qoftë popullore qoftë të shkruara, si p.sh. “Bukurinë e ballit” (popullore) “Kopshti im” (Çajupi), “Liria” (Mjeda), “Rent, or Marathonmak” (Noli) etj. etj.

Poezia lirike ndahet në lloje të shumëta. Llojet e saj janë: poezia përshkruese, poezia e dashurisë, oda, elegjia, epitafi, epigrafi, poezia patriotike, poezia sociale, himni, poezia satirike, poezia mendimtare, poezia idilike etj. Të gjitha këto më gjerësisht do t’i mësoni në arsimin e mesëm.



ZONJA RINË ARBËRESHA

Buzë detit të Koronit erdhi e hodhi hekurin një anije, që vinte nga larg, që përtej detit dhe sillte për të shitur mëndafshra e stolira grarie. Asnjëra nga zonjat e Koronit nuk zbriti në breg tek kish qëndruar anija. Zbriti vetëm zonja Rinë me shërbëtorët e shërbëtoret e saj. Ajo donte të blinte mëndafshra e stolira për të martuar kumatën.

-Gëzuashi, o detarë! – u tha zonja Rinë.

-Mirë se vjen, zonja Rinë.

-Ku i keni mëndafshrat, o detarë?

-Poshtë në palmetat, zonja Rinë. Urdhëro t'i shikosh e të zgjedhësh.

Ajo zbriti në palmetat e anijes dhe zuri të zgjedhë mëndafshra e stolira për të kumatën; zgjidhte e ua vinte në duar shërbëtorëve e shërbëtoreve.

Po ç'na ndodhi? Ndërkaq detarët zunë të punojnë lehtë-lehtë remat e ta çojnë anijen tej e më tej, në det. Kur u adunar zonja Rinë, anija ndodhej larg bregut e ikte, ikte...

Atëherë zonja Rinë thirri:

-O ju ena, ju detarë! Mbani më ngadalë anijen sa të porosit time kumatë të më ketë kujdes djalëthin. Kur ta lidhë në djep të m'i vajtojë e t'i thotë me këngë: “Qetmu, qetmu, birthi im! Bir, ku të vajti ty jot ëmë?” “Nana ime shkoi në Turqi” “Po ty kush do të japë qumësht? Ah, bir, nderi dhe bukuria e saj janë tani në duart e të ligut! Po ti qetmu, biri im! Qetmu, qetmu e fli gjumë, se ato faqet e nënës sate do të bëhen lule altari. Pastaj gjirin e nënës sate, atë gjirin e saj të bukur, do ta bëjnë pasqyrë që të shihen. Ah, tani nderi dhe bukuria e nënës sate ndodhen në rrezik të madh...”

Dhe pastaj e mbylli këngën e hidhur me këto fjalë:

Biri im – një copë borë –

Është i vogël e do në dorë...

Kështu vajtoi zonja Rinë, pastaj u kthye e iu lut detarëve:

-O detarë, a s'më lini pakëz të ngjitem lart në sterenin e anijes, që të shoh për

të fundit herë shtëpinë time?

Detarët ishin njerëz të vrazhdë, kusarë deti, po dhimbja e zonjës Rinë ua preku atë thërrime zemër që u kish mbetur. Ata e lanë të ngjitet majë anijes që të shohë për të fundit herë shtëpinë në breg të detit të Koronit, atë shtëpi ku kish lënë foshnjën e djepit.

Zonja Rinë hipi lart, pa tokën që po largohej dhe i gufoi zemra. Tha me mendje: “Më mirë e vdekur e me nder sesa e gjallë e pa nder!” Si tha këshut, mbylli sytë dhe u hodh në det. Valët e përpinë menjëherë, ndërsa anija largohej e largohej. Po valët e detit patën mëshirë për kurmin e zonjës Rinë: nuk e mbajtën shumë dhe e nxorën në zall të Koronit.

Atje, në zall, kur zbritën për lojë të varfrat e Koronit, e panë zonjën Rinë të mbytur dhe i puthën dorën – atë dorë të ngurosur që kish qenë krua mirësie. Zbritën dhe zonjat e Koronit, qanë e vajtuan, qanë e iu falën zonjës Rinë, dhe pastaj e varrosën buzë detit. Dhe mbi varr të zonjës rinë mbollën një qiparis.

...Kështu bëri zonja Rinë arbëresha për të ruajtur nderin e vet nga dhuna e të huajit. Kështu bënë edhe motrat arbëreshe kur u dynd në Arbëri sulltan Mehmeti II me tërë ushtrinë e tij të madhe, që, pasi shkatërroi vendbanimet e fushave dhe kodrave, u ngjit gjer në malet e larta, ku ishin tërhequr dhe vazhdonin luftën e tyre arbit e paepur. Po kështu bënë, pas disa shekujsh, ato motrat shqiptare, vashat e nusët sulioete: u zunë dorë për dore dhe, duke kërcyer vallen e vdekjes u hodhën poshtë nga shkëmbinj të lartë që të mos binin të gjalla në dorën e dhunëtarit Ali Pashë Tepelenës. Ato vdiqën të pastra si drita dhe kjo dritë ka përkruar e do të përshkojë shekuj të shumtë, sepse vdekja me nder është më e ëmbël sesa jeta në dhunë e robëri.

Mitrush Kuteli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

Koroni – qytet në More, i banuar që nga kohët e moçme nga shqiptarët. Kur turqit e pushtuan Koronin një pjesë e shqiptarëve të atjeshëm u hodhë në Itali.

palmetë-a – zbukurim që i ngjan gjethit të palmës

qetmu – afrohu, qasmu

altar-i – (këtu) simbol i sakrificës

steren-i – pjesë e anijes, pjesë e sipërme, maja e anijes

kusar-i – njeri që vjedh, plaçkit e grabit me dhunë

kurm-i – shtati, trupi

qiparis-i – dru mesdhetar me trup të drejtë, me gjethe të vogla përherë të blerta, selvi.



Bisedë rreth tekstit

Ku është zonja Rinë dhe nga është?
Çka donte të blinte Rina në anije?
Çka bënë detarët?
Çka u tha detarëve Rina dhe çka e porositi kunatën?
Përse kërcëu Rina nga anija dhe ku e shpunë valët e detit?
Kush bëri më vonë veprime si të Rinës?



Detyrë

Cilët janë arbëreshët, çka dini dhe çka keni lexuar për ta?



...DHE FENIKSI PËRSËRI FLUTUROI

*“Edhe nëntëdhjetë e nëntë herë po të biem,
ne duhet të ngrihemi përsëri!”*

Dhe u sulën mbi Feniksin e urtë
tufanët, korbat, uria
E rrahën, e kapën, e molisën
dhe mortja përmbi i qëndroi,
po ai prapë fluturoi.

Dhe i ranë Feniksit të gjorë
me gurë, me plumb, me zjarr
dhe qafën ia vunë në litar.
As “of”, as “lele”, as “lot”;
Të vërtetën nuk e vritnin dot!

Dhe e ndollën Feniksin zemërbardhë
me bukë, me gjellë “perëndie”,
S’i preku, s’i erdhën për shije,
i flaku të gjitha, për besë,
veç kores së njomur me djersë.

Dhe e shpunë Feniksin martir
në zjarr. – Të digjet – thanë. – Të humbasë!
Po hiri i tij e përvëloi
Dhe vazhdën e ndritur la pas.
Feniksi përsëri fluturoi.

Agim Vinca

Shënim

Kjo poezi (vjershë) i është kushtuar atdhetarit dhe Mësuesit të Popullit, Petro Nini Luarasit, i cili me veprimtarinë e tij u bë shembëlltyrë e qëndresës në luftën për çlirimin e Atdheut. Feniksi simbolizon ringjalljen, rilindjen dhe fitoren e popullit shqiptar mbi armiqtë.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

Feniksi – zog përrallor që sipas mitologjisë, kishte vetinë që të digjej dhe të ringjallej përsëri nga hiri i vet
 molis – lodh, ligështoj
 i, e gJORë – i mjerë, i shkretë
 flak – hedh tutje, dëboj, përzë
 martir-i – dëshmor
 vazhdë-a – shenjë, vragë, vijë.



Bisedë rreth vjershës

Si u sollën armiqtë ndaj Feniksit?
 Si qëndroi ai ndaj këtyre sulmeve?
 Ç'symbolizon Feniksi?
 Ç'kuptoni me vargun “Të vërtetën nuk e vritni dot”?



Detyrë

Ndajini vargjet në rrokje. Tregoni çfarë rime është përdorur dhe ku bien thekstat ritmikë në vargjet e strofës së parë.

PLAKU ZEMËRBARDHË

Gjithçka e tij ishte e bardhë. Edhe mjekra. Edhe mustaqet. Edhe flokët. Edhe plisi. Edhe tufa e deleve. Edhe shtëpiza... Edhe...

Por më e bardhë ndër të gjitha ishte zemra e tij.

Vërtet atë nuk ia kishte parë askush. Por tjetër zemër nuk mund të kishte ai, i cili tërë jetën ishte përpjekur që çdo gjë rreth tij të ishte e bardhë si qumështi që milnin për drekën baritore.

Prandaj e quanin të gjithë Plaku Zemërbardhë, kurse emrin e tij të vërtetë kishte shumë fëmijë që nuk e dinin.

Zemra e tij ishte e bardhë dhe e madhe, në të kishte vend për shumë, shumë dashuri.

Tërë pranverën e kalonte duke shartuar. Nuk kishte fidan të egër që mund t'i

shpëtonte syrit të tij. Për të nuk kishte: kjo është ara ime, ajo është e huaj. As ky është livadhi im, ai i tjetrit. As: ç'më duhet mua të punoj në tokë të fshatit?

- Mjaft shartove, xhaxha! – i thoshim nganjëherë.

- Jo, fëmijët e mi, nuk është mjaft – përgjigjej. – Dua që çdo pëllëmbë tokë të jetë me pemë. Dua që, kur të vijë behari, tërë fshati të duket i bardhë.

I pëlqente të shartonte, sidomos anës rrugëve dhe afër krojeve.

- Kalojnë këtej udhëtarët e lodhur dhe të etur duke vjelë pemët e arrira.

Ne rriteshim me shembullin e tij të punës dhe të dashurisë. Ai plakej, vinte dita-ditës duke u bërë edhe më i bardhë. Dhe sa më tepër e ndiente peshën e pleqërisë, aq më tepër ngutej të punonte.

-Jeta kalon shpejt, - na thoshte. – Pas mbeten vetëm puna dhe mirësia.

Një ditë, diku në të hyrë të vjeshtës, Plaku Zemërbardhë nuk u duk me tufën e deleve. Të gjithëve na theri diçka në zemër. Ku nuk na shkoi mendja. Ishte plak dhe mund t'i ndodhte ndonjë e keqe. As lozëm, as qeshëm. Tërë ditën vetëm për të folëm.

Kur u ktheva në shtëpi, babanë dhe xhaxhanë i gjeta rreth oxhakut. Dukej se bisedonin diçka të rëndësishme. Thashë: - Hajt t'i dëgjoj, mos po flasin për Plakun-Zemërbardhë. U ula në një kënd tërë sy e veshë.

- Kujt i kishte shkuar mendja tek ai?! – thoshte babai. – Atë as e thirrën në mbledhje! Plak i mbetur! Pa fëmijë dhe nipa për shkollë! Njeri që fort rrallë e sheh midis burrash, që pothuaj tërë jetën e ka kaluar pas deleve dhe me kalamajtë!Ja, mu ai, nga i cili s'është pritur asgjë, të ngrihet dhe të thotë: “Burra, unë po e lëshoj odën time për fëmijët. Ato dy vajza që pata, i martova. Tani vetëm me plakën jam. Mundem edhe pa të. Le të hapet shkolla, le të ndritë mendja e fëmijëve, të cilët i dua si të ishin të mitë”.-

Kështu tha? – u habit xhaxhai.

- Kështu, - u përgjigj babai. – Të gjithë ia shtrënguan dorën burrërisht dhe e falënderuan për të mirën që po i bënte fshatit.

E kuptova, flisnin për Plakun Zemërbardhë. U gëzova shumë që nuk i kishte ndodhur ndonjë e papritur? Por këtë punën e shkollës nuk e kuptova mirë.

- Babë, ç'u duhet fëmijëve oda? – pyeta.

- Për shkollë, - u përgjigj ai prerë. – Duhet ta festojmë sontë. Edhe fshati ynë do të bëhet me shkollë.

Nuk e zgjata. Fjala shkollë më shqetësoi pak. Kjo ishte diçka e panjohur. Mirëpo, kur kujtova se do të hapej në odën e Plakut Zemërbardhë, u çela menjëherë. Ai nuk do të lëshonte odën për diçka të keqe.

Të nesërmen Plaku Zemërbardhë qe tërë ditën me ne...

Edhe në shkollë ai ishte midis nesh. Pushimeve na sillte ujë të ftohtë. Për të

na provuar zgjuarsinë, shpesh na pyeste sa bëjnë kaq edhe kaq, kaq herë kaq, kaq pa kaq. Ai që gabonte, merrte një thumb pas.

- Ore, po ta dija kështu, nuk do të lëshoja odën, - na thoshte ndonjëherë me shaka. – Po si e harruat fare xhaxhanë? Kam mbetur fillikat. S’po më shkohet më andej nga Lugjet.

- Si i ke shartimet, xhaxha?
- Patën lule ato te Lugshtaja?
- Kanë lidhur ato në kodër?
- Ngjitemi sot pasdite deri te lëndinat?

Na përgjigjej me buzë në gaz. Por ngjitej andej gjithnjë e më rrallë.

Ndoshta nga pleqëria, mendonim.

Mund të ketë qenë kështu, por edhe mund të mos ketë qenë. Me sa dukej, atje nuk i shkohej pa ne. Na kishte dashur më tepër se qengjat, se zogjtë, se hijet, se krojet, se filizat e njomë...

Për ne kishte pasur më tepër vend në zemrën e tij të bardhë.

Arif Demolli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

plis-i – qeleshe

drekë baritore – drekë e barinjve

shartoj – veprim që u bëhet pemëve për t’i bërë të buta e pjellore.

i arrirë – i pjekur sa duhet (për frutat)

çelem – këtu: bëhem i qeshur në fytyrë

thumb-i – këtu: thënie që të ther, shaka, tallje

fillikat – vetëm, pa njeri, pa asnjë tjetër

kanë lidhur – këtu: kanë zënë kokërr



Bisedë rreth tekstit

Si e përfytyroni Plakun Zemërbardhë? Ku jetonte ai dhe ç’punë bënte?

Si sillej Plaku Zemërbardhë me fëmijët dhe përse këta e donin shumë?

Vallë Plaku Zemërbardhë mendonte edhe për të tjerët? Ku shihet kjo?

Të “Plaku zemërbardhë” ka edhe elemente ekologjike, ku shihen ato?

Si mendoni, cila është njëra ndër punët më të mira në tekst?



Detyrë

Bëni me shkrim portretin e Plakut Zemërbardhë. Përkthyeri pamjen e tij të jashtme, ndjenjat dhe mendimet e tij.

RINISË

Zemrat i mbush me bukurinë e përjetshme t'lumnisë,
me harresë t'këndshme vuejtjet i mbulon...
Hap rrug't e reja – në ditët e territ e t'zisë –
me ravat e thella t'gëzimit rrëgallat e jetës lavron.
Nëpër shtigje t'reja rrugë shpëtimi i çel,
me ato fuqi që ti njeh për bukuri:
çdo ar'e plleshme nga ti asht mbjellë,
prej kah do t'mbijë fara e re me t'reja brezni.
Fuqia jote jeton me shekuj e rritet gjithmonë,
kthjellohet, gufon, vlon – ky burim gëzimi
i jetës së re! – O, e dashura rinia jonë!...
- n'orët e shekujve ndëgjoj at'far' kumbimi.
Gërshetohet kënga e përherhme mbi t'madhnueshmen rini
–Ty, që ke le bashkë me këtë jetë!
- O, ti gëzim i vetëm i jetës, o ti lavdi,
para lumnisë sate fort n'habi kam mbetë!

Esad Mekuli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

ravë-a – rrugë e hapur që më parë në të cilën duhet ecur; drejtim, ulbi,



Bisedë rreth vjershës

Temë e kësaj poezie të Esad Mekulit është rinia. Poezi me këtë temë ju sigurisht keni lexuar edhe më parë. A ju kujtohet ndonjë? Cilat nga vargjet e kësaj vjershe ju duken më të qëlluara dhe pse? Pse poeti i jep aq rëndësi të madhe rinisë?



Detyrë

Gjeni mjetet letrare që përdor poeti në këtë poezi dhe shpjegoni kuptimin e tyre.



Esad Mekuli
(1916-1993)

Esad Mekuli është shkrimtar veteran i letërsisë sonë dhe punëtor i palodhur kulturor dhe shkencor. Lindi më 1916 në Plavë. Gjimnazin e kreu në Pejë, ndërsa Fakultetin e Veterinës në Beograd. Si krijues letrar i takon brezit të shkrimtarëve të viteve tridhjetë.

Më 1955 ka botuar përmbledhjen e poezive “Për ty”. Më vonë u botuan dhe u ribotuan përmbledhjet “Dita e re”, “Avsha Ada”, “Vjersha”, “Brigjet” etj. Ka qenë kryetar dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.



ASKUSH NUK DI TË LEXOJË NË FSHAT

Bariu mbeti i shtangur me letër dhe florinj në dorë. Nuk dinte se ç'të bënte tani. Ushtari me fytyrë të qeshur i tha fjalët më të rënda që kanë dëgjuar ndonjëherë veshët e mi: Kjo gjë ishte sekrete dhe po të dëgjonte ndokush, që të dy mund të mbesin pa kokë!...

“Si t'ia bëj tani?...” – mendoi edhe pak dhe letrën e futi në kraharor, kurse-florinj të i futi shpejt e shpejt në një gropë në rrënjë të plepit të gjatë qindvjeçar.

Në mbrëmje, kur u kthye grigja në fshat, nisi të pyesë tërthorazi të zotin e shtëpisë, ku bunte atë natë, se cili nga fshatarët ishte më i shkolluari.

- Më i shkolluari?! – u step fshatari. – Çfarë të shkolluarësh! Ne as që kemi parë me sy si duket shkolla.

- Domethënë askush nuk di të lexojë në fshat?! – pyeste djaloshi, thuajse nuk i besonte.

- Askush...

- As kryeplaku?

- As ai.

- Përse nuk ka shkuar dikush nga fshati të shkollohet në qytet? – pyeste Bariu si të ishte i xigëluar e i etshëm për dituri.

- Në tërë qytetin është vetëm një shkollë. Aty nuk ka vend as për të gjithë fëmijët e pasanikëve, e jo më për ne fshatarët... po mirë jemi, o Bari! Ç'na duhet neve shkolla? Jemi fare të ndarë nga bota...

Bariu kafshoi buzët me hidhërim. Atij i duhej shumë në këtë çast shkolla, njohja e alfabetit, e shkrim-leximit. I vinte gati të pëlcase kur flisnin për të aq gjakftohtë.

- Por, ja, dikush të shkruan një letër dhe nuk di ta lexosh. A nuk të vjen inat për këtë? – iu drejtua djaloshi si i ringjallur.

- Përse të më vijë inat? Nuk kam nevojë të më shkruajë askush.

- Fjala vjen, djali të shkon ushtar dhe të shkruan nga ushtria...

- Nuk ka nevojë, - ia priti fshatari me bulçinj të fryrë – As unë nuk i kam shkruar babait, as babai im nuk i ka shkruar gjyshit, po ç'më duhet mua të më shkruajë djali?

Bariu pa se do të ishte gjë e kotë të vazhdonte bisedën me të. Megjithatë nuk duroi pa e thënë atë që ndiente në zemër:

- Jam i bindur se do të ishte më mirë po të ishim të shkolluar...

Atëherë fshatari qeshi dhe iu afrua më shumë. Bariu e kuptoi se më në fund do ta hapte zemrën dhe do t'i fliste të vërtetën.

- Mbreti nuk do që ne të shkollohemi, - i tha ai me zë të qetë e sy të picërruar.

- Atij nuk i pëlqen të ndajë asgjë nga pasuria për shkollat e popullit. A e kupton tani? Ata që kanë kërkuar shkollë si ti, kanë humbur edhe kafshatën e gojës e disa edhe kokën... Prandaj hesht e mos fol më...

Bariu uli kokën. Iu duk sikur fshatari me këto fjalë i thoshte: "Më mirë është të mendosh për bagëtinë sesa për shkollën!..." Bariu nuk foli më asnjë fjalë. Ra në gjumë pa ngrënë darkë...

Në dhomë ku kishte rënë Bariu depërtonte drita e zbehtë e hënës. Ajo thujse shikonte me dhembshuri që nga larg dhe përpitëj t'i ndihmonte djaloshit, të derdhte tërë nurin e saj, ta shndriste letrën që e kishte nxjerrë nga kraharori dhe e shikonte me sy të menduar. Por ndihma e saj ishte e kotë. Bariu nuk kuptonte asgjë nga kjo letër e gjatë, e shkruar me kujdes, me shkronja mjaft të bukura për vjetët e një princeshe të vogël.

"Përsë kështu? – mendonte me vetvete: - Çfarë porosie më përcjell me këtë letër?..."

Mendimet venin e vinin, por kursesi të qetësohej zemra e tij. Atë natë Bariun nuk e merrte gjumi. Bariu më kot e mbante në kraharor letrën, sepse mund të kalonte edhe dyzet fshatra e të mos gjente askënd që dinte të lexonte...

Qamil Batalli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

sekret-i – gjë e fshehtë

bulçi-a – ana e brendshme e faqes



Bisedë rreth tekstit

Çka keni kuptuar nga ky tregim?

Cila është tema e tij?

Kush ishte shkaktar për gjendjen e mjeruar të arsimit në atë kohë?

Cili është personazhi kryesor.

Çka e mundon atë?

Kujt nuk i pëlqente shkollimi i popullsisë në atë kohë?



Detyrë

Shkruaj një hartim me këtë temë: "Shkolla është dritarja e jetës".

KLITHMA

Tërru u derdh, e një rigë e praruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngri poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet. Çdo gjë është strukur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit.

E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues.

Një klithmë u dëgjua!

Korbi krokati.

E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë.

Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan. Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë.

Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte preja e korbit.

Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

Anton Pashku

Sbënim

Tregimi i Anton Pashkut është shkruar me një gjuhë të bukur, të figurshme, që i afrohet shumë poezisë. Është shkruar me një stil të bukur. Secila vepër, secili shkrimtar e ka stilin e vet të veçantë.

Stili është tërësia e figurave, veçantia e shprehjeve dhe e thurjes së një vepre letrare.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

rigë-a – shi i imët dhe i hollë, vesë shiu

kreshtë mali – pjesë e sipërme e një mali

bulk-u (bulkth) – kandërr (insekt si karkaleci i vogël me krahë të errët)



Bisedë rreth tekstit

Si përshkruhet natyra në këtë tregim në fillim?

Ç' simbolizon kroatatja e korbit?

Si përshkruhet natyra në fund të tregimit?

Si e përshkruan shkrimtari vuajtjen e popullit të vet?



Detyrë

Tregoni ç'e dallon këtë tregim nga një poezi: gjuha, shprehja apo forma.



Anton Pashku
(1937-1995)

Anton Pashku është njëri ndër prozatorët dhe dramaturgët më të njohur të sotëm shqiptarë. Ka lindur në Grazhdanik të Hasit më 1937. Veprat e tij më të njohura në prozë janë: “Kjasina”, “Një pjesë e lindjes”, “Oh” dhe dramat “Gof” e “Sinkopa”. Anton Pashku vdiq në Prishtinë më 1995.



HAPMA DERËN ZONJA MËMË

Edhe sivjet, moj nënë,
nga mërgimi i shkretë,
më dogji malli për ty.
Unë e di që ti e pritje
birin tënd të largët,
e qave fshehurazi
kur s'pate mundësi ta përqafoje.
Ndjemë, o e paharruara,
mos qaj, pse mjafton sa qave
për bijtë gjatë shekujve.
Ti e di, nënë Shqipëri,
që unë s'kam asnjë faj
nëse jetoj larg teje,
ashtu ka qenë fati i shkretë,
e është kot t'i kujtojmë hallet.
Erërat kanë fryrë mbi mua,
dëborat kanë rënë mbi mua,
si edhe mbi kokën tënde,
por përmes erërave e dëborërave
fytyra jote e largët
më forcoi e ngushëlloi.
Ti paske qenë dhurata
që nuk e bleva në pazaret,
por më vinte nga gjaku,
gjithmonë e kërkuar
te vorbulla e jetës endacake.
U krenova me legjendat e tua,
dashurova me fjalët e tua,
qava me vajtimet e tua,
E tash në buzë të së kaluarës e së ardhmes

i drejtoj ende sytë nga ti,
 e prej së largu ndjek emrin tënd
 dhe orvatem ta mbaj lart.
 Lëri dyshimet e mos mendo
 që unë do të doja të kisha
 një pretendim të padrejtë privilegji,
 unë do të doja vetëm të isha
 biri yt, si të tjerët.
 Ashtu unë e di
 e i ardhur nga lufta e jetës,
 unë i bie derës sate:
 Hapma derën, zonja mëmë,
 se yt bir jam unë, o nënë.

Vorea Ujko



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

e dogji malli – e bëri të brengoset e të vuajë shumë
 vorbulla e jetës – vala e rrëmbyeshme që të merr me vete gjatë jetës
 së mbushur me përpjekje, gëzime e hidhërimë



Bisedë rreth vjershës

Si është përshkruar malli dhe dashuria për atdheun e të parëve të tij?
 Ç’ e shtyn poetin të rikthehet në atdheun e të parëve?
 Çfarë lloj vjershe është kjo?
 Si i kuptoni vargjet:

“Ti paske qenë dhurata
 që nuk e bleva në pazaret
 por më vinte nga gjaku,
 gjithmonë e kërkuar
 te vorbulla e jetës endacake”.



Detyrë

Gjeni figurat letrare në vjershë dhe diskutoni në klasë si janë ndërtuar ato.

NICA KUJTON

Unë nuk e di i cilës ushtrie je ti, sepse asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrisë dhe tani jam shumë plakë për t' i mësuar, por ti je i huaj dhe i një prej atyre ushtrive që na kanë vrarë. Ti ke zanatin e mallkuar të luftës dhe je një prej atyre që më kanë bërë mua gjysmënjeriu, një copë plakë të shushatur, që vjen në këtë dasmë të huaj dhe rri në qoshe dhe lëviz buzët, duke biseduar me ty. Asnjëri nuk e di ç' them unë, sepse të gjithë janë shumë të gëzuar dhe unë nuk dua t' ua prish gëzimin të tjerëve. Ngaqë nuk dua të prish gëzimin, po rri këtu në qoshe dhe lëviz buzët, duke mallkuar ngadalë, që të mos dëgjojë njeri. Dua të di përse erdhe ti në këtë dasmë dhe si të bënë këmbët që erdhe. Po nuk të pyes dot, se nuk dua të shqetësoj njeri. Pse nuk ngrihesh, të hedhësh kapotën krahëve dhe të ikësh në shi andej nga erdhe? Nuk e kupton që je i tepërt këtu, o i mallkuar?

Ti e kupton vetë që je i tepërt këtu. Ti e ndien që një njeri po të mallkon në këtë dasmë, se mallkimi i nënës nuk vete dëm kurrë. Megjithëse të nderojnë, ti e kupton se nuk duhet të vije këtu. Mundohesh të fshehësh atë që kupton, por nuk e fsheh dot. Të dridhet dora kur ngre gotën e rakisë dhe në sy të kalojnë hije plot frikë.

Thonë se ti mbledh të vrarët e vendit tënd. Mbase ke mbledhur shumë dhe do të mbledhësh akoma shumë të tjerë, mbase do t' i mbledhësh të gjithë, por dije se njërin nuk ke për ta gjetur kurrë në jetë të jetëve, ashtu si në jetë të jetëve unë nuk do t' i gjej më kurrë vajzën time dhe burrin tim. Sa do të doja të tregoja për atë që ti nuk do ta gjesh dot kurrë, por nuk e bëj, sepse nuk dua t' u kujtoj të zezat e luftës këtyre dasmorëve. Ç' shi që binte atë natë, më tepër se sonte. Uji buronte nga nata. Megjithatë, unë e hapa gropën. Po nuk do të tregoj asgjë, për të mos prishur gëzimin e të tjerëve, qoftë dhe gëzimin tënd, i mallkuar.

Më thanë se ti pyete veçanërisht për të. Siç duket keni kohë që e kërkon dhe nuk e gjeni dot. Po përse ke pyetur dhe e ke kërkuar kaq shumë atë kolonel të zi? Mos vallë e ke pasur mikun tënd? Me siguri e ke pasur mik, përderisa e kërkon kaq shumë. Gjithë mbrëmjen nuk lanë njeri pa pyetur në fshat. Sepse të gjithë e dinë se ai dergjet në dhe, diku këtu rrotull, por asnjërit nuk ia merr mendja ku ndodhet ai. Do të ikësh pa e marrë mikun tënd, mikun tënd të zi, që më sterrosi jetën. Të ikësh sa më parë, sepse edhe ti je i mallkuar si ai. Tani rri i urtë si një qengj, dhe të

qesh buza tek shikon se si kërcejnë njerëzit, por unë e di se ç'ke në mendje. Ti mendon si do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh dhe të na vrasësh, siç bënë shokët e tu. Nuk duhet të vije në këtë dasmë. Të të dridheshin gjunjët kur të niseshe për këtu. Së paku për hirin tim, të mua plakës së shushatur, të mua gjëmëzezës. Por ç'bëhet kështu? Ty po të ftojnë në valle? Dhe ti guxon të ngrihesh? Po vë buzën në gaz! Po ngrihesh! Daleni! Ç'bëni kështu! Kjo është e tepërt! Gjynah nga zoti!

Ismail Kadare

Shënim

Kjo pjesë është shkëputur nga romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare. Romani u botua për herë të parë më 1963. Ngjarjet në këtë roman ndodhin pas Çlirimit, kur gjenerali ishte ngarkuar nga qeveria e tij të tërhiqte eshtrat e ushtarëve fashistë të rënë në Shqipëri në kohën e pushtimit. (Nënës Nicë batalioni ndëshkimor i kolonelit Z. ia kishte varur të shoqin. Pastaj i thanë eshtrambledhësit se koloneli i mori vajzën e saj në çadrën e tij dhe se vajza ishte katërmbëdhjetë vjeçe kur u mbyt në pus, pa arritur akoma në shtëpi, tek po kthehej në mëngjes herët nga çadra e kolonelit. Pikërisht natën tjetër koloneli u zhduk. Thoshin se ai shkoi përsëri natën te shtëpia e Nicës, sepse nuk e dinte që vajza kish vdekur dhe roja priste përjashta. Pastaj ai vonoi shumë, shumë më tepër nga ç'duhej, por roja kishte urdhër të priste gjer në agim. Kurse në mëngjes në shtëpi nuk kishte njeri dhe asnjëri nuk mori vesh ku shkoi koloneli. Z. Disa thonin të tjera gjëra, kurse vetë oficerët e batalionit heshtnin dhe batalioni iku të nesërmen më tutje.)

Nga kapitulli XVI është shkëputur vetëm monologu i nënës Nicë, fjalët e shpirtit të saj të përvëlur, që u shqiptuan me gjysmëzëri nga goja e nënës. Dhe këtu na paraqitet monologu i brendshëm.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

në jetë të jetëve – përgjithmonë

pis i zi – shumë i zi

më sterrosi jetën – më solli shumë të këqija dhe hidhërimi,
ma nxu jetën

për hir të... - për hatër të...

gjëmëzezë – grua që ka pësuar fatkeqësi



Bisedë rreth tekstit

Prej ku u nisën gjenerali dhe prifti dhe me ç'qëllim?

Ku e njohu Nica gjeneralin?

Çfarë ndjenje e kaploi në atë moment?

Pse nëna Nicë nuk do që t'ua prishë gëzimin dasmorëve, ku thotë:

“Ngaqë nuk dua të prish gëzimin, po rri këtu në qoshe dhe lëviz buzët, duke mallkuar ngadalë, që të mos dëgjojë njeri”.



Detyrë

Përshkruani me fjalët tuaja gjendjen shpirtërore të nënës Nicë.

Monologu i brendshëm është njet letrar me anë të të cilit shprehen ndjenjat dhe gjendja e brendshme shpirtërore e personazhit duke kuvenduar me vetveten.

Tema dhe ideja

Përmbajtja e çdo vepre përbëhet nga dy anë themelore: nga Tema dhe Ideja poetike. Të dyja këto formojnë një tërësi tematike-ideore të pasbkëputshme, e që, megjithatë, janë të dallueshme dhe secila luan një rol të veçantë në veprën letrare.

Çdo vepër, në përputhje me botëkuptimin, me interesat, me prirjet e shkrimtarit, pasqyron një anë të veçantë, një problem të caktuar të realitetit.

Tema është pasqyrimi me figura artistike i një ane të caktuar të realitetit.



Ismail Kadare

Ismail Kadare lindi në Gjirokastrë më 1936. Mësimet e para dhe ato të mesme i mori në vendlindje, ndërsa studimet universitare, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Universitetin e Tiranës. Letërsinë e ka specializuar në Moskë. Ka punuar në shumë redaksi të gazetave e revistave dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Është figura më komplekse dhe më madhore e letërsisë bashkëkohore shqiptare. Shkruan poezi, tregime, novela, romane, kritikë letrare, studime, udhëpërshkrime, etj., për të rritur e herë edhe për fëmijë. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Veprat letrare: “Ëndërrime”, “Princesha Argjiro”, “Shekulli im”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Kronikë në gur”, “Dimri i madh”, “Ura me tri harqe”, “Koncert në fund të dimrit”, “Pallati i ëndrrave” etj.

LAMTUMIRË!

Lamtumirë, vendet e mia,
qe, po zhduken dalëngadalë!
Gjëmon deti, ushton duhia,
likundet barka valë mbi valë,
Kah njai diell, që asht tue flakue,
andej fill un tash do t'vete...
Lamtumirë, atdhe i bekue!
Lamtumirë, për sa t'jet jeta!
Nesër nade kur mbi ne,
rrezja e diellit ka me ra,
kush e din sa ujë e dhe,
mue prej teje ka me m'da!
E por n'pyetsha ret mizore,
e por n'pyetsha zogjt e detit,
se për ty, moj tokë arbnore,
s'ka me m'folë kush mue t'shkretit...
Tjera fusha e tjera zalle
kam me pa, e tjera dete;
kam me ndje po tjera valle,
tjera gjuhë, tjera qytete.
Vendin tem s'kam me e pa,
ku kam le e jam burrnue:
sytë e mi kan me kja.
pa u gjet kush me i ngushllue.

Gjergj Fishta

Sbënim

Vjersha “Lamtumirë”: (ose “I dbuemi”) është një ndër vjershat më të bukura lirike të Gj. Fishtës. Në të poeti jep dhembjen e thellë dhe dashurinë e zjarrtë për atdheun, nga i cili largohet pa dëshirën e tij.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

duhi-a – furtunë, stuhi, shtrëngatë

tue flakue – duke u skuqur flakë

nade – herët në mëngjes

me kja – qaj

dekun – vdekur

caran-i – guri i vatrës

jam burrnue – jam bërë burrë



Bisedë rreth vjershës

Ç'mendime dhe ndjenja ngjallen tek “I dëbuemi” kur fillon e largohet nga atdheu?

Tregoni idenë kryesore të vjershës.

Gjeni dhe shpjegoni figurat letrare që përdoren në këtë vjershë.

Sa rrokje ka vargu dhe si rimojnë vargjet?



Detyrë

Bëni një hartim me temë: “Malli për atdhe”



VILHELM TELI

dramë

(Pjesë nga akti II, skena III)

(Një lëndinë me pak pemë. Nga larg dallohet një kapelë e vendosur mbi një hu. Është kapela e sundimtarit të vendit. Para saj duhet të përkulen gjithë banorët që kalojnë andej. Për këtë qëllim pranë kapelës janë vendosur dhe roje.) Personazhet kryesore në këtë pjesë janë:

Vilhelm Teli – fshatar, shigjetar i zoti

Valteri – i biri

Gesleri – sundimtari i vendit

Frishardi etj. – roja.

Valteri: O babi, shih kapelën (kësulën) përmbi hu!

Teli: Pa lëre tash kësulën. Eja, shkojmë!

(Kur do të shkojë, i del përpara Frishardi, duke i drejtuar ushtë).

Frishardi: – Në emër të Kaizerit! Ndaluni!

Teli: (Ia kap ushtë). Ç'kërkon prej meje dhe përse më ndal?

Frishardi: – Ke shkelur urdhrin. Eja pas nesh!

Leutoldi: – Nuk iu përulë me nderime kësulës.

Teli: – Lëshomë or mik, të shkoj!

Frishardi: – Në burg, në burg!

Valteri: – Në burg tim atë! Ndhimë! Ndhimë!

(Duke thirrur në skenë).

Nxitoni, miq të mirë, e na ndihmoni!

Kërkojnë të burgosin babin tim!

Roselmani: – E ç'e ndalon atë njeri?

Frishardi: – Është tradhtar, armik i Perandorit!

Teli: – (E kap dhe e shkund). Unë tradhtar!

Roselmani: – Gabohesh! Është Teli, një qytetar i ndershëm e zemërbardhë.

(Gesleri, sundimtari, në kalë dhe një radhë e madhe trimash të armatosur, të cilët e rrethojnë skenën me një gardh ushtarësh.)

Gesleri: – Hapuni!

Ç'është ky rrëmet i madh? Kush thirri ndihmë?

(Heshtje e gjithanshme.)

Kush qe. Kërkoj ta di! (Frishardit.) – Ti eja këtu! Kush je dhe ç'e ke zën' atë njeri?

Frishardi: – Zotni i lartë, jam ushtari yt dhe po rri rojë ndaj kësulës sate.

Këtë njeri e kapa në ecje e sipër tek mohoi t'i falet kësulës, pas urdhrit tënd.

Kam dashur ta burgos.

(Pas një heshtjeje.)

Gesleri: – Keq, keq, o Tel, e urreke mbretin tënd, e mua që sundoj në vend të tij. Do t'ia mohosh nderimin festes, që unë e vara të provoj të botës bindje?

Qëllimin tënd të keq ta mora vesh.

Teli: – Më fal, i dashur zot! Prej pakujdesisë ka ngjarë, jo prej mospërfilljes sime. Të qenksha i mençur, nuk më thoshin Tel. Më fal, po tjetër herë nuk e bëj.

(Pas një heshtjeje.)

Gesleri: – Tel, flitet se në hark je mjeshtër i zoti dhe në nishan vë bast me cilindo.

Valteri: – Është e vërtetë. Im atë, o zot, qëllon një mollë njëqind çape larg prej drurit.

Gesleri: – Yt bir është ky. Tel?

Teli: – Po, zotni.

Gesleri: – A, ke të tjerë syresh?

Teli: – Dhe një tjetër.

Gesleri: – Dhe prej të dyve, cilin do më shumë.

Teli: – Njësoj më dhimbsen të dy bijtë, zotni.

Gesleri: – E po, Tel, pasi mundke të qëllosh një mollë njëqind çape larg prej drurit, provoma mjeshtërinë. Rroke harkun. Ja tek e paske. Bëju tash gati! Një mollë të qëllosh mbi kokën e djalit. Të këshilloj ta mbash nishanin mirë dhe mollën ta qëllosh që me të parën, se po e humbe rastin, humbe kokën.

(Të gjithë japin shenja tmerri.)

Teli: – Zot, ç'urdhër të llahtarshëm po më jep! Si të qëlloj mbi kokën e tim biri! Jo, i dashur zot! S'e pate me gjithë mend! Na ruajtë zoti! S'e pate me gjithë mend të duash gjë të tillë prej një prindi.

Gesleri: – Një mollë do qëllosh mbi kokën e djalit! Ma kënda dhe të urdhëroj!

J. Fridrih Shiler

Shënim

Kjo pjesë është nxjerrë nga drama "Vilhelm Teli" e shkrimtarit të madh gjerman Johan Fridrih Shiler. Drama u shkrua në vitin 1804. Tema e saj është marrë nga kryengritja e popullit zviceran kundër

pushtimit austriak.

Në të shprehen qartë idetë demokratike të Shilerit.

Në këtë pjesë tregohet për shigjetarin e aftë V. Teli, i cili, pasi nuk përkulet para kapelës së sundimtarit, urdhërohet të qëllojë mollën mbi kokën e djalit.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

ushtë-a – heshtë, shtizë

nishan-i – këtu: shenja që duhet të qëllohet kur shtien

regëtin – dridhet (zemra), qan me zë të ulët

të mbash nishan – të qëllosh në shenjë

nuk e pate me gjithë mend – nuk e pate me të vërtetë (ndoshta bën shaka)

ma kënda – këtu: ma ka qejfi, më pëlqen



Bisedë rreth tekstit

Pse Gesleri kërkonte të nderohej kapela e tij? Cilin kërkonte të poshtëronte ai me këtë urdhër dhe si vepron V. Teli?

Si e jep autori figurën e tiranit Gesler, që arrin deri atje sa të tallet me ndjenjat e dashurisë atërore?

Ç'dënim i jep TELIT?

Ç'ndjenja e pushtojnë Telin kur dëgjon vendimin e tiranit?

Pse të gjithë japin shenja tmerri kur dëgjojnë fjalët e Geslerit?



Detyrë

Përshkruani në fletoren e detyrave skenën e llahtarshme që ju del përpara nga një anë tirani me shpirt mizor, nga ana tjetër, prindi tej mase i tron-ditur, që me hark në dorë duhet të qëllojë mollën mbi kokën e djalit.

Gjejini dhe lexojeni këtë vepër interesante.

LULEVE QË VALVIT ERA

Fryu era e maleve
dhe rrëzoi hijen e lisit:
gjaku im mbetet lumit t'Vodhit!
Ushtarë, m'hapni shtatoren
që të shoh edhe një herë
Shkodrën dhe time motër
te dritarja përkundruall.
Më atje nuk do të zgjohem
luleve që valvit era,
posi valë që s'kanë mbarim.
Do të mblidhen shokët mbrëmjes
brenda vatrash në atdhe:
Unë i le si ëndërzël!

Jeronim de Rada

Sbënim

Ky fragment i shkurtër është marrë nga poema “Këngët e Milosaos”, botuar për herë të parë më 1836 në Napoli. Subjekti i poemës së gjatë është ky: në shek. XV jetonte në Shkodër Milosaoja, bir i një bujari. Një ditë ky takon në krua Rinën dhe menjëherë i lind dashuria. Atdheu ka qenë në rrezik, e Milosaoja e lë të dashurën dhe niset për në luftë. Pasi kthehet trimi nga lufta i lind një djalë me Rinën. Vdes djali, e pastaj edhe Rina nga dëshpërimi. Milosaoja vuan shumë. Kujtimi i nënës i bren ndërgjegjen; ai nuk e ka çuar në vend porosinë për të luftuar armikun. Milosaoja më në fund ia kushton tërë jetën Arbërit. I plagosur për vdekje, drejton vështrimin kah shtëpia e vet ku e pret motra, kah lulet që tund era.



Bisedë rreth poemës

Përse është përmalluar poeti?
Cilin qytet dëshiron ta shohë?
Në cilin mision nisej Milosaoja?



Detyrë

Lexoni poemën e De Radës “Këngët e Milosaos”

Poema (epi) është një krijim epiko-lirik i gjatë në vargje, zakonisht me temë heroike. Ajo trajton ngjarje historike dhe shoqërore. Në poemë ngjarjet tregohen ashtu si kanë ngjarë. Poeti (rrëfyesi) ngjarjet i paraqet në mënyrë kronologjike duke shprehur simpati ndaj virtyteve të larta të personazheve pozitive.



Jeronim De Rada
(1814-1903)

Jeronim de Rada është mësues, poet, publicist e studiues i famshëm arbëresh dhe njëra prej figurave më të shquara të letërsisë së Rilindjes sonë Kombëtare. Lindi në Maki të Kalabrisë. Mësimet e para i bëri në kolegjin e Shën Adrianit, më pas shkoi në Napoli, ku studioi drejtësinë. Gjallërisht mori pjesë në jetën politike dhe kulturore të kohës. De Rada botoi dy revista: “Arbëreshi i Italisë” (1848) dhe “Fjamuri i arbërit”, me të cilat është themelues i gazetarisë shqiptare. Krijimtaria e De Radës është shumë e gjerë. Ka botuar shumë vepra të fushave të ndryshme të letërsisë. Më të njohura janë: “Këngët e Milosaos”, “Këngët e Serafina Topisë”, “Skënderbeu i pafan” etj. Jeronim de Rada është njëri prej përfaqësuesve më të famshëm shqiptarë, i cili kishte miqësi me shumë shkrimtarë romantikë evropianë.

FJALA JONË

Ti ke fjetur n'ashtin tonë të shpuar
Ke thurë legjenda dhe tempuj ke rrëzuar

Ti urë e përgjakur në mes hirit dhe dritës
Ti fëmi kryengritës i zemrës, bukës e krypës

Ti n'ëndrra të vashave nuse e stolisur
Ti në kulla të bardha kurr duvak i grisur

Nëpër unaza të verdha emrin ke kaluar
Dashuria jote me harqe është gjuar

Si hënë e plotë ti lind në çdo dashuri
E në secilën zemër i bën vetes shtëpi

Ti n'ashtin tonë e kuqe flutur
Që t'murojmë këngën nga mishi t'kem këputur.

Rrahman Dedaj

Shënim

Kjo vjershë ka zënë vend në Antologjinë e poezisë lirike. Shkrimtari i jep rëndësi të veçantë fjalës. Përmes fjalës poeti shpalos të kaluarën e rëndë të popullit të vet.



Bisedë rreth vjershës

Çfarë ndjenjash shpreh poeti në këto vargje?
Për cilat kohë bën fjalë?
Cilat mjete poetike përdor ai?



Detyrë

Gjejini figurat letrare që përdor poeti në vjershë.

Metafora – është një nga figurat kryesore poetike. Metafora është ajo fjalë e figurshme që emëron një send a një fenomen me emrin e një sendi a fenomeni tjetër që i ngjan atij. Në bazë të metaforës pra ndodhet një krahasim i nënkuptuar. Për shembull: vullnet i hekurt.

Përdorimi i metaforës i thekson tiparet e ngjashmërisë ose, përkundrazi, ndryshimet e sendeve apo të fenomeneve mbi të cilat shkrimtari dëshiron të tërheqë vëmendjen tonë.

Për shembull, në vend që të thotë se vajzat ishin të bukura dhe e donin njëra-tjetrën, Mjeda shkruan:

Molla t'kputuna një deget
Dy qershija lidhë n'ji rrfanë,
ku fillojnë kufijt e Geget,
rrijnë dy çika me një nanë

(“Andrra e jetës”)

Ja edhe një shembull në vjershën e Lasgush Poradecit “Dremit liqeri”:

Mi zall të pyllit vjeshtarak
Dremit liqeri pakufinj
Ay ndaj fundesh u përflak
Posi me zjarr e me flori.

Tash po shuhet nënë mal
Qytet'i ngrysur në të zi
Po ndizen yjtë dalëngadalë
Plot bukuri! Plot fshehtësi!

Posi me flak u ndez e kroi
E vetëtiti plot magji
E yll i dritës perëndoi
Në qetësi dhe dashuri.

Në këtë çast perëndimor
Ndaj po më dehen sytë e mi
Kuptoj se shpirtin vjershëtor
M'a frymëzon një mall i ri

Vetë titulli i kësaj vjershe është një metaforë folje: liqeni *dremit*. Më poshtë hasim se si kroi *ndizet*, *vetëtin* etj., që janë po ashtu metafore folje. Në strofën e tretë hasim edhe metaforë mbiemër: qytet'i *ngrysur*. Edhe në strofën e fundit hasim dy metafora të sukseshme: çast *perëndimor* dhe shpirt *vjershëtor*.

SHKODRA

Tashti, pra, thonë disa të huaj se Shkodra paska qenë themeluar nga Aleksandri i Madh, mirëpo kjo, s' duhet pranuar, sepse Shkodra ka ekzistuar më përpara se të lindte Aleksandri i Madh. Disa të tjerë thonë se Shkodrën e themeloi njëfarë Johani, princ shqiptar, i cili për disa vjet paska sunduar në atë qytet, por mbasandaj qytetarët dhe populli mbarë i Shkodrës e paskan përzënë këtë princ, sepse tirania e tij ishte bërë e padurueshme e pastaj aty qenka vënë në jetë njëfarë qeverimi popullor. Shkodra duhet të mbahet me të drejtë si një qytet shumë i përmendur në daç për vendin e natyrshëm që ka, në daç për begatinë e madhe që gëzon. Andej mund të besohet se romakët, mbasi u bënë zot nga çdo anë, dërguan edhe këtu, si ndër shumë vendet tjera, kolonët e tyre për t'u bërë ballë sulmeve të huaja; për këtë lexojmë te Plini se Shkodra u quajt qytet i romakëve. Por mbasandaj kur ra Perandoria e kur punët e Romës shkuan si mos më keq, mund të besohet se Shkodra u shkatërrua e u shkretua prej barbarëve; në këtë mënyrë u zhdukën dhe ato pak shkrime që mbeteshin nga vjetërsia e saj.

Prandaj ne nuk mund të themi asgjë të sigurt rreth ndërtuesve të parë të këtij qyteti.

Ky qytet sot ka fituar nam të madh, sepse historia e tij është me të vërtetë madhështorë; pastaj ka këtë të veçantë se gjendet mbi një kodër krejt shkëmb dhe rreth e përçark ka fusha të mëdha pjellore. Është një qytet i fortë prej natyre, por i fortë edhe prej dorës së njeriut, është shumë i lartë me një gjerësi që sot është mesatare, sepse qysh kur u hodhën themelet e qytetit, rrethi i mureve shtrihej atje poshtë në fushë më tepër, se dy mijë hapa në formë katrori. Pjesës së pushtuar të këtij qyteti, i binte përmes lumi i Drinit, mbi të cilin ishte ndërtuar një urë guri e mrekullueshme që ishte aq e gjatë sa që shkonte e prekte Bunën në pjesën e vet të fundit; edhe sot kanë mbetë disa gjurma të asaj ure. Vendi ku më përpara gjendej vetëm qyteza, tashti përfshin të gjithë qytetin. Për të parë se çfarë qyteti ka qenë Shkodra, mjafton të themi se kur një ushtri e madhe barbarësh sulmoi tokat e saj, atëherë rreth pesëmijë kalorës, thujse e gjithë rinia shkodrane, u turrën të radhitur jashtë qytetit (sikurse thonë) mbas shenjës që jepte këmbana; u përlëshën me armikun pranë lumit të Drinit, që sot meqenëse ushtria shkodrane ishte shumë e

vogël në numër, aty nga fundi, për arsye se luftimi zgjati shumë, u lodh edhe u thye keqas. Ata që mbetën pa u vrarë u tërhoqën bashkë me familjet e tyre brenda kështjellës edhe atëherë armiku me një sulm të fortë, u hodh në qytet e mbasi s'gjeti njeri brenda, e dogji dhe e shkrumoi plot tërbim në të katër anët edhe e rrafshoi përdhe. Pastaj vuri të gjitha energjitë për t'iu sulur fortesës, mirëpo, meqenëse s'pati mundësi ta pushtonte, e la dhe iku prej andej. Qysh prej asaj kohe shkodranët nuk u kujdesën më për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e qytetit, sepse kur u pa se vetë fortesa paraqitej si vend më i sigurt, ata filluan ta përqëndrojnë qytetin vetëm brenda atij rrethi. Dhe në të vërtetë kjo qytezë, për natyrën që ka, bie krejt thikë nga të katër anët me përjashtim të asaj ane që është nga veriu, aty zbret, si të thuash, me njëfarë pjerrësie dhe aty afër, në një largësi sa hedh një shigjetë, ndodhet një kodër plot vreshta e ullishta. Mbi atë kodër, në rrethimin e parë, sundimtari i Rumelisë që osmanët e quajnë pashë, kishte ngritur shtatoren e vet. Që prej asaj kohe gjithmonë ai vend u quajt me emrin e pashës. Ky qytet aq i shkëlqyeshëm e aq i njohur dallohet mbi të tjerë për ajër të shëndetshëm, për ara pjellore e të punueshme mirë dhe për ujëra që i ka me shumicë. Nga qyteza syri i përland thuajse të gjitha fushat përreth, asgjë s'e pengon të pamit; prej andej i sheh të gjitha tokat që përfshijnë një hapësirë të madhe, edhe çdo gjë dallohet imtësisht. Prej andej sheh bujq që lëvrojnë tokën, njerëz që korrin të lashtat, sheh mullinj, peshkatarë sa ndër lumenj e sa në liqen (e çfarë liqeni!) duke gjuajtur peshk që del me shumicë të madhe. Mbasandej ka vreshtat, kopshtijet, burimet, liqenet e çdo gjë tjetër që ka krijuar natyra për të kënaqur njeriun. Sot rranzat e këtij qyteti, andej nga lindja, i lag degë e vogël e Drinit, kurse nga perëndimi kalon Buna që është e begatshme me çdolloj peshku. Ky lumë kalon nëpër qytet me rrymë të shpejtë, derisa derdhet në det mbas tetëmbëdhjetë miljesh. Buna buron prej atij liqeni shumë të përmendur, për të cilin të gjithë thonë se është formuar vonë nga shkaku se shkrimtarët e vjetër nuk e përmendin aspak; gjindet larg qytetit, gati gjashtëmbëdhjetë stade.

Marin Barleti

Shënim

Pjesa "Shkodra" është shkëputur nga libri "Rrethimi i Shkodrës" botuar në Venedik më 1504. Siç vihet re, nuk është një vepër letrare artistike, por një vepër shkencore historike. Është pikërisht për këtë arsye që Barleti përdor fare pak figura artistike (metafora, epitete, krahasime etj.) Kjo bie në sy edhe në copën e mësipërme.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

Aleksandri i Madh – mbret i Maqedonisë, që ka jetuar dy mijë e treqind vjet më parë

kolonë – këtu njerëz që dërgoheshin nga pushtuesit për të banuar në atë vend

Plini – shkrimtar i vjetër latin, ka lindur në vitin 23 dhe ka vdekur në vitin 79

kërdi-a – kasaphanë, gjakderdhje

milje-a – njësi masë për largësi gati një kilometër e gjysmë

fortesë-a – kala, kështjellë

Rumeli-a – krahinë e Ballkanit, që administrohej prej Turqisë

qytezë-a – fortesë, kala

stad-i – këtu: njësi mase largësie gati 177 metra.



Interpretojmë tekstin

Ç'përftyrim na jep Barleti për Shkodrën e kohës së tij?

Ç'thotë ai për themelimin e këtij qyteti?

Si quhet sot kështjella e këtij qyteti?

A dini ndonjë gojëdhënë për këtë kështjellë?



Detyrë

Shkruani shkurt në fletore: si i përshkruan Barleti qytetarët shkodranë?

Ç'virtyte vë ai në dukje?



GJITHË E VESHUR NË TË ZEZA

Gjithë e veshur në të zeza,
doli një vashë nga shtëpia,
vajti e mori uratëzën,
uratën e dheut tonë.
Përpoqi mënin e zi
dhe këputi degë plotë fletë;
poqi mollën dhe këputi
degën me mollë të bardha;
mblodhi lule në prehër,
pastaj nisi të qajë, fatin e zi të mëmëdheut.
- Oh, të fala dheu inë,
të fala sa me të lë
e s'kam të të shoh më,
e as kam u ku të vete,
pa vend ku të banoj,
pa një shtëpi ku të mblidhem!
Këto degë e këto lule,
vyshken sa të jenë larg
e mua mallin nuk ma nxjerrin dot!

Popullore arbëreshe



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

uratë-a – bekim
përpoqi – takoi, ndeshi
fletë-a – këtu; gjethe
poqi – takoi, ndeshi
inë – ynë
u – unë



Bisedë rreth këngës

Kur u shpërngulën shqiptarët në Itali?
Pse është veshur me rroba të zeza kjo vajzë?
Ku shkon ajo për të marrë bekimin?
Ç'përfaqëson kjo vajzë në këtë këngë?
Ç'na mëson kjo këngë popullore?

Shënim

Pas marrjes së tokave shqiptare nga ushtritë e sulltanit, shumë shqiptarë largohen nga atdheu. Një pjesë vajti në Itali (Kalabri) ku ndodhet edhe sot.



Detyrë

Bëni një koment për këngën.



KËNGA E DHOQINËS

Ditën e Pashkës në drekë,
seç u therr një ka në fshat.
Vajta e mora një okë mish
dhe e hodha në kusi;
me vrap dolla në avlli,
të marr një kërcu të zi.
Të më shpiket një stihi;
me vrap m' u hodh në kusi,
më helmoi djemtë e mi-
nënëtë djem e nëtë nuse,
të nëta me djem në duar!
Nëntë djepe ç'm'i përmbyste
nënëtë pajë ç'm'i zhurite
nëntë dyfekë ç'm'i shite!
Kostandin, të ardhhtë gjëma,
martove Dhoqinën larg-
larg e larg mërguar
tre male kaptuar!

Ditën e Pashkës së madhe,
Dhoqina na hidhej valle.
Kostandini u ngrit nga varri :
rrasa iu bë kalë,
balta iu bë shalë!

Vrap e vap e te Dhoqina
- Mirë se erdhe, im vëlla!
Në ke ardhë për të mirë,
të vishem si gjeraqinë;
në ke ardhë për të keq,
të vishem si kallogre.
- Jo, motër, sikundër je!

E hipi në vithe të kalit.
Zogjtë udhës thoshin:
“Çili-viu, viu-viu,
kush ia bën, ia bën vetiu!
Kini parë e s'kini parë?
Shkon një bishtbardhë,
I vdekuri me të gjallë”!

Venë gjer te dera e kishës.
- Ikë moj Dhoqinë,
se kam punë n`ajodhimë,
se aty e kam shtëpinë .

Shkon Dhoqina gjer te dera.
Çëk, çëk në portë .
- Ç` je ti që kërcet në portë ?
Mos je bushtë a murtajë?
A mos je zonja murtajë
që më hëngre nëtë djemt` djemt` e mi?

- Hap, moj nënë, derënë,
Jam Dhoqin` e vetëm!
- Me çin erdhe moj Dhoqinë?
- Un` arçë me Kostandinë.
Ç` Kostandin, moj t` arthhtë gjëma?
Kostandini i vdekur,
ç` bën tre vjet pa tretur?

Një në prak e një në derë,
Plasën si qelqe në verë.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

Pashkë-a festë e përvitshme e të krishterëve
okë-a masë peshë afro 1,50 kg
kusi-a enë e bakërt pa kapak
avlli-a oborr
shpiket-shpifet, del papritur, shfaqet
stihi-a qenie e frikshme përrallore
zhurit- përvëloj, djeg
dyfek-u pushkë
gjëmë-gjëma fatkeqësi, mënxyrë e madhe
kaptotj – kapërcej
rrasë-a- pllakë guri; këtu: guri i varrit
gjeraqinë-a-shpes grabitqar si skifter, petrit, sokol
kallogr/e-ja-murgeshë;
këtu: e mjerë, si grua e mjerë
ajodhim/ë-a – kungë; e kishës



Bisedë rreth tekstit

Ç'fatkeqësi ndodhi ditën e Pashkës?
Përse nëna e mallkon Kostandinin?
Përse e pyeti të vëllanë Dhoqina kur e pa?
Për ku u nisën bashkë?
Për kë mendon nëna, kur Dhoqina i troket te porta?
Për cilin virtyt të lashtë të popullit shqiptar flitet në këtë gojdhënë?



Shënim

Kjo këngë është një gojdhënë e vjetër qindravjeçare, ku nëpërmjet një ngjarjeje prekëse, populli shpreh idenë e madhe se, kur shqiptari jep besën, ngrihet dhe nga varri për ta mbajtur atë. Prandaj ajo quhet edhe Balada e Besës.

TË URTIT E RRUGËS

Shumë qytete, shumë krahina pashë në jetën time. Shumë gra e burra njoha. Në vargun e tyre një qytet më mbet në zemër. Një qytet dhe njerëzit e tij. Dhe rrugët e tij – të ngushta dhe të shtrembta. Shtëpitë me ballkone, lumi i shpejtë... Dhe jo vetëm kaq. Edhe tre pleq – tre të urtit e qytetit. Tre të varfërit me të cilët tallej çarshia.

O ti qytet i im dhe ju njerëz të tij! Qytet dhe njerëz të fëmijënisë sime...

Ishim vetëm shikues, ne – fëmijët e sokaqeve të strukura. Këmbëcullakët e mëhallave me erë gjelle prej tenxheresh.

“Puno pakëz dhe vidh pak, pakëz lutju zotit – qe shtëpia saraj! – ia përpëlaste çarshisë Kudruzi mahitar”.

Huaja për huanë. Urtia për urtinë...

“Puno pakëz e vidh pak.

pakëz lutju zotit...”

përsëritnim rrugëve, ne fëmijët, duke kërcyer e vrapuar.

Një kasollë, ishte shtëpi e tyre. Kasollë pa gra e fëmijë, pa zhurmë e gjallëri. Kasollja skaj qytetit.

Ata vetë – burra të varfër, në moshë. Njerëz të humbur...

Kudruzi kërkonte shumë lart e poshtë. Endej me ditë e javë nëpër vende të ndryshme. Dhe – flitte shumë. Mahitej gjithnjë. Për ngacmim apo për mahi. – Kapuç nuk bante. Nuk rruhej, nuk qethej. Nëpër rrugë kërcente e bërtiste. Zonjat i ngucte, sepetet ua barte...

Duket se s’kishte gajle për asnjë send në botë.

Por – nganjëherë zemërohej. Zemërohej kur e dehnin dhe me mashtrim e qethnin. Në kupë të qiellit shante atëherë çarshinë.

Osmani ishte tjetër njeri. I qetë dhe i matur. Mustaqet dhe mjekra, ia tregonin squarësinë. Fesi i kuq, tirqit prej cohe. Xhamadani me fermene. Tarabullus shoka me çibuk në të. Të gjitha të vjetra, por ta mbushte mendjen...

I ngadalshëm në lëvizje, i mendueshëm në bisedë. Këmbëkryq ulej pranë një dyqani dhe gjithnjë shikonte, mendonte. Me çibuk në dorë dhe bërrylin në gju, dëgjonte biseduesin, me tym e mbështillte...

“Kurrgjë se kurrgjë!” – thoshte më në fund duke luhatur kryet. Thoshte dhe vazhdonte të shkrihej në hiçin e botës...

“Kurrgjë se kurrgjë!” – përsëritnim rrugëve me mija herë ne fëmijët pa halle.

“Kurrgjë se kurrgjë!” – jehonin sokaqet për tallje e mahi. Për lojë e ngacmim...

I treti prej tyre ecte i krrusur dhe – nuk fliste gjë. Vetëm këndonte hareshëm, i binte harfës nëpër qoshe aty-këtu. Ankohej kundër jetës, qahej për fatin e njerëzve të braktisur. Urtinë e tregonte me këngë e melodi...

Me vëmendje e dëgjonte bota. Gratë e burrat. Edhe ne, fëmijët me sy të ndezur.

Tinguj fantastikë i nxirrnin gishtat e tij të hollë prej harfës së vjetër. Tinguj që preknin. Tinguj të shoqëruar me fjalë mallëngjyese të këngës. – Hallku e dëgjonin në qetësi. Në plot heshtje që ndërprehej vetëm me ofshamë të fshehura, të mbytura diku në thellësi.

Dridheshin telat dhe zëri i plakut. Tronditeshin shpirtërat e ndëgjuesve. Me fytyrën kah banesa e yjve, plaku luhatej dhe shkrihej në melodi. Bëhej hije e gjallë me sy të mbyllur...

Kur çohet për të shkuar, rruza e tij e shtrembëruar në pleqëri, u përcillte me shikime të ndjeshme, njerëzore.

Një ditë sëmundja e rrëzoi plakun me harfë. Njëfarë zjarrmie ia përvëlonte trupin. Shpeshherë humbte, bëhej si i vdekur.

A thua na shkoi plaku i urtë?

Diku natë, në thellësinë e saj të errët, plaku u çua, u ujdís në postajën e varfër. Me krye e sy bëri njëfarë shenje. Nuk e morën vesh shokët e tij.

-Harfën! Harfën e dua! – u pëshpëriti duke u munduar. Një ëndërr kam parë. Këngë dua të këndo.

-He, he, heee, sokol i gjallë – bëri Kudruzi dhe kërceu si lepur.

-U bëftë këngë kjo jetë e jona!

-Qe. Qe vegla tingëlluese!...

Nëpër natë të shurdhët jehoi kënga e një bote të vetmuar. Këngë pa vakt e kushte. Këngë për jetë.

“E hapët është bota,

E hapët për njeriun si flutur.

E hapët është bota,

E hapët dhe shumë e bukur...”

O, plaku i shkretë!...

Sytë po mjegullohen, e plaku po luhetet me harfën e tij. Me harfën të copëtuar nëpër jetë bashkë me të. – Po dridhen telat, po dridhet zëri. Flaka e qiriut vallëzon me hijet...

Jetë e çuditshme bënte në banesë pa llamba e fener, pa dyer e penxhere. Por kush po pyet! –

...Dikur vonë u shuan shenjat e gjallërisë. Një njeri i shtrydhur u nda nga bota.

-Eh, çka qenka jeta! – qan Osmani.

-Ah, jetë e shkretë! – ia priti Kudruzi.

Në ferik të mëngjesit e çuan shokun në varr. Në varr afër xhadesë, mu në skaj të qytetit. Me kujdes e lëshuan në dhe. Në krahëror ia vunë harfën. – Me mjeshtrin e saj edhe ajo vdiq.

Mbi kufomë ranë grushtat e dheut. Për herën e fundit jehuan telat e harfës. Tashmë pa harmoni, pa atë bukuri. Akordet u derdhën në trerët e thyer, të mbytur si në vaj...

Sahat-kulla e moçme, i shoqëroi me tinguj prej së largu.

Sot kanë mbetur vetëm kujtimet. E dikur:

“E hapët është bota,

E hapët dhe e bukur...”

Këndonim sokaqeve këngën e plakut. Këndonim ne, fëmijët e qytetit me shumë çardaqe, me plot penxhere.

Hivzi Sulejmani



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

sepët-i – shportë për të bartur diçka

harfë-a (harpë) – vegël muzikore, në formë të trekëndëshit me tela të gjatë të cilëve u bihet me gishta

postojë-a – lëkurë, lëkurë berrë me lesh të paqethur, e larë dhe e tharë që përdoret si shtrojë



Bisedë rreth tekstit

Cilët janë të urtit e rrugës?

Ç'moshë kishin dhe ku jetonin?

Me çka merreshin të urtit e rrugës?

Ç'bënte plaku me harpë dhe pse e varrosën bashkë me të?

Çka bënin fëmijët dhe si silleshin me të urtit e rrugës?



Detyrë

Përshkruani në fletore lagjen ku jetoni!

HAPE DERËN VËLLA!...

Trokita në derën tënde,
Trokita në derën tënde,
trokita në zemrën tënde,
që të kem shtrojë,
pse po më kthen?
Hape derën vëlla!...

Pse po më pyet
a jam nga Afrika,
a jam nga Amerika,
a jam nga Azia,
a jam nga Evropa?
Hape derën vëlla!...

Pse po më pyet
për gjatësinë e hundës sime,
për trashësinë e buzëve,

për ngjyrën e lëkurës
dhe për emrat e perëndive të mi?
Hape derën vëlla!...

Nuk jam i zi,
nuk jam i kuq,
nuk jam i bardhë,
jam vetëm njeri!!!

Ma hap derën tënde,
Ma hap zemrën tënde,
sepse jam njeri,
njeri i të gjitha kohëve,
njeri i të gjitha mjediseve,
njeri i të gjitha kontinenteve!

Rene Filiombi



Bisedë rreth vjershës

Cili është motivi i shtjelluar në këtë vjershë?
Kundër cilës dukuri lufton poeti?
Vëreni thjeshtësinë e fjalëve e të mendimeve të shprehura në këtë vjershë.
Çfarë qëndrimi ka poeti lidhur me dallimet në mes të njerëzve për nga ngjyra e lëkurës së tyre?
A dini ndonjë vend (shtet) në botë ku ende mbretëron diskriminimi racial?
Cilat nga vargjet po përsëriten? Me çfarë qëllimi e bën poeti këtë?
Si quhet vargu që përsëritet?



Detyrë

Çka dëshiron të damkosë poeti në këtë vjershë?
Çfarë ndjenjash ngjall ai tek ju?

PËRSHENDETJA

Të gjithë popujt le të jetojnë,
që ditë më të mira dëshirojnë,
dielli mbi ara të nxejë,
në prakun tonë
mos të kalojë
kurrë më armiku
të flasë me gojë.

Franc PRESHERN



Bisedë rreth vjershës

Presherni vjershën e tij të njohur “Përshendetja” e shkroi në vitin 1844, por e botoi në vitin 1848, sepse cenzura ia pat fshirë disa strofa. Në këtë vjershë poeti ka paraqitur programin dhe bindjen e tij politike.

Këtu keni vetëm një pjesë të kësaj vjershe të Preshernit.

Cila është dëshira e poetit në këtë fragment?

Çfarë do të thotë me vargjet:

Të gjithë popujt le të jetojnë,
që ditë të mira dëshirojnë;



Detyrë

Bëni një hartim me temë: Përshendetja dhe respekti.

PËRMBYTJA

Po nga mesnata Devolli shpërtheu përsëri në katër vende të tjera. Pendën që ngritën fshatarët me aq mund e djersë, e rrëmbeu me vete dhe s'la gjurmë prej saj. Uji për lau çdo gjë dhe hyri nëpër kasollat e përgjumura.

Dhorka dëgjoi si nëpër ëndërr të trokitura në derë dhe thirrje njerëzish që kalonin në rrugë. U ngrit për të pyetur se kush trokiste aq vonë e aq fort në derën e kasollës, po sa hodhi një hap, këmba e zbarthur dhe e ngrohtë iu lag.

-Ujë! – klithi ajo e frikësuar, duke mos guxuar të hidhte këmbën tjetër që e mbante mbi dyshek.

-Dhorkë, ti je? – e pyeti i ati duke nxjerrë kokën nga jorgani.

-Unë, - u përgjigj ajo e trembur na zëri i ngjirur i t'et që u dëgjua papritur në përdheshën e errët.

-Ç'ke që je ngritur?... Ou! – ia bëri Tasi dhe kërceu më këmbë. – Ç'është ky ujë, këtu? Ndiz kandilë! Grua, moj grua!

-Po hyn nga dera. Dëgjo si gurgullon.

-Ndiz kandilë, të thomë se s'i gjej dot bollkat!

-Upupu! Upupu! Ç'është kjo e keqe! – u llahtarisi e shoqja e Tasit duke kërkuar në terr fustanin e saj.

Dhorka ndezi kandilin duke i fryrë një thëngjilli dhe atëherë të tre ngrinë në vend. Ndënë pragun e derës një rrëke uji hynte duke sjellë me vete fije bari e kashte. Shumica e ujit ishte grumbulluar pranë plehut dhe vetëm një pjesë kishte filluar të përhapej nëpër dhomë.

-Bre, bre, bre! –ia bëri Tasi me vete dhe me një bel hodhi pleh te vrima nga hynte ujët me rrëmbim. E shoqja bëri kryq dhe duke veshur fustanin përshpëriti:

-O zoti Krisht? Na shpëto, o zoti Krisht!

Trokiti përsëri dera me tërsëllëmë dhe prapa saj u dëgjua një zë i fortë burri:

-Po hapeni, more, ç'bëni? Të vdekur jeni?

-Peti! – tha Dhorka duke ia njohur zërin dhe shkoi e hapi derën.

-Merrni ç'keni për të marrë dhe dilni shpejt, - tha Peti duke iu mbajtur fryma.

– Ka dalë Devolli te Lisat, te ara e Baliut, te Udha e Pazarit dhe s'di se ku tjetër. Fshati është përmbytur i tëri... Misri, ku është misri? Të shpëtojme bukën. Hajdeni, shpejt se do të na zihen udhët e s'kemi nga dalim.

Peti hodhi mbi kurriz një thes me misër të shkoqur dhe doli i pari. Edhe Tasi rrëmbeu një thes me miell mbushur përgjysmë dhe, duke dalë, i shfryu së shoqes

që po ngrinte jorganin.

-Lëri këto, moj! Bukën shpëto, bukën!

Kur dolën në oborr, dëgjuan të thirrurat e fshatarëve që ecnin përmes ujërave:

-O Kamber! A e nxore viçin?

-E nxora, e nxora, ajs?

-Hesht, mos qaj, se të hëngri gogoli!

-Ku jeni, more, a dolët?

-Mos shkoni andej se është hendeku. Hajdeni pas meje.

-S'vi dot! Kam frikë!

-Ç'i do këto! Shpëto veten një herë!

-Na ndihmo o perëndi! O zoti Krisht, na ndihmo!

Shkrepëtiu një vetëtimë dhe në dritën e saj Peti pa të atin, t'ëmën e Dhorkën që mezi çapiteshin prapa tij, duke kërkuar udhën, si të verbërit. Një erë e marrë fishkëllente mbi çatitë, mbi mullaret e lesnikët dhe me gjithë pikat e shiut përplasej në fytyrat e ftohta të tyre.

Fshatarët, duke shtrydhur bollkat e setrat, pyesnin të shqetësuar.

-E more, a dolët?

-Dolëm, që mos dalçim!

-Të tërë dolët?

-Të tërë.

-Po nga Dalipi?

-Edhe nga Dalipi.

Fatmir Gjata

Shënim

-Ky fragment është shkëputur nga tregimi “Ujërat e verdha”. Këtu duke përshkruar vërshimin si stih të natyrës, shkrimtari na paraqet jetën e rëndë e të mjerë që mbretëronte në të kaluarën në vendin e tij. Shiko se me sa detaje reale është paraqitur përmytja e fshatit, reagimet e ndryshme të secilit prej tyre i tregon në mënyrën e vet. Pse?



Bisedë rreth tekstit

Çka ishte për Tasin gjëja më e rëndësishme në atë moment?

Shihni se ç' thotë ai: “Bukën shpëtoje, bukën!”

A keni përjetuar ndonjë ngjarje të ngjashme? Nëse po, mundohuni ta përshkruani.



Detyrë

Lexoni disa fragmente interesante nga ky roman.

NATË DIMRI

Era me shi e borë ulërinte nëpër gadishullin e Bruciumit. Të gjithë banorët e qytetit të vogël dhe të fshatrave përreth rronin të fshehur në shtëpitë e tyre të vogla. Në kampin e Spartakut dëgjoheshin thirrje të gëzuara. Spartaku kishte dy net që u jepte zemër ushtarëve nëpër çadra.

-Hani, pini! Mos kurseni asgjë. Le t'i gëzojmë këto ditë që na kanë mbetur para se të biem fli me lavdi! Ne nuk do t'u dorëzohemi kurrë romakëve të poshtër.

Krasi kishte njerëz të tij midis skllëvërve kryengritës dhe merрте vesh çdo gjë që bëhej me kampin e Spartakut.

-Aq më mirë, ata nuk do të kenë shpëtim!

Pranë zjarreve u binin flautave dhe fyejve, ndërsa trakasit të kapur njëri pas tjetrit në brez, kërcenin duke lëvizur herë majtas e herë djathtas. Të gjithë udhëheqësit, së bashku me Spartakun, sipas një zakoni të hershëm, merrnin pjesë në këtë valle ushtarake dhe këndonin këngë të vjetra. Gladiatorët filluan të këndojnë një këngë që e kishin nxjerrë kur ishin në marshim:

Unë kazmë s'jam, t'i s'je lopatë
Njeri jam unë, njeri je ti;
Ngrehu, o shok, dhe çaj në shtërngatë!
Të zhdukim nga dheu të zezën skllavëri!

A nuk e sheh si qielli kaltron
E si toka me lule është mbuluar?
Po erën nuk e ndien që të ledhaton
Dhe ujët që po rrjedh i kulluar?

I lirë je, o shok, tashti përherë
Dhe dielli në mëngjes do të zgjojë.
Nuk do të kesh më roje ti në derë,
Dhe askush më s'do të të pengojë.

I lirë, je, o shok, ti dije mirë,
Ti gjakun s'do ta derdhësh, jo, më kot
Ndër cirqe, ku njerëzit bëjnë sehir
Të ngopur me barkun plot.

Në qoftë se puna do ta dojë,
Të vdesësh për lirinë, e të bëhesh fli,
Ti shko përpara, shok, me këngë në gojë,
Se çdo i shtypur pas do të vijë.

Ne jemi shumë, s'kemi të mbaruar
Kudo po ngrihen skllëvër anëmbanë;
Të parët tanë këtë kanë ëndërruar
Përpara, shok, të biem mbi tiranë!

Numidët kërcenin duke vringëlluar shpatat dhe duke hedhur sa andej-këndej, kurse grekët dilnin çifte-çifte dhe godisnin shpatat e njëri-tjetrit mbi kokën e tyre.

Në zjarret po digjeshin drutë e fundit. Era, duke ulëritur merrte me vete shkëndijat dhe i shpërndante nëpër shesh. Bora sa vinte e bëhej më e dendur. Shtresa e bardhë mbulonte gjithnjë e më shumë kampet e gladiatorëve.

Një pjesë e gladiatorëve nuk ishte larguar nga zjarret dhe bënte qejf. Në kampin e romakëve, kur u afruan gladiatorët, filloi një rrëmujë e madhe. Ushtuan boritë që thërrisnin për luftë dhe në atë çast ushtarët, duke u përpjekur me njëri-tjetrin, u radhitën në errësirë. Pishtarët e ndezur lëviznin nga të gjitha anët.

Me gjithë përleshjet e përgjakshme të reparteve të veçuara, romakët s'ishin në gjendje të përballonin zemërimin e gladiatorëve.

Dhe aty nga mëngjesi Spartaku me ushtrinë e tij hyri thellë në grykat e braktisura të maleve të Lukanies.

V. Jani

Sbënim

Kjo pjesë na çon në një kohë shumë të largët, rreth dy mijë vjet të shkuar, kur në botë lindën për të parën herë klasat shtypëse dhe klasat e shfrytëzuara. Në atë kohë Perandoria Romake mbledhte skllevër nga të gjitha anët. Ajo vriste, gjymtonte dhe shpërdoronte forcën e tyre fizike e mendore, talentët e tyre të rralla, poshtëronte personalitetin e tyre njerëzor. Jeta e vështirë nuk durohej dhe përpara del një hero i gjallë i papërkulur, Spartaku, i cili bashkë me skllevërit e tjerë u ngrit në luftë për liri. Kjo tregon se sa i madh është shpirti liridashës i popujve. Tregimi shquhet për skenat dhe tablotë realiste, për gjuhën e thjeshtë e të goditur.



Bisedë rreth tekstit

Ç'kuptoni me fjalën skllav?

Cilët ishin gladiatorët dhe cili ishte udhëheqësi i tyre?

Përkundër jetës së vështirë, ç'këngë të bukur këndojnë dhe me çfarë përmbajtjeje?



Detyrë

Bëni një hartim në lidhje me tekstin.

DIMNI

Nëpër fushë e nëpër male
fryn murlani me stuhi;
o murlan, njat frymë ndale,
ndal ti, o akull, mos më ngri.
Mos ma ngrini këtë pikë gjak!
- Struku, struku, i shkreti plak.
Po del dimni me kosë n'dorë.
Gjeth e bar i ka kositë;
qet balkoni pjalm e borë,
e plak-shkreta tuj mbërdhitë,
i thotë vedit me za pak:
- Struku, struku, i shkreti plak.

Ndre MJEDA



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

pjalm – borë e imët



Bisedë rreth vjershës

*Çka i thotë plaku dimrit?
Si e përshkruan poeti dimrin?*

Në këtë vjershë tregohet sesi dimri kosit. Kjo mund të shihet në vargjet:

*“Po del dimni me kosë n'dorë
Gjeth e bar i ka kosit;”*

PERSONIFIKIMI

*Shpesh në vjersha basim veti njerëzore, të cilat u jepen sendeve, bimëve, kafshëve, dukurive, etj., p.sh.: (dielli më përkëdhel, mali fle, lumi pëshpërit). Këto lloj mjetesh shprehëse quhen **personifikim**. Me anë të tyre vargu bëhet më figurativ, prandaj edhe e përjetojmë më thellë.*



Ndre Mjeda
(1866-1937)

Ndre Mjeda është një ndër poetët e njohur që letërsinë shqiptare e pasuroi me krijime të bukura letrare për të rritur e për fëmijë. Lindi në Shkodër më 1866 ku edhe vdiq më 1937. Përveç tjerash, në veprat e tij trajtohen edhe mjaft çështje sociale të kohës. Ka shkruar disa vepra, nga të cilat më e njohur është “Juvenilia”, ndërsa për fëmijë është e njohur përmbledhja me titullin “Guxo”.



LOTËT E HAJRISË

E shtrëngonte në prehën, e puthte dhe e lotonte. E njomte për herë të fundit me lotët e nxehtë nëpër fytyrën pak të zbehtë, me lotët e dashurisë, të dhembjes për këtë ndarje të padëshirueshme. Pushonte vetëm ndonjë çast e përsëri zhgrehej në vaj, dëneste një kohë të gjatë.

“... Alia i nanës në duar të kujt po të la unë ty sot? Ma këpute shpirtin loke... Sa shumë të kam bajtë mallë, nandë vjet të shkreta, e qe sot, po më duhet me të lanë, me u nda prej teje për së gjalli. Mos me të pa me sy nana jote, djali im. Çka ban nana pa ty, e ti pa nanë? Kurrë unë me sy ma dritë nuk kam me pa loçka ime, shpirti i mirë i nanës. Nandë vjet të gjata, loke, nuk lash as hoxhë as falltor, grue e burrë që di diçka, pa e vetë, e qe, kur u gëzova, po më duhet me të lanë përgjithmonë, mos me të pa kurrë ma, me ta kthye shpinën e me të lanë në duar të huaja...”

I biri e shikonte pa ditur gjë për atë që i thoshte ajo, sepse kishte vetëm një vjet nga lindja. Lotët e s'ëmës as që i bënin përshtypje. Ajo e puthi përsëri, kurse Aliu vetëm e shikoi dhe e përvoli buzën pak, si të dëshironte të qeshte, duke menduar se e ëma i fliste si zakonisht. Buzëqeshja e tij e përmalloi edhe më tepër Hajrinë, që atë ditë ishte shndërruar vetëm në lot.

- Hajriooo!... - u dëgjua një zë burri nga mesi i oborrit. Ajo nuk u çua menjëherë dhe u shti sikur nuk dëgjoi, sepse e dinte fare mirë shkakun e thirrjes. E dinte se kishte ardhur koha e ndarjes, e largimit përgjithmonë prej këtij vendi. Megjithatë pas pak doli përjashta me Aliun në dorë.

- S'due me shkue. Kam me e ruejtë gjithmonë djalin. Nuk ia mbylli shtëpinë kësaj trohe jo!... - fliste dhe qante ajo, por edhe vetë e dinte se të kota ishin fjalët e saj në atë moment. Qante me zë, dëgjohej bukur larg. Aliu vetëm herë pas here e luhaste kokën pa ditur se çka ndodhte rreth tij, por disi e shikonte t'ëmën me njëfarë habie. Qanin edhe gratë e fëmijët që kishin ardhur atë ditë ta përcillnin për herë të fundit. Oborri ishte plot gra e fëmijë. Nuk ishte vetëm e shoqja e Ukës.

Hajria në njërën dorë e mbante ende të birin. U ndal dhe u përshëndet edhe njëherë me të gjithë me radhë, me gra e fëmijë që ishin tubuar aty, i përqafoi të

gjithë sikur të donte që ato përqaftime dhe lot të derdhur atë ditë në atë truall t'i ruante gjithmonë në thellësinë e shpirtit të vet.

Hajrisë i ndihmoi Rama të hipte në kalë.

Rreshti i vogël, i pikëlluar, u nis ngadalë. Njerëzit mbeteshin mbrapa së bashku me katundin. Hajrija e shtrëngonte Aliun në prehër. E afronte pranë dhe i ukej se gjithçka do të humbte së shpejti, vetëm edhe disa çaste sa ta largonte për herë të fundit Aliun nga prehëri, e gjithçka do të mbaronte për të.

Sikur të pyetej ajo, më parë do të pranonte të vdiste se këtë ndarje. Mirëpo, të fuqishme ishin zakonet e atyre maleve që nuk pyetnin për dashurinë prindërore dhe për dëshirën e saj.

Askujt nga turma që zhagitej dhembshëm asaj rruge për herë të fundit, nuk iu kujtua se katundi tashmë kishte mbetur prapa. Ai katund me të cilin lidhej ngusht jeta e Hajrisë tashmë humbi pas kodrës. Ngadalë, rrua e lakuar dhe tërë gropa-gropa ngjitej përpjetë maleve. Vetëm atëherë Brahimi, si t'i binte ndër mend diçka, u ndal dhe tha:

-A po ndalemi more, se mjaft u ba!

Askush nuk bëri zë, por të gjithë e kishin ndalë hapin dhe shikonin. Edhe kuajt i kishin drejtuar shikimet e veta përpara dhe ecnin mërzitshëm. Të gjithë u përshëndetën, por disi frohtas. Hajrija qante. Aliu, që tashmë ishte zgjuar, shikonte pa ditur gjë. Më në fund njerëzit që ktheheshin përsëri në katund, u përshëndetën edhe me Hajrinë, e përcollën atë që nuk do të kthehej kurrë më tek ata. Pas pak Brahimi dhe Bahtiri i zgjatën përnjëherë duart kah Hajrija që mbeti si e shtangur.

Ajo ngurroi; nuk lëvizti nga vendi dhe i shikonte me lot në sy, sikur të donte të pyeste se ç'donin. E shtrëngonte të birin me sa fuqi kishte, thua se mundahej ta mbrojë nga një fuqi që ia rrëmbente. I dukej se vetëm në atë mënyrë mund t'i shfaqte tërë dashurinë e dhembjen, që e ndjente në atë çast. U kërrus ngadalë mbi të, e puthi në ballë, e mandej në të dy faqet. Ia nxori gjirin nga goja; e puthi rish-tas dhe në atë çast iu errësua gjithçka, harroi çdo gjë përreth; nuk i shihte as njerëzit që e pritnin. Ashtu, pa ditur gjë e shtriu të birin kah duart e Bahtirit, që qëndronin ende të zgjatura. Iu duk se ato iu përngjanin kthetrave të ndonjë përbindëshi të madh, i cili ia rrëmbeu çdo gjë të sajën. I dukej se njerëzit aty pranë u ngjanin vetëm disa hijeve të tmerrshme të cilat i rrëmbenin gjithçka që kishte. U frikëso-hej atyre sa s'ka.

Njerëzit largoheshin ngadalë, e së bashku me të edhe ai. Hajrija e shikonte ende dhe, në një moment, u duk se ata nuk u ngjanin njerëzve, por disa cungjeve të zeza, që lëviznin teposhtë rrugës. Ajo i fshiu lotët, i picërroi sytë dhe u kap më fuqishëm për samarin e kalit, duke u përpjekur ta shohë bile edhe njëherë të birin. I vërejti derisa humbën në kthesën e parë të rrugës zigzage.

Nazmi Rrabmani

Shënim

Tema e romanit “Malësorja” është fati i femrës shqiptare në përgjithësi. Ideja e veprës është qëndrimi jonjerëzor i mashkullit ndaj femrës.

Personazhi kryesor në veprën “Malësorja” është Hajrija, e përcjellë nga shtrëngatat gjatë tërë jetës që prej ditëve të para të rinisë e deri në pleqëri.

Ngjarjet që ndodhin, sidomos ato në momentin e ndarjes së saj nga i biri, si dhe sjelljet e burrave përbëjnë subjektin e veprës.



Bisedë rreth tekstit

Cila është tema dhe ideja e këtij teksti letrar?

Çfarë qëndrimi ka shkrimtari ndaj Hajrisë dhe në përgjithësi ndaj femrës?

Ku e shihni ju kulmin e vuajtjeve të Hajrisë në këtë tekst letrar?

Cilat janë ato vuajtje e vragë shpirtërore të Hajrisë?



Detyrë

Lexoni në tërësi romanin prej nga është marrë ky fragment.

Romani - është vepër e gjatë letrare e gjinisë epike, e shkruar në prozë që pasqyron një rreth të gjerë ngjarjesh e dukurish nga jeta shoqërore. Llojet kryesore të romanit janë: aventurier, historik, shoqëror, psikologjik, humoristik, satirik, fantastik etj. Ndër romanet e para në letërsinë tonë janë: “Shkodra e rrethuar” nga N. Nikaj(1913), “Lulja e kujtimit” nga F. Postoli, “Çlirimtarët” nga Dh. Shuteriqi, “Ata nuk ishin vetëm” nga S. Spasse, “Këneta” nga F. Gjata etj.



Nazmi Rrahmani

Nazmi Rrahmani lindi më 1941 në fshatin Ballofc të Podujevës. Shkollën fillore e mbaroi në Podujevë, gjimnazin dhe studimet universitare (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare) i kreu në Prishtinë. Ka punuar si redaktor në revistën letrare “Jeta e re” dhe në redaksinë e botimeve të “Rilindjes”. Njihet si romancier dhe përkthyes i letërsisë. Ka botuar këto vepra “Malësorja”, “Tymi i votrës së fikun”, “Toka e përgjakur”, “Pas vdekjes” dhe “Rruga e shtëpisë sime”. Veprat e Nazmi Rrahmanit janë bërë shumë popullore dhe janë ribotuar shumë herë. Dallohet si shkrimtar që përshkruan vuajtjet jetësore dhe mjedisin e fshatit kosovar.

FARKËTARI I FSHATIT

Në fshat është një kovaçanë
Nën hijen e një gështenje.
Burrë i fuqishëm është farkëtar,
Me duart e mëdha, tërë deje,
Muskujt e krahëve si hallka çeliku
Të rryera janë ndër zeje.

Flokt' e dredhura pis të zeza
Fytyrën e rrahur hijeshojnë,
Mbi ballë i ndrit djers' e ndershme
Ç'ka mundet vetë ai e fiton,
Me kryet lart botën e shih
Se kujt borxh nuk i kërkon.

Dita më ditë, nga mëngjesi në darkë
Kacakët fort i vërshtëllen,
Pareshtur godet çekan i rëndë
Forma të zjarra mbi hekur len,
Godet porsì kambanë e vonë
Që orën fshatit i rrëfen.

Fëmijët e vegjël tek dalin prej shkollë
Nga der'e hapur rrinë e vështrojnë;
I duan ata flakët e furrës
Kacakët e fryrë që zjarrin tërbojnë
E duart e vogla mundohen të kapin
Shkëndijat e ndriçme që rreth fluturojnë.
E lodhshme, e rëndë rrjedh jet'e farkëtarit
Herë në gëzim e herë në trishtim,
Çdo mëngjes e pret një punë e re,
Çdo darkë e gjen atë në mbarim.
Përherë në punë, me djersë e fiton
Pushimin e qetë deri në agim.
Të falem, të falemnderit mik!
I vlefshëm është ky mësim.
Kështu si ti në kurdhën e jetës
Do rrahur edhe fati ynë,
Kështu do derdhur në forma të zjarra
Çdo hap që hedhim e çdo mendim!

H. U. Longfelou



Bisedë rreth vjersbës

Për kë na flet poeti në tri strofat e para?

Po në strofën e katërt?

Lexoni me kujdes strofën e fundit. Aty përmblihet porosia e kësaj vjershe.

Pozeia sociale (shoqërore) trajton tema shoqërore dhe nëpërmjet të saj poeti shpreh ndjenjat dhe idetë e tij ndaj padrejtësive të njerëzve në shoqëri.

PROVERBAT

Fjalët e urta ose proverbat janë mendime të mprehta e të plota të shprehura me fjalë, në të cilat populli tregon urtinë e tij dhe përvojën e madhe në jetë. Ato e pasurojnë gjubën dhe i japin bukuri. Fjalë të urta kanë krijuar edhe shkrimtarët tanë, si Naimi dhe Sami Frashëri, Dritëro Agolli etj.

Për punën

Njeriu s'peshohet nga fjalët, por nga veprat.

Puna pa nda, bën një kala.

Mos ia shih gunën, por punën.

Më mirë puno kot e mos rri kot.

Për vendosmërinë

Fjala është fjalë, kur ta flasësh, mbaje.

Kau lidhet për brivë, njeriu për fjalë.

Atë që ta thotë zemra, dubet të ta thotë edhe gjuha.

Kush është i vendosur ditën, natën nuk trembet.

Për lirinë

Liria s'falet, por fitohet.

Më mirë një ditë e i lirë se njëqind vjet e rob.

Për liri s'kursebet as gjaku.

Njeriu i lirë askujt s'i ka smirë.

Më mirë i varfër e i lirë se i pasur e rob.

Për krenarinë

Mendja e madhe të thyen qafën.

Qeni që leh shumë, nuk të ha.

Mallkimi më i madh: T'u rritë mendja!

Harroi qeni esbtrat se u bë langua.

Mos ec me vrap se bie në trap.

Njeriu i lehtë mban kryet përperjetë.

Ena e zbrazët bën zburmë shumë.

FAJTORI

Një e keqe që kudo përhapi tmerr, po bënte kërdrinë midis kafshëve.

Nuk vdisnin të gjitha, por që të gjitha ishin goditur. Dhe asnjë nuk po përpiquej t'i bënte derman jetës që po i shuhej.

Asnjë ushqim nuk nxiste më oreksin e tyre. Tani as ujku, as dhelpra nuk gjurmonin gjahun e pafajshëm. Të gjithë i shmangeshin njëri-tjetrit. Nuk kish më dashuri, nuk kish më gëzim.

Luani i mblodhi në këshillë dhe u tha: - Miqtë e mi të dashur, unë besoj se këtë fatkeqësi na e solli qielli, për mëkatet që bëjmë. Le të flijohet, pra, më fajtori nga ne ndaj goditjes së zemërimit hyjnor dhe, ndoshta, do të arrihet shpëtimi i përgjithshëm. Historia na mëson që në rrethana si këto, bëhen fljime të tilla. Të mos zhgënjehemi, pra, në këtë pikë. Le ta shohim, pa u ndikuar nga ndjenjat gjenden e ndërgegjes sonë.

Sa më takon mua, për të kënaqur oreksin tim të pangopur kam gllabëruar shumë desh. Ç'më kishin bërë mua ata? Asgjë të keqe. Madje, më ka ndodhur që ndonjëherë të kem ngrënë edhe bariun. Do të flijohem, pra, po qe nevoja, por unë mendoj se është mirë që secili të vetakuzohet, ashtu siç bëra unë, mbasi për të bërë drejtësi të plotë, koka i duhet prerë vetëm atij që është më fajtori.

-Madhëri, - u përgjigj dhelpra, - ju jeni një mbret tepër i mirë. Në ndërgegjen tuaj ne vërejmë shumë ndjeshmëri. Të hash desh, këtë farë të përcmuar, të rëndomtë, mos, vallë, është ndonjë mëkat? Jo, po! Ju u keni bërë atyre një nder tepër të madh, duke i kaluar dhëmbin tuaj, zotëri.

Për sa i takon bariut, duhet thënë se ai i meriton gjithë të këqijat. Ai (dhe të tjerët) sillet ndaj kafshëve sikur të ishte perandori i tyre.

Këto tha dhelpra dhe lajkatarët duartrokitën.

Nuk u guxua më tej të bëheshin përcaktime të tepruara për tigrin, ariun e të tjerë të fuqishëm dhe rreth bëmave të tyre më të dënueshme. Gjithë grabitqarët e tjerë, përfshirë këtu edhe qentë e thjeshtë rojtarë, dolën gjynahqarë.

I erdhi radha gomarit e ai foli:

- Mua më kujtohet që kur po kaloja nëpër një livadh: uria, rasti i volitshëm, bari i njomë, besoj dhe ndonjë djall që më shtynte, bënë që të haja pak bar në atë livadh. Dhe, meqenëse duhet folur hapur, them se nuk kisha asnjë të drejtë.

Menjëherë pas këtyre fjalëve, ndaj gomarit jehuan thirrjet: “Të kryqëzohet!”.

Një ujë në rolin e akuzuesit, me fjalimin e tij provoi se kjo kafshë e mallkuar, ky rrjepacak, nga i cili u vinte tërë e keqja, duhej bërë kurban.

Mëkati i tij u gjykua i denjë për varje. Të hash barin e të tjerëve! Ç’krim i shëmtuar! Asgjë përveç vdekjes nuk do të mund të shlyente krimin e tij. Dhe ia treguan mirë vendin.

Sipas gjendjes, i fuqishëm apo i mjerë, vendimet e gjyqit do t’ju nxjerrin të bardhë apo të zi.

La Fonteni

Sbënim

Në këtë fabul, nëpërmjet figurave të kafshëve, La Fonteni godet tiranët, hipokritët lajkatarë, që flasin e veprojnë siç i pëlqen më të fortit, si edhe syleshët që gënjehen shpejt, bien viktimë dhe bëhen fli e intrigave të tyre. Fabula është alegorike.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

i bënte derman jetës – i gjente një rrugë zgjidhjeje
gjuhnaqar-i – mëkatar-i,
duhej bërë kurban – duhej bërë fli, theror

ALEGORIA

Të fabula “Fajtori” ose edhe të shumë fabula të tjera, si “Tre qetë dhe ujku” fjala ose gjithë pjesa ka një mendim të tërthortë, që dubet kuptuar mirë, sepse autori nuk e jep atë drejt-përdrejt. P.sh. tre qetë kur u ndanë, i çau ujku. Nga kjo ne kuptojmë mendimin e autorit se njerëzit, po të përçaben, munden shpejt nga armiku.

Në këto çaste, kur fjalët janë përdorur në një kuptim tjetër ose fshehin një kuptim tjetër, që dubet zbuluar e sqaruar mirë, themi që autori ka përdor figurën letrare të alegorisë. Pra, alegoria është ajo figurë letrare, me anën e së cilës theksohet një mendim që nuk është shprehur drejtëpërdrejt, por dubet nënkuptuar.

Alegoria nuk përdoret vetëm të fabulat dhe përrallat. Ajo përdoret shumë edhe në vjersha, tregime e romane. E gjithë vjersha ose tregimi mund të kenë kuptim alegorik, p.sh., “Shkëndijë diellit ndaj manushaqes”, vjersha e Naimit ; “Vaji i bylbylit” e Ndre Mjedës kanë kuptim alegorik. Përdorimi i alegorisë e bën më të gjallë, më emocionuese, më të bukur vjershën ose tregimin. Alegoria është përdorur dendur nga shumë shkrimtarë të Rilindjes si dhe nga ata bashkëkohorë.

PULËBARDHA

Pulëbardhën në rërën e lagur e gjetëm,
e kishte thyer këmbën nën gjurin e brishtë,
e kishin lënë shoqet në bregun e detit vetëm
e kishin lënë e askush nuk e priste.

Pulëbardhën në dhomën tonë e shpumë
e u mësua me ne si njeriu i shtëpisë,
veç nga dritarja shikonte detin me shkumë
dhe valën që ngrihej mes shiut e stuhisë.

Jetoi pulëbardha shumë në dhomë,
po humbi papritur një ditë,
një ditë kur deti hidhej mbi rërën e njomë,
një ditë kur vinin stuhitë...

Dhe shkuam në det ta kërkonim,
kur vala me valën si deshët kokat kishin përpjekur,
kur era dhe retë rënkonin,
dhe e gjetëm pulëbardhën të vdekur...

E pamë!
Kish hapur krahët e bardhë në rërën e njomë...
e pamë!
Ndofta nuk donte të vdiste në dhomë...

Dritëro Agolli

T'i duam dhe t'i mbrojmë kafshët, mjedisin dhe natyrën – ekologji



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

pulëbardha-a – shpend që rron afër detit e liqeneve dhe ushqehet me peshq e është i bardhë dhe i madh sa një pulë
i brishtë – që thyhet shpejt.



Bisedë rreth vjershës

Vjersha përmban edhe elementin ekologjik.

Ku shihet?

Ç`thuhet në strofën e parë të kësaj vjershe?

Pse e kanë lënë shoqet pulëbardhën e plagosur?

A vepruan mirë ata që e morën dhe e mjekuan pulëbardhën?

Pse ajo shikon nga dritarja detin me shkumë?

Pse pulëbardha largohet? Ku shkoi ajo?

Çdo të thotë autori me vargun e fundit: “Ndofta nuk donte të vdiste në dhomë”?

Detyrë:

Si duhet të kujdesemi për kafshët?

Ç`na mëson ekologjia?

Dritëro Agolli lindi në fshatin Menkulas të Devollit më 1931. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjirokastrë, ndërsa studimet e larta për gazetari në Leningrad. Punoi kryesisht në gazetën “Zëri i popullit” dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Shkruan poezi, tregime, novela, romane, drama etj.

Veprat letrare: “Në rrugë dola”, “Mesditë”, “Komisari Memo”, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, “Njeriu me top”, “Fjala gdhend gurin”, “Trëndafili në gotë”, “Moshë e bardhë”, “Vjen njeriu i qeshur”.



Dritëro Agolli

Që ditën që vdiqe , qëkur s'të kam parë
Lotë që kam derdhur s'më janë dhe tharë!...
Shumë vjet u bënë , sot u mbushnë dhjetë
Qëkur më ke lënë dhe s'të sho ndë jetë
Ndë ç'kopshte me lule ke qëndruar vallë?
S'të vjen keq për mua ? S'të vjen mall për djalë?
O Ëngjëll i bukur , mos mëno në botë.
Kthehu të të shomë , të na mbeten lotë.
S'rrojmë dot pa tynë , ti si rron pa neve?
Motëmot që rrojtëm bashkë s'më urreve.
Atje tek rri , janë qepariz 'e varre ...
Kthehu të të shomë , mos na le për fare!
Mos na le të gjorë , me zëmër të ngrirë,
Kthehu të gëzonesh , kur të shoç të birë.
E ke lënë foshnjë , tani u bë burrë,
S'arrite ta rritje , s'të ka parë kurrë!
Për ty , shumë herë çoç do të më thotë,
Po s'mund t'i përgjigjem se më mbytin lotë!
Kthej kokën mënjandë dhe vështroj përtpjetë ,
Duke psherëtitur te Zot i vërtetë ...
O Zot i vërtetë , s't'erdhi keq për djalë ,
Kur i more mëmën dhë më le të gjallë?
Të më kishe marrë , do të qe më mirë,
Dhe të rronte mëma të rritte të birë.
Me se rrojnë foshnjat ? Ç'i rrit çilimitë?
Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitë.
O Zot , të jam falë , mos më le të mjerë,
Dërgom Efgjeninë , ta shoh dhe një herë.
“ – Pse s'kuvendon mirë more punë bardhë ?
Cili vdiq njëherë dhe prap ka ardhë?
Gjith 'humbasin gruan , mëmën a babanë ,
Po , ata që mbetën si ti nuk qanë.
Të vdekurin lotët s'e bien në jetë ,
Po lutu dhe falu të rriç djalin vetë “

Doje dritë o Qiell , more dritën time ,
Dhe më mbushe jetën plot me hidhërimë !...
Tani rroj pa shpresë , ndaj s’dua të rroj,
Se dhe Perëndinë tani s’e besoj!...

Çajupi

Sbënim

Këtë poezi , poeti e shkroi dhe ia kushtoi Efgjenisë, gruas së tij të ndjerë nga pikëllimi i madh ,dhjetë vjet pas vdekjes së saj. Me një hiperbolë reale, ai shprehet me aq emocione. Vjersha u bë elegjia më e fuqishme e të gjitha kohëve të lirikës shqiptare. Me mjeshtri në këtë elegji poeti e ka përdorur vargun dymbëdhjetë rrokësh të dyzuar.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

sho – shoh
tynë - pa ty



Bisedë rreth vjershës

1. Ç’përshkruan poeti në këtë poezi lirike ?
2. Nga u frymëzua poeti për të shkruar këtë poezi?
3. Cila është tema e kësaj poezie?

ELEGJIA

Është lloji i poezisë lirike, në të cilën poeti shpreh ndjenjat e dhembjes, pikëllimit dhe hidhërimit për gjënë e humbur, që nuk mund të kthehet më. Zakonisht vjershat e këtilla shkruben me rastin e vdekjes së ndonjërit nga anëtarët e familjes, siç është rasti me këtë vjershë, ose ndonjë njeriu që ka luftuar për liri. Në vjershat e këtij lloji dominojnë shprehjet që sjellin dhembje, trishtim, pikëllim për njeriun e humbur.

Të këtij lloji janë edhe elegjitë e shkruara nga Noli, kushtuar Bajram Currit (“Shpell e Dragobisë”) dhe Luigj Gurakuqit (“Syrgjyn vdekur”), si dhe “O moj Shqipni” e Vaso Pashës, “Naim Bej Frashërit” e Çajupit etj.



Detyrë

Mësoni përmendsh këtë elegji kaq të bukur dhe bëni një recitim artistik.

UJKU DHE QENGJI

Dhentë në vathë po rrinin,
qentë ndënë hije po flinin,
bariu fyellit i binte,
e gjësendi re më s'vinte.
Ujku erdhi dhe nga vrima
e gardhit, si vetëtima
hyri në vathë laduti,
djalli e pru' edhe e futi.
Një qengj që ishte i mitur
dhe fare i pastërvitur,
iu qas, nga fjala u zunë,
i tha: - Pse erdhe këtunë?
I tha: - Sheshi i lulëzuar
dhe ky përroi i kulluar
më prunë mua këtunë.
Ta dish fort mirë se unë,
me pak ujë e me dy fletë
rroj e kam rrojtur në jetë...
Qengji i varfër me të qetë
i tha: - Në është kjo e vërtetë
eja këtu, bashkë të rrojmë,
nëpër sheshe të kullosim
e zemrën ta zhbregosim.
Me të thënë këtë fjalë
dhe nga vatha duke dalë,
qengjin ujku më s' e priti
po e zu e kollofiti!
Qysh mund të mbetet gjallë
ëngjëlli bashkë me djallë?



Botën mos e gjykoni
me fjalët q'u dëgjoni,
mos u shikoni ç'tregojnë,
po vini re ç'gjë punojnë.

Naim Frashëri



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

vathë-a – vend i rrethuar ku mbahen bagëtia

ladut-i – i keqi, gjakësori

i mitur – i vogël

nga fjala u zunë – filluan të bisedojnë

këtunë – këtu

fletë-a – këtu: gjethe

ta zhbregosim – këtu: të mos kemi më brenga, halle

kollofit – e fut të gjithë në bark përnjëherësh

botën – këtu: njerëzit



Biseda rreth vjershës

Pse e besoi qengji i vogël ujkun? Po të kishte qenë dele ose dash i rritur, a do ta kishte besuar?

Ç'mësim nxjerrim nga kjo fabul?

Cilat janë vargjet ku shprehet ky mësim?

Shpjegoni këto shprehje: e pruri djalli, nga fjala u zu, rroj me pak ujë e me fletë.

Thoni se sa rrokëshe janë vargjet e kësaj fabule. Gjeni rimat e gjashtë vargjeve të para dhe thoni se ç'lloj rime është.

Detyrë

Shkruani vetë një fabul.



DRENUSHA DHE PJERGULLA

Një hardhi e lartë me fletë të gjera dhe plot me kopanë rrushi, që shkëlqenin si ar, vuri re një drenushë me brirë të gjatë që po kalonte me vrap aty pranë.

- Ja një drenushë e mjerë – tha pjergulla me vete – që s’di nga t’ia mbajë; po e ndjekin qentë, të gJORËN! Sikur të kthente kokën këtej nga unë do ta pështillja me fletët e mia dhe do ta fshihja nga sytë e armiqve.

S’kaloi shumë kohë kur drenusha, sipas zakonit që ka për të humbur gjurmët e ndjekësvet, u kthye përsëri nga rruga që kish bërë dhe kështu pjergulla zemërgjerë pati kohë sa t’i thotë:

- Futu shpejt nën fletët e mia që të shpëtosh!

Drenusha i dëgjoi fërfëllimat e pjergullës dhe pa humbur kohë u struk nën fletët e gjera, pa bërë as më të voglën lëvizje. Qentë kaluan disa herë me radhë aty pranë, u kthyen përsëri, po s’mundën ta gjejnë. Ndofta era që frynte nga ana e kundërt ose kundërmimi i fortë i luleve bënë që qentë të mos e ndjenin erën e drenushës dhe të mos e zbulonin dot.

- Po largohen, ja po largohen – murmuriti lehtë pjergulla, e kënaqur që e shpëtoi drenushën e gJORË nga vdekja e sigurt.

Drenusha zgjati kokën përmes fletëve dhe vuri re se vërtet qentë dhe gjahtari ishin larguar mjaft.

Po a e dini se ç’bëri atëherë drenusha? Ajo e harroi shumë shpejt të mirën që i kish bërë pjergulla dhe pa pikë turpi nisi të hajë njërën pas tjetrës fletët e pjergullës që e kish shpëtuar nga rreziku.

Pjergulla u ankua për këtë mosmirënjohje dhe për sjelljet e këqija të drenushës; po ajo as çante kokën fare dhe bënte sikur s’i dëgjonte ankimet e mirëbërëses.

Kur u ngop mirë e mirë dhe e la pjergullën gati lakuriq, pa fletë, doli jashtë.

Në atë kohë gjahtarët dhe qentë po ktheheshin përsëri. Ata e panë e i lëshuan qentë, të cilët e kapën, e shqyen dhe e bënë copë-copë.

Duke lëshuar lot hidhërimi për të keqen që e gjeti, mbasi mbeti pa rroba, pjergulla kur e pa drenushën të copëtuar, tha me anën e fletëve të pakta që fërfëllinin:

- Atje ku ha bukën mos përmbys kupën, se mund të pësosh keq, moj drenushë.

Nonda Bulka

Përrallëzat (fabulat)

Shpjegimi për përrallëzat popullore me pak fjalë është dhënë në librin e klasës së pestë. Megjithatë, këtu po e zgjerojmë shpjegimin. Përrallëzat janë tregime të shkurtra në të cilat kafshët dhe bimët luajnë rolin e personazheve. Nëpërmjet këtyre viben në pah disa dukuri e marrëdhënie shoqërore. Bashkë me përrallat ato janë ndër krijimet më të vjetra popullore. Origjina e tyre është shumë e lashtë, që prej kohës së njeriut primitiv. Populli nëpërmjet të një humori therës me anë të përrallëzave kritikon dobësitë e njeriut në përgjithësi. Përrallëza ka qenë një armë e fortë për të kritikuar në mënyrë të tërthortë realitetin shoqëror, atëherë kur shumë konstatime të vërteta nuk mund të thuheshin haptas. Shumë përrallëza mund të shërbejnë edhe si mjet edukues e didaktik. Përrallëza kanë shkruar: Ezopi, La Fonteni, Naimi, Çajupi etj.

PËRLESHJA ME PESHKAQENIN

Natën deti është i tmerrshëm për ata që nuk e njohin. Po unë e dua detin. Dhe ai më do shumë mua. Deti është si një nënë zemërgjerë. Po e deshe nënën, ajo ç' nuk bën për ty. Por, po nuk e deshe, po e mërzipte, po e mashtrove, ajo të nëm dhe mallkimi i saj është shumë i rëndë. Mallkimi i nënës të zë! Mua deti kurrë s' më ka mallkuar, se unë kurrë nuk jam zemëruar me të...

Më lindi një mendim i mrekullueshëm. Mora një levrek të madh nga ata që kisha nxjerrë, i çava barkun dhe i futa brenda një dinamiti të tërë. Fitolin e lashë të gjatë. Kur sillej peshkaqeni ja, aty poshtë, ndeza fitilin dhe e vërvita në det levrekun me dinamiti në bark. Peshkaqeni, me ta parë, e gëlltiti. Unë desh u çmenda nga gëzimi. Prisa nga çasti në çast që të pëlciste dinamiti. "Ma more të keqen!" – i thashë me zë. Dhe në këtë kohë u dëgjua një plasje e thellë, si në fund të dheut. Peshkaqeni bëri dhjetëra rrokullisje të shpejta si elika gjigante e vaporit. Herë i dukej koka mbi det, herë i dukej bishti. Deti u turbullua, sikur po bëhej kiameti. Peshkaqeni ende po rrokullisej si një përbindësh i tmerrshëm. Sa i fuqishëm që ishte! Kurrë s' e besoja që peshkaqeni të mos ngordhte duke i plasur dinamiti në bark. Edhe shkëmbi çahet e thërrmohet nga dinamiti!

Prita shumë minuta për të parë se ç' do të ndodhte. Peshkaqeni po e humbiste

forcën. Pak nga pak e rralloi rrotullimin. U zgjat. E, kur e pashë të kthehej me barkun nga dielli, thirra: “Ta mora hakun, baba!” Prita se mos dilte mbi ujë. Më kot. Ai po fundosej dhe arriti ja, mu aty te ajo gropa e thellë që shikoni. Atje u shtri si një nëndetëse. Ç’ të bëja? S’më punonte mendja nga gëzimi. Menjëherë mblodha litarin e gjatë. Mora frymë thellë dhe me shpejtësinë e forcën e predhës u krodha në thellësi. I afrohesha. Sa i madh që dukej! I drejtohesha picingul kokës së tij, po s’kisha ç’ti bëja. Brenda në ujë mendova t’i futja thikën thellë në kafkë e pastaj të lidhja litarin... Mirëpo, ah! Kur u afrova, ai më shikoi me ata dy sytë e tij të xhindosur dhe lëvizzi bishtin. Ende s’kishte ngordhur! Iu turra dhe e rroka prej koke me të dy krahët. Dy gishtërinjtë e mëdhenj ia futa te sytë! M’u duk sikur kisha mbërthyer një trung ulliri. Ai “përt” ia bëri dhe më rrëmbeu e më solli disa herë rrotull. Ngriti shpatën e tij mprehëse të qafës dhe më çau, mu këtu... në gjoks. Unë e shtrëngova më me fuqi. Dhe dy gishtërinjtë e mëdhenj ia futa edhe më thellë në sytë e tij. Përsëri bëri ca rrotullime të shpejta. Menjëherë, kur e pashë se po fundosej bashkë me mua, nxora thikën dhe, me sa fuqi që kisha, ia ngula thellë në tru. Pa humbur kohë, në dorezën xhungë të thikës, ngula dhe përdrodha grepin e duke mbajtur bishtin e litarit, u gjenda mbi ujë. Më plasi gjaku nga veshët dhe nga hunda. Nga gjoksi gjaku s’pushonte. U shtriva si i vdekur mbi ujë, që të çlodhesha. Më kishin shteruar fuqitë. E ndieja veten si në bark të peshkaqenit. E dija se ç’duhej të bëja, po ja që s’kisha fuqi as të lëvizja gishtin. M’u duk sikur po më tërhiqte. Çela sytë. Me të vërtetë ai po më tërhiqte. Ende s’kishte dhënë shpirt!

Mblodha gjithë forcat e mia dhe me mundime mbinjerëzore arrita shkëmbin, ja, mu aty. Lidha fort litarin dhe erdha dhe u shtriva mu këtu si i vdekur. Kur erdha në vete, ishte pasdreke. Gjaku më ishte mpiksur në gjoks. Ndjeva dhembje therëse. U ngrita. Pashë se peshkaqeni ishte aty, i mbërthyer dhe i ngordhur. Kjo më gjallëroi. Ashtu është. Kur del fitimtar, njeriu, edhe i vdekur, ngjallet. Fitorja të ringjall e të jep forca të reja.

Petro Marko

Shënim

Ky fragment është shkëputur nga romani “Shpella e Piratëve”.

Kjo është një vepër shumë e bukur për fëmijë. Në të bëhet fjalë për një ekspeditë të fëmijëve që arrijnë deri te Shpella e Piratëve, duke kaluar në shumë peripeci.

Petro Marko është një nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë sonë.

Ai është autor i shumë romaneve si dhe tregimeve për fëmijë.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

kridhem – zhytem

levrek – peshk i ujërave të kripura me mish të shijshëm

picingul – me kokën poshtë e këmbët lart

i xhindosur – i zemëruar shumë, si i tërbuar nga zemërimi



Bisedë rreth tekstit

Me kë e krahason shkrimtari detin dhe pse?

Si përshkruhen përpëlitjet e peshkaqenit?

Tregoni me fjalët tuaja përleshjen e fundit me peshkaqenin.

Ç'kuptoni me këto fjalë “Fitorja të ringjall e të jep forca të reja”?



Detyrë

Gjejeni romanin e bukur “Shpella e piratëve” dhe lexojeni.

Romani fantastiko-shkencor

Romanet e këtilla si Shpella e Piratëve e shumë të tjera në të cilat përshkruhen ngjarje që na duken jo të besueshme, jo të vërteta, por që mund të realizohen në të ardhmen, quhen romane fantastiko-shkencore. Në to mbretëron imagjinata krijuese.

SUBJEKTI

Çdo vepër letrare ka kompozicionin e vet. Në veprat epike (në prozë) paraqiten personazhe që flasin me gjuhën e tyre nëpërmjet dialogëve dhe monologëve. Në veprat lirike zotëron gjuha lirike e autorit, i cili shpreh botën e vet shpirtërore. Në gjininë dramatike zotëron gjuha e personazheve.

Subjekti është vargu i tërë ngjarjeve që sillen rreth një konflikti të caktuar, ku janë përfshirë personazhet e veprës letrare.

Subjekt kanë vetëm veprat e gjinisë epike, epiko-lirike e dramatike (skica, tregimi, novela, romani, poema, komedia, drama etj.).

Veprat poetike, meqë shprehin kryesisht botën e brendshme shpirtërore, ndjenjat e poetit nuk kanë subjekt, ose kanë vetëm disa elemente të veçanta subjekti.

Subjekti i shërben përmbajtjes, temës dhe idesë poetike të veprës.

KOMPOZICIONI

Edhe kompozicioni është element i formës. Nuk ka vepër letrare pa kompozicion. Kompozicioni është mënyra se si ndërtohet vepra letrare, si paraqitet subjekti dhe gjuha, si grupohen e si zëbrtheben, si bashkohen në një tërësi të vetme të gjitha elementet e veçanta të veprës.

Në kompozicion dallojmë: *Zhvillimin e veprimit që përbën ballkën e subjektit, shpjellimin e ngjarjes. KULMINACIONIN – çastin kur subjekti a ngjarja arrin kulmin e acarimit. Zakonisht këtu zbulohet plotësisht thelbi i temës qendrore, ideja poetike dhe domethënia e karaktereve të personazheve kryesore dhe ZGJIDHJEN E VEPRIMIT – Shurjen ose përfundimin e natyrshëm të subjektit. Shpesh zgjidhja vjen menjëherë pas çastit kulmor.*



Petro Marko
(1913-1991)

Petro Marko lindi në fshatin Dhërmi të Himarës më 1913. Është luftëtar vullnetar i Spanjës. Ka shkruar vjersha, skica, tregime, reportazhe, romane etj. Pas çlirimit krijoi një varg romanesh nga më të njohurit në letërsinë shqiptare, si: “Hasta la vista”, “Stina e armëve”, “Qyteti i fundit”, “Ara në mal”, “Ultimatumi” etj.

E DI NJË FJALË PREJ GURI

Kosovës së gjerë valojnë arat e grurit
e u digjet kokrra etit të djersës sate,
Kosovës së gjerë, ballit t’lavruar,
flokun i kalliut hidhet si flok vashe.
Ndër logje t’saj, thonë, hapin e ke të erës,
Ndër ara t’saj, thonë, duart i ke të gurit,
ndër suka t’saj, thonë, supet i ke t’Sharrit,
ndaj toka e bukës s’mbetet shterpë. Korriku
shkrep nga syri yt e i merr gjithë fushat
e n’pishë të diellit shkumbon toka shtatzanë
gjithë ditën e lume, derisa një muzgu
s’del një vashë me shtambë nga lulet e gjakut

dhe me dy gishta e ngjyen me të kuq perëndimin
e ta derdh ndër muskuj pak lëng zanash
e t'përbën n'atë benë e lashtë të bukës:
Ngreu, or trim, se plasën kallinjtë e gjinkallat.

Azem Shkreli



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

etit – dëshirë e madhe, e zjarrtë për diçka, dëshirë për të pirë ujë
t'lavruar – të lëruar, të pluguar, këtu: i është lëruar, rrudhur balli nga lodhja e mendimet
log-u (sh.logje) - lëndina të vogla, zakonisht në mal a në mes të pyllit, shesh i vogël, vend i rrafshët
sukë-a – vend i ngritur si breg në një fushë, kodrinë
shterpë-a – që nuk shtohet, nuk lind
ditën e lume – ditën e bekuar, e ndritur
lëng zanash – këtu: qumësht zanash siç i dhanë zanat Mujit te cikli i Kreshnikëve



Bisedë rreth vjershës

Kujt i këndon autori?
Cila është ideja e kësaj vjershe?
Ç'vjersha të tjera keni lexuar nga ky poet?
Për cilën stinë bëhet fjalë?



Detyrë

Gjeni figurat letrare në këtë vjershë.

MËNGJESI

A di përse këndesi po këndon
Me natë dhe nga gjumi po të zgjon?
Që shkoi një ditë po të lajmëron;
Dhe ti, shkujdesur, fle dhe ëndërron.

Zgjohu! Mëngjesi me shigjetë e grisi
Perden e natës, yjt i arratisi
Dhe dielli gjahtar me rreze kapi
Çdo majë mali e pallati e lisi.

Qesh trëndafili e thotë: “Lulëzoi
Dhe botës bukurinë po ia shtoi
Pastaj e hap kuletën e mëndafshtë
Dhe përmbi kopsht thesarin po e shtroi”.
Mbi lulet po pikojnë vesë retë,
Dhe me një zë qiellor bilbil’ i shkretë:
Ah verë! Verë! Verë! Trëndafil!
I lyp të skuqë faqëzën e zbetë.

Omar Kbajami



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

me natë – pa u gdhirë, pa dalë drita
thesar – tërësi gjërash të çmuara, sendesh a monedhash të arta që mbahen në një vend të sigurt.



Bisedë rreth vjershës

Përse bëhet fjalë në këtë vjershë?
Ç’lajmëron këndesi?
Si e paraqet poeti mëngjesin në këtë poezi?



Detyrë

Gjeni figurat letrare në këtë vjershë.

VËLLAZËRI E INTERES

Skëna XVII

(KOCI, MARGA)

Koci: A e pe se ç'pësuam?

Marga: E pësuam shumë keq, po prapë të themi shyqyr, që u ndoth Miti e na shpëtoi nga një shnderim i math, se ku do futeshim nga bota?

Koci: Pse u nxituam kaqë fort? Ti e ke fajin!

Marga: Unë, apo ti? Më duket se ti e ke më tepër! Ti e ke vëlla e duhej të silleshe mirë, mos më shëko mua!

Koci: Po ti pse jo? Pse s'u solle dobaremi ti mirë? Po thuaj se gabuam që të dy e hidhi gunën tani!

Marga: Sido që të themi, është e kotë! Tashti të shohim ç'do bëhet!

Koci: Ta merr mendja se munt të na nxjerrë jashtë Miti, dyke çfryrë për sa folmë ne?

Marga: Atë s'e bën kurrë Miti, se i vjen turp nga bota, po të paktën le të na lerë të rrimë pa qira, pa s'ja themi as priftit! Për Mitin mjafton të na ketë nën thundër, që të mos kemi sy e faqe të flasim gjë, pa atë që thua s'e bën kurrë aj!

Koci: Fundi për hajr, do ta shohim edhe këtë!

Skëna XVIII

(Të parët, MITI)

Miti (Hyn brenda i veshur bukur, me kapelë të lartë, me gante, me bastun, me sahat me qostek të florinjte, me një tabaro amerikane lluks, tamam si një gjentëlmen amerikan). Më falni, se ardhja t'ju trazoj edhe një herë!

Koci, Marga: Urdhroni, urdhëroni vëlla i dashur!...

Koci (Afrohet ta zërë për qafe): Vëlla i dashur, të kam vëlla, vëlla!...

Miti: Ngadale, ngadale, mos më zërë, mos të të ngjit ndonjë morr!

Marga (Fillon t'i hidhet për qafe):

Miti: Ruaju, ruaju se unë kam tabore morrash përsipër! (E largon).

Koci (Miti): Të kam vëlla, s'na ndan gjë!

Marga: Je shpëtimtari ynë!

Koci: Aman, Miti, xhan, shpirt, na e fal gabimin!

Marga: Ma fal edhe mua; një copë grua jam, lesh-gjatë e mendje-shkurtër!

Miti: Pse, xhanëm, pse? Ju s'më keni bërë ndonjë faj, pse bëni kështu? Pa lini këto tani dhe uluni t'ju flas...

Koci: Urdhro e ri, zotërote, më parë.

Miti: Unë s'munt të ri mbi kanapënë t'uaj se jua ndynj.

Marga: Bah, bah, bah, fjalë është ajo për të thënë?

Miti (Margës): Ma the, zotërote, dhe e vura ndërmënt, prandaj po ruhem! Uluni, ju lutem e më ndëgjoni! (Koci me Margën unjen). Tani me Ballaurin s'kini më punë, ajy e mori gjer më një hesapin e borxhit që i kishit dhe hoqi dorë. (Nxjerr nga xhepi një akt noterial). Ja, ky është akti noterial, që Ballauri pohon se mori prej jush 250 e ca lira turke dhe jua shpengoi shtëpinë, pra, shtëpija është e juaja dhe e gëzofshi!

Koci me Margën (duke fshirë sytë vijnë t'i puthin dorën Mitit, po Miti i largon): Faleminderit fort e fort!

Miti: S'kini përse; është një detyrë e një vëllajt kjo!

Koci: Të na rrosh e të të kemi sa malet!

Marga: Ti je shpëtimtari ynë! Ti s'na le të turpërohemi! Të solli Perëndija këtu, që të mos shnderoheshim fare!

Kristo Floqi

KOMEDIA

Komedia është një lloj i gjinisë dramatike, ku kryesisht pasqyrohen dukuri shoqërore të shëmtuara dhe të ulëta, që viben në lojë dhe goditen përmes ironisë dhe sarkazmës.

Ndryshe nga tragjedia, që përfundon me dhembje, me vdekjen e personazhit kryesor komedia, zakonisht, mbaron në mënyrë të gëzueshme, në të mirë të personazheve pozitive.

Komedi të bukura kanë shkruar Aristofani, Shekspiri, Molieri, Gogoli etj.

Një nga komeditë e para të letërsisë shqiptare është komedia "14 vjeç dhëndër" e Çajupit.

Komedi të bukura janë dhe "Karnavalet e Korçës" e Spiro Çomorrës, "Zonja nga qyteti" e Ruzhdi Pulahës etj.

Monolog është kur aktori flet vetë në skenë, ose u drejtohet të tjerëve.

Dialogu paraqitet kur në skenë flasin dy ose më shumë persona.



Detyrë

Teksti është shkruar në një nga dialektet e shqipes. Shkruajeni në gjuhën letrare.

PESHA E DHEUT

(DRAMË)

SKENA E PARË

Skena është e ndarë në m b i s k e n ë me tavolinë të gjatë për mbledhje të forumeve të rangut të lartë, rreth së cilës janë radhitur kolltuqe të viteve tridhjetë të këtij shekulli. Paraskena në rrafsh më të ulët përfaqëson këndin e një dhome të një diplomati, po ashtu me mobilie të stilit të njëjtë. Në të majtë të skenës, këndi i një shtëpie beu, po të këtyre viteve. Në të djathtë, zyrë policore të ish-Jugosllavisë të viteve tridhjetë të këtij shekulli. Me lojën e dritave, sipas veprimeve skenike, ndërrohet njëra pjesë e skenës, ndërsa tjetra errësohet. Pjesa e përparme e skenës është e lirë dhe shfrytëzohet sipas nevojës. Në çdo skenë vijuese, mbiskena mbetet e pandryshuar. Përsëritet hyrja e diplomatëve për hartimin dhe miratimin e Konventës për shpërngulje. Këta, në çdo skenë hyjnë me hapa ritmikë si figura të dyllosura dhe ulen rreth tavolinës rrotullake.

Në kolltukun kundruall është ulur gazetari me veshje elegante, kurse në këmbë, duke u endur për një çast, është diplomati, i cili sjell një gotë uiski, I ofron gazetarit dhe një e mban për vete.

DIPLOMATI: T'i cakrojmë!

GAZETARI: Kemi edhe arsye...

DIPLOMATI: Arsye?! Do të shohim.

GAZETARI: Mos u brengosni! Metodat e mia janë të sprovuara. Këtë çështje e kam studiuar mirë, sepse më ka angazhuar enkas vetë Kabineti. Konstatova se ndikimi im në qarqet e këtushme është i mirë. E njoh mendësinë e këtij mileti. Sidomos qarqet më të dalluara. (Me djallëzi) Kryesorja është të shembim strumbullarin se pastaj çdo gjë shembet, si kullë kashte.

DIPLOMATI: (Qesh me djallëzi) Po e hoqe fillin e perit, puna shthuret si të dëshirosh. Besoj se e keni të njohur se delegati ynë në Lidhjen e Kombeve kishte biseduar me shkëlqesinë e Tij, ministrin e punëve të jashtme të qeverisë Tuaj, rreth çështjes së migrimit. Kishin pasur mirëkuptim të plotë. (Pushim i shkurtër). E pse jo? Ish bërë fjalë në nivel ministror.

GAZETARI: E kam të njohur.

DIPLOMATI: Për ju biseduam në mbledhjen ndërministrrore dhe u shprehën mendime shumë të larta për aftësitë tuaja lidhur me këtë çështje. Ekspert i vërtetë, kishin thënë. E njeh mirë parandjenjen e këtij elementi që ka tendencë për brumosje të re, natyrisht në vendin e ri...

GAZETARI: Ju faleminderit për komplimentin. Do të përpiqem ta arsyetoj bindjen tuaj

DIPLOMATI: Atëherë ç'na mbetet?

GAZETARI: T'i hyjmë punës me zell. Edhe njëherë do ta analizojmë sheshin e disponimit... Do të angazhohemi në përgatitjen e rrafshit psikologjik. Do të konstatojmë a dëshirojnë këta elementë të shkullen me dëshirë ose me dhunë.

DIPLOMATI: Mbetet të dëshmohet kjo e vërtetë. E dimë s'do ta kurseni as mundin e fundit. Qeveria jonë ka besim të plotë në rolin tuaj.

GAZETARI: Dhe nuk gabon. Do të binden në efikasitetin e metodave të mia. Ne kemi hartuar programin konkret për këtë element. Do t'i dëbojmë nga këto troje pa telashe... Njerëzit tanë janë futur në gjirin e këtij mileti dhe punojnë në këtë drejtim.

DIPLOMATI: Kam nderin t'ju informoj se një komitet i specializuar për këtë çështje ka hartuar një elaborat për mënyrat, format dhe mjetet për shkulljen e këtij elementi. Është element që pengon shtrirjen e jetës sonë normale, ndërsa juve ju begaton. Së shpejti do ta keni në disponim dhe shpresojmë se do të ndihmojë veprimtarinë tuaj.

GAZETARI: Me siguri do ta keni të mirëseardhur.

(Me këtë çast një zonjushë e bukur dhe e re hyn me rrëmbesë)

DIPLOMATI: O, Lepa! Erdhe? Mirë se erdhe. T'jua prezentoj, miku im... Gazetar i huaj... Por i yni.

LEPA: *(Me elegancë të tepruar)* O, gëzohemi! Unë jam Lepa.

GAZETARI: Më bën kënaqësi... Jashar, shkurt Sharr.

DIPLOMATI: *(Lepës)* Herët e paskeni kryer kursin e frëngjishtes?

LEPA: Po, e mbaruam leksionin dhe... orevuar *(me ledhësi)*.

DIPLOMATI: E kemi si të lazduar këtë mbesë por ja na e gjallëron ambientin.

GAZETARI: Nëse dita varet nga mëngjesi, ky kontakt i parë me mbesën tuaj lë përshtypje se do të kemi ditë të bukura...

LEPA: Më mbuluat me komplimente, jam e detyruar që konstatimin tuaj ta dëshmoj në vepër, posa të më jepet mundësia. Mos harroni se jam duke përvetë-

suar një gjuhë të civilizuar... Frëngjishtja është gjuhë damash dhe e diplomacisë. Apo jo, zoti Jashar? (Me theks frëngjisht)

GAZETARI: Siurdhëroni zonjushë! Më ngazëllen stili juaj i bisedës. Ka tone të një maturie të ëmbël. Duket se silleni në qarqe diplomatike. Sa me origjinalitet u qaseni gjërave!... Zili mund t'ju kenë shoqet tuaja.

LEPA: Më pëlqen komunikimi natyror, pa protokoll e formalitete.

DIPLOMATI: (*Duke u afruar me gota në dorë*) Ju, si duket gjetët gjuhë të përbashkët. Mbesa ime ka kriter seleksionues ndaj njerëzve. Me ju gjeti interferencë të njëjtë valore...

GAZETARI: Kur gjen gjuhë të përbashkët edhe zemrat gëzohen.

Duket se keni sens të veçantë për t'i përvetësuar njerëzit që i doni. Lepa, më lejoni t'ju emëroj e t'i shfaq emocionet e mia natyrore ndaj jush. Më kënaq prania juaj.

LEPA: Ju faleminderit! Thonë se ç'ndjenja ushqen tjetri për ty, pyete zemrën tënde... Apo jo dajë?

Nexhat Mustafa

Shënim

Tëma që trajton kjo dramë është historia më e trishtueshme e popullit tonë pas Luftës së Dytë Botërore - shpërnguljes për në Turqi me detyrim nga pushteti i kuq famëkeq për shqiptarët. Autori këtu paraqet rezistencën e shqiptarit dhe torturimet nga pushteti.



Bisedë rreth dramës

Cila është ideja e këtij fragmenti?

Cili është personazhi që ju frymëzon?

Ç'është të nxjerrim si mësim nga kjo pjesë?

Drama

Është një shfaqje që, me ndihmën e fjalës e të veprimit, përfytyron konflikte të ndryshme të interesave vetjake ose shoqërore të njerëzve, pa pasur karakter tragjik. Krijimet dramatike kanë këtë strukturë:

Akti - është pjesa e krijimit dramatik, që luhet në skenë që nga çasti kur ngrihet perdja deri në mbylljen e saj.

Pamja - është pjesa më e vogël e aktit (praktikohet në rastet, kur akti është i gjatë dhe ka nevojë të ndërrohet skena).

Skena - sajohet atëherë kur në skenë paraqitet ose largohet një person (aktor), i cili shkakton ndryshim.

Radiodrama

Radio drama është një lloj drame që e cila nuk shfaqet në skenë, por interpretohet nga aktorët. Ajo incizohet në shirit magnetofoni dhe transmetohet nëpërmjet valëve të radios, por jo para publikut.

Ka një strukturë më të thjeshtë se drama dhe shumë elemente skenike plotësohen me efekte të ndryshme muzikore e tingullore.



KUR NISA TË SHKRUAJ VARGJE

Kur nisa të shkruaj vargje
për erën, lulet, tokën,
fshatarët qeshën dhe fshatarçe
me mua duart rrokën.
Dhe thanë: në libra le të hyjë
aroma, bari i njomë,
dhe flladi nëpër fletë të fryjë,
dhe er' e djersës sonë!
Të hyjë në libra jeta jonë,
në varg të hyjë si dritë,
siç futet dielli përgjithmonë
dhe na ndriçon shtëpitë!
Të hyjë zhurma e traktorëve
dhe zëri i njerëzisë,
të hyjë toka shekullore
dhe afshi i poezisë!

Dbori Qiriaz



Bisedë rreth vjershës

Kjo është një poezi e bukur lirike. Ideja kryesore e shkrimtarit është që poezia të shkruhet për punëtorin, njeriun, natyrën dhe shoqërinë. Ç'farë gjen njeriu në librat?

Po në këto vargje?

Të hyjë në libra jeta jonë,
në varg të hyjë si dritë,
siç futet dielli përgjithmonë
dhe na ndriçon shtëpitë!

I BURGOSURI DHE LIBRAT

Ai kaloi shtatë vjet në burg. Natën, kur të burgosurit luanin me zare dhe tregonin barcoleta e anekdota të ndryshme, ai rrinte shtrirë në krevatin e tij të ngushtë dhe lexonte libra. Lexonte biografitë e muzikantëve, tregimet e Gorkit dhe të shkrimtarëve të tjerë.

- Ç'e ke atë libër nën sqetull? – pyeste me mosbesim.

Nexhati shtangej. Ai nuk përgjigjej menjëherë. Kur talljet e kujdestarit dhe të rojave kapërcenin çdo masë, ai zbriste në birucën e vet.

Kujdestari i burgut e pyeste duke i hedhur thumba:

- Nexhat-bej, sa shkollë ke bërë?

Nexhati përgjigjej rëndë-rëndë:

- Isha punëtor, s'kisha nge të mësoja, punoja për të nxjerrë bukën e gojës.

- As filloren nuk munde ta mbaroje?

- Nuk munda.

- S'ke bërë as dy vjet shkollë?

- Jo.

- Atëherë çfarë kupton nga ky libër?

Nexhati heshte, kridhej në mendime.

Pas pak kohësh kujdestari i burgut përsëri e pyeti.

- Nuk më thua, çfarë kupton nga ky libër?

Nexhati, pasi mendoi një copë herë, u përgjigj:

- Ai që e shkroi këtë libër ishte ashtu si unë, njeri pa shkollë.

Kujdestari ia krisi të qeshurit.

- Ç'thua, ore, ai paska qenë, ashtu si ti, njeri pa shkollë?!

Nexhati nuk u përgjigj. E urrente kujdestarin e i dhembte shpirti.

- Po si u bëka kështu, Nexhat-bej? Edhe gjysmanalfabetët ditkan të shkruajnë libra? Atëherë u dashkan mbyllur shkollat dhe institucionet arsimore?

Nexhati s'hapi gojë. Po kujdestari dhe të burgosurit e tjerë që rrinin aty afër prisnin përgjigjen.

- Në qenka kështu, shkruaj edhe ti një libër.

Nexhati nuk u përgjigj. I silleshin vërdallë disa mendime në kokë. Vetvetiu mendonte një ditë të shkruajë një libër për këta budallenj të mëdhenj që dinë vetëm t'i torturojnë njerëzit nëpër burgje.

Nexhati vazhdonte të lexonte libra revolucionarë. Një shok që e kishte kuptuar shpirtin revolucionar të Nexhatit i tha: - Do që të këndoje simfoninë e nëntë?

Ai nisi... Pak nga pak po e pushtonte një valë mallëngjimi, melodia po kumbonte fort e më fort, iu mbyllën sytë, lotët po i rridhnin nëpër fytyrë, fytyra iu çel, rrudhëzat po i sheshoheshin. Atë çast u hap dera e te pragu u duk roja.

- Ç'po bëhet këtu? E paske bërë burgun kishë!

E, kur Nexhati u zhduk, e ndoqën pas të qeshura therëse.

Orban Qemal



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

s'kisha nge - s'kisha kohë



Bisedë rreth tekstit

Cili është personazhi kryesor i tregimit dhe ku gjendej ai?

Tregoni përmbajtjen e këtij tregimi.

Çfarë ndjenja ngjalli te Nexhati simfonia e nëntë (fjala është për simfoninë e nëntë të Betovenit)?



Detyrë

Lexojeni tekstin dhe bëni një hartim.

RREZJA NË LITAR

Prej gojës së përgjakur t'agimit
lindi foshnja e tij – rrezja e parë –
e me dritën e bebzave të shuara
u këput, duke u kalamendur në litar.
Me kthetrat e ftohta të trishtimit
xhelati hesht si mumja e gjallë.

- Hej, qafa ime bardhoshe,
që ende dor' e nxehtë djaloshi
me afsh nuk të ka përkëdhelur!
Duart e xhelatit e laku i tij
për ty qenkan dhurat' e mbrame,
fati dhe shtegu im i fundit!

Përpara nuk dija
shoqja ime e panjohur,
që vetëm emrin ta dëgjoj – Liri,
sa aq mahnitëse është drita jote,
sa veten njeriu ta harrojë,
sa veten njeriu ta bëjë fli!

E di – kënga jote do t'i thyejë
ku shekujt na ndrydhën n'robëri,
Shoqja ime e panjohur,
që vetëm emri yt më ngroh
e të ruaj si xhevahirin në gji!

Kujt t'ia lërë kujtim
ëndrrat e shpresat e rinisë?
Ec shikimi im i këputur!
Lodro nëpër sytë e brezave
dhe këndoju këngën e nisur
në buzët e mia t'shkrumuara!

Enver Gjerqeku

Shënim

Vjersha “*Rrezja në litar*” është një ndër krijimet lirike më të mira të poezisë sonë që i janë kushtuar heroinës sonë Ganimete Tërbeshit. Shikoni se me ç’ndjenjë të ngrohtë, plot figura të qëlluara poetike, të thjeshta e të kuptueshme, poeti i ngre një himn femrës e cila sakrifikoi rininë e saj për një të nesërme më të bukur për shoqen e saj “të panjohur”.



Bisedë rreth vjershës

Vargjet e fundit të vjershës kanë një kuptim simbolik.
Cila është simbolika e tyre?
Kujt i këndon poeti në këtë vjershë?



Detyrë

Përmendni shembuj të tjerë të qëndresës heroike të femrës shqiptare kundër armikut.

DHE PRANVERA ERDHI

... Dhe pranvera erdhi...

Nëpër ftyra tona rrëshqiti një gëzim
dhe ndër zemra tona ngriti një fole,
e një jetë e bukur e një jet e re,
me dëshirë të shumta, po buzqesh në lulzim.

...Dhe dalldysha erdhi...

Si shpirti n'ekstazë, në hovin e shejt shtri
me qiellin rroket, me diellin puthet,
dridhen krahët në hare – mandej poshtë vërsulet
tue dhurue me cicrim përshëndetje një mijë.

...Dhe vesa shkëlqen...

Në një pikë t'argjendt pasqyrohet jeta,
tërheqëse si andrra dhe si vizatimi
ndër orët e hyzimit, kur shpërthen agimi
e rrezet e arta rrëshqasin ndër fleta.

Migjeni

Shënim

Në këtë vjershë autori duke ëndërruar për një të ardhme të lumtur i këndon jo vetëm pranverës në natyrë, por edhe asaj pranvere për të cilën ai shpreh besimin se do të vijë edhe në atdheun e tij dhe do të gëzojë mbarë popullin.

Në të kuptohet se kemi pranverë në natyrë, por edhe një pranverë tjetër (gëzim të madh) në shpirtin e poetit, që shkojnë përkrah dhe e japin më bukur gjendjen e përgjithshme.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

ekstazë-a – gjendje shpirtërore shumë e gëzueshme e një njeriu, dehje lumturie

ndër orët e hyzimit – këtu: në kohën kur yjet fillojnë e zhduken, se afron agimi

fletë-a – këtu: gjethe, fletë pemësh



Bisedë rreth vjershës

Me ç’kuptim e përdor poeti emrin pranverë?

Si e kuptoni vargun “Një jetë e re... po buzqesh në lulzim?”


Shpjegoni kuptimin e fjalive: “rëshqiti një gëzim”, “ngriti një fole”, “me qiellin rrocket”, “me diellin puthet”, “në një pikë t’argjendt pasqyrohet jeta”, dhe tregoni pse i përdor autori ato?

Si mund t’i shprehim ndryshe këto mendime?



Detyrë

Gjeni sinonimet e fjalëve të kësaj vjershe:
rëshqas, fole, hovi, rrokem, hare.



Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni është poet e prozator, është përfaqësuesi më i shquar i letërsisë demokratike para Çlirimit. Lindi në Shkodër dhe ka punuar si mësues në fshatrat e këtij qyteti. Libri i tij me vjersha titullohet “Vargjet e lira”. Në të njëjtën kohë, ai ka shkruar me urrejtje të madhe kundër pasanikëve dhe çifligarëve të pamëshirshëm, kundër të gjithë shfrytëzuesve.

Millosh Gjergj Nikolla
Migjeni
(1911-1938)

DEBUTIMI IM NË BURGTEATËR

Kur jetoja në Vjenë, isha i ri dhe i varfër. Për të fituar bukën, u jepja mësimë private të gjuhës italiane disa nxënësve. Në atë kohë e ardhmja më ishte shumë e errët. Nevoja për të jetuar, oreksi i madh, zorrët që më gërryenin, më detyruan të punoj si figurant në Burgteatër duke marrë çdo mbrëmje një shpërblim fare të vogël. Që të them të drejtën, pa u mburrur nuk isha figurant, po ndihmësfigurant, ose më mirë të themi statist i thjeshtë. Për punën që bëja, merrja 1,35 marka për çdo shfaqje. Si statist, luajta rolin e një plaku grek në pjesën “Mjeshtër Palmira” dhe atë të një plaku romak në tragjedinë “Jul Çezari”.

Por ja, në komedinë e Molierit “Tartufi” m’u dha gabimisht roli i shërbëtorit të Tartufit, që kishte një emër: ai quhej Lorend. Roli nuk ka asnjë fjalë, por atij i flet Tartufi, që e interpretonte Jozef Kainci. Atë unë e kisha parë shumë herë, kurse ai mua asnjëherë. Tartufi hyn në skenë nga ana e majtë, i përcjellë prej shërbëtorit. Para se të dilnim në skenë, unë isha afër Kaincit dhe i thashë “mirëmbërëma”, por ai nuk ma vuri veshin dhe as më shikoi. Me gishtin tregues të dorës së djathtë, hoqi pluhurin nga sipërfaqja e një mobiljeje dhe i tha inspektorit të skenës: “Duhet të kujdeseni që të ketë më shumë pastërti në teatër?!” Inspektori i nevrikosur iu përgjigj: “Zotni Kainc, ju lutem hyni në skenë” dhe shtoi, duke u drejtuar nga unë: - “Edhe ju”.

I gatshëm dhe i shpejtë. Kainci filloi rolin e vet: “Lorenc, o shërbëtori im, më përgatit petkat e pendesës...” Në çast Kainci ngre sytë, shikimet tona kryqëzohen, ai thotë edhe tri fjalë dhe i mbahet goja.

Sufleri, një burrë i moçëm mjekërrosh, i kujton aktorit fjalët e rolit. Mua më mbulojnë djersë të ftohta. Inspektori vrapon si një shpëtimtar dhe, më në fund, e ndihmon Kaincin të dalë nga kjo gjendje e vështirë.

Pengimi që i ndodhi Kaincit, pati pasoja, jo për të, po për mua, pasi të nesërmen, nisën të më kërkojnë nëpër gjithë Vjenën. Kur më gjetën, më thanë se zoti këshilltar mbretëror, doktor Shlenter, kërkonte të fliste me mua! Nga këto fjalë unë u trondita shumë. Iu paraqita Shlenterit, i cli me njerëzit më tha që t’i recitoja diçka. “Nuk di gjë përmendësh”, i thashë dhe i premtova se do të mësoja diçka. Pas një bisedë të shkurtër me kolegët e mi figurantë, vendosa të mësoj diçka nga Rikardi III”.

Këtë ia recitova doktor Shlenterit me një gjuhë të keqe; por ai, si guximtar që ishte, më paraqiti para kolegjiimit drejtues të Burgteatrit. Të gjithë personalitetet e mëdhenj si: Sonetali, Levinski, Bermajsteri, Harmani e të tjerë, pas një diskutimi serioz, vunë nënshkrimet e tyre në një copë pusullë, ku edhe sot mund të lexohen këto fjalë: “Aleksandër Moisiu, lindur..... baba..... shkolla e tjerë, është i paaftë për t’u bërë aktor”. Po rrugët e fatit janë të çuditshme dhe unë ndoshta do t’i isha nënshtruar këtij vendimi sikur... Jozef Kainci mos t’i kishte dhënë rëndësi tij pengimi të gojës, që i ndodhi kur më pa, dhe sikur të mos më kishte mbrojtur.

Ai më tregoi rrugën që unë ndoshta do ta kisha humbur njëherë e përgjithmonë.

Aleksandër Moisiu

Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

debutim-i – dalja për herë të parë në skenë.

figurant-i – ai që në një pjesë teatrorë del në skenë, po nuk luan ndonjë rol të veçantë e nuk flet

statist-i – figurant që rri i palëvizur në skenë

inspektor i skenës – ai që mbikqyr mbarëvajtjen e shfaqjes në skenë, hyrjen e daljen e aktorëve etj.

pendesë-a – pendim: këtu: lutje fetare për të kërkuar faljen e mëkateve

sufler-i – njeriu i caktuar në teatër për t’u kujtuar fjalët e rolit aktorëve duke ua përshpëritur

pasojë-a – rrjedhimi

kolegjiim-i – këshilli që merr pjesë në mbarëvajtjen e punëve në një institucion.

Pyetje dhe detyra

Ç’duhet të ketë parë në fytyrën, në shprehjen e syve të A.Moisiut Jozef Kaincit, ky aktor i madh, që t’i merrej goja në skenë dhe ta kërkojë më pas me kaq këmbëngulje?

Përse A.Moisiu është mirënjohës për tërë jetën Jozef Kaincit?

Ç’dini ju për A.Moisiun, për vendlindjen, jetën dhe veprimtarinë teatrorë?

Shpjegoni punën që kryejnë këta njerëz që punojnë në teatër: aktori, regjisori, figuranti, skenografi, sufleri, kostumisti, grimjeri, punëtori i ndriçimit, kompozitori, punëtorja e garderobës.

Shpjegoni kuptimin e këtyre fjalëve: skenë, lozhë, dekor, maskë, perde.

HOXHA TAHSINI

Hoxha Hasan Tahsini (1832-1884) ishte nga fshati Ninat i Çamërisë, por jetoi e punoi në Stamboll. Shkencëtar i flaktë, ai bashkëpunoi me P. Vasën, J. Vreton, I. Qemalin, S. Frashërin etj. Ai ishte një punëtor i palodhur dhe njeri me zemër të madhe.

Megjithëqë në vendin tonë pothuaj nuk ka njeri që nuk e di të zotin e këtij emri, janë fare të pakët ata që e kanë njohur e kuptuar siç duhet. Unë kam pasur fatin të njihem dhe të kem biseduar shumë me të, kështu që i kam njohur deri në njëfarë shkalle mendimet dhe natyrën e tij dhe përherë kam mbetur i habitur nga virtytet e tij të larta.

Pasi kreu studimet, në medresetë e kryeqytetit, duke përvetësuar dituritë arabe e islame dhe letërsinë e Lindjes, Hoxha Tahsini vajti në Paris, ku bashkë me gjuhën frënge, studioi të gjitha shkencat e reja të asaj kohe.

Nuk e hiqte kurrë librin nga dora. Vendi ku banonte dhe shtrati ku flinte ishte i rrethuar me libra; leximin e ndërpriste vetëm kur mësonte të tjerët. Nuk i shmangej bisedës me të tjerët, por edhe biseda e tij ishte një mësim, një diskutim diturie; nuk kënaqej fare nga fjalët e kota që nuk sillnin ndonjë dobi dhe sidomos nga bisedimet për çështje vetjake. Në të tilla raste ua priste me zemërim fjalët atyre që flisnin të tilla dhe nuk duronte të bisedohej për çështje që nuk kishin të bënin me diturinë, shkencën, të vërtetën dhe drejtësinë. Ai vetë ishte dashamirës i diturisë, i shkencës, i drejtësisë dhe i së vërtetës. Fjalët “Të kërkosh të vërtetën” ishin ato që përsëriteshin më shpesh nga goja e tij.

Nëse themi se sot në vendin tonë titullin e dijetarit nuk e meriton njeri tjetër më shumë sesa Hoxha Tahsini, mendoj se me këtë nuk i kemi hidhëruar njerëzit e tjerë të dijës e të shkencës të atdheut tonë. Dhe, me të vërtetë, një njeri që dëshiron të meritojë këtë titull, duhet të njohë me rrënjë të gjitha dituritë e shkencat e kohës së tij. Ashtu si Ibn Sina (Aviçena), i cili, duke i ditur të gjitha dituritë e shkencat e zbuluara e të njohura në kohën e vet, e fitoi me të drejtë këtë titull nderi, ashtu edhe Hoxha Tahsini, duke njohur gati të gjitha dituritë e shkencat e kohës sonë, e meriton plotësisht këtë titull. Njohuritë e tij në shkencat e fizikës, në shkencat natyrore, në ato të matematikës e të astronomisë nuk janë të sipërfaqshme. Ai i zotëronte

plotësisht këto dituri bashkë me zbatimet e tyre. Aq shumë i kishte përvetësuar ligjet e rregullat e këtyre shkencave dhe që shtrirë plotësisht me to, saqë për asnjë temë a çëshje shkencore nuk kishte nevojë të hapte librat.

Jeta e këtij njeriu nuk është tjetër gjë veçse një mësim që ka vazhduar për një gjysmë shekulli; ai e kaloi të gjithë jetën duke lexuar dhe duke mësuar të tjerët. Përpjekjet dhe dëshira e tij e zjarrtë përqëndroheshin në dy gjëra: E para, dëshironte t'i shtonte njohuritë që kishte fituar, duke hedhur për herë e më shumë nga një hap përpara për t'iu afruar "së vërtetës" dhe, e dyta, ai digjej nga dëshira për t'i bërë kombit e atdheut një shërbim, duke u mësuar të tjerëve ato që i dinte. Aq shumë ishte i dhënë pas këtyre dy dëshirave, këtyre dy qëllimeve, saqë ata nuk mund ta çmonin shenjtërinë e kësaj pune, mbase mund të thonin se ishte i krisur nga mendja. Por ai, këtyre dy dëshirave u kushtoi tërë jetën, tërë mendin, tërë kohën, zgjuarsinë dhe fuqinë e mendjes; për t'u shërbyer këtyre qëllimeve ai sakrifikoi qetësinë, çdo zbavitje e kënaqësi tjetër, çdo gëzim tjetër, të ngrënit dhe gjumin.

Ai nuk gjente kohë për t'u menduar e për t'u kujdesur për veten; ai e quante humbje kohe të merrej me trupin e personin e vet, duke lënë kështu pas dore gjëra të tjera shumë të mëdha, që kishte në mendje dhe në zemrën e tij. Po ndonëse nuk shikonte veten, ai shikonte e kujdesej shumë për mjetet dhe veglat e tij shkencore, madje edhe mureve të dhomës ku banonte u jepte më shumë rëndësi sesa vetes. Ata që e vizitonin e gjenin shpeshherë të zënë me rregullimin e dhomës; ai përpiqej me ditë të tëra për të rregulluar një sekstant, një teleskop ose një vegël të fizikës a të kimisë, ai punonte së bashku me karpentierët dhe në këto raste, duke pastruar e rregulluar dhomën mbulohej i tëri nga pluhuri e dheu. Në njërin nga muret e dhomës kishte varur një pllakat të vogël me këtë frazë: "Një vend për çdo gjë dhe çdo gjë në vendin e vet". Po t'i binin të holla në dorë i shpenzonte për libra dhe vegla shkencore dhe vetëm kur e merrte uria kujtohej për të ngrënë, madje shumë herë hante vetëm bukë e djathë. Kur flinte kishte kundrejt shtratit një makinë elektriciteti, sipër një teleskop të gjatë, te këmbët një mikroskop dhe në dorë një libër. Muret dhe tavani ishin të mbuluara me vizatimet e figurat e historisë së natyrës, gjeologjisë, gjeografisë politike e fizike, kozmografisë, fizikës dhe kimisë. Mund të thuash se dhoma e tij paraqiste të zvogëluar krejt natyrën e rruzullin tokësor.

Hoxha Tahsini e shikonte racën njerëzore si një familje të madhe e të vetme dhe të gjithë njerëzit si vëllezër. Ai dëshpërohej shpirtërisht nga ndarja e përçarjet e tyre. Ai e quante të nevojshme përmirësimin e gjendjes së racës njerëzore në përgjithësi. Dëshira e zemrës së tij fisnike dhe lutjet e tij ishin për të mirën e dobisë e krejt njerëzimit.

Hoxha Tahsini ka qenë nga njerëzit e mëdhenj që shumë rrallë me vështirësi i lindin shekujt dhe epokat. Nga dituria, virtyti, shkenca, idetë dhe nga veprimtaria

e tij, bijt e atdheut mund të përfitonin shumë.

Dhe në të vërtetë, ai i kreu shumë shërbime atdheut. Në mësimet e tij ndodheshin përbri të pranishëm pesë deri dhjetë nxënës të zellshëm për arsim. Në këtë mënyrë. Hoxha Tahsin punoi së tepërmi për përhapjen e diturive e të shkencave të ndryshme dhe për zhdukjen e paditurisë.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

medrese-ja – shkollë e lartë fetare

Ibn Sina (Avicëna) – mjek e filozof iranian (980-1037)

i sipërfaqshëm – i përciptë, që nuk shikon në thellësi

astronomi-a – shkenca që studion yjet

seksant i – vegël që shërben për të matur largësinë e yjeve

teleskop-i – vegël që shërben për të këqyrur trupat qiellorë

mikroskop-i – vegël që shërben për t'i vështruar trupa që s'i shquan dot syri p.sh. mikrobet etj.

gjeologji-a – shkenca që studion përbërjen, ndërtimin dhe historinë e tokës.

kozografi-a - shkenca që e studion tokën si trup qiellor, në lidhje me trupat e tjerë qiellorë.

fanatizëm-i – zell i tepruar dhe i verbër në punë të zakoneve, fesë etj.



Bisedë rreth tekstit

Si e përshkruan S. Frashëri figurën e Hoxha Tahsinit?

Ç'njohuri shkencore zotëronte ky njeri i madh i popullit tonë?

Ç'mendonte ai për njerëzimin?

Cilat ishin dy qëllimet kryesore që ai i kishte vënë vetes?



Samii Frashëri
(1850-1904)

Samii Frashëri lindi në Frashër ku i mori edhe mësimet e para. Gjimnazin Samiu e kreu në Janinë bashkë me Naimin. Samiu njihte shumë gjuhë si ato klasike, lindore dhe ato perëndimore. Punën dhe veprimtarinë e tij si shkrimtar, shkencëtar e publicist e vazhdoi në Stamboll. Samiu ka botuar shumë vepra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke. Në gjuhën shqipe na la disa vepra me karakter arsimor dhe pedagogjik si “Abetarja e shkronjëtorja” (gramatikë), dramën “Besa”, “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është dhe ç’do të bëhetë” etj.

RREGULLA MIRËSJELLJEJE

Sjellja është një nga shenjat kryesore të qytetërimit. Atdhetarët tanë janë përpjekur që herët të edukojnë të rinjtë me rregullat kryesore të mirësjelljes. Këtë bën edhe J. Vretoja me librin e tij “Mirëvetia” nga është marrë pjesa e mëposhtme:

Mënyrat që përdor njeriu ndë të rrojtur me njerëzit thuhet të sjellë, dhe mënyra e pëlqyer, të sjellë të mirë, e papëlqyer të sjellë të keqe. Njeriu, që sillet mirë, quhet i zbutur e i qytetëruar; ai që sillet keq, quhet i egër e barbar.

Të sjellët e njeriut shikohet ndë këto punë: ndë të pastruar, ndë të ecur e të qëndruar, ndë të ndenjur, ndë të vajtur vizita, ndë të pritur e të përcjellë, ndë marrëdhëniet me miq e me shokë, ndë të ngrënë.

Të pastruarit. Të pastruarit është tri farësh: të trupit, të rrobave dhe të vendit... Të pastruarit e trupit për dy punë të nevojshme, për të ruajtur shëndetin dhe për të mos ardhur të ndohtë njerëzve me të cilët takohemi.

Por, që të pastrohemi, duhet tërë trupin ta lajmë të paktën një herë në javë, edhe më shpesh në u dashtë. Kryet të paktën një herë në javë, edhe më dendur ndë mos ardhhtë mjaft. Sytë e faqet e qafën për çdo mëngjes, edhe sa herë hamë bukë dhe kurdo zëmë gjëkafshë që lyros. Po kurdo që lahemi, të kemi mënd të mos lahemi të dirsur me ujë të ftohtë, se na prish, po të presim sa të na shkojë djersa.

Edhe dhëmbët t’i lajmë e t’i fërkojmë për mëngjes, që të na mbahenë të shëndoshë e të bukur, edhe të mos na bjerë erë fryma e t’u vijë ndohtë njerëzve që na ndodhen pranë. Thonjtë t’i presim për javë, që të mos zgjaten jashtë mishit e të mblidhet plehësirë ndënë ta.

Të ecurit e të qëndruarit. Në të ecur e të qëndruar, që të jemi të hijshëm, duhet kryet e tërë trupin ta mbajmë drejt.

Të ecurit është mirë ta mësojmë sa të mundim të shpejtë, po jo duke u sulur, veç kur është shtrëngim pune që nuk pret, as duke u hedhur, as duke përpjekur këmbët përdhe a duke i hequr zvarrë, as duke përkundur duart, as duke tundur e lëkundur trupin, as duke ngritur një sup dhe tjetrin duke u ulur, as duke kthyer kryet tej e këtej, as duke hedhur sytë me vëmendje të madhe mbi njerëz e gjëra të huaja, as me duar prapa lidhur që dëfton madhështi, as duke qëndruar e duke u habitur, as duke shtrembëruar udhën, as si hu duke mos vënë re kush na vjen përpara, a pas, po drejt si e do vetia edhe duke shikuar ku shkelim, që të pengohemi

a të baltosemi, edhe duke vënë re kush e kush vjen pas.

Kur piqemi me miq e njerëz të njohur, ndë janë shokët tanë a më të vegjël, të kujdesemi t'i përshëndesim me të ulur të kryes më parë; ndë na përshëndesin ata, menjëherë t'ua kthejmë me të ulur të kryes. Ndë janë të mëdhenj, të qëndrojmë, të shkojmë, edhe, ndë na përshëndetshin, t'ua kthejmë me nder pas zakonit, të mos i përshëndetim ne të parët, se duket se sikur i bëjmë a u bëhemi shokë.

Kur ecim dy vetë bashkë shoqërisht, i vogël të madhit t'i lërë anën më të mirë të udhës.

Kur ecim tre a më shumë veta bashkë, më të madhin ta marrim në mes, edhe t'i mbajmë këmbët pakëz më prapa.

Kur është nevoja të qëndrojmë përpara njeriut, që do të na flasë a t'i flasim, të qëndrojmë drejt mbi të dy këmbët, të mos këmbejmë njëren mbi tjetrën, a të mbështetemi mbi gjë; dhe të qëndrojmë me kësulë nxjerrë, ndë është zakon.

Të ngrënët. Të ngrënët është rrënja e jetës së njeriut edhe e gjithë gjësë së gjallë. Të ngrënët bëhet kështu: Bukën e marrim me dorë dhe e presim dhe kafshatën e vemë në gojë me dorën e djathtë.

Gjellët, ato që janë të lëngshme a të qullme i hamë me lugë me dorën e djathtë; ato që janë të fërguara e me pak lëng duke vënë kafshatën e bukës në pirun dhe duke e ngjyer e duke e vënë në gojë.

Thelat i hamë me pirun e me thikë; me dorën e majtë mbajmë pirunin dhe me të djathtë thikën edhe, si e zemë thelën me pirun, presim kafshatën me thikë dhe e marrim me pirun e e vemë në gojë. Edhe koska ndë pastë, me pirun e me thikë e zhveshim, me dorë nuk e zemë, se quhet paqytetëri.

Pemët, që nuk lyejnë, i marrim me dorë, ndë gojë, ato që qërohen, si pjeshkë e mollë e të tjera, i qërojmë me thikë dhe duke prerë thelën, i marrim: me majën e thikës, e i hamë.

Me një fjalë, të vënë dorë ndë gjellë e ndë thelë është punë e paqytetëruar e për turp. Kafshitat e bukës të mos i presim të mëdha sa mezi të na i nxërë goja e të fryhenë bulçitë, edhe të mos t'i ndrysim me dorë, t'i vemë ndë gojë. Të mos ulemi shumë përmbi trapezë, po sa mos na pikoje mbi krahëror, ndë bëftë të na pikoje ndonjë pikë.

Ndë bëftë të jetë gjella e nxehtë sa të mos na e durojë goja, të mos i fryjmë, po të presim e të marrim nga pakëz, sa të ftohet. Të mos mbllaçitemi me forcë duke përpjekur buzët e duke rruftur gjellët e lëngshme, po sa të mundim lehtë e pa u dëgjuar. Kurdo që të rrimë të hamë, të kaptojmë mirë kafshitën e të fshijmë më parë buzët, pa të pijmë, që të mos lyhet qelqi; edhe të mos pijmë rrembyrazi e të na dalë nga hundët; as shumë sa të dehem, po sa na vjen ndë shendët.

Jani Vreto



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

të sjellë-t – sjellje: të sjellë të mirë – sjellje e mirë, të sjellë të keqe – sjellja e keqe

ndë – në

të ndohtë – ndoti, këtu neveri, krupë

më vjen ndot (kam ndot) – më vjen vështirë, më vështiroset

prapo – prapë, përsëri

pakëz – pak

kafshitë-a – kafshatë

bulçi,-a – pjesa e butë e faqes së njeriut që nga mollëza deri te nofulla e poshtme

ndrys – shtyp lehtë me dorë

trapezë,-a – tryezë

mblaçitem – përtypem, për një kohë zakonisht me zhurmë e duke mbajtur diçka nëpër dhëmbë.

rrufit – rrufitur – pi pak nga pak diçka, gjerb, surb

kaptoj – kapërcej



Bisedë rreth tekstit

Përse bëhet fjalë në këtë tekst?

Si duhet të sillemi me shokët?

Si duhet të sillemi në rrethin familjar?

Si duhet të sillemi në shkollë dhe në vendet e tjera publike?



Detyrë

Duke pasur parasysh copën e mësipërme, kontrolloni veten tuaj dhe tregoni se cilat rregulla i keni zbatuar drejt dhe cilat jo, cilat rregulla i dini e cilat duhet t'i mësoni.

PËR SA TOKË KA NEVOJË NJERIU

Pahomi ishte një fshatar rus. Kishte qenë aq i vobektë tërë jetën e tij sa gjëja që deshi më tepër në këtë botë që të bëhej i pasur me tokë. Ai thoshte shpesh:

- Le të fitoj vetëm pak tokë dhe atëherë s'do t'i kem frikë askujt.

Kursente shumë, vishej dhe ushqehesh keq, derisa ia arriti që të blinte një copë tokë. Pas kësaj u bë mjaft i lumtur e mund të kishte rrojtur fare mirë, po të mos i ishte bërë sëmundje dëshira për të pasur më tepër tokë. Kështu, e shkonte jetën me të keq duke përdorur çdo pesësh që kishte, për të blerë tokë; përsëri e përsëri. Sa më shumë tokë që blinte, aq më shumë kërkonte. Në krye besonte se do ta ndiente veten krejt të lumtur, sikur të shtinte në dorë tokë për një pendë që, po tani që kish me qindra pendë e ndiente veten krejt të palumtur, e i vinte keq për vdekje, sepse donte të kishte një mijë pendë. E shoqja dhe fëmija e tij vuanin, se nuk kishin mjaft ushqime. Veshja e tyre ishte e pakët dhe e vjetër. S'kishin asnjë dëfrim në jetë, po Pahomi kishte tokë, të cilën po e shtonte çdo ditë e çdo muaj. I shkreti Pahom, dukej se çdo tokë që i vinte në dorë, e bënte edhe më fatkeq.

Një ditë i arritën në vesh disa lajme gazmore. Një udhëtar i tha që larg, atje në vendin e bashkirëve, çdo njeri mund të merrte aq tokë sa t'i donte e bardha e zemrës!

Udha ishte e gjatë gjer te bashkirët e duheshin mjaft të holla që të arrinte njeriu gjer atje. Po Pahomi shiti tokën, që kishte blerë më parë, la të shoqen dhe fëmijën, dhe u nis përpjetë për në vendin e bashkirëve.

Ditën e shtatë arriti në stepat, ku ishte vendi i bashkirëve. Sa i lodhur dhe zemërstrubull ishte Pahomi!

- Kam dëgjuar, - tha, - nga një tregtar që kishte qenë këtu, se i dhatë shumë tokë, bëtë edhe një ujdë me të: ju lutem bëni edhe me mua ashtu.

Kryetari i bashkirëve kuptoi sakaq sesi ishte puna.

- Fare bukur! – u përgjigj. – Këtu kemi një shkruer e mund të shkojmë në qytet ta bëjmë marrëveshjen me të shkruar e me vulë.

- Po çmimi sa është? – pyeti Pahomi.

- Këtu kemi vetëm një çmim: 10.000 rubla një ditë.

Pahomi s'po e kuptonte dot.

- Një ditë! – u mendua ai. – Çfarë mase qenka kjo? Me sa pendë qe është baraz?

- Këtë s'e dimë as ne, - u përgjigj kryetari. – Ne shesim me mëditje që do të thotë: sa vend do të jesh i zoti të shkelësh në një ditë, aq është masa për ty, çmimi 10.000 rubla ditën. – Kryetari nënqeshi. – Po, sa tokë do të arrish të shkelësh aq është malli yt. Vetëm me një kusht. Në qoftë se në fund të ditës nuk do të kthehesh dot në pikën nga je nisur, i humbet edhe të hollat e s'merr gjë prej gjëje.

- Si qenka kjo kështu? – pyeti Pahomi përsëri. – Mos doni të thoni se ju do të matni vendin, që do të kem shkelur unë?

- Ne do të qëndrojmë në një pikë nga ku do të nisesh ti. Ne do të qëndrojmë pa lëvizur gjatë kohës që ti do të shkelësh vendin, dhe njerëzit tanë do të venë kaluar të ngulin nga një hu atje ku do t'u thuash ti, duke hapur një vazhdë nga një hu te tjetri. Ti je i lirë të zgjedhësh vendin se ku do të bësh kthesën e të bësh një qark, i cili do të përmbledhë brenda gjithë atë copë toke, që do të bëhet malli yt, po duhet të kthehesh prapë në vendin nga je nisur përpara se të perëndojë dielli. Çdo vend që do të kesh shkelur gjer në atë kohë do të jetë yti.

Pahomi e pëlqeu këtë marrëveshje dhe e vendosën që të fillojnë nga puna të nesërmen në mëngjes.

Pahomi u ngrit nga gjumi, zgjoi punëtorin e tij dhe e urdhëroi të bënte gati karrocën. Vajti të zgjonte edhe bashkirët.

Bashkirët morën udhën ca me kuaj, ca me karroca. Pahomi me punëtorin e tij hipi në karrocën e vet. Kur arritën në stepë, agimi kuqalash nisi të dukej. Arritën në një kodër të vogël dhe zbritën. Bashkirët vanë në majën e kodrës e u mbloodhën tok. Kryetari i tyre iu afrua Pahomit, duke i treguar me gisht.

- Shiko, - tha ai, - aq larg sa arrin vështrimi yt, tërë ai vend është yni. Zgjidh atë që të pëlqen! – Pahomi tani zuri të kruante kokën duke mos ditur se nga të niste; toka kudo ishte e mirë.

Pahomi në krye e mori punën me ngadalë me çapa të qetë. Eci ndonjë milje dhe porositi bashkirët të ngulnin një hu. Pastaj hoqi më tej. Këmbët e tij e humbën atë rëndësinë që ndien njeriu në krye, kur zë të ecë. E shpejtoi, pra, çapin. Vajti ca më tutje dhe i porositi të ngulnin një hu tjetër. Shikoi prapë diellin, vuri re që kodra ishte afër ende dhe mund të shikonte njerëzit e mbledhur atje. Pahomi kujtonte që do të kishte ecur të paktën nja pesë milje. Dhe tani nisi të djersijë. E hodhi gunën mënjanë dhe e shtrëngoi rripin. Eci tutje e më tutje dhe bëri pesë milje të tjera. Zuri të bëjë vapë. Prapë Pahomi ktheu sytë dhe shikoi diellin. Ishte kohë për të ngrënë mëngjes.

- Kam bërë të paktën pesëmbëdhjetë milje, - u mendua, - dhe pesëmbëdhjetë milje bëjnë një ditë qiraxhiu. Po është shumë shpejt që të kthehem prapë, po mund

të çliroj pak këpucët. Çliroi këpucët e u nis për më tutje. U mendua e tha:

- Do të bëj pesë milje të tjera në këtë anë e pastaj do të kthehem më të mëngjër. Toka këtu qenka e mirë.

Po sa më tej vinte, aq më e mirë bëhej toka. Vazhdoi pra, duke ecur drejt përpara. Shikoi prapa më në fund. Kodra mezi dukej, dhe njerëzit në majë të saj ngjanin si miza.

- Mirë! – u mendua Pahomi. – Mjaft toka mora në këtë anë. Tani të kthehem në të mëngjër.

Ishte nxehur shumë dhe ndjeu një dëshirë të madhe për të pirë ujë. E ngriti plloskën dhe piu pa qëndruar, porositi njerëzit që të ngulnin një hu tjetër, dhe u kthye më të mëngjër. Eci dhe eci përpara. Bari ishte shumë i ashpër e i gjatë. Vështroi përsëri diellin. Ishte koha e drekës.

- Le të çlodhem pak! – tha Pahomi. Qëndroi dhe rrëmbeu disa kafshata buke, po s'deshi të rrinte poshtë. – Po të rri poshtë. – u mendua, - do të më vijë të shtrihem dhe po të shtrihem mund të më zërë gjumi! E kështu qëndroi pa luajtur fare, sa mori frymë e pastaj u nis përsëri.

Ishte gati që të kthehej përsëri në të mëngjër, kur sytë e tij vanë mbi një copë vend fort të mirë. S'i bënte zemra që ta linte jashtë atë vend të bukur. E kështu vazhdoi udhën gjithë në atë anë dhe e mori brenda atë copë vend. Porositi të ngulnin një hu tjetër dhe u kthye më të mëngjër. Pahomi hodhi sytë nga kodra. Njerëzit që ishin në majë, mezi shquheshin. Ishte pesëmbëdhjetë milje larg. Hodhi sytë nga dielli, i cili kish zënë që të ulej. Në anën e tretë kishte ecur vetëm dy milje e megjithatë ishte pesëmbëdhjetë milje larg nga kodra.

- Ndonëse prona ime do ta ketë një anë më të shkurtër, tani duhet të vazhdoj drejt e përpara, në drejtim të kodrës. Po të marr brenda më tepër tokë, nuk do të jem në gjendje ta punoj. Mjaft me kaq.

Tani ecte në drejtim të kodrës duke ndjerë se po i rëndohej trupi. Çapitej duke u penguar kohë më kohë. Këmbët zunë t'i dhembnin e t'i ënjtëshin. Donte që të çlodhej, po kjo tani ishte gjë e pamundur, se po të humbte një minutë, nuk do të arrinte dot kodrën përpara se të perëndonte dielli. Dielli s'priste për të, dhe po ulej, po binte poshtë, sikur e hiqte njeri tatëpjetë.

Pahomi e mblodhi veten dhe nisi të rendë. Këmbët zunë t'i gjakoseshin, po ai rendte me sa mundej. E hodhi poshtë jelekun, këpucët, plloskën, më në fund hodhi poshtë edhe kapelën. "Fatkeqësi! – thirri Pahomi. – Kam ikur shumë larg, dhe do t'i humbas të gjitha, po të mos arrij me kohë". Një frikë e tmerrshme kapi shpirtin e tij. Pahomi rendte. Këmisha dhe pantallonat, të mbytura në djersë, i ngjiteshin pas trupit, goja i ishte tharë dhe i digjte. Kraharori i tij dukej si gjyryk kovaçi; zemra i rrihte; shalët thahehin nën të e dukeshin sikur s'ishin të tijat. Pahomi e harroi

tani dheun, e vetmja gjë, për të cilën mendohej ishte kjo: “Po sikur të bie i vdekur nga lodhja?”. Kishte frikë nga vdekja, po prapë s’i bënte zemra që të qëndronte. Shikoi edhe një herë nga ana e diellit. Dielli ishte i madh e i kuq, e fare afër dheut, ishte gati të zhdukej. Kur Pahomi arriti në rrëzë të kodrës, dielli perëndoi. Pahomi rënkoj. E kuptoi se po humbiste çdo gjë; papandehur u kujtua që vetëm ai, në rrëzë të kodrës, nuk mund të shihte diellin, ndërsa ata që ishin në majën e saj, duhej ta shihnin ende. Pahomi u drodh që të ngjitej në kodër. Hipi me të katra dhe pa qylafin që ishte vënë si shenjë e mbarimit të udhës. Dhe atëherë u pengua dhe ra poshtë, po, duke rënë, zgjati duart që të zinte qylafin.

- Shumë mirë! – thirri kryetari i bashkirëve. – Fitove me të vërtetë shumë tokë! Punëtori i Pahomit rendi tek ai, dhe do ta kishte ngritur më këmbë, po pa që po i dilte gjak nga goja. Pahomi mbeti i shtrirë, i vdekur.

Leon Tolstoi

Shënim

Në tekstin e mësipërm, në pika të shkurtra përshkruhet një pjesë e jetës së Pahomit. Posaçërisht theksohet pjesa e fundit e jetës së tij. Në këtë novelë heroi kryesor, Pahomi, është realizuar në lëvizje, në rendje. Ai nuk qëndron në një vend. Duke e përshkruar moskënaqësinë e tij për atë që ka, shkrimtari bën portretizimin moral, fizik dhe shpirtëror të Pahomit.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

bashkirët – popull që banon në pjesën jugore të vargmaleve të Uralit
sakaq – menjëherë
stepë-a – fushë e hapët dhe e thatë, pa drurë e me bimësi të varfër
plloskë-a – enë prej druri për të mbajtur ujë e verë
gjyryk-u – kacek i farkatarit që përdoret për t’i fryrë zjarrit
ujdi-a – marrëveshje



Bisedë rreth tekstit

Cila është tema dhe ideja e kësaj novele?
Ç’ dëshironte Pahomi?
Si jetonte ai?
Ç’ na mëson fundi i kësaj novele?



Detyrë

Shkruani për portretin e Pahomit (pamja e tij e jashtme, veshja, ndjenjat dhe mendimet e tij).

Tregimi është një vepër e vogël artistike, që merret zakonisht me një ngjarje të veçantë të jetës së njeriut pa treguar hollësi se ç'kishte ngjarë më parë ose çdo të ngjajë pas asaj ngjarjeje. Zakonisht te tregimi numri i personazheve është shumë i kufizuar.

Leon Tolstoi (1828-1910) ka qenë një shkrimtar i madh rus. Ka shkruar vepra të bukura (tregime, romane, drama) që janë bërë të dëgjua në tërë botën, si romanet: “Lufta dhe paqja”, “Ana Karenina”, “Ringjallja” etj. Ka shkruar edhe mjaft libra për të vegjëlit.

VRULL

Zogj të bukur këndojnë me hare,
po zemra do më plasë mua në gji.
I helmuar shkoj jetën te ky dhe,
mërzitem në katund, në vetmi.

Hapet përpara meje deti i shkëlqyer,
që zgjon tek trutë e mi mendime shumë,
e shqetësim zembrën time çjerr,
aq sa pushoj vetëm kur bie në gjumë.

Arbëria matanë detit na kujton
se ne të huaj jemi te ky dhe!
Sa vjet shkuan! E zemra nuk harron,
që nga turku mbetëm pa mëmëdhe.

Prej hakmarrjes lind shpresa e dritë e bardhë.
Era po fryn dhe akulli më zë,
se arbëreshi harroi ç'ish më parë,
edhe nuk ka më turp, po rri e flë.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

hare-ja – gëzim i madh

plas - pëlçet

i helmuar – i hidhëruar, i pikëlluar

gjerr – këtu: i copëton zemrën, i shkakton dhembje

ia plasi zemrën – e hidhëroi tepër, i hëngri shpirtin



Bisedë rreth vjersbës

Cila është ideja kryesore e kësaj vjershe?

Ç'kuptoni me vargjet:

“se arbëreshi harroi ç’ish më parë,

edhe nuk ka turp, po rri e flë”

Cili është qëllimi i tyre?

Poezia patriotike

Vjershat në të cilat shprehet ndjenja e dashurisë ndaj vendlindjes dhe lirisë së atdheut, quhen poezi patriotike.

Vjersha “Vrull” është po ashtu një lloj i poezisë lirike që ngjall ndjenja dhe emocione për atdheun. Poezi me përmbajtje patriotike kanë shkruar, veçanërisht rilindësit tanë si: Naimi, Çajupi, Ndre Mjeda, Asdreni etj.



Zef Serembe
(1843-1901)

Zef Serembe është poet i shquar arbëresh, i cili i këndoi me afsh e vrull dashurisë së vashës dhe dashurisë së atdheut. Lindi në fshatin Strigari (San Kozmo Albaneze) të Kalabrisë.

Ka shkruar vjersha, poema dhe drama. Njihet vetëm një pjesë e veprimtarisë së tij letrare, e cila u botua nga i nipi Kozmo Serembe. Botoi librin “Poezi italisht e këngë origjinale të përkthyer nga shqipja”. Ai i këndon të kaluarës së lavdishme, shpreh mallin dhe dashurinë për atdheun e lirë, jep kushtrimin për çlirim kombëtar nga sundimi osman. Me entuziazëm u këndon edhe lëvizjeve çlirimtare të popujve të tjerë. Mbi të gjitha i këndoi dashurisë për vajzën e fshatit të cilën e dashuroi me

thellësitë e zemrës.

POLIFONISTËT

Qyshkur dinte për vete, sidomos për ekzodin, në të cilin iu shua edhe jeta, vazhdimisht donte të zbresë thellë-thellë te të vetët, madje edhe deri tek ata të humburit; në shpirtin e tij jehonin tingujt e këngës shumë të vjetër polifonike toske nga buzëliqeni i vendlindjes së tij.

Dikur buzë liqenit të vjetër me qindra mijë vjet, shumë, shumë më të vjetër edhe nga vetë njerëzit, me të vetët e këndonte këngën e trashëguar polifonike.

Kënga polifonike e buzëliqenit përgjithmonë i mbeti në kujtesë, si njëra ndër më të lashtat e Ballkanit, si një lidhje e përhershme me të vetët, me atdheun. Mendonte dhe ndjente, kur më thoshte se kishte humbur, se vetëm me këtë këngë i takon popullit të vet. Dhe në jetë më rëndë e kishte atëherë kur kënga i vinte nga thellësitë e vetëdijes, në ëndërr e nuk kishte me cilin të këndoje...

Këngët polifonike toske, vetëm ato, e lidhnin me të vetët përgjithmonë të munguar dhe për të cilët kurrë s'merrte lajm a janë gjallë, apo kanë vdekur. Në fillim të fatit të vet prej emigranti, i cili i ndodhi në qytetin buzë lumit, mu në kohën e stalinizmit, në kohën e vetmisë gjysmëshekullore të popullit të tij, e këndonte këngën toske të vendlindjes së tij edhe me dy emigrantë të tjerë. Ato ende ishin kohëra fatlume, kur kënga ende ishte e plotë, polifonia e kapshme.

Qëllonte dita kur që të tre, pa biseduar paraprakisht, tuboheshin te babai, thujase në të njëjtën kohë që të tre i brente diçka në shpirt, prandaj edhe deshnin që nëpërmjet të këngës të shkarkohen. Kur nëna i shihte këta të dy fis të babait – emigrantët, e dinte se kishin ardhur të këndojnë. Edhe ajo, ashtu fshehurazi, i gëzohej kësaj kënge, edhe pse ishte e vetëdijshme se kënga e këtillë jo e rëndomtë në kohën staliniane ndryshe-ndryshe mund të interpretohej. Në raste të këtilla ajo e mbyllte shtëpinë nga të gjitha anët, përgatiste raki e meze, rëndomë më tepër se në raste të tjera. Atëherë e tërë shtëpia, e tërë qetësia në të, i përfaqonte tingujt polifonikë, herën e parë atë të babait, e pas një kohe edhe të dy të tjerëve; ne fëmijët, por jo rrallë edhe nëna, shndërroheshim në shoqërues të qetë të këngës toske, e cila kuptimësinë e vet e kishte në zgjatjen e zanoreve dhe në shprehjen e harmonisë, të cilën mund ta kenë vetëm shpirtat që gërshtohen në një jetë të përbashkët në familje, në popull, në popuj. Këto këngë e shprehnin të vërtetën për

qëndresën e familjes, dëshmonin për bartjen e pazëvendësueshme të kuptimisë së atdheut në vetvete. Prandaj ato në ekzod janë edhe më të shpeshta. Nëse kishte çaste fatlume në ekzod, atëherë ato ishin vetëm në plotësinë e këngës polifonike toske. Interpretët këngën e plotësonin me të vërteta nga jeta e tyre, i plotësonin me heroizmat dhe vuajtjet e të parëve të tyre...

Në shtëpinë tonë mbaheshin në mend këngët më të bukura polifonike toske.

E ato ishin këto, të emigrantëve. Të dy solistët kryesorë, shpesh këta dy emigrantë, ose babai me njërin prej tyre, herë prinin me zërat e tyre, herë e arrinin njëri-tjetrin, sikur shënonin njëfarë kthimi në diçka të papërcaktuar, por të rëndësishme, të cilën ekzodi ua kishte marrë përgjithmonë.

Nganjëherë zërat pavarësoheshin, vazhdonin vetë dhe melodia thuajse fitonte një derdhje horizontale. Kënga në të njëjtën kohë ishte edhe e qetë, edhe e fortë, thuajse e derdhur prej vetë qetësisë, e mbrojtur prej natës.

Nëna kur i dëgjonte këto dy zëra meshkujsh sesi depërtojnë nëpër qetësinë, shpesh pyeste pse asnjëherë nuk e arrijnë njëri-tjetrin. Në këtë e gjente ngjashmërinë e familjes së vet emigrante, e cila qe e dënuar kurrë të mos e arrijë atdheun e lënë, vatrën e të parët e humbur.

Dhembja emigrante me siguri kristalizohej në këto zëra. Secila familje në ekzod e kishte variantin e vet të këngës polifonike, kthimin e vet nga ekzodi. Neve fëmijëve kjo këngë, në çaste pikëllimi të jetës, shpesh na e impononte vajin. Ndodhte, madje shpesh, kur babai kthehej nga puna e ne na gjente të kapluar prej njëfarë shqetësimi, prej ndonjë barre që na rëndonte në shpirt, ai t'ia niste këngës së qetë polifonike, toske, disa akorde të së cilës i pranonte edhe nëna dhe kështu të na e kthejë qetësinë në shtëpi...

Më vonë, kur miqtë emigrantë shkuan, njëri me tërë familjen në Turqi e tjetri në Amerikë, kuptohet më kurrë edhe s'u kthyen, babait i erdhi shumë keq që e humbi edhe këngën e përbashkët toske.

Në shtëpi sikur mbretëroi një nuancë e re e melankolisë dhe e qetësisë emigrante. Babai tani, kur do të zbraste ndonjë kupë, e pijen nuk e konsideronte si të njëmendtë, në vetvete do të këndonte edhe ndonjë akord të këngës polifonike toske. Këndonte këngë që kurrë s'e kishte kënduar, por që, pas disa gjeneratave, kushedi si e bartur në të, ishte këngë epike lidhur me një heroizëm të të parëve të tij suliotë, lidhur me një mbarim mitik që formën e vet e kishte gjetur vetëm në këngë. Por nuk mund ta përfundonte këngën, nuk kishte kuptim vetë të këndonte këngë të vjetër toske për të parët e vet. Mandej u kthehej këngëve që i këndonte me emigrantët e vet të shkuar. Këndonte fragmente, ashtu mallëngjyeshëm, duke e zgjatur.

Por, një herë, kur këndonte një këngë, i ndodhi ajo më e mira që mund të

ndodhë kur këndohet, në këtë thirrje të kohës së humbur familjare. Këndonte, ashtu ngadalë, por me një siguri që shpejt ta përfundojë, pse i mungonte zëri i dytë për këngën e njëmendtë polifonike toske. Kur zëri thuajase i humbte në atë qetësi, i arriti një zë tjetër plot gjallëri, një zë i njohur nga rrethi familjar. Vëllai i madh ishte ai që e priti këngën toske të babait. Ai, pa vërejtur se kush ishte, e çonte zërin e vet që t'i largohej zërit të ri, që kënga të bëhej më e arrirë. U bashkoheshin edhe zëra të tjera, zërat e të gjithë neve fëmijëve.

Nëna, e lumtur, si në kohën kur vinin emigrantët, i mbyllte kapakët e dritareve. Kënga përsëri e mbushte shtëpinë, përtrihej vazhdimsisht e saj, qetësia shndërrohej në kremte. Nga e tërë historia familjare që e mbanim në mend, kurrë nuk mund ta harronim ditën kur e tërë familja e këndonte këngën polifonike toske. Në raste të këtilla thuajase vetë parajsa bartej në familjen tonë emigrante...

Kur pas shumë vitesh e humbëm babanë, pa u kthyer sa që gjallë në qytetin e vet të lindjes, kurse në fëmijët u shpërndamë pas familjeve tona, nëna mbeti e vetmuar në shtëpi me arsyetimin se kjo ka qenë dëshirë e babait, vetmi që fëmijët e saj kurrë s'e përjetuan. Ajo rrinte deri natën vonë, ashtu e vetme dhe e këndonte këngën e vjetër toske të babait, me shpresë se do t'i bashkohet zëri i dytë i tij...

Luan Starova

Shënim

Romani "*Librat e babait*" i shkruar në formë ditari bën fjalë për familjen e një emigranti që kalon një rrugë të vështirë me plotë peripeci, por me optimizëm për t'i mbikaluar ato. Shpirti i Babait mbeti në librat e tij dhe që i shkoi për dore edhe te bijtë e tij të bartë dashurinë e madhe ndaj librit.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

egzod-i – shpërngulje, jetë në mërgim

këngë polifonike – këngë me shumë zëra, këngë me iso

emigrant-i – njeri që është larguar nga atdheu për shkaqe ekonomike, politike

konsideroj – parapëlqej



Bisedë rreth tekstit

Si e shprehte mallin e tij Babai ndaj vendlindjes?

Me cilët i këndonte këto këngë në fillim?

Po më vonë, pasi i largohen shokët, kush e shoqëronte atë në këto këngë?



Detyrë

Gjejeni dhe lexojeni romanin “Librat e babait”.



Luan Starova lindi më 1941 në Pogradec, Republika e Shqipërisë. Gjimnazin dhe Fakultetin Filologjik - Gjuhën frënge i kreu në Shkup. Ka qenë ambasador në dy mandate në Tunis dhe Paris. Tani është profesor ordinar i historisë së letërsisë frënge në Fakultetin Filologjik të Shkupit.

Luan Sarova ka shkruar tregime, ese, romane, etj. Ai është marrë edhe me publicistikë. Veprat më të rëndësishme të tij janë: “Kufijtë e pranverës”, “Njerëz dhe ura”, “Barrikada e kohës”, “Afrime”, “Relacione”, “Miqtë”, “Koha e dhive”, “Librat e babait”, etj.

Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës.



KËNGË

Po udhëtojnë turistët skaj më skaj vendit. Po kalojnë me mjete të ndryshme. E fëmijët të pahalle as që mendojnë se kush është prej tyre spiun dhe hileqar e kush turist i vërtetë dhe shtegtar.

Diku, afër qendrës së qytetit, u ndal një veturë. Menjëherë e rrethuan fëmijët kureshtarë.

Po e kundrojnë tashmë automobilin. Po e përkëdhelin prej së largu.

- Preke! – i tha njëri shokut.

- Preke ti! – iu përgjigj ky.

- Hajde, ti më parë.

- Jo, jo, preke ti e mandej unë.

Po shtyhen nga pak fëmijët.

- Jo, jo, preke ti njëherë, preke.

- Stu-de-ba-cker, stu-de-ba-cker.. – po pëshpëritnin buzët e fëmijëve, me sy të ngulur në markën e automobilin.

- Stu-de-ba-cker...

Eh, sa qesharakë janë disa prej këtyre turistëve të huaj! Jo për rrobat e tyre, jo, as për hundët. Për diçka tjetër janë qesharakë ata.

Ballkani është xhungël, mendon ende shumëkush prej tyre. E njerëzit e tij pa vlerë e dituri, të lindur vetëm për argatë, për kaçakë e hajdutë. Ja përse janë qesharakë njerëzit e këtillë.

Një burrë dhe një grua zbritën prej automobilin të tyre. U zhytën në popull, u përziën me të. Ishte ditë pazari.

Po shtyhen njerëzit nëpër shesh. Po shtyhen, po shesin e po blejnë. Aty-këtu, dikush çon diçka, mban... Aty-këtu bërtet dikush, pyet me zë.

Në pikë të diellit, në shesh.

Aty afër një muri janë ulur nja tre burra. Para tyre shtruar mushamaja; në të buka. Pranë bukës – specat, domatet, kripa.

Po drekojnë burrat e varfër. Po ngjyjnë në kripë perime.

Pak më tutje, djaloshi në këmbë. Po këput kafshatat e bukës. Një kafshatë për vete, një për qenin pranë tij. Një me një, pra, hiç pa gabuar.

Njerëz të varfër me të vërtetë. Të varfër, por jo në fisnikëri e burrëri, në ndjenja njerëzore.

Po vëzhgojnë turistët e huaj, po fotografojnë. Burri dhe gruaja u kthyen. U ulën në veturë.

- Stu-de-ba-cker... - edhe një herë i vargoi rrokjet njëri prej çunave.

I buzëqeshi zonja kur e vërejti. I buzëqeshi pranë timonit. Mandej diçka i tha ëmbël. E më në fund? Më në fund i zgjati çunit kutinë plot me biskota.

Aj, aj, aj!... Ç'ka ndodhi, burra, papritur e pakujtuar!

Vocërraku u ngrit si të ishte përvëlur. Befas u ngrit e mprehu fytyrën.

Me dhjetëra palë sy u tubuan tani në faqet e femrës, në buzët e saj, atje te zonja dhe kutia e saj në dorë.

Të gjithë sytë u bënë tashmë si një palë sy të vetëm.

"A thua i merr biskotat? – po pyesin vetveten njerëzit.

"Posi jo!... Do ta marrë kutinë pa ngurrim, do ta marrë", - pëshpëritën disa.

"Jo, nuk do ta marrë!" – mendon shumica.

"Do ta marrë, do ta marrë! Kutia është lara-lara dhe plot me biskota".

"Jo, jo!... Nuk do të përulet çuni. Di ai për krenari".

"Prapë do të përulet! Të ëmbla janë biskotat"...

U krijua më në fund njëfarë heshtjeje dhe qetësie. Lulatje e mundimshme.

Të gjithëve iu ngritën damarët si telat e çiftelisë. Të gjithë pritnin me padurim, me kërshtëri.

- Jo! – i kundërshtoi vocërraku biskotat dhe i fshehu duart prapa shpine.

- Haaa! – bënë të gjithë gati në zë.

- Të lumtë, o çun krenar! – bërtiti dikush i gazmuar.

Vocërraku u ngrit prapa nja dy hapa dhe u ndal. Dora e zonjës mbeti në hava.

Me të edhe biskotat. Vocërraku këmbëzbathur kundërshtoi t'i merrte pra!

Kutia e zonjës u drejtua tashmë nga fëmijët e tjerë. Mirëpo as duart e tyre nuk u zgjatën t'i merrnin. Duke tundur duart në shenjë mospranimi, të gjithë u tërhoqën nga një hap prapa. E huaja u habit sa s'ka. Mbylli derën me rrapëllimë, i dha madje gaz automobilin dhe humbi fluturimthi.

- Udhë e mbarë, o grua e pasur! – bërtiti pas saj një katundar. – Udhë e mbarë dhe mbajti në mend këta çuna krenarë.

Fëmijët e shikuan me sy vizëllueshëm. Me miqësi, me buzë në gaz.

- Rrofshi dhe qofshi, o fëmijë sokola! – foli gëzueshëm dhe ia mori djalit faqet ndër shuplaka. – Ju jeni vetë mrekullia... Ju jeni më e bukura këngë imja, a po më dëgjoni. Të atillë ju dua, ore çuna. Djelmoha të vyeshëm do të bëheni. Po shihet kjo. Dhe burra të fortë, trima, pa pikë dyshimi.

- Shumë u gëzua Tafil Gaca për këtë qëndrim krenar të fëmijëve. E me të edhe të tjerët, plot me kapuçë të bardhë, por edhe me kasketa.

Aty pranë, në qendër. Në pisk të vapës në Prishtinë.

Hivzi Sulejmani



Bisedë rreth tekstit

Pse i quan shkrimtari “qesharakë” disa nga turistët që e vizitojnë vendin tonë? A pajtoheni me të? Arsyetoni qëndrimin tuaj.

Çka zgjoi interesimin e fëmijëve?

A ishte e arsyeshme frika (dyshimi) e të rriturve? Në fund çka ngadhënjeu: lakmia apo krenaria? Pse i quan shkrimtari vogëlushët “Kënga ime më e bukur”?



Detyrë

Tregoni cila është tema dhe ideja e shkrimtarit?

Pse fëmijët e vegjël nuk pranuan dhuratat e turistest?

Cilat ishin motivet që i shtynjë të mbajnë këtë qëndrim krenar?

DOKTORI

Kish vajzën të sëmurë. Të sëmurë për vdekje.

- Shko, bre, në qytet! Shko te doktori, se ai do ta shërojë përnjëherësh!

Dhe plaku i gjorë, e ngarkoi mbi një gomar vajzën gati të vdekur. Dhe rendte i këputur. Kaloi male dhe fusha. Lumenj e moçale.

- Baba! Vdiqa! Ku është doktori?

E mjera e kishte dëgjuar shumë herë emrin doktor, po nuk e dinte se ç'ishte ai. Perëndi, engjëll, shpëtimtar... Ç'ishte ky doktor ?

- Doktor! Doktor!

Thërriste vajza, e cila gati po jepte shpirt.

- Edhe pak se arritëm, oj bijë! Duro se “doktori” do të ta heqë atë dhembje, atë sëmundje që të treti! Unë ja po e nxitoj gomarin:

Hush, hush!

Ecnin duke përsëritur mijëra herë emrin e “shenjtë” të doktorit.

- Arritëm!

Andej-kënde, me mundime gjetën “zyrën” e doktorit.

- Doktor! Doktor!

Thërriste e sëmura. Shpresonte se një fjalë e doktorit do ta shëronte. Kujtonte se një e parë e “doktorit” do t’i bënte mirë.

- Doktor! Doktor!

Murmuriste vajza me gjysmëzëri.

Plaku i gJORë me vajzën që kishte frymën e fundit doli nga “zyra” e “doktorit” i këputur, i vrarë dhe gati me sy të mbushur plot me lot.

“Doktori” i kishte thënë:

- Dua një dëshmi që je i varfër, pastaj ta vizitoj vajzën tënde! Shko në fshat te kryeplaku!

Dhe ky ç’të bënte?

Vajza që ishte shtrirë për vdekje thërriste me zë të mekur:

- Doktor! Doktor!

Plaku i bërtiti kafshës:

- Hush! Hush!

- Vdekja erdhi!

- Bëhu gati, moj e mjerë!

Vajza duke dhënë shpirt për herë të fundit psherëtiti:

- Doktor!

Dhe “doktori” që e shihte duke hequr shpirt, kërkonte dëshmi vobektësie!...

Zbatonte ligjin!...

Petro Marko

Shënim

Sa i preکشëm është ky tregim i shkurtër ose kjo skicë. Tregimi bën fjalë për një ngjarje reale të vitit 1937, kur gjendja e fshatarit shqiptar dhe në përgjithësi të varfërve ishte shumëfish më e rëndë. Atëherë në çdo qytet kishte nga një mjek, por ai nuk ishte për të varfërit. I sëmuri duhej të kishte certifikatën (dëshminë) nga kryeplaku se ishte i varfër! Ç’ironi e kohës!



Bisedë rreth tekstit

Si e përshkruan fshatin autori?

Çka i ndodhi vajzës?

Me se e çoi i ati atë në qytet?

Doktori a e pranoi si duhet të sëmurën?

Ai a bëri mirë?



Detyrë

Shkruani një ngjarje të ngjashme si në tekstin e mësipërm.

THIRRJE NGA NËNTOKA

Do të ngrihemi nga thellësia e tokës
t'i biem përmes kohës
ta shplojmë dheun nga fytyra

do t'i mbyllim sytë
ta dëgjojmë veten

do të biem e do të ngrihemi
e kurrë s'do të agojë
dhe do ta shohim dritën e thyer
në kristalet e nëntokës
do të shkruajmë vjersha programike
për një kohë do ta lëmë botën
- tash e kemi ujin në fyt dhe ajrin e rrallë

kur të na mbërrijë kësula majë koke
do të ngrihemi nga thellësia e tokës
dhe do të klithim në kupë të qiellit
që ta dëgjojmë veten.

Eqrem Basha

Shënim

Në këtë vjershë të Eqrem Bashës bëhet fjalë për kërkimin e vetvetes, d.m.th. njeriu vihet ballë për ballë me vështirësitë e kohës në të cilën kërkon zgjidhje.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

ta shplojmë dheun – ta shpalojmë dheun
vjersha programatike – vjersha parimore



Bisedë rreth vjershës

Ç'e mundon autorin në këtë poezi?
Ç' do të thotë poeti me vargjet:

“do të ngrihemi nga thellësia e tokës
t'i biem përmes kohës
ta shplojmë dheun nga fytyra”

FATET

E kalova Murin e Berlinit
në majë të gishtërinjve
me një trëndafil në dorë.

Frikësohesha se lëndoj
shpirtrat e rënë,
Kur deshta ta kapërcej
edhe Murin shqiptar,
para këmbëve më ra
koka ime në gjak e larë.

Një grua veshur me të zeza
kodrave, fushave
ma kërkon varrin,
e trupin tim.

Çdo ditë zgjohet në mes jush
një torzo i tmerrshëm i qytetërimit.
A nuk ju shqetëson
se gjymtimi im akuzon?

Ali Podrimja

Sbënim

Këtë poezi autori e ka shkruar kur ndodhej në Gjermani, pas rënies së murit famëkeq të Berlinit. Dëshirë e autorit ishte të shemben të gjitha muret.



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

torzo – kafazi i kraharorit, kraharori

gjymtim-i – i është dëmtuar ndonjë gjymtyrë, ka mbetur me të meta.



Bisedë rreth vjershës

Si e kaloi Murin e Berlinit? Cilat janë këta shpirtra të rënë?

Çfarë ndryshimi ka mes dy mureve? Pse në Murin shqiptar koka i bie në gjak e larë?

Ku do t'i gjendet varri udhëtarit?



Detyrë

Përse Muri shqiptar “ra” pas Murit të Berlinit?

Mësojeni poezinë përmendsh.



THEMRA E AKILIT

Dëbora e mbajti fshatin të pushtuar deri në fund të shkurtit. Ibrahim shkoi edhe dy herë për gjah, por kafshët ishin mësuar me hilet e çarkut të tij dhe nuk i afroreshin më patateve dhe mishit të ftohtë. Gjatë ditës, djemtë luanin në dhomën e tyre dhe në darkë i kërkonin Sarës t'i tregonte histori me perëndi. Sara i tregoi për Akilin e pavdekshëm që kishte mundur trojanët dhe që ishte vrarë nga një shigjetë në thembër. Po ai ishte i pavdekshëm, pyeti Niko, si iu ngul shigjeta në thembër? Akili ishte bir i perëndisë dhe kur lindi ai e ëma, që e donte shumë, vendosi ta bënte të pavdekshëm. E çoi në Had dhe e futi në ujërat e lumit të Hijeve, por, kur e zhyti, e mbajti nga thembra që djalin të mos e merrte lumi. Trojanët e dinin që ai mund të vritej vetëm në thembër dhe aty ia ngulën shigjetën.

Akili duhet të ketë qenë në sandalë ditën që e vranë, tha Niko. Troja është një vend i nxehët dhe aty nuk ka dimër si këtu te ne, tha Sara. Dua të jem Akili, thoshte Aliu, por nuk do vesh asnjëherë sandale. Kush e vrau Akilin, pyeti Niko. Akili u vra nga Paridi, u përgjigj Sara, e cila duhet të fillonte një rrëfim të ri sa herë që në rrëfimin e mëparshëm dilte emri i një heroji të ri. Paridi ishte djali i mbretit të Trojës. Para se të lindte, e ëma pa në ëndërr sikur djali që do të lindte do ta shkatërronte Trojën. Kur lindi Paridi, i ati, që e kishte besuar ëndërrën, e dëboi nga qyteti dhe djali u rrit në pyll dhe u bë shumë i bukur. Një ditë tre perëndeshat kryesore greke: Athina – perëndesha e drejtësisë, Afërdita – perëndesha e bukurisë dhe Hera – perëndesha e fuqisë bënë një garë bukurie. Zeusi që i kishte vajza, Athinën dhe Afërditën dhe grua Herën nuk donte të zgjidhte vetë dhe vendosi që burri më i bukur në tokë të përcaktonte kush ishte më e bukura mes perëndive. Burri më i bukur ishte Paridi, të cilit Zeusi i dha një mollë të kuqe.

Kështu, një ditë, të tri perëndeshat shkuan te Paridi dhe i kërkuan mollën. Athina i premtoi se në qoftë se do t'ia jepte asaj, atëherë Paridi do t'i fitonte të gjitha luftërat. Hera i premtoi ta bënte mbretin më të madh të botës, ndërsa Afërdita i premtoi gruan më të bukur të botës. Paridit i pëlqeu premtimi i Afërditës dhe ia dha asaj mollën, kurse ajo e martoi me Helenën. Kjo mollë u quajt molla e sherrit, sepse pas saj filloi lufta e trojanëve me grekët.

Ana Komnena ka jetuar në Bizant. Bizanti ishte perandoria më e madhe në

botë për një mijë vjet. Bizanti shtrihej në të gjitha tokat e grekëve dhe të shqiptarëve, por edhe në Afrikë dhe Azi. Perandorët e Bizantit në fillim qendruan në Romë dhe ishin romakë. Por Roma sulmohej nga fise njerëzish të pafë dhe Konstandini, një perandor që kishte lindur në Shqipërinë e asaj kohe, vendosi të ndërtonte një qytet të madh larg Italisë, ku të pafetë nuk shkonin dot. Ai zgjodhi një vend shumë të bukur mbi det ku themeloi qytetin e tij që u quajt Konstandinopojë. Ky qytet tani është Stambolli, sepse turqit kur e pushtuan ia ndryshuan emrin. Përpara një beteje të madhe, Kostandini pa në ëndërr një kryq dhe ai vendosi të bëhet i krishterë dhe pas tij i gjithë Bizanti u bë i krishterë derisa erdhën turqit. Pas Kostandinit, perandoria pati shumë luftëra dhe shumë perandorë. Ana Komnena ishte vajza e perandorit dhe ka lindur shtatëqind vjet më parë në vitin 1083, dy vjet pasi babai i saj Aleks Komneni u shpall perandor. Ana mori emrin e gjyshes së saj Ana Dalasena.

sipas Ben Blushit

Sbënim

Romanin “ Të jetosh në ishull” e shkroi Ben Blushi..

Tema e romanit përfshin një periudhë jo fort të njohur për historinë e shqiptarëve. Fabula shtrihet në gati katër shekuj duke sjellë në letërsinë shqipe personazhe të njohur, ngjarje e data të çuditshme, nga periudha të ndryshme kohore.

Romani paraqet shumë tema interesante nga historia, sikurse shihet edhe në këtë fragment..



Bisedë rreth tekstit

Për cilën luftë bëhet fjalë në copën e leximit?

Cilët janë personazhet kryesor?

Çfarë dini për themrën e Akilit?

Kush e vrau Akilin?

Çka dini për “mollën e sherrit”?

Cilin qytet e themeloi Konstandini? Dhe pse?



Detyrë

Gjeni pjesë interesante nga ky roman.

Gjeni mitin në këtë copë leximi.

NË VERI

E vetmja “shenjë” e kalimit të kufirit suedezo-norvegjez ishte natyra thjeshtë gjeografike.

Aty, me të shkelur në Norvegji, niste një konfiguracion i ri tokësor. I lamë vërrijet suedeze dhe hymë nëpër pyje, male, tunele, kodra, bjeshkë.

Kjo dhe – konduktori i ri, që hyri të na kërkonte biletën, më bëri të bindem se nuk jam më në Suedi, por në Norvegji.

Edhe një gjë, kur shikova nga dritarja: automobilat nuk shkonin në krahun e majtë, si në Suedi, por – djathtas, si shumëkund në botë. Kurrfarë formalitetesh të tjera, pasaportë a kontroll. Kurgjë.

Norvegjinë e kanë pagëzuar tokë fjordesh dhe – “tokë të diellit të mesnatës”.

Në bllokun tim të shënimeve lexoj:

“Oslo. Tash është ora 22 e 30 minuta. Unë jam ulur në një bangë skaj një shëtitoreje, e rruga është plot njerëz. Kam nxjerrë bllokun e shënimeve dhe shkruaj: terri s’e ka mendjen të bjerë, edhe pse tash, në vendin tim, shumica janë në më të mirin gjumë.

Hyra në një kinema, në ora 19, atëherë kur “piqte” dielli i Veriut, me shpresë se kur do të dalën, kah ora 21, do të jetë terr. Mendoja të bija më herët, sepse vështirë do të kisha mundur të kënaq kureshtjen time që të shoh menjëherë jetën e Oslos atë natë, apo edhe vetëm vitrinat e kësaj metropole.

Kur dola, në orën 21, ende diell! E pabesueshme! Shikova orën. U frikësova mos nuk është gjë në rregull me të. Mirëpo, shumë shpejt u binda: jam në Veri, e gjatë, shumë e gjatë është këtu dita e verës, por – tejet e shkurtër ajo e dimrit.

Ajo ditë thujse s’kishte natë.

E shtuna dhe e diela: rrugët plot njerëz. Edhe të bëhet se lidhet dita me natën, pa u vërejtur aspak.

Më tutje, në Veri, është dielli i mesnatës – “mednatsoi” – që “ndriçon” dhe u jep një bukuri magjike fjardeve norvegjeze, laponëve e fiseve të tjera që gjenden afër Polit Verior.

Që në orën 2 të mëngjesit lindi dielli në Oslo.

Prandaj njerëzit flejnë ditën. E jeta fillon mbas orës 9 a 10 e vazhdon deri në orën 17 e 18.

Mandej, mbas kësaj kohe, një “vakuum” në qoftë se mund ta thotë njeriu kështu. Heshtje.

Krejt qyteti “vdes”.

Rrallë ndonjë njeri shihet rrugëve.

Kah ora 21, 22 e 23 e “natës” bëhen gati prapë e dalin në shëtitje, shkojnë në kinema, në koncerte, teatro e – më së shumti me automobila në pikniqe dhe në shtëpitë e tyre verore.

Për të dëshmuar, ndoshta origjinën, nëpër rrugë të Oslos, shihen shumë shpesh të rinj të parruar, më flokë të gjatë, si të vajzave, djem e vajza që s’ dallohen ç’gjini janë, “viking” modernë, në të vërtetë – djerrakohës e dallaverexhinj, të cilët, pos që nuk janë “vikingë” nuk janë as dashamirë të mëdhenj të higjienës dhe të mirë-sjelljes.

Në “Karl Johan gate”, në sheshin kryesor të Oslos, e sidomos para një “kafiterie”, një byfeje si kishim për të thënë ne – plot fytyra që nuk u përngjajnë vendasve.

Në shtetet skandinave është shumë lehtë të njohësh atë që s’është skandinav. Për kah shtati, për kah dukja, për kah ngjyra veçanërisht, për të mos thënë edhe për kah veshja.

Aty, në “Karl Johan gate”, ishte pikëpjekja e të huajve. Sepse – i madh është fitimi dhe e çmueshme puna (fizike sidomos), por shumë e shtrenjtë jeta...

Ramiz Kelmendi



Pasurojmë fjalorin me fjalë dhe shprehje

konfiguracion – formë e jashtme, pamje e jashtme e sipërfaqes së tokës

kafeteri – byfe, lokal i vogël ku hanë e pinë njerëzit në këmbë

laponë – emri i banorëve të Laponisë që gjendet në veri të Evropës

djerrakohës – humbje kohe kot, bredhje pa nevojë andej – këndeje

metropolë – qytet i madh, më i rëndësishëm i një vendi

pikëpamje – vendtakimi

vikingë – trima, luftëtarë – popull i vjetër norman

vakuumi – zbrazëti, heshtje

vërria – kullotë dimri, vend i ulët

fjorde – gjire të shumta karakteristike detare në Skandinavi



Bisedë rreth tekstit

Bisedojmë për vendet që i kanë vizituar fëmijët edhe atë, për popullin, jetën, natyrën, rrugët, komunikacionin, ashtu si i kanë parë.

Për cilin shtet bëhet fjalë në këtë përshkrim?

Cila pjesë të pëlqen më tepër në këtë përshkrim?

Çfarë bën autori në tekst, vetëm i përshkruan gjërat apo edhe i analizon?

Çfarë mendon ti, a është paraqitur jeta reale, apo është trilluar?

Po të ishit në vend të autorit, edhe çka do t'i shtonit këtij përshkrimi?

Si vishen shokët dhe shoqet e klasës dhe a e përcjellin modën?



Detyrë

Bisedoni me të afërmit tuaj që punojnë në shtete të ndryshme për jetën reale në ato shtete dhe për to bisedoni në një orë të komunikimit.

UDHËPËRSHKRIMI DHE PËRSHKRIMI

Teksti i mësipërm dallohet nga tekstet e tjera letrare. Ky lloj i veçantë i shkrimeve letrare quhet udhëpërshkrim. Kështu, në këto krijime përshkruhen vende të ndryshme, veçoritë e tyre, bukuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik, historik, kulturor e arsimor.

Përpos udhëpërshkrimit, në prozën letrare publicistike kemi edhe përshkrimin. **Përshkrimi** është lloj tregimtar i prozës së shkruar letrare a publicistike, në të cilin jepen, pa hyrë në analizën e lidhjeve të brendëshme të gjërave, tiparet e një njeriu, të natyrës etj. Ose përshkruhet një ngjarje, një dukuri e jetës, etj.

REPORTAZHI

Reportazhi është gjini letrare e publicistikës, që pasqyron punën e veprimtarinë e një fushe ose ngjarje nga jeta e përditshme, të cilat gazetari i ka parë vetë.

Reportazhet mund të jenë të gjata dhe të shkurta.

BIBLIOTEKA

Biblioteka është institucion kulturor ku grumbullohen libra.

A ke vizituar ndonjëherë ndonjë bibliotekë?

Cilët libra ke kërkuar?

A ke libra ti në shtëpi?

Librat në bibliotekë mund të jenë të llojllojshme:

Libra me vjersha

Libra me përralla


Libra me tregime

Romane për fëmijë

Libra enciklopedikë

Libra në gjuhë të huaj





LIBRI, RADIOJA DHE TELEVIZORI

Luli, e hodhi librin pranë televizorit dhe doli të luante. Radioja që ishte aty pranë zuri ta ngacmonte.

Habitem ç'të duan edhe më njerëzit ty?! – i tha ajo. - Ti tashmë je vjetëruar. Pse të lodhen njerëzit mbi shkronjat e tua të imëta, kur mund të shtrihen çlirë-çlirë dhe ta dëgjojnë zërin tim?

Edhe ty të shkoi koha, - ndërhyri televizori. – Unë jam fjala e fundit e teknikës. Në mua çdo gjë është e gjallë: edhe shihet edhe dëgjohet. Mrekullia vetë! Ëndërr mijëvjeçare e njerëzimit. Krejt botën i sjell në shtëpi çdo njeriut.

Mos u krekosni kaq shumë, - u tha libri i qetë. – Së pari, kini një çikë nderim për më të vjetrit. Pastaj kujtojeni nga keni dalë. Pa dijen që kam bartur unë ndër shekuj, ju nuk do të zbuloheshit kurrë. Dhe, fundja, mua më duan ende njerëzit, sepse jam i pazavendësueshem...

INTERNETI

Në kabinetin e informatikës mund të gjeni internetin.

Ç'është interneti?

Interneti është njëlloj si një bibliotekë e madhe kombëtare, ku ka me mijëra e mijëra libra dhe kur hyn njeriu në të hutohet e nuk di ç'të zgjedhë më parë. Por, për të hyrë në internet duhet të dish e ta kesh të qartë se ç`kërkon. Për këtë mund t`ju ndihmojë arsimtari i informatikës ose ndonjë tjetër që di ta përdorë internetin.

Si mund të kërkosh në internet?

Pasi ke hyrë në internet, ke dy mundësi:

a) Ta kesh të qartë se ç`kërkon. Për këtë gjë të këshillon mësuesja ose ar-

simtari i gjuhës ose ndonjë shok që ka lexuar një libër interesant e që ke dëshirë edhe ti ta lexosh, p. sh.: Libri për artin (në internet).

b) Nuk njeh asnjë web-site në lidhje me temën që ty të intereson.

Në rastin e parë, kur ti e di adresën, kërkon në //http.www.artonline.it dhe këtë duhet ta shkruash te vendi bosh ku shkruhet adresa. Pasi t`i kesh dhënë komandën(enter) nga tastiera, ty do të të shfaqet në ekran (home page) e Website-it, të cilin ti e ke zgjedhur.



- Në rastin e dytë, kur ti nuk di asnjë adresë, atëherë mund t`u drejtohesh websit-eve. Aty mund të shkruash me pak fjalë ç`kërkon dhe do të të shfaqen në ekran shumë Website, (ueb-sajt), ndërmjet të cilëve ti duhet të zgjedhesh atë që të intereson.

Disa nga këto Websit-e, janë: www.yahoo.com, www.google.com

Mësoni: www = world – wide – web
 bota - e gjerë - rrjeti

DISKUTIMI

Kujdestari i klasës nuk është i kënaqur me suksesin e arritur nga nxënësit e klasës së tij në gjysëmvetorin e parë. Për këtë çështje vendosi të bisedojë me nxënësit në orën e kujdestarisë. Para nxënësve parashtrroi këto pyetje për diskutim:

Ku qëndron shkaku i këtij mossuksesi te prindërit a tek arsimtarët?

Sa jeni angazhuar për mësim? –

A i keni kryer detyrat e shtëpisë rregullisht?

A janë përgaditur sa duhet arsimtarët gjatë procesit të mësimdhënies?

A ju kanë ndihmuar sa duhet prindërit?

Të diskutojmë rreth këtyre çështjeve dhe të sjellim një përfundim për të diskutuar më tej me prindërit tuaj në një mbledhje prindërore.

Për të diskutuar si duhet ekzistojnë disa rregulla.

Rregullat e diskutimit

Çdo njeri duhet të përpiqet të marrë pjesë në diskutim.
Mendimi duhet shprehur shkurt e pa përsëritje.
Nuk duhet t'i ndërpresim të tjerët, kur flasin.
Të flasim kur na jepet fjala nga drejtuesi i diskutimit.
Duhet t'i dëgjojmë me vëmendje të tjerët, kur flasin.
Ndërsa të tjerët janë duke folur, mund të mbajmë shënime për disa çështje të parashtruara.

Ç'është diskutimi?

Diskutimi është tërësia e mendimeve dhe e pikëpamjeve që paraqit dikush ose që paraqitin një grup njerëzish, për një çështje që shqyrtohet.



Detyrë

Diskutoni rreth temës: Ç' duhet bërë për të përmirësuar suksesin e klasës sonë.

Diskutimi dhe të shprehurit

Diskutimi është një lloj komunikimi që kryhet ndërmjet dy a shumë personash për të shkëmbyer ide, informacione dhe opinione për një fakt a ngjarje të caktuar.

Çdo të thotë të bindësh dike në një diskutim? Do të thotë të japësh informacion, t'i kujtosh bashkëfolësit faktet e argumentet, t'i japësh atij fakte të reja, të panjohura duke dhënë edhe opinion vetjak për to.

Çdo diskutim mbështet mbi tri elemente bazë, të cilat janë:
faktet, argumentet dhe opinionet.

Një diskutim që mbështetet mbi faktet dhe argumentet, për të përballuar opinionet e pjesëmarrësve, është i domosdoshëm dhe i frytshëm. Secili diskutant ka mundësi të pasurojë mendimin e vet me fakte të panjohura, të sjella nga pjesëmarrësit.

NJOFTIMI

Njoftimi është kumtim a lajm i shkurtër dhe i thjeshtë që përmban një informacion të qartë.

Në të mund të jepen të dhëna të hollësishme për diçka që mund të jetë i interesuar dëgjuesi.

Të dhënat në njoftim duhet të jenë zakonisht burimore. Mund të jepen njoftimet të ndryshme, si:

Njoftime për ngjarje që kanë ndodhur dhe

Njoftime për ngjarje që priten të ndodhin.

Të parat mund të jenë më të përpikta dhe përmbajnë më shumë detaje se të dytat. Për nga përmbajtja janë të llojllojshme varësisht nga sfera që u përkasin. Psh.:

Njoftim për ekskursion.

Njoftim për zgjatjen e pushimit gjatë një feste shtetërore.

Noftim për pjesëmarrje në gara sportive etj.

Detyrë

Bëni një njoftim për një ngjarje që pritet të ndodhë në shkollën tuaj. (Dita e Mësuesit, Festa e shkollës).

NJOHIM GJUHËN
TONË

GJUHA SHQIPE DHE VJETËRSIA E SAJ

Shqipja është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Ajo është vazhdim i ilirishtes, i gjuhës së popullsisë ilire që ka banuar në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit të paktën që nga mijëvjeçari i parë para erës sonë.

Nga ilirishtja nuk kemi dokumente të shkruara. Janë ruajtur vetëm disa fjalë të shkëputura që shpjegohen vetëm me anë të shqipes, si: **sika** (thika), **pele** (pleq), **aspetos** (i shpejtë); disa emra gjeografikë: **Dyrrahu** (Durrësi), **Butroti** (Butrinti), **Scodra** (Shkodra), **Lissus** (Lezha), **Dardania** (lidhet me fjalën shqipe dardhë), **Delminium** (lidhet me fjalën shqipe delme, dele), **Dimalum** (lidhet me fjalën shqipe *di* (dy) dhe mal, **Barduli** (emër njeriu lidhet me emrin Bardhyl, e të dy me fjalën i bardhë).

Këto fjalë na shërbejnë vetëm si dëshmi, për ekzistimin e ilirishtes, sepse, disa fjalë, me kalimin e shekujve, e kanë ndryshuar formën edhe kuptimin, kështu që nuk përdoren më. Nga ana tjetër, mjaft fjalë që përdorim sot, nuk ekzistonin atëherë. Një pjesë e tyre janë huajtur nga gjuhë të tjera. Pushtimi romak i Ilirisë dhe më vonë pushtimi i vendit prej sllavëve dhe turqve, ndikuan edhe në gjuhë. Filluan të përdreshin edhe shumë fjalë latine, sllave a turke. Ja disa prej tyre: Fjalë nga latinishtja: **mik**, **shok**, **mjekër**, **qytet**, **pushtet** etj. fjalë nga sllavishtja: **grusht**, **kockë**, **prag**, **strehë**, **çekiç**, **zakon**, **prashit**, **vadit**, **gostit**. etj. Fjalë nga turqishtja: **bari**, **daulle**, **çarçaf**, **perde**, **tepsi**, **sahat**, **dyfek**, **bilbil** etj.

Mjaft prej këtyre fjalëve u bënë pronë e gjuhës shqipe. Të tjera (**sahat**, **surrat** etj.) përdoren në disa situata të caktuara, sepse gjuha letrare shqipe ka të tjera fjalë në përdorim në vend të tyre (**orë**, **fytyrë**).

Gjuha shqipe është folur shumë herët, por me shkrim është dokumentuar mjaft vonë, ndonëse është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Para shekullit të XV hasen vetëm disa fraza të shkurtra, që njihen me emrin:

“Dokumentet e para të shkrimit shqip” dhe ato janë:

1. “Formula e pagëzimit”, shkruar nga Pal Ëngjëlli, kryepeshkop i Durrësit në kohën e Skënderbeut (1462), me qëllim që fëmijët të pagëzohen nga vetë familjet, kur s’mund të dërgohen në kisha apo s’mund të shkojë prifti për t’i

pagëzuar ata. Kjo është një frazë e shkurtër: “Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit” (Unë të pagëzoj në emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë).

2. “Fjalorthi” i Arnold von Harff”-it i cili nga viti 1496 kaloi në Ulqin, Durrës, Sazan. Në Durrës ai mblodhi 26 fjalë, 8 shprehje dhe 12 numërorë shqip, të cilave u vuri përbri edhe përkthimin gjermanisht.

3. “Perikopeja e ungjillit”, e cila përbëhet prej dy pjesësh të vogla shqipe që ndodhen brenda një dorëshkrimi greqisht të shekullit XIV – XV, e shkruar në dialektin toskërisht.

Por vepra e parë e shkruar shqip është “Meshari” i Gjon Buzukut, i vitit 1555. Ai është shkruar në dialektin e Veriut dhe nuk është larg gjuhës së sotme.

Ja një pjesë nga kjo vepër e shkruar në origjinal:

“Ndë vjetët 1554 njëzet dit ndë mars zuna nfill e mbarova ndë vjetët 1555, ndë kallënduar 5 ditë. E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fëjyem, u duo, tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtojnë ndë e mirë... përse nuk çuditëm se në paça fëjyem, këjo tue klenë ma e para vepërë fort e fështirë për të vepruom ndë gjubët tanë...”

Në gjuhën e sotme:

Në vitin 1554 njëzet dit të marsit e fillova dhe e mbarova në vitin 1555, në janar 5 ditë. E nëse, për fat, do të kem gabuar kund më ndonjë vend, unë dua ku të jetë gabimi, ai që të jetë më i ditur se unë, atë gabim e lus ta ndreqë... Sepse nuk çuditëm në paça gabuar, duke qenë kjo vepra e parë e fort e vështirë për t’u punuar në gjuhën tonë...)

Si dokument i parë i plotë i gjuhës shqipe, kjo vepër ka vlerë të madhe gjuhësore. Ajo i ndihmon gjuhëtarët ta shohin zhvillimin e gjuhës shqipe gjatë këtyre 450 vjetëve dhe të depërtojnë në historinë e saj.

KLASAT E FJALËVE

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. A janë shkruar njësoj apo e kanë ndryshuar formën e tyre?

Një **dhelprë** me dinakëri i thotë **korbit**:

- Unë e di që ti këndon mirë, **por** unë kam dëgjuar se yt vëlla këndon edhe më mirë se ti. Përse nuk ia merr edhe ti këngës?

Korbi me **djathë** në gojë heshti, ndërsa tjetri iu përgjigj:

-Im vëlla vërtet këndon bukur, **por** ai nuk bindet lehtë dhe nuk dëgjon mirë, prandaj afrohu e ne **po** zbresim pakëz dhe unë do ta bind.

Dhelpra u afrua nën korbin dhe ia lëshoi **djathin** në gojë. Ajo e gëlltiti dhe menjëherë iu skuqën sytë dhe nisi të villte.

Ju **qenkeni** pa edukatë. Djathi **paska qenë** i prishur!

Ata ia morën këngës; **krra, krra**, gjithë gëzim që ia punuan dhelprës.

Në tekstin e mësipërm janë përdorur **fjalë të ndryshueshme**. Disa prej tyre e kanë ndryshuar formën e disa nuk e kanë ndryshuar. Fjalët e shkruara me shkronja të zeza e kanë ndryshuar formën e tyre gjatë përdorimit në fjali të ndryshme, si: **dhelprë-dhelpra-dhelprës**; **korbi-korbit-korbin**; **djathë –djathi-djathin**; **qenkeni- paska qenë** etj., e këto quhen **fjalë të ndryshueshme**. Ndërkaq fjalët: **me, por, dhe** etj. nuk e kanë ndryshuar formën e tyre, prandaj ato quhen **fjalë të pandryshueshme**.

FJALËT E NDRYSHUESHME

Fjalët e ndryshueshme, sipas disa rregullave të caktuara dhe sipas funksionit që kryejnë në fjali, ndahen në disa klasa (pjesë të ligjëratës) siç janë: **emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët dhe foljet**.

- **Emrat** emërtojnë (tregojnë) qenie të gjalla (frymorë): **djalë, vajzë, nxënës, kalë, dele** etj.; sende a objekte: **mal, fushë, ujë, stilograf,** etj.; dukuri të natyrës:

ditë, natë, mëngjes. Ata kanë një gjini të caktuar (mashkullore, femërore dhe asnjansë) dhe ndryshojnë sipas : **trajtës** (trajtës së shquar dhe të pashquar), **numrit** (njëjës dhe shumës) dhe sipas **rasës** (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore e rrjedhore).

- **Mbiemrat** emërtojnë (shprehin) cilësi (tipare) të frymorëve ose të objekteve a dukurive të treguara dhe përshtaten me emrat në gjini, numër, rasë dhe në trajtë, si: **djalë i vogël, fushë e gjelbër, qytet i madh, njerëz të mirë.**

- **Përemrat** janë fjalë që zakonisht zënë vendin e një emri ose mbiemri, me qëllim që të mos përsëriten. Si të tillë përdoren: **ai, ajo, ata, ato** etj. Kështu emri **Ardi** mund të zëvendësohet me përemrin **ai** në fjalinë e dytë: 1. **Ardi** përgadit librat. 2. **Ai** (Ardi) shkon në shkollë. Por ka edhe disa përemra që përdoren si emra pa e zënë vendin e ndonjë emri si: **ndokush, gjithkush, kurrkush, askush, asnjëri.** Përemrat **lakohen në njëjës dhe në shumës**, ashtu si emrat.

- **Foljet** janë fjalë të ndryshueshme që emërtojnë një veprim, si: **them, këndoj, dëgjoj, marr,** etj., ose një gjendje të kryefjalës, si: **jam, gjendem.** Foljet ndryshojnë sipas **mënyrave, në numër, kohë dhe vetë.**

- **Numërorët** janë fjalë që tregojnë sasi të caktuara frymorësh ose sendesh të një fare. Kur nuk shoqërohen me emra, ata tregojnë thjesht numra

Ç' tregon numërori *një krap* në këtë fjali: Bleva një krap të madh nga ata që kishte zënë peshkatari.

FJALËT E PANDRYSHUESHME

Fjalët e pandryshueshme sipas rolit të tyre, ndahen në disa klasa: **Ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pasthirrma dhe pjesëza.**

-**Ndajfoljet** shërbejnë për të plotësuar kuptimin e një folje, një mbiemri ose një ndajfolje tjetër. P.sh. : Afrimi këndon **bukur.**

Kënga e tij ishte **shumë** e bukur.

Nxënësit u grumbulluan **shumë shpejt** në oborrin e shkollës.

Gjeni ndajfoljet në fjalitë e mësipërme.

- **Parafjalët** janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që vihen para një emri,

përemri a numërori dhe shërbejnë për t'i lidhur këta me fjalë të tjera në një rasë të caktuar, si p.sh.:

Luaj **me** top.

E njoha **nga** të folurit.

Ishte i dashur **nga** të gjithë.

Shkuan dy **prej** nesh.

Ndodhej **afër** qendrës.

Vëreni me kujdes fjalët: **me, afër, prej**, para cilave fjalë qëndrojnë ato ?.

- **Lidhëzat** shërbejnë për të lidhur dy fjalë , dy grupe fjalësh ose dy pjesë të fjalisë së përbërë.

Lidhëzat si fjalë shërbyese ndahen në dy grupe të mëdha:


Lidhëza **bashkërenditëse**: e, dhe, edhe, as, por, kurse, a, ose, prandaj etj., dhe 2. lidhëza **nënrenditëse**: kur, ku, sikur, pasi, se, sepse, që, poqë, po qe se etj.

-**Pjesëzat** shërbejnë për të plotësuar kuptimin e një fjale ose të një fjalie ose të pohojnë ose të mohojnë një mendim, si p.sh.: **Po** dalim menjëherë. Ata **nuk** i kap dot në befasi. Kush të jetë, **vallë**, ky që erdhi tani?

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë pjesëza.

- **Pasthirrmat** shërbejnë për të shprehur një ndjenjë të folësit ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve, si p.sh.: **Ua!** Ti qenke? **Oh**, sa mirë! **Uh**, po atë e dinë të gjithë. **Lamtumirë!** – **Mirupafshim**, gjysh. – **Mirëdita**, u përgjigj Besniku.

Tregoni se çfarë shprehin ato.



MBANI MEND

Mos ngatërroni klasën e fjalëve, me funksionin e tyre. Një fjalë i përket gjithmonë një klase (p.sh. emër) por mund të ketë funksione të ndryshme: kryefjalë, përcaktor, kundrinor, rrethanor.

P.sh.: **Mali** zbardhte nga dëbora.

Fëmijët shkuan **në mal** të mblidhnin çaj **mali**.

Nga ana tjetër, fjalë të klasave të ndryshme (emra, përemra vetorë) mund të kenë të njëjtin funksion (kryefjalë).

Ushtrime

1. Kopjoni tekstin e mëposhtëm. Dalloni emrat dhe thoni ç'funksion kryejnë në fjali.

Pasdite filloi të binte shi. Frynte erë e ftohtë dhe shiu përplasej me forcë pas mureve të avllisë, çative... Malet përreth ngarkuar me mjegull dukeshin sikur ishin sheshuar ose zhvendosur diku larg, duke ia lënë vendin një hapësire të hirtë, pa formë.

2. Gjeni në cilin nga grupet e mëposhtme fjala me shkronja të pjerrëta nuk është parafjalë.

Pas mureve, me Artën, buzë detit, para shtëpisë, përreth vendit, ndodhet afër, sipas parashikimit, shkoi larg.

3. Për secilën nga fjalët e fjalisë së mëposhtme, shkruani ç'pjesë ligjrate është dhe veçoritë gramatikore:

Dielli lëshohej ngadalë prapa maleve të Pelisterit.

Fjala	Pjesa e ligjeratës	Veçoritë gramatikore
Dielli		
lëshohej		
ngadalë		
prapa		
maleve		
të larta		
të Pelisterit		

GRUPI EMËROR

EMRI - KATEGORITË GRAMATIKORE

Gjinia dhe numri i emrit

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe nënvizoni emrat.

Ku ta di unë se kush i kishte treguar se në librari gjendej ai libër, në të cilin bëhej fjalë për një princ të lumtur. I kishin thënë se një shkrimtar i vjetër e kishte shkruar atë përrallë për një princ, që në fëmijërinë e tij kishte qenë shumë i varfër.

Vetëm kaq dinte për atë përrallë të atij libri dhe asgjë më tepër. I kishin thënë se, po të kishte dëshirë të mësonte më shumë për jetën e tij, duhej ta blinte librin.

Mirëpo vogëlushi për të cilin po e shkruaj këtë tregim, nuk kishte para. Ishte shumë i varfër, ndoshta edhe më i varfër sesa princi në fëmijërinë e tij. I qe lutur s'ëmës t'i jepte diçka nga shtëpia për të shitur dhe me ato para ta blinte librin, por ajo i ishte përgjigjur se edhe ato plaçka ishin tepër të pakta.

Gjinia e emrit

Çdo emër ka një gjini të caktuar: **mashkullore, femërore dhe asnjane**.

Si dallohet gjinia e emrave?

Dallimi i gjinisë bëhet duke u mbështetur në **mbaresat** (nyjat e prapme) e tyre.

Janë të **gjinisë mashkullore** të gjithë ata emra që në rasën emërore të shquar të numrit njëjës marrin mbaresën **-i** ose **-u** : **djalë-i, zog-u, burrë,-i, mal-i, peshk,-u, krah,-u** etj.

Janë të **gjinisë femërore** të gjithë ata emra që në rasën emërore të shquar, të numrit njëjës marrin mbaresën **-a** ose **-ja**: **vajzë-vajza, lule-lulja, derë-dera, shkollë – shkolla** etj.

Janë të **gjinisë asnjane** ata emra që në rasën emërore të shquar njëjës marrin mbaresën **-t** ose **-të**: **kryet, të zitë, të kuqtë, të ecurit**.

Emrat e **gjinisë asnjane** në shqipen e sotme janë shumë të kufizuara. Këtu hyjnë disa emra të prejardhur nga mbiemrat si: **të kuq-të, të bardhë-t, të zitë**, si dhe emrat foljorë të tipit: **të folurit, të menduarit, të shkruarit**.

Dallimi i gjinisë së emrave bëhet duke u mbështetur në kuptimin e fjalës si dhe në gjininë e mbiemrave dhe të fjalëve të tjera përcaktuese.

Kini kujdes!

1) Disa emra njerëzish a kafshësh si: **daja, axha, Leka, deda, Kola, Koçoja** lakohen si emrat e gjinisë femërore dhe kur përdoren në fjali në bashkëvajtje me mbiemra, mbiemrat i marrin format e gjinisë mashkullore. Psh.:

Leka i Madh sundoi në shekujt e parë të erës së re.

Kola është punëtor i mirë.

Emrat e këtij tipi do të merren si emra të gjinisë mashkullore.

Nga ana tjetër, kemi emra të tillë si: **Fitnet-i, Irin,-i, Antigona,-i**, megjithëse marrin mbaresën **-i** dhe lakohen si emrat e gjinisë mashkullore, do të merren si emra të gjinisë femërore. Ata shoqërohen me mbiemra të gjinisë femërore: **Fitneti** ishte e **urtë** dhe e **zgjuar**. **Nedreti** është punëtor e **zellshme**.

2) Gjinia e një emri mund të dallohet edhe duke u bazuar në gjininë e fjalëve përcaktuese që i përshtaten emrit: **ky** nxënës, klasë e madhe, motra ime.

- Në ç'gjini janë grupet emërore të mësipërme?

TRAJTA E EMRIT

Lexoni me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe gjeni emrat.

Në ç'gjini dhe në ç'rasë janë ata ?

Në shkollë na erdhi një nxënës i ri. Nxënësi ishte nga një fshat malor. Fshati i tij është i përmendur për mikpritje dhe bujari. Që ditën e parë ai ia filloi punës me zell të madh. Brenda një kohe të shkurtër ai u dallua si në sjellje, ashtu edhe në mësim. Tani ai ka shumë shokë dhe miq që e adhurojnë dhe e ndihmojnë për të përparuar edhe më shumë.

Në tekstin e mësipërm emrat: **nxënës, fshat** janë përdorur edhe në trajtën: **nxënësi, fshati**.

Emrat në gjuhën shqipe kanë dy trajta :

Trajtën e pashquar (nxënës, fshat) dhe **trajtën e shquar** (nxënësi, fshati).

Emri në trajtën e pashquar tregon sende, frymorë etj., në përgjithësi në mënyrë të pacaktuar, p.sh.: nxënës, fshat, shok, mik, shoqe etj.

Emri në trajtën e shquar tregon sende, frymorë etj., të caktuar, të njohur, p. sh. : nxënësi, fshati, miku, shoqja etj.: Nxënësi i ri ishte nga një fshat malor.

Emri **nxënës** në të dy rastet është përdorur në rasën emërore dhe është kryefjalë në fjali. Por emri mund të përdoret edhe në rase të tjera, por me një funksion tjetër, p.sh.: Nxënësin e mirë e duan të gjithë .

Në këtë rast është përdorur në rasën kallëzore dhe është kundrinor i drejtë.

Emrat e pashquar shquhen duke marrë në fund njërin nga këto mbarese, në rasën emërore në numrin njëjës: **a (ja), i, u**: shkollë- shkolla, shoqe-shoqja; mal – mali; fik-fiku, dushk-dushku etj.; ndërsa në numrin shumës: **t** ose **të**: shokë – shokët, miq - miqtë, shoqe – shoqet etj.

Përdorimi i trajtës së shquar e të pashquar

Emri përdoret në **trajtën e shquar** në disa raste :

- Kur është përmendur më parë: Ngadalë se më shkele! – bërtiti një grua dhe vështroi me inat një **djalosh** aty pranë. Gruas i erdhi keq, kur pa fytyrën e turpëruar të **djaloshit**.

- Kur nuk është përmendur, por ka lidhje me një nga emrat e përdorur më parë:

Ai hyri në klasë. **Nxënësit** po rrinin heshtur .

- Kur kuptohet për çfarë bëhet fjalë nga situata në të cilën zhvillohet biseda : Mos flisni me zë të lartë se do më zgjoni **djalin**, - tha **nëna**.

- Kur shoqërohet me një fjalë përcaktuese: me përemra, mbiemra, emra në rasën gjinore etj. P. sh.: **Motra** e tij është mësuese. **Nipi** yt është mjek.

Emri përdoret në **trajtën e pashquar** zakonisht kur shënon një qenie ose send të panjohur deri në atë moment, kur përmendet për herë të parë në një tekst:

Një **djalë** të kërkoi.

Krahaso me: Djali të kërkoi (në këtë rast është fjala për një djalë të njohur).

- Kur shoqërohet nga përemrat dëftorë **ky, kjo, ai, ajo** : Kjo **vepër** duhet lexuar.

Ai **burrë** është trim.

Kujdes!

Për të gjetur trajtën e pashquar të një emri duhet t`i vëmë fjalën **një** (nyjën e pacaktuar) përpara një emri në numrin njëjës dhe **ca (disa)** për numrin shumës : një djalë, një vajzë – ca djem, ca vajza etj.

Lakimi i emrit

Emrat lakohen në trajtën e pashquar dhe të shquar, njëjës dhe shumës.
Më poshtë po japim nga një emër të lakimit të parë, të dytë dhe të tretë.
Vëreni mbaresat që marrin emrat gjatë lakimit nëpër rasi.

Njëjës

Trajta e pashquar

Emërore	(një) djalë	(një) shok	(një) vajzë
Gjinore	(i, e) (një) djal-i	(i, e) (një) shok-u	(i, e) një vajz-e
Dhanore	(një) djal-i	(një) shok-u	një vajz-e
Kallëzore	(një) djalë	(një) shok	një vajzë
Rrjedhore	(një) djal-i	(një) shok-u	një vajz- e

Shumës

Trajta e pashquar

Emërore	(ca) djem	(ca) shokë	(ca) vajza
Gjinore	(i, e) (ca) djem-ve	(i, e) (ca) shokë-ve	(i, e) (ca) vajza-ve
Dhanore	(ca) djem-ve	(ca) shokë-ve	(ca) vajza-ve
Kallëzore	(ca) djem	(ca) shokë	(ca) vajza
Rrjedhore	(ca) djem-sh	(ca) shokë-sh	(ca) vajza-sh

Njëjës

Trajta e shquar

Emërore	djali	shoku	vajza
Gjinore	(i, e) djal-it	(i, e) shok-ut	(i, e) vajz-ës
Dhanore	djal-it	shok-ut	vajz-ës
Kallëzore	djal-in	shok-un	vajz-ën
Rrjedhore	djal-it	shok-ut	vajz-ës

Shumës

Trajta e shquar

Emërore	djemt -të	shokë-t	vajza-t
Gjinore	(i, e) djem-ve	(i, e) shokë-ve	(i, e) vajza-ve
Dhanore	djem-ve	shokë-ve	vajza-ve
Kallëzore	djem-të	shokë-t	vajza-t
Rrjedhore	djem-ve	shokë-ve	vajza-ve

Ushtrime

1. Gjeni emrat në fjalitë e mëposhtme dhe tregoni gjininë, numrin dhe trajtën e secilit.

Po ma plotësove këtë dëshirë, atëherë bindem plotësisht se je shportë, jo si të gjitha të tjerat, por magjike.

Djali kërkonte rreth e qark shokët e tij.. Në rrugë takoi një shoqe të klasës.

Në oborrin e shkollës u dëgjua një zë i fuqishëm, që e bëri plakun të dridhej nga gëzimi.

2. Formoni fjali me emrat e mëposhtëm duke i përdorur një herë në trajtën e shquar e një herë në trajtën e pashquar.

shkollë _____

tryezë _____

mjek _____

personazh _____

portret _____

NUMRI I EMRAVE

Emri ka dy numra: **numrin njëjës** dhe **numrin shumës**. Kur një emër emërton një objekt, një njeri, një dukuri etj., ai është në numrin njëjës: **mal-mali, zog-zogu, mendim-mendimi**. Kur emërton më shumë se një njeri, objekt, një dukuri, është në numrin shumës: **male-malet, zog-zogjtë, mendime-mendimet**.

Formimi i shumësit të emrave

Emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore e formojnë **numrin shumës** në disa mënyra:

- Duke i shtuar formës së numrit njëjës **mbarësa** të ndryshme nga të cilat më të përdorshme janë **-ë, -a** dhe **-e**. P.sh.: një punëtor-**dy punëtorë**, një gur-**dy gurë**, një shok-**dy shokë**, një qytetar-**dy qytetarë**, një drejtor-**dy drejtorë**, një trim-**dy trima**, një shkollë-**dy shkolla**, një vajzë – **dy vajza**, një viç- **dy viça**, një qytet – **dy qytete**, një fis- **dy fise** etj.

Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me **mbarësën –e**, dhe **–ra**, si: **mal-male, vend-vende, fis-fise, ujë –ujëra, djathë-djathëra, fshat-fshatra** kur shoqërohen me mbiemra në numrin shumës e **ndërrojnë gjininë**, kalojnë nga **gjinia mashkullore** në atë **femërore**: **mal i lartë- male të larta, vend**

i bukur- vende të bukura, fshat i ri- fshatra të reja, ujë (uji) i pastër- ujëra të pastra, vaj i mirë- vajra të mira etj.

- Duke ndërruar tinguj në temën e emrave. Ndërrimet më kryesore janë:

a-e p.sh.: dash-desh, plak, pleq etj;

k-q: bujk- bujq, mik-miq, fik-fiq etj;

ll-j: akull-akuj, tingull-tinguj, popull-popuj etj,

r-j: lepur-lepuj, bir-bij etj.

- Duke ndërruar tinguj dhe duke marrë mbaresa njëkohësisht. P.sh.; breg-brigje, shteg-shtigje, lak-laqe, rrezik-rreziqe etj.

- Duke e ruajtur formën e njëjësit: një nxënës- dy nxënës, një mësues-dy mësues, një mësuese-dy mësuese, një kafshë-dy kafshë etj.

Disa emra e formojnë shumësin me mbaresën enj dhe inj : lumë –lumenj, lëmë–lëmenj, por gjarpër-gjarpërinj, shkëmb-shkëmbinj etj.

MBANI MEND

Emrat kanë tri gjini: **gjininë mashkullore, femërore dhe asnjane.**

Emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresat shquese **-i, -u** (djal/ë,-i, zog,-u etj.);

Emrat e gjinisë femërore marrin mbaresat shquese **-a** (nënë-nëna, shkollë -shkolla etj.).

Emrat e gjinisë asnjane marrin mbaresën **-t** dhe **-të** (kryet, të kuqtë etj.).

Shumica e emrave tregojnë frymorë dhe sende që mund të numërohen, prandaj mund të përdoren në të dy numrat: **në njëjës** dhe **në shumës**.

Numri shumës i emrave formohet:

- me anë të mbaresave të ndryshme,

- me anë të ndërrimit të tingujve të temës,

- me anë të mbaresave dhe të ndërrimit të tingujve njëkohësisht dhe

- duke ruajtur formën e njëjësit.

Emrat e gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me mbaresën **-e** dhe **-ra** kur shoqërohen prej mbiemrave kalojnë në gjininë femërore (**male të larta, ujëra të pastra**).

Emri **vit** ka dy shumësa: **vjet** kur shoqërohet me **numërorë** ose fjalë që tregojnë **sasi** (pesë vjet, shumë vjet); vite (këto vite, vitet e para).

Ushtrime

1. Më poshtë është dhënë një listë emrash të gjinisë femërore. Tregoni cilët emra janë futur gabimisht:

Kalë, nënë, grua, motër, plakë, dajë, bankë, pulë, kuti, shtëpi, hoxhë, Kolë, Nermin.

2. Gjinia e emrit caktohet sipas mbaresës që merr emri në rasën emërore, në trajtën e shquar, në numrin njëjës.

Ktheni në numrin shumës emrat e mëposhtëm në trajtën e pashquar:

Ushtar, shofer, fotograf, rosak, kapiten, mikrofon, plep, çelës, gjarpër, shkëmb, fshat, litër, shekull, plak; natë, kërmill, lepur, akull, fik, krushk, peshk, zog, kalë, dash.

3. Shkruani për secilin nga emrat e mëposhtëm emrin në gjininë femërore:

nxënës _____	mjek _____
shkrimtar _____	princ _____
punëtor _____	shitës _____
vogëlush _____	lypës _____

PËRCAKTORËT

- Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'pjesë të ligjëratës janë fjalët që shoqërojnë emrat në grupet emërore?

Ishte pak a shumë siç e kisha parafytyruar. Një **pallat i vjetër**, **ngrehinë hijerëndë** që të kujtonte një **kështjellë mesjetare**... Kapërcejmë **pragun e portës** dhe futemi në oborr. **Ndërtesa trekatëshe** është e rrethuar nga **oborri i madh** ku lëshojnë hije **drurë me kurora** të gjera. Diku përpara vjen **çezma**, një **çezmë** e lartë, ndërtuar me **pllaka guri** të skalitur. Ky ishte një nga **ato vendet** e pëlqyera të Milloshit. Afrohemi dhe pimë ujë te **çezma prej metal**i, e nxirë nga koha e gjatë, ku ka shuar etjen sa e sa herë Milloshi.

Në tekstin e mësipërm ka disa grupe emërore: **pallat i vjetër, oborr i madh, ngrehinë hijerëndë, kështjellë mesjetare, pragun e portës, drurë me kurora, çezma prej mali, ato vendet.**

Fjalët që e shoqërojnë emrin në grupet emërore quhen **përcaktorë (përcaktues)**. Përcaktorët shprehen me **emra, mbiemra, numërorë, përemra** dhe me një pjesë të nënënditur përcaktore.

1. EMRI

a) Emri si një përcaktor i një emri bërthamë.

- Në tekstin e mësipërm gjeni emrat dhe tregoni në ç'rasë janë. Çfarë roli luajnë ata ndaj emrit bërthamë?

Emri në rolin e një përcaktori mund të jetë në rasën:

a) **gjinore, rrjedhore e kallëzore pa parafjalë** e në këtë rast ai tregon:

- **përkatësi**: Shtëpitë e fshatrave janë të vogla.

- **cilësi**: Ajo ishte e **gojës** e s'linte njeri t'i dilte përpara.

- **vend a origjinë**: Këto janë mollët e përmendura të **Prespës**.

Kam blerë ullinj **Berati**.

- **lëndë**: Kishte blerë vathë **argjendi**.

- **përmbajtje**: Bleu një thes **miell**.

b) **emërore, kallëzore e rrjedhore me parafjalë** e në këtë rast ai tregon:

- **karakteristikë a cilësi**: Ajo në Amerikë do të punojë në një fabrikë të **re**.
Kjo është fjalë me **vend**.

- **lëndë**: Do të jap një sheqerkë me **mjaltë**. Shtëpia **prej guri** është e fortë..

- **përmbajtje**: Gjyshja i vinte gjithmonë përpara një **pjatë me fiq**.

- **synim**: Në zemër i vlonte dëshira **për punë**.

- **vend**: U bë fjalë për një shkollë në **malësi**.

Nga shembujt e mësipërm shihet se emri përcaktor vë në marrëdhënie sendin ose frymorin e emërtuar nga emri bërthamë me një send ose frymor tjetër.

b) Emri si ndajshtim i një emri bërthamë

Vëreni fjalët e shkruara me të zeza në fjalitë e mëposhtme. Në ç'rasë janë ato?
Ai ka lindur në muajin **maj**.

Nënë Tereza u shqua për bamirësi.

Usta Dinia u nis për në mal.

E lexova dy herë romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur”.

Fjalët e shkruara me të zeza janë emra. Ata u janë ndajshtuar emrave-bërthamë, dhe i përcaktojnë ata. Pra, janë ndajshtime.

Ndajshtimi është një lloj **përcaktori** që shënon të njëjtin send a dukuri që shënon edhe emri a grupi emëror që ai përcakton. Kështu emrat **maj, nënë, usta** përcaktojnë emrat **muajin, Tereza, Dinia** dhe janë gjithmonë në rasën emërore, në trajtën e pashquar.

Ndajshtimi mund të jetë i **veçuar**, ose i **paveçuar** nga emri - bërthamë. Kur është i veçuar ndahet me presje dhe vjen pas emrit që përcakton.

Psh. Liria, **motra më e madhe e Lirimit**, është profesoreshë.

Ndajshtimi i **paveçuar** qëndron para dhe **pas emrit** që përcakton dhe zakonisht shprehet me një emër të përgjithshëm që tregon **profesion, titull, gradë**: **Profesor Çabeji** është gjuhëtar i dalluar. Ndërsa kur ndodhet **prapa** shprehet me **një emër të përveçëm** që tregon emrin e një vepre, rruge shkollë etj. Psh. : Këshilli i komunës **Saraj** bëri mbledhjen e parë. Lexova romanin „**Lulja e Kujtimit**”.

2. MBIEMRI

Vëreni edhe një herë shembujt e tekstit të mësipërm. Ç’emërtojnë **fjalët i vjetër, hijerëndë, i madh**?

Mbiemri, si përcaktor i emrit, emërton (tregon) **një cilësi, një karakteristikë** (formë, ngjyrë, madhësi) të një frymori, sendi a dukurie të emertuar nga emri.

Mbiemri i vendosur **para** ose **pas** emrit, i cili është i lidhur ngushtë me emrin, quhet edhe **epitet** i emrit.

Përcaktori i shprehur me mbiemër mund të jetë:

- i **paveçuar**, kur lidhet drejtpërdrejt me emrin nga i cili varet dhe shqiptohet pa pauzë. Psh. Drita e **fortë** na i verboi sytë. Puna e **mirë** lavdërohet nga të gjithë.

- i **veçuar**, kur nuk lidhet me emrin që përcakton. Psh. **I kënaqur** shumë, trajneri fluturonte nga gëzimi. Dini, **i dëshpëruar**, përplasi shkopin pas raftit.

Mbiemri kur është i veçuar prej emrit shqiptohet me pauzë, ndërsa në gjuhën e shkruar ndahet me presje.

Përcaktori i shprehur me mbiemër **të nyjshëm** përshtatet me emrin në **gjini, numër** dhe në **rasë**: djalë i **mirë**, vajzë e **mirë**, djalit të **mirë**, vajzës së **mirë**, djem të **mirë**, vajza të **mira**; por kur shprehet me një mbiemër të panyjshëm përshtatet me emrin vetëm në gjini dhe në numër: djalë **besnik**, vajzë **besnike**, djem **besnikë**, vajza **besnike**.

3. PËREMRI

a) **Përemrat pronorë: im, i tij, ynë, juaj, i tyre, ime, jote** etj., përdoren pranë një emri të përcaktuar mirë dhe tregojnë se kujt i përket frymori a sendi i emërtuar nga emri. Ata përshtaten në **numër, gjini**, dhe në **rasë** me emrin që përcaktojnë. P.sh.: **Libri im** është i pastër. **Shtëpia jote** është e madhe. **Fletorja ime** është e pastër.

Provojeni këtë në grupin emëror stilolapsi im duke përdorur veprimet e zëvendësimit. Formoni fjali duke përdorur këta përemra: **yt, i tij, ynë, juaj, i tyre, tanë, tonë**, sipas këtij shembulli: Shokët tanë shkuan në shëtitje.

b) **Përmerat dëftorë ky, kjo, ai, ajo, ata, ato, i këtillë e këtillë, i tillë, e tillë** etj., përdoren për të treguar sende a frymorë të vendosur **afër** ose **larg** folësit. Përdorimi i tyre i shoqëron shpesh gjestet me të cilat tregohen objekte a frymorë të caktuar.

Edhe përemrat dëftorë përshtaten me emrin që përcaktojnë në **gjini, numër e rasë**. P.sh.: **Ky stilolaps** shkruan mirë. **Kjo shkollë** është e madhe. Përemrat dëftorë: **ky, kjo, këta, këto** përdoren me sende a dukuri që ndodhen **afër** folësit, ndërsa **ai, ajo, ata, ato** për sende që ndodhen **larg** folësit.

c) Përemrat pyetës

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funktion kryejnë ato?

Cili djalë hyri në dhomë? **I kujt** je more bir? **Cilët** nxënës treguan sukses të shkëlqyeshëm?

Përemrat pyetës përdoren për të pyetur për një send a një frymor të treguar nga emri. Përemri **cili**? Përshtatet me emrin në **gjini**, në **numër** e **rasë**.

Përemri **ç? çfarë?** Nuk ndryshon formë, kurse përemri **kush?** ndryshon vetëm sipas rasës.

ç) Përemrat e pacaktuar:

Lexoni shembujt e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Sot erdhën **disa** alpinistë të rinj. **Të gjithë** garuesit ishin përgaditur mirë. Fjalët **disa** dhe **të gjithë** janë përemra të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar tregojnë frymorë ose sende në mënyrë të pacaktuar: Të dielën pamë **disa** këngëtarë të rinj. **Të gjithë** nxënësit ishin përgaditur mirë.

Disa përemra të pacaktuar ndryshojnë sipas gjinisë (të gjithë sportistët – të gjitha sportistet); një pjesë ndryshon sipas **rasave** (**secili** punëtor- **secilit** punëtor, **secila** punëtore, **secilës** punëtore). Në përgjithësi përemrat e pacaktuar ndryshojnë sipas numrit.

4. PJESA E NËNRENDITUR E FJALISË SË PËRBËRË SI PËRCAKTUESE E EMRIT

Lexoni me vëmendje këto fjali: Lumi, që kalon përmes qytetit, është i bukur. Filmi që pashë dje më pëlqeu shumë.

Pjesa e nënrenditur përcaktore kryen po atë funksion që kryen një mbiemër a një emër përcaktor. Kur përcakton një emër që nuk është i dalluar qartë, nuk vihet presje.

Rruga që dredhonte anës bregut me plepa, të çonte në qendër të fshatit. Arta kishte sy të ndritshëm, që i lëshonin xixa.

MBANI MEND

Pjesa e nënrenditur përcaktore kryen po ato funksione që kryen një mbiemër a një emër përcaktor.

Detyrë

Përemrat dëftorë: ky, kjo, ajo, i këtillë, i tillë, ato i përdorni në të gjitha format sipas këtij shembulli: Kjo ndërtesë duket shumë e madhe.

Ushtrime

1. Formoni tri fjali me mbiemrat: i guximshëm, i zellshëm, besnik. Vendosni mbiemrat në grup emëror sipas modelit: emër + mbiemër, mbiemër + emër: Trimi i guximshëm s'trembet kurrë:

2. Formoni fjali me grupe emërore me mbiemrat e mëposhtëm: i dendur, i sjellshëm, trim.

3. Emrat e mëposhtëm përdorni si bërthama të grupeve emërore duke i bashkuar me një mbiemër, një emër, një përemër, një pjesë fjalie të përbërë.

rrugë...hartim.....shkollë.....

4. Bashkoi (lidhi) emrat e shtyllës së parë me mbiemrat e shtyllës së dytë duke pasur parasysh përshtatjen në gjini.

rrugë	i lartë
shkollë	i sjellshëm
fëmijë	e gjerë
mal	e re
vajzë	e bukur

4. Shoqërojeni secilin nga emrat e mëposhtëm me një përemër dëftor: aktor, hero, magazinë, album, shoqëri, jetë, banesë, mjedis.

5. Tregoni ç'pjesë e ligjëratës janë fjalët me shkronja të pjerrëta në fjalitë e mëposhtme.

1.- *Cilën* ngjarje po u tregon? – e pyeti xha Guri gjyshin. 2. *Të gjithë* fëmijët u hodhën në ujë dhe filluan të notonin me shpejtësi. 3. *Kohët e fundit* trupa e *teatrit* ka vënë në skenë *disa* drama të bukura.

SHKALLËT E MBIEMRIT DHE TË NDAJFOLJES

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funktion kryejnë ato?

Fshatari ishte mentar **i madh**.

Ti je princ, unë jam fshatar **i thjeshtë**- tha ai. Ti banon në pallat, unë kam shtëpi **të vogël**. Por mik **i dashur**, unë jam në zemrat e të gjithë banoreve të fshatit. A ka gjë **më të bukur** se të të dojë zemra e njeriut? A ka më lumturi? Mandej kur ke **mjaft** miq e shokë, a s'mjafton edhe një pasuri e **vogël** që të **jesh i lumtur**?

Rikujtohuni në atë që keni mësuar më parë. Krahasojeni fjalën **mjaft** me fjalët e tjera të nënvizuara. A ka ngjashmëri me to?

Fjalët **i madh**, **i thjeshtë**, **të vogël**, **i dashur**, **më të bukur**, **e vogël**, **e lumtur**, janë mbiemra ndërsa fjala **mjaft** është ndajfolje.

Mbiemrat mund të tregojnë cilësinë e frymorëve a sendeve në tri shkallë:

Në shkallën **pohore** (shih shembujt e tekstit të mësipërm) si : **i madh**, **i dashur**, **e dashur**, **e vogël** etj. Psh.: Fshatari ishte mentar **i madh**. Delja është një kafshë e **madhe**.

Në shkallën **krahasore** mbiemri e shpreh cilësinë në formë krahasimi , i cili mund të tregojë barazi të cilësisë: **po aq i madh, po aq e madhe, po aq i mirë** etj. Psh.: Delja është një kafshë po aq e madhe sa dhia. Hartimi i Mirlindës është po aq i mirë sa edhe i Flamurit.

– Shkallë më të lartë: **më i madh**: Lopa është kafshë më e madhe se delja.

– Shkallë më të ulët **më pak i madh**. Delja është kafshë më pak e madhe se dhia.

Në shkallën sipërore mbiemri e shpreh cilësinë në shkallë shumë të lartë dhe merr përpara fjalët **mjaft, shumë, tepër, jashtëzakonisht** etj. Psh.: Buallica është një kafshë **shumë e madhe**.

Mbiemrat që tregojnë **lëndë, radhë, kuptime kohe, vendi** etj. përdoren vetëm në **shkallën pohore**. Psh.: Derë e hekurt, gazetë e sotme, populli shqiptar etj.

MBANI MEND

Shkalla krahasore e sipërisë dhe e barazisë si dhe shkalla sipërore e ndajfoljeve formohen me të njëjtat fjalë që formohen shkalla krahasore e sipërisë dhe e barazisë dhe shkalla sipërore e mbiemrave.

SHKALLËT E NDAJFOLJEVE

Ndajfoljet emërtojnë tipare të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat kryhet veprimi ose tregojnë shkallën e një cilësie a një tipari.

Edhe **ndajfoljet**, ashtu si mbiemrat përdoren në shkallë të ndryshme. Ndajfoljet dallohen nga mbiemrat sepse janë **pjesë të pandryshueshme të ligjëratës** dhe rrinë pranë foljeve.

Përdoren në shkallën: **pohore, krahasore dhe sipërore** zakonisht **ndajfoljet e mënyrës: mirë, bukur, ëmbël, qartë, etj.**, si edhe disa **ndajfolje vendi e kohe: lart, poshtë, afër, larg, vonë, herët.**

Shkalla krahasore dhe shkalla sipërore e ndajfoljeve formohet me po ato fjalë me të cilat formohen shkalla krahasore e shkalla sipërore e mbiemrave.

Shkalla pohore: Visari vrapon shpejt.

Shkalla krahasore: Albani vrapon më shpejt se Artani.

Shkalla sipërore: Fisniku vrapon shumë shpejt.

Ushtrime

Gjeni në ç'shkillë janë përdorur mbiemrat në fjalitë e mëposhtme.

Qytezat më të lashta ilire kanë qenë të rrethuara me ledhe dheu. 2. Liqeni i Ohrit është shumë i thellë. Ai është liqeni më i thellë i Gadishullit Ballkanik.

Formoni fjali me mbiemra të shkallëve të ndryshme të lidhur me emrat: Shkupi, Tëtova, Ohri, Pelisteri, Galiçica.

PËREMRA

1. PËRDORIMI I PËREMRAVE

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

“...**Unë** di t’**ua** kallëzoj fshehtësinë shekullore të Shpellës së Piratëve se **ju** jeni guximtarë. Po...u mendua dhe u mendua, - pa uluni pakëz! **Uluni** këtu! Dhe **ne** u ulëm.

Lulja i kishte çelur më shumë sytë e **saj** të mëdhenj. Dhe të dy gërshetat e gjata **që** i binin përpara nuk i linte të qeta.

Peshkatari plak **na** hodhi një sy **të gjithëve**. E shikoni **atë**? – dhe **na** tregoi me dorë hyrjen e çuditshme të Shpellës së Piratëve..- Atje gjer sot nuk ka mundur të hyjë njeri. **Unë** jam munduar disa herë të futem, por nuk ka qenë e mundur.”

Fjalët **unë, ua, ne, ju, e saj, që, të gjithëve, atë, na janë përemra.**

Në gjuhën e folur apo të shkruar përdoren shpesh fjalë që zëvendësojnë emrat ose që përfaqësojnë ata në fjali. Këto fjalë quhen **përemra**.

Disa janë përdorur në vend të emrave për të treguar a zëvendësuar ata (unë, ne, ju, etj.) disa për të përcaktuar (të gjithëve).

Përmerat përdoren që t’i shmangemi përsëritjes disa herë të emrit të njëjtë.

2. LLOJET E PËREMRAVE

Përemrat në gjuhën shqipe sipas kuptimit dhe funksionit që kryejnë ndahen në:

përemra vetorë:	unë, ti, ai, ajo, ne , ju, ata, ato.
përemra dëftorë:	
për afër:	ky, kjo, këta, këto;
për larg:	ai, ajo, ata, ato; i atillë, e atillë, të atillë, të atilla.
përemra pronorë:	im, ime, yt, jote, i tij, i saj, e tij, e saj, i tyre, e tyre, e mi, e mia, e tu, e tua, tuaj, tuaja.
përemra lidhorë:	që, i cili, e cila, të cilët, të cilat.
përemra pyetës:	kush?, cili?, cilët?, ç?, çfarë?.
përemra të pacaktuar:	dikush, ndokush, gjithkush, kushdo, askush, kurrkush; një, ndonjë, njëri, ndonjëri, asnjë, asnjëri; secili, gjithsecili, cilido; çfarëdo, gjithçka, diçka; ca, disa, të gjithë.
përemra vetvetorë:	vete, vetvete, vetvetja.

3. FUNKSIONI I PËREMRAVE

Përemrat kryejnë funksionet e emrit. Kështu sipas funksionit që kryejnë, ata mund të jenë:

- kryefjalë: **Ai** është nxënës i mrekullueshëm.
- kundrinor i drejtë: Shokët e shikojnë **atë** me admirim.
- kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë: Shkolla **u la atyre** mbresa të paharrueshme.
- kundrinor i zhdrejtë me parafjalë: Edhe nxënësit ishin të një mendjeje **me ta**.
- rrethanor: **Te ne** në shkollën tonë erdhën shumë prindër.

PËRMERAT VETORË

Pasqyra e lakimit të përemrave vetorë

Numri	Njëjës			Shumës		
	I	II	III	I	II	III
Vetat						
Rasat	unë	ti	ai, ajo	ne	ju	ata, ato
emërore	unë	ti	ai, ajo	ne	ju	ata, ato
gjinore	-	-	(i,e) atij, asaj	-	-	(i,e) atyre
dhanore	mua, më	ty, të	atij,i; asaj i	neve,na	juve, ju	atyre,u
kallëzore	mua, më	ty, të	atë, e	ne,na	ju, ju	ata, ato, i
rrjedhore	(prej) meje	(prej) teje	(prej) atij,asaj	(prej)nesh	(prej)jush	(prej)atyre

Nga tabela e mësipërme shihet se:

Në të tria vetat përemrat vetorë kanë **numër njëjës** dhe **shumës**.

Vetëm në vetën e tretë ata dallohen edhe sipas **gjinisë**.

Në rasat **dhanore** dhe **kallëzore** kanë një trajtë të **plotë** dhe një trajtë të **shkurtër**.

Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë nuk përdoren në **rasën gjinore**. Konkretizoni çdo rast në tabelë.

Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës dhe shumës: **unë, ti, ne, ju** nuk zëvendësojnë emra që janë përmendur më parë, por tregojnë:

- vetën (personin) që flet ose që shkruan (**folësin**).

- vetën (personin) së cilës i drejtohet mesazhi (**bashkëbiseduesin**).

Pra, ata nuk janë në kuptimin e vërtetë të fjalës përemra vetorë, por tregues të vetës.

Përemrat e vetës së tretë: **ai, ajo, ata, ato** janë përemra në kuptimin e plotë të fjalës. Ata zëvendësojnë emra tashmë të përmendur dhe tregojnë qenien ose objektin për të cilin flitet.

TRAJTAT E SHKURTRA TË PËREMRAVE VETORË

Në pasqyren e lakimit shihet qartë se përemrat vetorë në rasën **dhanore** e në **kallëzore** kanë, veç trajtave të **plota** dhe trajta të **shkurtra**. Trajtat e shkurtra shërbejnë për të shprehur kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë dhe përdoren vetëm ose krahas trajtave të plota.

A i tregove atij?

Nuk i tregova.

Ndodh shpesh që trajta e shkurtër e rasës dhanore **mua më** të shkrihet me trajtën e shkurtër të rasës kallëzore **atë** e dhe të fitohet forma **ma**. Prej **më+e=ma**. Psh.: Këtë stilolaps vëllai **ma** dha mua. Për ta bërë më të qartë këtë formë pyesim: Kujt ia dha këtë stilolaps vëllai? Përgjigja do të jetë **mua më** (në rasën dhanore) + cilin **atë** e (në rasën kallëzore – stilolapsin).

Në këto raste e para është në rasën dhanore, kurse e dyta është në rasën kallëzore.

Pasqyra e trajtave të shkurtra të bashkuara

Trajta e dhanores	Trajta e kallëzores	Trajta e bashkuar	Shembuj
më (mua)	+ e (atë)	= ma	Ma dha librin.
të (ty)	+ e >>	= ta	Ta dha librin.
i (atij, asaj)	+ e >>	= ia	Ia dha librin.
na (ne)	+ e >>	= na e	Na e dha librin.
ju (juve)	+ e >>	= jua	Jua dha librin.
u (atyre)	+ e >>	= ua	Ua dha librin.
më (mua)	+ i (ata, ato)	= m'i	M'i dha librat.
të (ty)	+ i (<< >>)	= t'i	T'i dha librat.
i (atij, asaj)	+ i (<< >>)	= ia	Ia dha librat.
na (neve)	+ i (<< >>)	= na i	Na i dha librat.
ju (juve)	+ i (<< >>)	= jua	Jua dha librat.
u (atyre)	+ i (<< >>)	= ua	Ua dha librat.

MBANI MEND

Me apostrof shkruhen vetëm trajtat **m'i, t'i**.

Shkruhen ndaras vetëm trajtat **na e, na i**.

Mjaft herë vihen re përdorime të gabuara të trajtave të shkurtra të përemrave. Këto gabime janë në numër dhe në vetë. P.sh:

Gabime në numër:

Në vend të: **u** tha atyre

përdoret gabimisht **i** tha atyre

Në vend të : **ua** dha atyre

përdoret gabimisht **ia** dha atyre

Gabime në vetë:

Në vend të: **ju** thashë juve

përdoret gabimisht **u** thashë juve

Në vend të **jua** dhashë juve

përdoret gabimisht **ua** dhashë juve

Në vend të **ua** dhashë atyre

përdoret gabimisht **jua** dhashë atyre

PËREMRI VETVETOR

Njeriu që mendon vetëm për **vetë** është vetjak (egoist).

Lorikut i duket **vetja** i madh.

Ky në **vetvete** është një problem shumë i rëndësishëm.

I dhimbset **vetvetja**.

Fjalët **vetë, vetvete, vetvetja** janë përemra vetvetorë.

Përemrat vetvetorë përdoren në të njëjtën formë për të dy gjinitë dhe për të dy numrat. Përemrat **vetja, vetvetja** lakohen njësoj si emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me e.

Vërtetoheni këtë duke plotësuar me përemër vetvetor këto fjali:

Atij i dhimbset...

Asaj i dhimbset...

Atyre u dhimbset...

MBANI MEND

Përemrat zëvendësojnë ose përfaqësojnë në fjali emrat që janë përmendur më parë që këta të mos përsëriten.

Përemrat janë disa llojesh: **vetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë, pyetës, të pacaktuar.**

Përemrat mund të kryejnë të gjitha **funksionet** e emrit.

Në rasën **dhanore** dhe **kallëzore**, përemrat vetorë kanë, veç **trajtave të plota**, edhe **trajta të shkurtra.**

Kur përdoren dy trajta të shkurtra të përemrit vetor pranë njëra - tjetrës, e para është në rasën **dhanore**, e dyta në **kallëzore.**

Ushtrime

1. Në vend të pikave vini përemrin vetor që duhet.

Në livadhe dolën lulëshqerat.....dukeshin si të mbuluara me breshër kokërrmadh. 2. Dallëndyshet ishin kthyer.....endeshin në kaltërsi duke cicëritur me gëzim.3. Nexhmije Pagarusha është këngëtare shumë e talentuar.....ka

kënduar në Kosovë dhe jashta saj. ...e pres me gëzim Vitin e Ri. Edhe....e pret me gëzim.

2. Nënvizoni trajtat e shkurtra në tekstin e mëposhtëm dhe tregoni në ç'rasë janë.

Ajo pamje gjithnjë e çlodhte. Po mendimet e errëta që e mundonin nuk po i shqiteshin. Donte që t'i këpuste ato si një trëndafil dhe t'i flakte tej. Por mendimet nuk u këputkan lehtë! Ato i vinin dhe i iknin dallgë-dallgë dhe i linin në shpirt e në fytyrë një vrage gëzimi ose hidhërimi.

Për secilën trajtë të shkurtër shkruani pyetjen dhe trajtën e plotë të përemrit vetor. Ç'funktion kryen trajta e shkurtër?

Shembull kë? + atë e - kundrinor i drejtë.

3. Në vend të pikave vini një nga këto trajta të shkurtra të thjeshta ose të bashkuara: e, i, ia.

Afërditës nisi t' hidhej përpjetë zemra, si ai zogu i mbyllur në kafaz. Dhe gati s'mbeti në vend nga gëzimi, kur pa babanë që, me lëvizje të shpejta, ...hoqi përsëri gjerdanin, ..zbërtheu xhakëtën, ...zhveshi dhe ..., hodhi atij.

4. Korrigjoni gabimet në vetë ose në numër në përdorimin e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë.

1. Këto janë mallra që i përgjigjen kërkesave të blerësve. 2. Të rinjtë u ngritën për t'ia lënë vendin të moshuarve. 3.Nuk do t'u harroj kurrë.4.Unë kurrë nuk do t'u harroj.

PËREMRA TË LIDHORË

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Ekipi ynë do t'i shpërblejë vetëm ata lojtarë, **që** do të arrijnë rezultate të mira.

Blerta **që** i mori këto fjalë sikur i drejtoheshin vetëm asaj, fshiu lotët.

Dje takova një shokun tim të rinisë, **i cili** më solli një lajm të mirë.

Fjalët **që** dhe **i cili** janë **përemra lidhorë**.

Përemrin **që** të fjalisë së parë mund ta zëvendësojmë me përemrin lidhor të **cilët** dhe në këtë rast nuk ndryshon kuptimi i fjalisë. Ndërsa po të zëvendësohet me përemrin **e cila** të fjalisë së dytë nuk do të përkonte me natyrën e gjuhës sonë.

Përemrat lidhorë që dhe i cili lidhin pjesën e nërenditur përcaktore me pjesën kryesore të fjalisë së përbërë dhe zëvendësojnë një emër, një grup emëror ose një përemër që ndodhet në pjesën kryesore e që quhet **paraprijësi** i përemrit lidhor ose i pjesës së nënrenditur përcaktore.

Kështu në fjalinë e parë:

Ekipi ynë do t'i shpërblejë vetëm ata **lojtarë**, që.....paraprijës i emrit lojtarë.

Pra përemrat lidhorë luajnë rolin e **përemrave** dhe të fjalëve lidhëse, sepse lidhin pjesën e nënrenditur përcaktore me paraprijësin, që ndodhet në pjesën kryesore.

Përemri lidhor që nuk ndryshon fare në formë, ndërsa përemri lidhor i cili pëson ndryshime në formë, sipas **gjinisë** (e cila), sipas **numrit** (të cilët) dhe sipas **rasës** (të cilit, së cilës).

PËREMRAT DËFTORË

Lexoni shembujt e mëposhtëm dhe dalloni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Kjo shkollë është e bukur.

Po ajo atje është edhe më e bukur.

Ne do të ndërtojmë një të **t**illë.

Fjalët **k**jo, **a**jo të **t**illë janë përemra dëftorë.

Përemrat dëftorë tregojnë frymorë sende ose dukuri që ndodhen afër ose larg folësit.

Përemrat dëftorë për afër janë: **ky**, **kjo**, **këta**, **këto**, **i këtillë**, **e këtillë**, të **këtitilla**, të **këtitillë**, **i tillë**, **e tillë**, të **tilla**.

Përemrat dëftorë për larg janë: **ai**, **ajo**, **ata**, **ato**; **i atillë**, **e atillë**, të **atillë**, të **atilla**.

Kujdes!

Duhet pasur kujdes që përemrat dëftorë **ai**, **ajo**, **ata**, **ato** të mos ngatërrohen me përemrat vetorë që janë të së njëjtës formë **ai**, **ajo**, **ata**, **ato**.

Këta përemra do të jenë përemra dëftorë, nëse pranë tyre mund të përdoren ndajfoljet **aty**, **atje** si dhe kur shoqërohen me një emër. Psh.: Sa e ka gjatësinë **ajo** (dhomë)? Sa e ka gjaësinë **ajo** atje?.

Ajo dhomë është rregulluar bukur.

Përemrat dëftorë zakonisht shoqërohen me gjeste treguese: me dorë, me gisht, me kokë etj.

Përemrat dëftorë **ky, kjo, ai, ajo** lakohen si përemrat dëftorë **ai, ajo**.
Kjo gjë më mirë shihet në pasqyrën e mëposhtme:

Rasa	ky	kjo	këta	këto
E.	ky	kjo	këta	këto
Gj.	i, e këtij	i, e kësaj	i, e këtyre	i, e këtyre
Dh.	këtij	kësaj	këtyre	këtyre
K.	këtë	këtë	këta	këto
Rr.	(prej) këtij	(prej) kësaj	(prej) këtyre	(prej) këtyre

Ndërkaq përemrat i këtillë, e atillë dhe të tjerët e këtij lloji për afër dhe larg lakohen si mbiemrat e nyshëm. P.sh:

Rasa	një libër i këtillë	një fletore e atillë
E.	një libër i këtillë	një fletore e atillë
Gj.	i, e një libri të këtillë	i, e një fletoreje të atillë
Dh.	një libri të këtillë	një fletoreje të atillë
K.	një libër të këtillë	një fletore të atillë
Rr.	(prej) një libri të këtillë	(prej) një fletoreje të atillë

PËREMRRAT PRONORË

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbijt që të pushtoni tokat e **mia**. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia **juaj** do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të të pushuarit. Jo. Nuk na njihni mirë. Ju keni marrë guxim prej fatkeqësisë **sime** dhe prej urrejtjes **suaj**. Guximi **juaj** do të jetë edhe fatkeqësia **juaj**. Ju do t'i shihni kufijtë e vetes kur t'i kaloni kufijtë.

Fjalët: **e mia, juaj, sime, suaj** janë përemra pronorë.

Përemrat pronorë zëvendësojnë ose përfaqësojnë një emër të përmendur më parë dhe tregojnë se kujt i përket (cilës vetë) objekti i emërtuar nga emri. Përemrat pronorë u përshtaten emrave në gjini, numër dhe vetë, si të tillë i marrin format

nëpër rasi. Në vetën e tretë përdoren edhe përemrat pronorë vetvetorë: **i vet, e vet, e veta**. Psh.: Djali i vet, - djemtë e vet; vajza e vet-vajzat e veta.

Përemrat pronorë kanë dy lakime të veçanta:

a) kur përdoren si përcaktues të emrave: **Libri im, i e librit tim, librit tim, librin tim, (prej) librit tim; vajza ime, i e vajzës sime, vajzës sime, prej vajzës sime** etj. dhe

b) kur përdoren më vete: **imi, i e timit, timit, timin prej timit; imja, i e simes, simes, timen, prej simes**.

Përemrat pronorë në gjininë mashkullore kur përdoren më vete në numrin njëjës kanë mbaresën – **i: imi, yni, yti, i tiji, i saji, i tyri**; ndërsa në gjininë femërore marrin mbaresën – **a: imja, jona; jotja, juaja; e tija, e tyrja, e saja**.

Në numrin shumës të gjithë përemrat pronorë kanë mbaresën – **t**.

Përemrat pronorë kanë dy lakime të veçanta:

kur përdoren si përcaktues të emrave: **libri im, i e librit tim; vajza ime; i e vajzës sime** dhe

kur përdoren më vete: **imi, i, e, timit, timin, prej timit ; imja, i e simes, simes, timen, (prej) simes**.

Përemrat pronorë në gjininë mashkullore kur përdoren më vete në numrin njëjës kanë mbaresën – **i: imi, yni, joti, i tiji, i saji, i tyri** etj. Ndërsa në gjininë femërore – **a: imja, jona; jotja, juaja, e tija; e tyrja, e saja** etj.

Kujdes!

Duhet pasur kujdes në përdorimin e drejtë të përemrave pronorë.

Kështu shpesh herë mund të përdoren gabimisht, duke mos u përshtatur në rasi dhe në gjini.

Përdoren gabimisht:

time (Ju përgjigj pyetjes time?!)

tonë (...nxënësit e klasës tonë?!)

tënde (...libri i motrës tënde?!)

tuaj (...nxënësit e klasës tuaj?!)

tonë (Klasa tonë... ?!)

tënde (Shtëpia tënde?!)

Në vend të:

sime (Ju përgjigj pyetjes sime.)

sonë (...nxënësit e klasës sonë.)

sate (...libri i motrës sate.)

suaj (...nxënësit e klasës suaj.)

jonë (Klasa jonë...)

jote (Shtëpia jote.) etj.

MBANI MEND

Përemrat pronorë zëvendësojnë ose përfaqësojnë një emër duke treguar njëkohësisht edhe se kujt i përket objekti i emërtuar nga emri.

Përemrat dëftorë dhe përemrat pronorë përdoren edhe si përcaktorë të një emri, edhe më vete.

Duhet pasur kujdes për të shmangur disa përdorime të gabuara të përemrave pronorë.

Ushtrime

Këto grupe emërore për afër përdorni si grupe emërore për larg: Ky nxënës, kjo nxënëse, këta burra, këto gra.

Plotësoni pasqyrën e lakimit të përemrit dëftor i këtillë në numrin njëjës dhe shumës:

E.	një djalë i këtillë	ca djem...
Gj.	i, e një djali...	ca djemve....
Dh.	një djali...	ca djemve....
K.	një djalë të këtillë	ca djem..
Rrj.	(prej) një djali...	(prej) ca djemve..

1. Lakoni në njëjës dhe në shumës grupin emëror: Një vend i atillë.

2. Plotësoni lakimin e përemrave pronorë në tabelë.

E.	stilolapsi yt	yti	stilolapsi i saj	i saj
Gj.	i, e stilolapsit tënd	i,e tëndit	i, e stilolapsit të saj	i,e të sajit
Dh.	stilolapsit	stilolapsit
K.	tilolapsin...	stilolapsin
Rrj.	(prej) stilolapsit	(prej)	(prej) stilolapsin....	(prej)

PËREMRRAT PYETËS

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Përse përdoren ato?

Kush troket në derë?

Jeton, **kush** po troket në derë?

Baba, një njeri po të thërret.

A e njeh.

Jo baba, nuk e njoh. Kurrë s'e kam parë.

Baba, **cili** ishte ai njeri?

Njeriu që trokiti në derë ishte babai i Afrimit.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza **kush?**, **i cili?** janë përemra pyetës dhe zakonisht përdoren për të pyetur për njerëz, kafshë a sende.

Përemrat pyetës **kush?**, **cili?**, **cila?**, **ç?**, **çfarë?** luajnë rol të dyfishtë.

Zënë vendin e emrave për të cilët shtrohet pyetja, zakonisht emrat që i emërtojnë këto genie a sende konkretizohen në fjalitë që jepen si përgjigje.

Psh.: **Kush** trokiti në derë? - **Një njeri**. b) Dhe janë fjalë pyetëse që shërbejnë për të formuar: **fjali të thjeshta të pyetjes së drejtë**. Psh. **Kush** trokiti në derë? dhe **pjesët të nërenditura të pyetjes së zhdrejtë**. Psh.: Nuk e dinim se **kush** trokiti në derë.

Funksionet e përemrave pyetës

Gjithmonë janë në raport me **foljen** ose me një fjalë tjetër pyetëse. Ata mund të jenë: **kryefjalë**, **përcaktor**, **kundrinor** e **rrethantor**.

Përemrat pyetës **cili** dhe **kush** sipas funksionit që kryejnë ndryshojnë në formë sipas rasave, si :

Kryefjalë: **cili?**, **kush?**

Përcaktor: (Libri) **i cilit?** (Libri) **i kujt?**

Kundrinor i drejtë: **cilin?** **kë?**

Kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë: **cilit?**, **kujt?**

Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë: **me cilin?**, **me kë?**

Rrethantor: Për shkak të **cilit?** Për shkak të **kujt?**

Përemri pyetës **se** përdoret për të pyetur për sendin, për mjetin ose shkakun, por vetëm i shoqëruar me parafjalë: **me se?**, **nga se?**, **për se?** (=për **çfarë?**). Psh.: Me se udhëtove? Përse erdhe qaq shpejt? etj.

MBANI MEND

Përemrat pyetës luajnë rol të dyfishtë:

- si **përemra** përfaqësojnë genie ose sende për të cilat shtrohet pyetja dhe si **fjalë pyetëse** për të formuar **pyetje të drejta dhe të zhdrejta**.

Përemri pyetës **kush** përdoret për të pyetur vetëm për njerëz dhe nuk shoqërohet kurrsesi me emra. Pra është gabim të thuhet: Kush djalë?, Kush qytet?, Kush u nisën? etj. Por duhet: Cili djalë?; Cili qytet?; Cilët (cilat) u nisën?.

Përemri pyetës **cili** përdoret për të pyetur për njerëz, kafshë e sende dhe mund të shoqërohet me emra. P.sh.: Cili djalë?; Cili qengj?; Cilat vajza? etj.

Përemrat pyetës **ç’?** dhe **çfarë?** Përdoren gjithnjë në të njëjtën formë pavarësisht nga funksioni që kryejnë. Përemri pyetës **ç’** shkruhet gjithmonë me apostrof, p.sh: Ç’do të bësh këtu?; Ç’t’u kujtua që erdhe?; Ç’donte të thoshte me atë?.

Në vend të pikave vini përemrin pyetës që mungon (kush, mujt, sa, cilin, me se).

..... foli me zë të lartë?

..... vetë kanë mbetur pa ardhur ende?

..... i vinte ndërmend se ishte për te ne?

..... erdhët në qytet?

..... po e pret me kaq padurim?

PËREMRAT E PACAKTUAR

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja më të zeza. Ç`funktion kryejnë ato?

Bariu mbeti i shtangur me letër dhe florinj në dorë. Nuk dinte se ç’ të bënte tani. Ushtari me fytyrë të qeshur i tha fjalët më të rënda që kanë dëgjuar ndonjëherë veshët e mi: Kjo gjë ishte sekrete dhe po të dëgjonte **ndokush**, që të dy mund të mbesin pa kokë!...

“ Si t’ia bëj tani?...- mendoj edhe pak dhe letrën e futi në kraharor, kurse florinj të i futi shpejt e shpejt në një gropë në rrënjë të plepit të gjatë qindvjeçar.

Në mbrëmje, kur u kthye grigja në fshat, nisi të pyesë tërthorazi të zotin e shtëpisë, ku bunte atë natë, se cili nga fshatarët ishte më i shkolluari.

Më i shkolluari?! – u step fshatari. – Çfarë të shkolluarësh! Ne as që kemi parë me sy si duket shkolla.

Domethënë **askush** nuk di të lexojë në fshat?! – pyeste djaloshi, thuajse nuk i besonte.

Askush..

As kryeplaku?

As ai.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë përemra të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyrë të pacaktuar. P.sh.:

Kush trokiti në derë?- Pyeti **babai**.

Kush trokiti në derë?- Pyeti **ai**;

Kush trokiti në derë? -Pyeti **njëri**.

Po ta analizojmë këtë fjali do të vërejmë se në fjalinë e dytë është përdorur përemri vector **ai**, ndërsa në fjalinë e tretë përemri i pacaktuar **njëri** që përdoren në vend të emrit babai. Vetëm se kur themi **ai** kemi të bëjmë me një person të caktuar, kurse kur themi **njëri** personi lihet i pacaktuar.

Pra edhe përemrat e pacaktuar përfaqësojnë në fjali emra vetëm se ky përfaqësim bëhet në mënyrë të pacaktuar.

Përemrat të pacaktuar janë: **një, njëri, njëra, disa, ca, fare, dikush, ndokush, askush, kurrkush, ndonjë, ndonjëri, ndonjëra** etj.

Disa përemra të pacaktuar ndryshojnë sipas gjinisë, si p.sh: **njëri – njëra, ndonjëri-ndonjëra, secili-secila, cilido-cilado, të gjithë-të gjitha, tjetri-tjetra** etj.

Zakonisht përemrat e pacaktuar që ndryshojnë sipas **gjinisë** edhe **lakohen**.
Më poshtë po japim tabelën e lakimit të disa përemrave të pacaktuar.

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	njëri-ndonjëri-secili	njëra-ndonjëra-secila
Gj.	i, e njërit-ndonjërit-secilit	i,e njërës-ndonjëres-secilës
Dh.	njërit-ndonjërit-secilit	njëres-ndonjëres-secilës
K.	njërin-ndonjërin-secilin	njëren – ndonjëren-secilën
Rr.	(prej) njërit-ndonjërit-secilit	(prej) njëres-ndonjëres-secilës

Po ashtu lakohen edhe përemrat e pacaktuar **dikush, kushdo, disa, askush, kurrkush** etj., por pa pësuar ndonjë ndryshim në gjini.

Rasa	dikush	ndokush	disa	askush
E.	dikush	ndokush	disa	askush
Gj.	i, e dikujt	i, e ndokujt	i, e disave	i, e askujt
Dh.	dikujt	ndokujt	disave	askujt
K.	dikë	ndokë	disa	askë
Rr.	(prej) dikujt	(prej) ndokujt	(prej) disave	(prej) askujt

Nuk lakohen këta përemra të pacaktuar : një, ndonjë, shumë, tërë.

Përemrat e pacaktuar, në përgjithësi nuk ndryshojnë sipas numrit.

Disa përemra të pacaktuar kanë **kuptim mohor**, si p.sh.: askush, kurrkush, asnjë, asnjëri etj.

Disa përemra të pacaktuar përdoren edhe **veç**, edhe të **shoqëruar me emra**. Dhe në këtë rast kryejnë funksionin e kryefjalës a të kundrinorit, si p.sh: Garat olimpike i ndoqën të gjithë. Garat olimpike i ndoqën të gjithë nxënësit e shkollës sonë. Kur përdoren krahas emrave, janë fjalë përcaktuese ose përcaktorë të grupit emëror.

MBANI MEND

Përemrat e pacaktuar përdoren në vend të emrave për të treguar frymorë, dukuri ose sende në mënyër të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar nuk ndryshojnë sipas numrit.

Përemrat e pacaktuar **gjithë** dhe **kurrë**, kur përdoren si pjesë e parë e fjalëve të përbëra, **ë**-ja në fund të kësaj pjese nuk shkruhet. Pra jo **gjithëçka**, **kurrëgjë**, por: **gjithçka**, **gjithsecili**, **gjithfarë**, **kurrëgjë**, **kurrkush**.

Ndërkaq përemrat e pacaktuar **njëri-tjetri** dhe **shoqi –shoqin** shkruhen me vizë në mes.

Ushtrime

Secilën fjali pyetëse bashkoheni me vijë me përgjigjen e saj.

Kush foli në mbledhjen e prindërve? Ai kishte qenë nxënës i at Gjergj Fishtës.

Kë rrethuan fëmijët? → Ata i dhuruan lule mësueses.

Kujt i dhuruan lule ata? Fëmijët rrethuan shkrimtarin.

Nxënës i kujt kishte qenë ai? Në mbledhjen e prindërve foli kujdestari i klasës.

Në cilat raste janë përdorur gabim përemrat pyetës? Pse janë përdorime të gabuara?

Kush erdhën dje?

Cilët nxënës erdhën dje?

Kush nxënës erdhi me vonesë?

Kush erdhi me vonesë?

Kujt nxënëse i humbi stilolapsi?

Kush djalë u kthye?

Kush u kthye?

Cili i kthye?

Formoni nga një fjali me përemrat e pacaktuar të mëposhtëm:
njëri, ndonjëra, secila, dikush, asnjë, të gjithë.

FJALËT E PREJARDHURA

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni me kujdes fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Krahasoni ato me fjalët e tjera.

Babai im, që në mëngjes, pa zbardhur drita shkon në punë. Ai është **punëtor** i dalluar, sepse e do punën pa masë. Ai **punon** në një **punëtori** të re. Me të punojnë edhe shumë **punëtorë** të tjerë. Punimet e tyre janë të cilësisë më të mirë.

Po, babai yt ku punon?

Ai punon në një **punëtori** të vogël. Ai është **teneqepunues** dhe punët i kryen menjëherë.

E babai i Bekimit?

Ai është **nëpunës** në një uzinë.

Në këtë tekst janë përdorur fjalë të **thjeshta** të cilat nuk mund të ndahen në pjesë më të vogla, si: **babai, im, që, shkon, në, ai** etj. dhe fjalë **jo të thjeshta** që ndryshe quhen edhe **fjalë të prejardhura**. Këto dallohen nga të parat, sepse në përbërjen e tyre, së paku, kanë dy elemente që kanë kuptim të qartë, d.m.th. përbëhen nga fjala **bazë** (rrënja, tema) dhe nga **elementi shtues** që quhet **parashtesë** ose **prapashtesë**, si: **punëtor-punë+tor, punëtori – punë+tori, punimet –pun+im(et)**. Por ka edhe fjalë të tjera që përbëhen nga dy ose më shumë **fjalë bazë** të cilat quhen **fjalë të përbëra**.

Si fjalë e tillë në tekstin e mësipërm na paraqitet fjala **teneqepunues – teneqe + punues**.

Fjalët e prejardhura me parashtesa

Më poshtë janë dhënë disa parashtesa, si: **jo, tej, zh, mbi, për**, etj. dhe disa emra dhe folje. Bashkoni parashtesat me fjalët bazë dhe formoni fjalë të reja.

RI – lindje ndërtim ngjallje kujtim punim	JO - kalimtar pjellor shques bindës miqësor	TEJ - dukje kalim dukshëm kaloj pamës	ZH - bëj gënjehem vishem vendos dukem
Mbi – shkrim shtresë këqyr emër	Për – punim kujtim shkrim	Mos – pëlqim njohje pajtim	Stër - gjysh holloj nip

Fjala **mospëlqim** është formuar nga parashtesa **mos** – dhe fjala bazë **pëlqim**. Tregoni për çdo fjalë parashtesën.

Parashtesë quhet **pjesa e fjalës** që i shtohet një fjale **përpara**.

Parashtesat nuk kanë theks dhe shkruhen bashkë me fjalën bazë.

Fjalët e prejardhura të formuara me prapashtesa

Më poshtë janë dhënë disa prapashtesa, si: **-sor, ësi, -tar, im**, etj. Formoni fjalë të reja me ndihmën e tyre.

-sor	-ësi	tar	-tor	-tari	-im
anë	shëndet	arsim	punë	pemë	pun(oj)
këmbë	fshatar	çlirim	skia	pyll	gërm(oj)
mal(ë)	lig	flamur	mina	veprim	rrezat(oj)
tokë	pafaj	gjyq	faj	zej	pëlq(ej)
bujq (ë)	bujq	lavër	vjesh	lavër	mës(oj)

Prapashtesë quhet ajo pjesë e fjalës së prejardhur që i shtohet **prapa** fjalës bazë. P.sh., **arsim + tar = arsimtar, shëndet + si = shëndetësi**.

Numri i prapashtesave është shumë më i madh krahasuar me atë të parashtesave dhe shumica e tyre janë të theksuara. Ato ia ndryshojnë klasësn fjalës së cilës i shtohen. P.sh., nga folja hap mund të formohen këto fjalë:

hap	i hapur	- mbiemër
	hapur	- pjesore
	hapje	- emër

Prapashtesat më prodhimtare e që përdoren më dendur janë ato që i përmendëm në shembujt e mësipërm. Por ka edhe të tjera, si: **-ues** (lexues, punues; **- ishte** (lulishte,

pemishte); - **shëm** (i ndershëm, i sjellshëm, i rrjedhshëm); - **nik** (fisnik, lisnik) etj.

Prapashtesat **-o, -ro, -so, -zo** etj. shërbejnë për të formuar folje të zgjedhimit të parë, si: punoj, shkoj, numëroj, pjesëtoj, qetësoj etj.

Me prapashtesat **-as, -azi, -isht, -thi** formohen ndajfolje, si p.sh.: haptas, djathtas, fshehtas, fshehtazi; fshehurazi; rregullisht, rrjedhimisht, fluturimithi; kalimthi etj.

Fjalë të prejardhura të formuara me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht

Ka edhe disa fjalë që formohen me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht, si p.sh.: **ç + arma + tos = çarmatos, ç + arma + tim = çarmatim; z + bardh + oj = zbardhoj** etj.

Formoni fjalë të reja me anë të prapashtesave **-tar, -tor, -si**:

arsim _____	fshat _____	anë _____
qytet _____	faj _____	gjellë _____
fakt _____	punë _____	
(i) vogël _____	(i) bardhë _____	(i) thatë _____

FJALËT E PËRBËRA

Formoni fjalë të përbëra me fjalën bazë **sy-, dorë-** dhe **kokë-** dhe fjalët e poshtëshënuara nën to.

sy-	dorë-	kokë-
mbyllur	lirë	fortë
zi	thatë	çarje
çelë	shtrenjtë	fëlliqur
shkruar	cung	varur

Siç shihet nga shembujt e mësipërm **fjalët e përbëra** janë formuar **nga bashkimi i dy fjalëve bazë** **sy + (i) zi = syzi; dorë + (i) lirë = dorëlirë**, etj. d.m.th. nga bashkimi i një emri me një mbiemër.

Ka edhe fjalë të përbëra që formohen nga bashkimi i dy emrave, si p.sh.: bregdet (breg + det);

i një numërori me një mbiemër ose emër si p.sh.: dyluftim (dy + luftim), dyjavor (dy + javor);

i një folje me një emër; vëmendje (vë + mendje);

i një emri me një folje: dorështrënguar (dorë + shtrënguar);

i një ndajfolje me një emër; baraspeshë (baras + peshë), drejtshkrim (drejt + shkrim); bashkëpunëtor (bashkë + punëtor); parathënie (para + thënie) etj.

FJALËT E PËRNGJITURA

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Gjëegjëza është fjalë e këndshme.

Thashethemët janë fjalë të kota.

Nxënësi u kthye menjëherë në shtëpi.

Bleva njëmbëdhjetë kilogramë mollë.

Fjalët e shënuara me shkronja të zeza janë **fjalë të përngjitura**, të cilat duke u përdorur një kohë të gjatë njëra pranë tjetrës janë bashkuar, përkatësisht janë ngjitur dhe kanë formuar fjalë të përngjitura.

Fjalë të përngjitura janë :

emrat: **gjëegjzë**, **farefis** etj;

numërorët: **dymbëdhjetë**, **katërmëdhjetë**, **njëqind**, **pesëqind** etj

ndajfoljet: **atëherë**, **menjëherë**, **gjithandej** etj;

parafjalët: **nëpër**, **përmbi**, **përveç** etj.

FAMILJA E FJALËVE

Fjalët e prejardhura dhe të përbëra që formohen prej një rrënje të përbashkët përbën një familje fjalësh. Kështu fjalët:



janë formuar në bazë të fjalës rrënjë **mbyll**.


Të familjet e fjalëve dallohen dy lloje serish:

Seritë e rregullta dhe

Seritë e çrregullta

Të rregullta janë ato seri të cilat zanorja e theksuar mbetet e pandryshuar të gjitha fjalët e prejardhura të formuara me parashtesa, me prapashtesa, me bashkim apo përngjitje siç është seria e fjalës **mbyll** (folje). Po kështu mund të formohen seri të rregullta me foljet: **hap**; **vesh** etj.

Të çrregullta janë ato seri, të cilat rrënjat që është bartëse e të gjitha kuptimeve leksikore të fjalëve të një familjeje, pëson ndryshime fonetike. P.sh.:



Në këtë rast rast shihet se zanorja e rrënjës o e fjalës grumbulloj ka pësuar ndryshime: o – bie ose zberthehet në **ua, ue**.

MBANI MEND

- Fjalët janë **të thjeshta** dhe **jo të thjeshta**. Fjalët jo të thjeshta janë fjalë **të prejardhura** ose **të përbëra**

- Fjalët **e prejardhura** formohen me anë **të parashtesave**: mbishkrim – mbi + shkrim, çrregulloj – ç + rregulloj etj. ; me anë **të prapashtesave**: qytetar – qytet + ar; malor – mal + or; **me parashtesa** dhe **prapashtesa njëkohësisht**: pagjumësi (pa + gjumë + si), stërmadhim (stër + madh + im) etj.

- Fjalët **e përbëra** formohen nga **bashkimi i dy rrënjëve** (temave) pikënisje (pikë + nisje), kokëfortë (kokë + fortë) etj.

- Fjalët **e përngjitura** janë formuar nga përngjitja **e dy a më shumë fjalëve** të përdorura për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës: menjëherë, tetëmbëdhjetë etj.

Ushtrime

1. Tregoni si janë formuar fjalët e mëposhtme:

i çuditshëm, i përhershëm, fitimtar, stërnip, përmirësim

2. Formoni fjalë të përngjitura me fjalët: gjithë, një, herë, farë. Kini kujdes si do ti shkruani ato.

3. Bashkoni fjalët e shtyllës së parë me ato të shtyllës së dytë dhe formoni fjalë të përbëra.

mik	kryq
bukë	gjerë
udhë	mbathje
zemër	hollë
mendje	pjekës
vesh	pritje
	heqës

KLASIFIKIMI I FOLJEVE NË ZGJEDHIME

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'emërtojnë ato?

Unë nuk e **di** i cilës ushtrie **je** ti, sepse asnjëherë nuk i **kam** njohur rrobat e ushtrisë dhe tani **jam** shumë plakë për t'i mësuar, por ti **je** i huaj dhe i një prej atyre ushtrive që na **kanë** vrarë. Ti **ke** zanatin e mallkuar të luftës dhe **je** një prej atyre që më **kanë** bërë mua gjysmënjeriu, një copë plakë të shushatur, që **vjen** në këtë dasmë të huaj dhe **rri** në qoshe dhe **lëviz** buzët, duke biseduar me ty. Asnjëri nuk **di** ç'them unë, sepse të gjithë **janë** shumë të gëzuar dhe unë nuk **dua** t'ua **prish** gëzimin të tjerëve.

Me siguri vërejtët se fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë **folje**.

Fjalët që emërtojnë një veprim, një punë a ndodhi ose një të qenë të kryefjalës quhen folje.

Foljet janë pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që ndryshojnë në **kohë**, **mënyrë**, **vetë** e **diatezë**. Folja përbën bërthamën kryesore të fjalisë. Çdo folje në gjuhën shqipe ka një **trajtë përfaqësuese**, e cila jepet edhe në fjalorë.

Si trajtë përfaqësuese e foljes merret veta e parë njëjës e kohës së tashme të mënyrës dëftore në formën veprorë. P.sh.: trajta përfaqësuese e foljes **kam njohur** është **njoh**. Ndërsa trajta përfaqësuese e foljes **kam shkruar** është **shkruaj**. Kjo formohet nga **tema shkrua + mbaresa j**.

Sipas temës dhe mbaresave që marrin në trajtën përfaqësuese foljet ndahen në tri zgjedhime:

Zgjedhimi i **parë** përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në **zanore** dhe marrin mbaresën **j**. P.sh: **lexo-j, la-j, gje-j, pëlqe-j, shkrua-j, lye-j** etj.

Zgjedhimi i **dytë** përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në bashkëtingëllore dhe nuk marrin asnjë mbaresë në të tria vetat e njëjësit. P.sh.: **Hap, kap, mbyll, mbush, qesh, lodh, rrit** etj.

Në këtë zgjedhim bëjnë pjesë edhe një numër foljesh që pësojnë ndryshime në temë duke ndërruar zanoren a në e ose e në o, si p.sh.: heq (hoqa- hequr), marr (mora- marrë), dredh (drodha- dredhur), nxjerr (nxora- nxjerrë), hedh (hodha – hedhur), pres (prita – pritur), flas (fola – folur) etj.

Zgjedhimi i **tretë** përfshin një numër të kufizuar foljesh që në trajtën përfaqësuese dalin me temë në zanore dhe nuk marrin asnjë mbaresë. P.sh.: **pi, fle, di, lë, vë, zë, shpie**, etj.

Në tekst dalluam edhe foljet **rri** dhe **dua**. Këto janë folje të parregullta dhe nuk klasifikohen në zgjedhime, sepse tema e tyre ndryshon mjetat në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore nga tema e trajtës përfaqësuese: rri – ndenja – ndenjuri; dua – desha – dashur etj.

Më poshtë po japim një pasqyrë për tri zgjedhimet e foljeve.

Koha e tashme e mënyrës dëftore (forma veprare)				
Nr.	Veta	Zgjedhimi I	Zgjedhimi II	Zgjedhimi i III
Njëjës	unë	mësoj -j	mbyll -	lë -
	ti	mëson -n	mbyll -	lë -
	ai, ajo	mëson -n	mbyll -	lë -
Shumës	ne	mësojmë -jmë	mbyllim -im	lëmë -më
	ju	mësoni -ni	mbyllni -ni	lini -ni
	ata, ato	mësojnë -në	mbyllin -in	lënë -në

F O L J E T								
Nr.	Veta	marr	bredh	mbledh	pres	hedh	zgjedh	djeg
Njëjës	unë	marr	bredh	mbledh	pres	hedh	zgjedh	djeg
	ti	merr	bredh	mbledh	pres	hedh	zgjedh	djeg
	ai, ajo	merr	bredh	mbledh	pret	hedh	zgjedh	djeg
Shumës	ne	marrim	brechim	mblechim	presim	hedhim	zgjedhim	djegim
	ju	merrni	bridhni	mblidhni	pritni (prisni)	hidhni	zgjidhni	digjni
	ata, ato	marrin	brechin	mbedhin	presin	hedhin	zgjedhin	djegin

Ushtrime

1. Lexoni tekstin “Nica kujton” dhe nxirrni nga dy folje të secilit zgjedhim. Zgjedhijini ato në kohën e tashme.

2. Ndani në zgjedhime foljet e mëposhtme; zë, hip, ngarkoj, qesh, hyj, dërgoj, kërkoj, nxjerr, mbush, përmbush dhe tregoni arsyen.

3. Vini në formën e duhur foljet në kllapa.

Vëllai im më (pres) sa të bëhem gati.

Shoku im (merrem) më gjimnastikë. Ai nuk (mësoj) sa duhet. Vjollca e vogël (krihem) vetë. Shpendi (flas) shpejt dhe nuk i (shqiptoj) mirë fjalët.

FORMAT VEPRORE DHE JOVEPRORE TË FOLJEVE

Lexoni me vëmendje fjalitë e mëposhtme, analizoni domethënien dhe formën e foljeve të shkruara me shkronja të zeza.

Alba e uli kokën dhe filloi të shkruante letrën. Në letër ajo pasqyroj të gjithë ngjarjen. Pasi e mbaroi mësuesi i tha që ta lexonte letrën. Letra ishte shkruar bukur dhe u pëlqye shumë nga të gjithë. Edhe kësaj herë Alba u lavdua nga mësuesi.

Foljet **uli**, **filloi të shkruante**, **pasqyroj**, **lexonte** janë në formën veprore, sepse tregojnë veprime që kryejnë kryefjalët **Alba** dhe **mësuesi** e që bien mbi kundrinorët e drejtë: (kokën, ngjarjen, letrën) të cilët mund t'i gjejmë me pyetjet : **kë?**, **cilën?**, **çfarë?** që ja bëjmë foljes- kallëzues. P.sh.: Alba e uli kokën. Kë e uli Alba?-**Kokën**.

Ndërsa foljet **ishte shkruar**, **u pëlqye**, **u lavdua**, janë të formës joveprore, sepse tregojnë veprime që kryehen prej dikujt tjetër dhe që e pëson kryefjala (**Alba**).

Pra, foljet në përgjithësi veprimin e shprehin në dy forma: **në formën veprore** dhe **formën joveprore**.

Këto dy forma dallohen njëra nga tjetra:

1. nga **mbaresat e ndryshme** që marrin foljet në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer të mënyrës dëftore;

2. nga përdorimi ose jo i pjesëzës u para foljes në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore dhe

nga foljet ndihmëse **kam** për formën veprore e **jam** për formën joveprore që përdoren për të formuar kohët e përbëra p.sh. **kohën e kryer**, **më se të kryer** dhe në kohën e kryer të tejshkuar.

Pasqyra e zgjedhimit të foljes mësoj në mënyrën dëftore

Numri	Veta	Koha e tashme		Koha e kryer e thjeshtë	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	mësoj	mësohem	mësova	u mësova
	ti	mëson	mësohesh	mësove	u mësove
	ai, ajo	mëson	mësohet	mësoi	u mësua
Shumës	ne	mësojmë	mësohemi	mësuam	u mësuam
	ju	mësoni	mësoheni	mësuat	u mësuat
	ata, ato	mësojnë	mësohen	mësuan	u mësuan

Numri	Veta	Koha e pakryer		Koha e kryer	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	mësoja	mësohesha	kam mësuar	jam mësuar
	ti	mësoje	mësoheshe	ke mësuar	je mësuar
	ai, ajo	mësonte	mësohej	ka mësuar	është mësuar
Shumës	ne	mësonim	mësoheshim	kemi mësuar	jemi mësuar
	ju	mësonit	mësoheshit	keni mësuar	jeni mësuar
	ata, ato	mësonin	mësoheshin	kanë mësuar	janë mësuar

Numri	Veta	Koha më se e kryer		Koha e kryer e tejshkuar	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	kisha mësuar	isha mësuar	pata mësuar	qeshë mësuar
	ti	kishe mësuar	ishte mësuar	pate mësuar	qe mësuar
	ai, ajo	ka mësuar	është mësuar	pati mësuar	qe mësuar
Shumës	ne	kishim mësuar	ishim mësuar	patëm mësuar	qemë mësuar
	ju	kishit mësuar	ishit mësuar	patët mësuar	qetë mësuar
	ata, ato	kishin mësuar	ishin mësuar	patën mësuar	qenë mësuar

Zgjedhimi i foljes marr në mënyrën dëftore

Numri	Veta	Koha e tashme		Koha e kryer e thjeshtë	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	marr	merrem	mora	u mora
	ti	merr	merresh	more	u more
	ai, ajo	marr	merret	mori	u mor
Shumës	ne	marrim	merremi	morëm	u morëm
	ju	merrni	merreni	morët	u morët
	ata, ato	marrin	merren	morën	u morën

Numri	Veta	Koha e pakryer		Koha e kryer	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	merrja	merresha	kam marrë	jam marrë
	ti	merrje	merreshe	ke marrë	je marrë
	ai, ajo	merrte	merrej	ka marrë	është marrë
Shumës	ne	merrnim	merreshim	kemi marrë	jemi marrë
	ju	merrnit	merreshit	keni marrë	jeni marrë
	ata, ato	merrnin	merreshin	kanë marrë	janë marrë

Numri	Veta	Koha më se e kryer		Koha e kryer e tejshkuar	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	kisha marrë	isha marrë	pata marrë	qeshë marrë
	ti	kishe marrë	ishe marrë	pate marrë	qe marrë
	ai, ajo	kishte marrë	ishte marrë	pati marrë	qe marrë
Shumës	ne	kishim marrë	ishim marrë	patëm marrë	qemë marrë
	ju	kishit marrë	ishit marrë	patët marrë	qetë marrë
	ata, ato	kishin marrë	ishin marrë	patën marrë	qenë marrë

FOLJET PAVETORE

Përveç foljeve vetore të cilat lidhen në fjali me një kryefjalë dhe mund të përdoren në të tria vetat njëjës dhe shumës ka edhe folje ose shprehje foljore që nuk kanë kryefjalë dhe që përdoren vetëm në vetën e tretë njëjës, e këto quhen folje pavetore. Të tilla janë: **veson, vetëtin, bubullin, bën ftohtë** etj.

Psh.: **Dje bëri ftohtë.** Këtyre foljeve nuk mund t'u bëjmë pyetje për ta gjetur kryefjalën, sepse nuk mund të jepet një përgjigje e duhur. Psh : Cili bëri ftohtë?- s'mund të jepet një përgjigje, pra s'mund të gjendet një kryefjalë.

Por ka edhe folje të tilla si folja **duhet** dhe **do**; folja **kam** që përdoren edhe si vetore edhe si pavetore. Zakonisht foljet pavetore emërtojnë **dukuri atmosferike** ose **natyrore**, si p.sh.: **bie** (shi), **fryn** (erë), **bleron** (livadhi) etj., e disa janë karakteristike për të treguar veprimet e kafshëve, si p.sh: **hingëllin** (kali), **hungëron** (ujku dhe qeni), **kakaris** (pula), **pëllet** (gomari) etj.

MBANI MEND

Foljet veprimin e tyre e shprehin në **dy forma**: në **formën veprore** dhe **joveprore**.

Këto dy forma dallohen ndërmjet tyre nga: **mbaresat foljore**, nga pjesëza **u** në të kryerën të thjeshtë dhe nga **folja ndihmëse** që përdoret në **kohët e përbëra**: **kam** për **formën veprore** dhe **jam** për **formën joveprore**.

Disa folje apo shprehje foljore pavetore përdoren vetëm në vetën III njëjës dhe nuk kanë kryefjalë.

Ushtrime

1. Foljet e mëposhtme të formës veprore i ktheni në formën joveprore, si p.sh.: **laj, pyes, gëzoj, mendoj**.

2. Shkruani fjali të tilla që fjalët me shkronja të zeza të përdoren si kryefjalë. Si ndryshon forma e foljeve?

Nxënësit e klasës sonë e vizituan **ekspozitën e librave**.

Dita e mësuesit "7 Marsi" do të festohet nga të gjithë **nxënësit**.

Ardiani ndërtoi **një shtëpi të madhe**.

3. Dalloni foljet pavetore në fjalitë e mëposhtme. Thoni në ç'mënyrë e në ç'kohë janë ato?

Mjegulla u shkri.

Bënte vapë.

Deti shkëlqente nga rrezet e fundit të diellit flakë.

Në vjeshtë gjëmon.

Tërë ditën veson.

MËNYRA DËFTORE

Lexoni dialogun e mëposhtëm dhe vëreni foljet e shkruara me shkronja të zeza. Tregoni se në ç'kohë kryehen veprimet.

Genc, ç'bën ashtu?

Po **lexoj** një libër me tregime.

Po nesër **ç'do të bësh**?

Nesër **do të shkoj** te gjyshja. Atje **do të ndihmoj** në vjeljen e pemëve.

E ti, Vjollcë, **çdo të bësh**?

Unë **do të shkoj** në teatër me motrën.

Sigurisht **do ta shohësh** atë pjesë që e **kam parë** unë.

Foljet e dialogut të mësipëm janë në kohën e tashme: **lexoj**, në kohën e ardhme: **do të shkoj**, **do të bësh**, **do të ndihmoj**, **do të shohësh** dhe në kohën e shkuar: **kam parë**, në mënyrën dëftore.

Pra, foljet në mënyrën dëftore kanë tri kohë kryesore: të tashmen, të kaluarën dhe të ardhmen. Veprimi i foljes në këtë mënyrë paraqitet si i vërtetë.

MBANI MEND

Me anën e mënyrës **dëftore** folësi e paraqet si **të vërtetë** veprimin e emërtuar nga folja.

Por ka edhe mënyra të tjera të foljes që veprimin mund ta shprehin si **të mundshëm** dhe si **të dëshirueshëm** apo edhe ndonjë mënyrë tjetër, siç janë: **mënyra lidhore, habitore, dëshirore, urdhërore e kushtore**.

Koha e tashme e mënyrës dëftore tregon se veprimi kryhet në **çastin kur flasim** ose kur shkruajmë: Po **lexoj** një libër interesant.

Folja në këtë kohë shoqërohet edhe me pjesëzën **po**, kështu që kjo i jep mundësi foljes të tregojë një veprim të caktuar që vazhdon të zhvillohet në **çastin e ligjërimit**: Hesht!-Ja, po hesht.

Koha e shkuar tregon se veprimi është kryer **para çastit të ligjërimit**: Sigurisht do ta shohësh atë pjesë që e kam parë.

Kjo kohë ka pesë nëndarje: **të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më se të kryerën dhe të kryerën të tejshkuar**.

Koha e ardhme tregon se veprimi do të kryhet **pas çastit kur flasim**: Atje **do të ndihmoj** në vjeljen e pemëve.

Koha e shkuar e mënyrës dëftore

Në të folur e në të shkruar shpesh ndodh që të tregojmë ngjarje që kanë ndodhur në të kaluarën. Këtë gjë e bëjmë në hartimet në shkollë, po ashtu edhe gjatë bisedimeve ose kur shkruajmë një letër, një raport ose reportazh etj.

Nga format e së shkuarës më shpesh përdoret **e pakryera** dhe **e kryera e thjeshtë**. Përdoren edhe **e kryera** dhe **më se e kryera** e shumë më rrallë edhe **e kryera e tejshkuar**.

Koha e pakryer

Foljet në kohën e pakryer tregojnë një veprim **që ishte në zhvillim e sipër në një çast të caktuar** të së shkuarës. Psh.: Bekimi **punonte** shumë. Edhe e pakryera mund të shoqërohet me pjesëzën **po** dhe tregon një veprim që ishte duke u kryer në një çast të caktuar të së shkuarës. Psh.: Treni **po hynte** në një ndërtesë të madhe.

Koha e kryer e thjeshtë

Foljet në këtë kohë tregojnë **një veprim të përfunduar në një çast të së shkuarës**. Psh.: Më **pa**, siç po më sheh ti. Ai **punoi** tërë jetën për lirinë e atdheut dhe kurrë nuk **u tremb** nga kërcënimet dhe ndjekjet e armiqve.

Folja në të kryerën e thjeshtë zakonisht shoqërohet me **rrethanorë kohe** që shënojnë një kohë të caktuar të së shkuarës dhe që përjashtojnë kështu çastin e ligjërimit: **dje, vjet, atëherë, atë ditë, një ditë, para një jave etj**: Dje u lava në liqen. Para një jave **erdhi** nipi tek unë.

Folja në të kryerën e thjeshtë mund të përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes : Eja, ç'pret?-Ja, **erdha** (=do të vij).

Koha e kryer

Foljet në këtë kohë tregojnë një veprim të përfunduar që nuk i ka ndërprerë lidhjet me çastin e ligjërimit. Psh.: Kur ia kujtuan sjelljen e Gencit, Liridoni tha: - Mos ma përmendni, Genci gaboi rëndë dhe më ka mërzitur shumë.

Folja në të kryerën e thjeshtë **gaboi** tregon se veprimi i Gencit kishte marrë fund në çastin kur flet Liridoni, ndërsa folja në të kryerën (**më**) ka mërzitur tregon se Liridoni ishte ende i mërzitur nga veprimi që kishte kryer Genci.

Folja në kohën e kryer të mënyrës dëftore përdoret edhe me kuptimin e së kryerës së thjeshtë: Naim Frashëri ka lindur (= lindi) më 1846 në Frashër.

Koha më se e kryer

Foljet në këtë kohë tregojnë një veprim të përfunduar para çastit të caktuar të së shkuarës. Psh.: Vetëm të nesërmen Dini mendoi i qetë për ato që i kishin ndodhur.

Dikush kishte kaluar dhe kishte lënë gjurmë mbi dëborë.

Koha e kryer e tejshtuar

Edhe foljet në kohën e kryer të tejshtuar tregojnë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Psh.: Është dragua, - Patën folur disa.

Po e pate bërë edhe këtë të mirë, qofsh i bekuar.

Kjo formë e foljes përdoret rrallë, më shpesh përdoret forma më se e kryer.

Koha e ardhme

Koha e ardhme e foljeve (veprore dhe joveprore) ka dy forma gramatikore: kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme.

Koha e ardhme tregon një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit. Psh.: Unë të premtën do të laj tesha (forma veprore) dhe Unë të premtën do të lahem në banjo me dush (forma joveprore).

Koha e ardhme e përparme

Koha e ardhme e përparme tregon se veprimi i foljes pritet që të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër. Psh.: Kur të vini ju, unë do t'i kem larë teshat. (forma veprore) dhe Kur të vini ju, unë do të jem larë (forma pësore).

MBANI MEND

Me anën e **mënyrës dëftore**, folësi e paraqet veprimin si të vërtetë.

Mënyra dëftore ka tri kohë themelore të foljes: **të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen.**

Koha e tashme tregon një veprim që **kryhet** në çastin e ligjërimit.

Koha e shkuar tregon një veprim që **është kryer** para çastit të ligjërimit.

Kjo kohë ka pesë nëndarje: **kohën e pakryer, kohën e kryer të thjeshtë, kohën e kryer, kohën më se të kryer dhe kohën e kryer të tejshkuar.**

Koha e ardhme tregon një veprim që **pritet të kryhet** pas çastit të ligjërimit.

Koha e ardhme e përparme tregon një veprim që **pritet të kryhet** në të ardhmen para një veprimi tjetër.

Pasqyra e zgjedhimit të foljes laj në mënyrën dëftore

Numri	Veta	Koha e tashme		Koha e kryer e thjeshtë	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	laj	lahem	lava	u lava
	ti	lan	lahesh	lave	u lave
	ai, ajo	lan	lahet	lau	u la
Shumës	ne	lajmë	lahemi	lamë	u lamë
	ju	lani	laheni	latë	u latë
	ata, ato	lajnë	lahen	lanë	u lanë

Numri	Veta	Koha e pakryer		Koha e kryer	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	laja	lahesha	kam larë	jam larë
	ti	laje	laheshe	ke larë	je larë
	ai, ajo	lante	lahej	ka larë	është larë
Shumës	ne	lanim	laheshim	kemi larë	jemi larë
	ju	lanit	laheshit	keni larë	jeni larë
	ata, ato	lanin	laheshin	kanë larë	janë larë

Numri	Veta	Koha më se e kryer		Koha e kryer e tejshkuar	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	kisha larë	isha larë	pata larë	qeshë larë
	ti	kishe larë	ishe larë	pate larë	qe larë
	ai, ajo	kishte larë	ishte larë	pati larë	qe larë
Shumës	ne	kishim larë	ishim larë	patëm larë	qemë larë
	ju	kishit larë	ishit larë	patët larë	qetë larë
	ata, ato	kishin larë	ishin larë	patën larë	qenë larë

Numri	Veta	Koha e ardhme		Koha e ardhme e përparme	
		Forma veprore	Forma joveprore	Forma veprore	Forma joveprore
Njëjës	unë	do të laj	do të lahem	do të kem larë	do të jem larë
	ti	do të lash	do të lahesh	do të kesh larë	do të jesh larë
	ai, ajo	do të lajë	do të lahet	do të ketë larë	do të jetë larë
Shumës	ne	do të lajmë	do të lahemi	do të kemi larë	do të jemi larë
	ju	do të lani	do të laheni	do të keni larë	do të jeni larë
	ata, ato	do të lajnë	do të lahen	do të kenë larë	do të jenë larë

Ushtime

1. Zgjedhoni foljen harroj, dërgoj, sjell në kohën e tashme, në të kryerën e thjeshtë dhe në kohën e ardhme të mënyrës dëftore në të dyja format veprore dhe joveprore.

2. Në cilën formë të së shkuarës janë përdorur foljet me të zeza.

Dielli ende nuk **kishte përfunduar**.

Malet **kishin marrë** një pamje të çuditshme.

Besniku **ngjiti** edhe një bregore tjetër dhe **ia doli të mbërrinte** në majën e malit.

Ai **ka lexuar** shumë libra, prandaj **ka** një fjalor të pasur.

Dy pulëbardha **fluturonin** në qiellin e kaltër.

Shumë vallëtare e këngëtarë të vegjël **u kthyen** nga festivali “Këngë Jeho”.

3. Bëni një hartim të shkurtër rreth një ngjarjeje që ju ka ndodhur këto ditë. Përdorni të kryerën e thjeshtë.

FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

PJESORJA, PËRCJELLORJA DHE PASKAJORJA

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. A ndryshojnë këto fjalë?

Nuk mund të lë **pa treguar** një ngjarje nga jeta ime si inspektor, -tha Genci.

Kur shkonim **për të kontrolluar** nëpër shkolla, zakonisht bënim një plan pune dhe i njoftonim disa ditë përpara drejtoritë e shkollave. Këtë e bënim jo vetëm **për t'i ndihmuar, për të mos i gjetur** të papërgatitur, po edhe për arsye se, në atë kohë, fshati ishte i varfër dhe mësuesit duhej të merrnin masa **për të na pritur**. Ishim dy a tre veta dhe, sigurisht, mikpritësit, duke mos pasur hotel, duhej të mendonin jo vetëm **për të na gostitur** me të ngrënë, por edhe **për të na strehuar** gjëkund në ndonjë shtëpi të rehatshme e më të kamur. Kundër kësaj tradite, një herë, kam vajtur në një fshat të Lezhës **pa bërë** asnjë njoftim përpara.

Më kujtohet se, kur hymë në klasë, mësuesi, ndonëse nuk e dinte që do të shkonim për kontroll, na priti me buzën në gaz dhe e zhvilloi mësimin **pa u shqetësuar** fare.

Fjalët **pa treguar, pa bërë, pa u shqetësuar; për të kontrolluar, për t'(i) ndihmuar, për t'(i) mos i gjetur, për të (na) pritur, për të (na) gostitur** janë forma të pashtjelluara të foljes. Quhen kështu sepse nuk ndryshojnë sipas vetës, numrit dhe kohës, por dalin me forma të **pandryshueshme**, domethënë nuk zgjedhohen dhe me to nuk mund të formohen fjali, nuk mund të shërbejnë si kallëzues – bërthamë e fjalisë, por mund të përdoren në funksion të rrethorëve të ndryshëm.

PJESORJA

Dy shembujt e parë në tekstin e mësipërm janë pjesore.

Pjesore quhet ajo formë e pashtjelluar e foljes që **ka tipare kuptimore e gramatikore edhe foljore edhe mbiemërore**. Kjo formë në gjuhën shqipe është e **ngurosur**. Kthehet në mbiemër me ndihmën e nyjes së përparme si p.sh.: 1. Kur e pashë ashtu, **lagur** e **mbështjellë** me një pallto të vjetër, u trondita shumë. 2. Kur e pashë ashtu, **i lagur** edhe **i mbështjellë** me një pallto të vjetër u trondita shumë. Në fjalinë e parë **lagur** e **mbështjellë** janë **pjesore**, domethënë **forma foljore**, ndërsa në të dytën **i lagur** edhe **i mbështjellë** janë **mbiemra të nyjshëm me prejardhje prejpjesore** që në këtë rast shërbejnë si **përcaktorë**.

Ajo ka një përdorim të kufizuar si gjymtyrë më vete. Më shpesh përdoret për të formuar kohët e përbëra të së shkuarës, si: **kam punuar, kisha punuar, pata punuar** dhe të formave të tjera të pashtjelluara: **pa punuar, duke punuar, për të punuar**.

Si formohet pjesorja?

Pjesorja formohet duke i shtuar temës foljore prapashtesat:

- rë: larë, tharë, prerë etj.;
- r: punuar, shkruar, thyer, pëlqyer etj.;
- ur: hapur, mbyllur, matur etj.;
- ë: dalë, mbjellë, sjellë, marrë, etj.;
- në: vënë, zënë, lënë etj.

PËRCJELLORJA

Folja në këtë formë të pashtjelluar shpreh një veprim që shoqëron veprimin e foljes me të cilin ajo lidhet. Këto dy veprime kryhen në të njëjtën kohë.

Përcjellorja sajohet me ndihmën e pjesëzës **duke** dhe **pjesores të foljes**. Përcjellorja përdoret:

a) **me funksion mënyror**: Njeriu po afrohej **duke ecur** në mënyrë të çuditshme;

b) **me funksion kohor**: **Duke kaluar** pranë stadiumit, m'u kujtua se kishte ndeshje;

c) **me funksion shkakor**: **Duke pasur frikë** se mos e shikonte plaku bëri sikur nuk e vuri re.

PASKAJORJA

Paskajorja shërben për të emërtuar një veprim si **proces**, pa e lidhur me një vetë të caktuar.

Paskajorja sajohet duke i paravënë pjesëzat **për të** para pjesores: **Për të kontrolluar, për të regjistruar** etj. Paskajorja përdoret me **funksion**:

a) **qëllimor**: Po shkoj në gjimnaz **për të regjistruar** djalin në kursin e anglishtes;

b) me funksion përcaktor: Më ndodhi diçka e papritur, diçka **për të qeshur** e për të qarë.

MBANI MEND

Format e pashtjelluara të foljes janë: **pjesorja, përcjellorja dhe paskajorja**.

Pjesorja është një formë e pashtjelluar që ka tipare kuptimore e gramatikore edhe **foljore**, edhe **mbiemërore**.

Forma e pashtjelluar **mohore** shpreh moskryerjen e një veprimi në të shkuarën ose në të ardhmen.

Përcjellorja shpreh një veprim që shoqëron veprimin e foljes me të cilën lidhet.

Paskajorja shërben për të emërtuar një veprim si proces, pa e lidhur me një vetë të caktuar.

Ushtrime

1. Nënvizoni format e pashtjelluara, tregoni llojin dhe funksionin që kryejnë. Duke kaluar rrugës u ndal menjëherë.

Kamioni i ngarkuar rëndë ndaloi para dy udhëtarëve pa i zgjatur dorën njeri. Pa i përveshur mirë krahët s'fitohet gjë.

Buka do pjekur e fjala do matur.

Duke u marrë me stërvitje harroi ta thërriste shokun.

2. Në vënd të foljeve në kllapa vini përcjelloren.

Ai shkante (këndoj).

Mjegulla filloi të ngrihej lart (krijoj) një hapësirë të tejdukshme midis saj dhe fushës.

Në qiell, re të zymta rrinin (varr) (lëviz) fare.

3. Shkruani pjesoren, formën e pashtjelluar mohore, përcjelloren dhe paskajoren e këtyre foljeve: punoj, mbyll, qep, mat, vjel, nxjerr, zë, sipas këtij shembulli: punoj-punuar; pa punuar; duke punuar; për të punuar.

FJALIA E THJESHTË

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm. Gjeni fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra.

Vapë e madhe. Pushimet po mbarojnë. Drita është sa e lumtur, aq edhe e pikëlluar. Ajo bëri shëtitjen e fundit nëpër fshat. Me shumë mbresa e kujtime largohet nga fshati. Kudo mbretëronte qetësi e madhe. Lart në qiell lundronin dytri re si floku i dëborës. Një erë e lehtë i lëvizte ato, ashtu siç e lëvizin anijen valët e detit. U err. Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë. Do bjerë shi.

Ky tekst përbëhet nga fjali të thjeshta dhe të përbëra. Dy fjalitë e para dhe dy të fundit janë fjali të thjeshta, por me strukturë (ndërtim) të ndryshme.

Fjalja e parë **Vapë e madhe** ka vetëm një gjymtyrë kryesore që shprehet me një grup emëror (togëfjalësh emëror).

Fjalja **U err**, po ashtu shprehet vetëm me një gjymtyrë kryesore, me foljenkallëzuesin.

Ndërkaq fjalja **Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë** përbëhet nga kryefjala + kallëzuesi + rrethanori. Fjalja **Një erë e lehtë i lëvizte ato, ashtu siç e lëviznin anijen valët e detit** është fjali e përbërë dhe përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa I

Pjesa II

Sipas ndërtimit fjalitë ndahen në të thjeshta dhe në fjali të përbëra.

Tipi më i zakonshëm i fjalisë së thjeshtë është fjalja dykryegjymtyrëshe, e cila përbëhet nga kryefjala dhe kallëzuesi. P.sh.: *Pushimet po mbarojnë.* (**Pushimet** –kryefjalë, **po mbarojnë** –kallëzues), që janë gjymtyrë kryesore-bërthama të fjalisë.

Fjalja e thjeshtë mund të zgjerohet edhe me gjymtyrë të dyta. P.sh.: *Një mjegull e bardhë lundron mbi luginë*. Në këtë fjali kemi kryefjalën (Një mjegull) + përcaktorin (e bardhë) + kallëzuesin (lundron) + rrethanorin (mbi luginë).

Pra kjo fjali përbëhet nga dy grupe fjalësh, nga grupi emëror (GE) dhe nga grupi foljor (GF).

Skematikisht struktura e fjalisë së thjeshtë mund të paraqitet kështu:



Në gjuhën shqipe ka edhe një tip fjalie ku **mungon** një nga gjymtyrët kryesore.

Këto quhen fjali njëkryegjymtyrëshe. Këto mund të jenë:

Fjali foljore: U err. S'gjen dot vajzë më të mirë se Blerina.

Fjali emërore: Vapë e madhe. Natë. Errësiirë.

MBANI MEND

Grupi emëror i kryefjalës përbëhet nga një emër dhe përcaktuesit e tij, ku emri është bërthamë e grupit.

Grupi foljor përbëhet nga një folje (kallëzues) që është bërthamë e këtij grupi dhe nga gjymtyrët që e plotësojnë atë (kundrinori, rrethanori, etj.)

FUNKSIONET GRAMATIKORE

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Ndani fjalët nëpër klasa dhe tregoni ç'funksion kryejnë në fjali.

Bardhyli dhe Luljeta i kaluan pushimet në fshatin e gjyshes. Koha ishte shumë e freskët. Bardhyli i çonte bukë gjyshit në arë. Ngadonjëherë ndalej pranë një lumi dhe me kënaqësi e shikonte ajrin e kthjellët.

Në tekst dallojmë:

Emra: **Bardhyli, Luljeta, pushimet, fshatin, gjyshes, koha, bukë, gjyshit, arë, lumi, kënaqësi, ujin.**

Mbiemra: **e freskët, e kthjellët.**

Folje: **kaluan, ishte, çonte, ndalej, shikonte.**

Ndajfolje: **shumë, ngadonjëherë.**

Parafjalë: **në, pranë, me.**

Lidhëza: **dhe.**

Këto fjalë u përkasin klasave të ndryshme, por duke u lidhur gramatikisht hyjnë në marrëdhënie me njëra-tjetrën dhe kështu kryejnë funksione të ndryshme sintaksore në një grup emëror a foljor. P.sh.:

funksionin e kryefjalës: **Bardhyli dhe Luljeta, koha;**

funksionin e kallëzuesit: **kaluan, ishte (e freskët), çonte, ndalej, shikonte;**

funksionin e përcaktorit: **e kthjellët;**

funksionin e kundrinorit: **pushimet, gjyshit, ujin dhe**

funksionin e rrethanorit: **në fshatin (e gjyshes), në arë, ngadonjëherë, pranë një lumi, me kënaqësi.**

FUNKSIONET E FJALËVE DHE TË GRUPEVE TË FJALËVE BRENDAPËRBRENDIA GRUPIT EMËROR

1. Funkzioni bërthamë e grupit emëror

Në këtë funksion na del emri nga i cili varen të gjithë përbërësit e grupit emëror, ku emri është **fjalë kryesore**. P.sh.: Një erë e lehtë pranverore na i freskoi fytyrat.

Emri **një erë** është bërthamë e grupit, është kryefjalë në fjali.

Në funksion të kryefjalës mund të jetë:

Një emër: **Flamuri** këndon. **Nxënësit** mësojnë.

Një grup emëror: **Plaku zemërbardhë** i donte fëmijët. **Peshku i madh** e ha të voglin.

Një përemrë vector: **Ti** e di mirë këtë gjë. **Ju** e dini mirë këtë gjë.

Një përemër i pacaktuar: **Asnjë** nuk e foli të vërtetën.

Një emër a përemër që e pëson veprimin e kryer nga dikush tjetër: **Vajza** u qortua nga e ëma.

2. Funkzioni bërthamë e fjalisë

Bërthamën e fjalisë e formon **folja**, e cila në të vërtetë e kryen **funksionin e kallëzuesit**. Kjo bërthamë plotësohet nga shumë gjymtyrë të tjera si: nga kundrinorët e ndryshëm, rrethanorët etj. P.sh.: Era e malit e **shpërndante** këngën gjithandej.

3. Funkzioni i kallëzuesorit (të kryefjalës ose të kundrinorit të drejtë).

Kallëzuesori (përcaktori kallëzuesor i kryefjalës) mund të jetë: një mbiemër, një emër, ose një grup emëror që lidhet me kryefjalën me anë të foljeve: **jam, dukem, bëhem, emërohem** etj., ose me kundrinorin e drejtë me foljen **kam (për, si) emëroj, quaj** etj.

P.sh.: Vajza jonë është e **bukur**. Ariani u bë **shofer**. Genti u emërua **mësues**. Benin e emëruan **mësues**. Shpendin e emëruan **drejtor**.

Kallëzuesori ka lidhje të dyfishtë në fjali: Me **foljen – kallëzues** dhe me **kryefjalën** (kur është kallëzuesor i kryefjalës) si, p.sh.: Beni u emërua mësues. Fjala **mësues** është kallëzuesor i kryefjalës Beni, ose me foljen dhe kundrinorin e drejtë dhe është kallëzuesor i kundrinorit të drejtë. P.sh.: Benin e emëruan mësues. Puna e bëri njeriun njeri.

4. Funkzioni përcaktor

Në grupet emërore përveç emrit a grupit emëror bërthamë kemi edhe përbërës të tjerë që shërbejnë për të përcaktuar bërthamën apo ndonjë përbërës tjetër të grupit.

Një funksion të tillë luajnë në një grup emëror **përemrat, mbiemrat dhe emrat me parafjalë ose në rasën gjinore**. Këta shërbejnë për të përcaktuar më mirë në fjali emrin bërthamë, për t'i dhënë një kuptim sa më të qartë, p.sh. në fjalinë **Rezari i vogël reciton bukur** emri **Rezari** luan funksionin e bërthamës së grupit emëror, kurse mbiemri i **vogël** atë të përcaktorit të këtij emri. Po kështu edhe përemrat dalin në funksion të përcaktorit: **Ky** nxënës mëson shumë. Klasa **jonë** doli e para në garat sportive.

5. Funkzioni ndajshtim

Në funksion të ndajshtimit si një lloj përcaktori na paraqitet një emër ose një grup emëror që i ndajshtohet një emri tjetër për ta konkretizuar a sqaruar më mirë grupin emëror, të cilit i ndajshtohet emri që luan funksionin e ndajshtimit, e emërton për herë të dytë. P.sh.: **Nënë** Tereza njihet në tërë botën. Migjeni, **poeti** i mjerimit, vdiq i ri.

Nga shembujt e mësipërm shihet se ndajshtimi (Nënë dhe poeti i mjerimit) e emërton për herë të dytë emrin e parë në një formë tjetër.

6. Funkzioni i kundrinorit

Funksionin e kundrinorit e kryen një emër, një grup emëror, një përemër, a një fjalë e emëruar, mbi të cilin bie drejtpërdrejt ose tërthorazi veprimi i shprehur nga folja – kallëzues. P.sh.: Ta doni dhe ta çmoni **punën**. Ju bëni **tuajën** dhe unë **timen**. Duhet t’u ndihmojmë shokëve **tanë**. **Më** të mirëve të klasës sonë u ndanë **shpërblime** dhe **fletëlavdërime**.

7. Funkzioni i rrethanorit

Funksionin e rrethanorit e kryen një ndajfolje, një emër a një grup emëror që tregon një rrethanë në të cilën kryhet veprimi i shprehur nga folja. P.sh.: U ngritëm **herët në mëngjes** dhe **menjëherë** u nisëm **për në Ohër**. **Atje** na prisnin shokët tanë të shkollës sonë.

MBANI MEND

-Fjalët në grupet emërore a foljore dhe në fjali lidhen gramatikisht midis tyre dhe kryejnë funksione të ndryshme.

- Në një fjali mund ta kryejnë funksionin e kryefjalës, të bërthamës së fjalisë (të kallëzuesit), të kallëzuesorit, të kundrinorit e të rrethanorit.

- Në grupin emëror mund ta kryejnë funksionin e fjalës bërthamë të grupit, të përcaktorit, të ndajshtimit.

Ushtrime

1. Dalloni me ngjyrë të kuqe grupin emëror dhe me të kaltër grupin foljor në këto fjali:

Shumë valltarë e këngëtarë të vegjël do të shkojnë në festival.

Dy pulëbardha fluturonin në qiellin e kaltër.

Një dallëndyshe ndërton çerdhen e vet.

Puplat e korbit shkëlqejnë shumë.

Fshatari i lodhur iu afrua fshatit.

2. Dalloni kallëzuesorin e kryefjalës dhe të kundrinorit dhe thoni me se janë shprehur.

Këmbët i kishte të rënda nga balta që i qe ngjeshur nën këpucë. Dy zogj fluturuan të trembur. Zërin e kishte të akullt dhe mjekrën të shtrënguar. Kryetari e shpalli festivalin të hapur. Qielli duket i kaltër. Iliri u zgjodh kryetar i klasës. Shtëpinë e Agimit e gjetën të mbyllur.

3. Shkruani si duhet mbiemrat në kllapa:

Ujëra (i zi), kanale (ujitës), arte (i bukur), shira (i rrëmbyer), fshatra (malor), male (i lartë).

4. Kopjoni fjalitë dhe nënvizoni fjalët në funksion të kundrinorit.

Ju i bëni detyrat e shtëpisë në kohë.

Ai zgjedh një palë rroba të mira.

Vullneti e thyen gurin dhe hekurin.

5. Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe dalloni rrethanorët.

Ajo shkon në shkollë bashkë me shoqet.

Ata zgjidhën një detyrë shumë të rëndë.

Takohemi shpesh dhe shëtisim bashkë.

Ai e kishte shtëpinë në fund të fshatit.

RRETHANORËT DHE LLOJET E TYRE

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Ç'funktion kryejnë ato në fjali?

Në pranverë fusha e gjerë ishte veshur me ngjyra dhe me blerim të freskët.

Pikat e shiut rrokulliseshin në faqet e pjerrëta të çatisë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë e pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e kaltër. Porsa pushoi shiu, bujqit shkuan në fushë. Ata ia filluan punës menjëherë.

Fjalët e shkruara me të zeza tregojnë rrethanat në të cilat kryhet një veprim, prandaj quhen rrethanorë.

Shprehja e rrethanave në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet rrethanorëve:

me anë të ndajfoljeve të ndryshme,

me emra me ose pa parafjalë dhe

me forma të pashtjelluara të foljes (me paskajore, përcjellore dhe pjesore), ndërsa në fjalinë e përbërë: me pjesët e nënrenditura rrethanore.

Sipas rrethanës që tregojnë rrethanorët marrin edhe emra:

rrethanor vendi: Bujqit shkuan në fushë.

rrethanor kohe: Kam lindur në muajin prill.

rrethanor mënyre: Fliste bukur.

rrethanor shkaku: Fytyra iu çel nga gëzimi.

rrethanor qëllimi: Kemi ardhur në shkollë për mësim.

rrethanor sasi: Flisnin shumë.

RRETHANORI I KOHËS

Shprehja e rrethanës së kohës në fjalinë e thjeshtë

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'shpreshin ato?

Aliu punon **prej mëngjesi** e gjer në **mbrëmje**.

Dje ra shumë shi.

Lojërat olimpike do të mbahen **pas dy javë** .

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë rrethanorë kohe.

Rrethanori i kohës tregon **kohën a çastin** kur kryhet një veprim a një gjendje dhe gjendet me pyetjen **kur**. Psh.: Kur ra shi? – **Dje**. Kur do të mbahet lojërat olimpike?- **Pas dy javë**.

Rrethanori i kohës shprehet me :

Ndajfolje kohe ose me shprehje ndajfoljore: **sot, nesër, dje, shpejt, vonë, sivjet; ditë e natë, ditë për ditë, dy ditë më parë, që sot e kësaj dite etj.** Psh.: Ai punonte **ditë e natë**, po s'tregoi gjë.

Me formë të pashtjelluar foljore, mohore dhe përcjellore. Psh.: Shkoi në mal **pa gdhirë**.

Në fjalinë e përbërë me një pjesë të nënrenditur rethanore: **Kur erdhe ti tek unë**, unë kisha dalë nga shtëpia.

Rrethanori i kohës shpreh **kohëzgjatjen** (vazhdimin e veprimit) dhe shprehet me një grup emëror me parafjalë. Psh.: Bisedova me Astritin **gjatë gjithë mbrëmjes**. Gjendet me pyetjen **sa**. Kjo shitore rri hapur vazhdimisht.

Ky rrethanor shpreh edhe **kufijtë kohorë** të një veprimi dhe gjendet me pyetjen: **Që kur?**; **Deri kur?**. Psh.: **Që ditën e shtunë s'ka pushuar shiu**. **Që kur?**.

Mësimi do të vazhdojë edhe një javë. **Deri kur?**.

Tregon edhe kohën e **mbarimit të veprimit**: **Shkolla e re u ndërtua më 2007**.

RRETHANORI I VENDIT

Shprehja e rrethanës së vendit në fjalinë e thjeshtë

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Me ç'pyetje mund t'i gjejme ato.

...**Në oborrin** e shtëpisë së vjetër, **pranë dritares**, gjelbëronin e fëshfërinin degët e gjethet me erë të një lisi të madh shekullor...

Rrotull tij ishin mbledhur shumë njerëz.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë rrethanorë vendi dhe gjenden me pyetjen **Ku?**, **Në ç'vend?**. Rrethanori i vendit tregon vendin ku ndodh një veprim ose vendin ku ndodhet një send a një njeri.

Rrethanori i vendit shprehet me:

Ndajfolje ose shprehje ndajfoljore vendi: **këtu, atje, poshtë lart, diku, kudo**

etj. Psh.: Shëtita **lart e poshtë**, po s'të gjeta. **Kudo** shikoja gjelbërim. (Ku?)

Me ndihmën e një grupi emëror me parafjalë: **Nëpër rrugët e qytetit** përcëllonte asfalti i nxehur prej rrezeve të diellit.

Rrethanori i vendit mund të shprehë pozicionin, vendin ku ndodh një veprim.

Psh.: Ai u ngjit **lart**.

Mund të shprehë lëvizjen, vendosjen, drejtimin (**për ku, drejt cilit vend**).

Psh.: U nisën **për në Ohër**. Mund të tregojë edhe pikënisjen e veprimit: **që nga, nga ku, për nga**. Psh.: Ky aeroplan u nis **nga Çikagoja**. (Nga ku?)

Rrethanori i vendit në fjalinë e përbërë me nënrenditje shprehet me pjesë të nënrenditur vendore. **Ku dhemb** dhëmbi, vete gjuha.

MBANI MEND

- Rrethanori i kohës mund të tregojë:

Kohën kur zhvillohet veprimi dhe gjendet me pyetjen **Kur?**.

- Vazhdimin e veprimit (**Për sa kohë?**).

- Kufijtë kohorë të kryerjes së veprimit (**Që kur?**, **Deri kur?**).

- Rrethanori i vendit tregon vendin ku kryhet veprimi (**Ku?**; **Në ç'vend?**).

Zhvendosjen, lëvizjen (**Që nga?**; **Për ku?**).

Ushtrime

1. Gjeni rrethanorët dhe tregoni llojin e tyre.

Prej Qarishtes, te stanet, kur shkon drejt jugës, për Rajcë, e përpjeta mban më shumë se tri orë. Dy shokët i ishin qepur asaj të përpjete. Ktheheshin prej Labinoti e shkonin në Qukës e Bërzesh të.

2. Në vend të pyetjeve në kllapa vini rrethanorin e vendit ose të kohës. Thoni me se shprehet secili.

1. (ku?) Këtu qenka shumë bukur.


2. Sa mirë është (ku?)!

3. (nga?) Vinte një erë e këndshme trëndeline.

4. Ra shumë shi.(kur?)

5. Mësimi do të vazhdojë(deri kur?).

3. Tregoni ç'kanë të përbashkët dhe të veçantë rrethanorët e kohës dhe të vendit duke dhënë shembuj për të argumentuar mendimin tuaj, sipas kësaj skeme:



RRETHANORI I SHKAKUT

Lexoni fjalitë e mëposhtme, vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zëza. Ç'shërbim bëjnë ato? Me ç'pyetje mund t'i gjejmë?

Pemët u thanë **nga ngrica**.

U lodha së **punuari**.

Për **shkakun tënd** u vonova në mësim.

Fjalët e theksuara janë rrethanorë shkaku dhe gjenden me pyetjet: **Pse?**, **Për ç'shkak?**, **Për ç'arsye?**.

Rrethanor shkaku quhet gjymtyra e dytë e fjalisë që tregon shkaku ose arsyen e kryerjes së një veprimi a të ndryshimit të një gjendjeje. Në këto fjali vihet në dukje **vepruesi dhe shkaku**.

Shkaku është dukuria që bën të lindë një veprim a një dukuri tjetër, ndërsa vepruesi është ai që kryen veprimin (kryefjala në fjalitë veprore), ndërsa në fjalitë pësore është kundrinori i zhdrejtë. P.sh.: Ngrica i thau pemët. Vepruesi është **ngrica** (kryefjala). Po ta kthejmë këtë fjali veprore në fjali pësore, atëherë kryefjala **ngrica** kthehet në një rrethanor shkaku **nga ngrica**. P.sh. Pemët u thanë **nga ngrica**.

Shkaku tregon arsyen e lindjes a të zhvillimit të një veprimi atë ndodhjes së një ngjarjeje dhe u përgjigjet pyetjeve: **Pse?**, **Për ç'arsye?**, **Për çfarë shkaku?**.

Shprehja e rrethanës së shkakat në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet të rrethanorit të shkakat i cili mund të jetë:

- një ndajfolje pyetëse **pse?**: **Pse** u vonove mbrëmë?.

- një emër ose një grup emëror me parafjalë. P.sh.: **Nga gëzimi** më kishte ikur gjumi.

- me një përemër: **Prej teje** e pësova edhe unë.

- me formë të pashtjelluar të foljes: **Duke u ftohur** shpesh u sëmur rëndë.

Shprehja e rrethanës së shkakat në fjalinë e përbërë shkakore bëhet me pjesën e nënrenditur shkakore: **Duart na kishin ngrirë, ngaqë ishte shumë ftohtë**.

RRETHANORI I QËLLIMIT

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funktion kryejnë dhe me cilat pyetje mund t'i gjejmë ato?

Agimi mbledh të holla **për ekskursion**.

Puno për të mirën e popullit.

Nëna punonte për djalin e vogël.

Fjalët e mësipërme tregojnë qëllimin e kryerjes së një veprimi dhe janë rrethanorë qëllimi.

Rrethanor qëllimi quhet gjymtyra që tregon qëllimin e kryerjes së një veprimi. U përgjigjet pyetjeve: **Përse?**, **Me ç'qëllim**, **Për çfarë qëllimi?**.

Rrethanori i qëllimit shprehet:

- me një ndajfolje pyetëse **përse**: **Përse** ke ardhur këtu?.

- me një emër ose me një grup emëror me ose pa parafjalë: Ne kemi ardhur këtu **për mësim**.

- me formë të pashtjelluar të paskajores: Ai shkoi në Amerikë **për t'u specializuar në fushën e kompjuterave**.

Në fjalinë e përbërë rrethana e qëllimit shprehet me një pjesë të nënrenditur që fillon me një lidhëz qëllimore që, me qëllim që: Puno që të mos mërdhish.

Kujdes!

Mos e ngatërroni rrethanorin e qëllimit me atë të shkakut kur shprehet me ndajfoljen **përse**, sepse rrethanori i qëllimit tregon se veprimi kryhet me një qëllim të caktuar, ndërsa i shkakut një fakt real të pasynuar.

Ushtrime

1. Analizoni fjalitë e mëposhtme. Gjeni rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit dhe thoni me se janë shprehur.

Ermira bëri disa gabime nga nxitimi.

Afërdita ngriti kokën për të parë dasmorët.

Mali oshëtinte nga gjëmimi i bubullimave.

Nxënësve u shkëlqente fytyra nga lumturia.

Ata erdhën në Shkup për t'u regjistruar në një shkollë të mesme.

Shpesh na vijnë shokët e shkollës për vizitë.

RRETHANORI I MËNYRËS

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'pjesë të ligjëratës janë ato dhe cilën nga gjymtyrët kryesore plotësojnë ato?

Drita e recitoi vjershën për bukuri.

Shiu binte **pa pushim**.

Nxënësit ishin rreshtuar **dy nga dy**.

Im vëlla shkruan **mirë**.

Ajo fliste **me buzëqeshje** për gjëra serioze.

Fjalët e mësipërme tregojnë se në ç'mënyrë kryhet veprimi i shprehur prej kallëzuesit dhe janë rethanorë mënyre.

Rrethanori i mënyrës u përgjigjet pyetjeve : **Si?, Qysh?, Në ç'mënyrë?**

Shprehja e rethanës së mënyrës në fjalinë e thjeshtë bëhet nëpërmjet rethanorit të mënyrës, i cili mund të jetë:

- një ndajfolje mënyre ose shprehje ndajfoljore: **mirë, keq, ashtu, kështu, burrërisht; me të mirë, me të keq, me mish e me shpirt, shpejt e shpejt etj.**
Ai që punon **mirë** nuk i trembet punës.

- një emër ose grup emëror me parafjalë: **Me, më, pa, sipas etj.** Psh: Qeshi **me lot**.

Nxënësit e dëgjonin mësuesin **me gojëhapur**.

- një formë foljore e pashtjelluar, zakonisht përcjellore, por edhe mohore:
Ai shkante **duke kënduar**.

Në fjalinë e përbërë shprehet me një pjesë të nënrenditur mënyrore që lidhet me lidhëzat **si, siç, ashtu si etj.** Psh.: Zemëra i rrihte **sikur kërkonte të dilte nga gjoksi**.

RRETHANORI I SASISË

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'gjymtyrë të fjalisë plotësojnë ato?.

Më tepër mendo e **më pak** bisedo.

Sa do të punosh, **aq** do të kesh.

Miqtë ishin të kënaqur **shumë** nga bukuria e detit Adriatik.

Erdha **dy herë**, po s'të gjeta.

Agimi banon **250 metra** larg shkollës.

Ky libër kushton **200 denarë**.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë rethanorë sasië.

Rrethanori i sasisë është gjymtyrë që tregon masën e veprimit, të gjendjes, të kohës e të hapësirës. I përgjigjet pyetjes **Sa?**

Sasia mund të shprehet:

me një ndajfolje a shprehje ndajfoljore sasië: **Shumë, pak, tepër; dy herë, tri herë** etj. Mbrëmë Albana e vogël hëngri pak, përkundrazi Astriti hëngri sa për katër.

me një **grup emëror** të formuar nga një emër me ose pa parafjalë që tregon një njësi matjeje, si: **metër, kilogram, litër, orë** etj. P.sh.: Bleva 2 kg rrush.

Në fjalinë e përbërë rrethana e sasië shprehet nëpërmjet një pjese të nënrenditur: **Sa më shumë** ngjiteshin, aq më shumë i afroheshim majës së malit.

MBANI MEND

1. Rrethanori i mënyrës tregon mënyrën e kryerjes së veprimit dhe shprehet me :

- ndajfolje ose shprehje ndajfoljore,
- grup emëror me parafjalë,
- formë të pashtjelluar foljore: përcjellore, mohore.

2. Rrethanori i sasië tregon sasi dhe shprehet me:

- ndajfolje a shprehje ndajfoljore,
- grupe emërore që tregojnë njësi matjeje dhe paraprihen nga një numëror.

Ushtrime

1. Thoni ç'funktion kryejnë fjalët me shkronja të zeza:

Besniku ecte me hapa **të shpejtë**.

Sot ishte lodhur **shumë**.

Qëndroi **disa minuta**.

Kështu bënin ata pas përfundimit të ndeshjeve.

Fjala vret **pa bërë** plagë.

2. Në vend të pyetjeve vini një nga rrethanorët në kllapa dhe thoni ç'lloj është:

Arbëri e përqafoi nënën (si?).

Motrës sime i pëlqejnë lulet (sa?).

Këtë verë notova (si?, sa?).

Më mirë të vdesësh se të rrosh i gjunjësuar (si).

3. Bëni një hartim të shkurtër me temë: "Natyra ose arsimitarët e mi", duke përdorur lloje të ndryshme rrethanorësh.

4. Shkruani vetë nga një fjali me rrethanorë kohe, vendi, shkaku, mënyre dhe sasië.

LLOJET (TIPAT) E FJALIVE

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Vëreni fjalitë dhe shenjat e pikësimit që janë përdorur në fund të tyre. A dallohen ato njëra prej tjetrës?

Petrit, shiko këto dhen dhe këta qengja!
Sa mirë që kullosin!
Të kujt janë këto dhen?
Ata janë të fshatarëve.
Sa shumë qengja paska!
Ah, sikur të kisha një qengj larosh, sikur ai atje!
Shpejto Ilir! Lëri qengjat!
Do të vonohemi për në mësim.

Fjalitë që janë dhënë në këtë tekst ndryshojnë njëra prej tjetrës për nga kuptimi, për nga mënyra e të shqiptuarit të tyre dhe për nga shenjat e pikësimit.

Për nga kuptimi ato shprehin një urdhër, një nxitje, një fakt (ndodhi) një dëshirë, një habi ose një pyetje.

MBANI MEND

Fjalitë sipas kuptimit mund të jenë:
dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore.

FORMAT E FJALIVE

Lexoni me kujdes këtë dialog dhe vëreni fjalët e shënuara me shkronja të zeza dhe thoni ç'kuptoni me to.

Në dhomën e vogël dëgjohet vetëm tiktaku i orës.

Në tavolinën e gjerë dy nxënëse po shkruajnë.

A nuk e zgjidhe ende detyrën?
Jo, nuk e kam zgjidhur- u përgjigj Besa.
Po ti, a e zgjidhe?
Po, unë e zgjidha detyrën – u përgjigj Lindita.
Të dyja vazhdojnë të punojnë . Detyrat e sotme s’qenkan aq të vështira.

Çdo mendim i shfaqur me anë të një fjalie mund të pohoet ose të mohoet si,
p.sh. : **Po**, unë e zgjidha detyrën dhe **Jo**, unë nuk e kam zgjidhur detyrën.

MBANI MEND

Të gjitha llojet e fjalive sipas kuptimit për nga forma mund të jenë **fjali pohore** dhe **fjali mohore**.

FJALIA DËFTORE, POHORE DHE MOHORE

Fjalja dëftore pohore shërben për të treguar diçka për të dhënë a për të marrë një informacion për diçka. Këto lloje fjalish kanë një kuptim të gjerë.

Drita e zgjidhi me kohë detyrën e shtëpisë.

Rendi më i shpeshtë i fjalëve a i grupeve gramatikore është **kryefjalë + folje – kallëzues + kundrinor + rrethator**.

Ardi lexon një roman.

Por në gjuhën shqipe rendi i fjalëve në fjali mund të ndryshojë. Shpesh në krye të fjalisë mund të përdoret edhe një rrethator:

Atje lart mbi një kodrinë shihet një fshat i vogël.

Folja-kallëzuesi përshtatet në **numër** dhe në **vetë** me kryefjalën e saj. P.sh.:

Nxënësi i mirë i kryen detyrat me kohë.

Nxënësit e mirë i kryejnë detyrat me kohë.

Fjalja dëftore mohore tregon se një veprim, një gjendje a një ngjarje që nuk ka ndodhur, nuk po ndodh ose nuk do të ndodhë. Pra këto fjali shprehin një **mohim**. Në këto fjali para kallëzuesit përdoren pjesëzat mohuese **nuk, s’, pa, mos, as** dhe atëherë kemi mohim të thjeshtë. P.sh.:

Besa **nuk** e zgjidhi detyrën.

Lindita e zgjidhi problemin **pa** vështirësi.

Por, kur fjalia dëftore mohore ka, përveç pjesëzave mohuese **nuk, s, as** edhe mjete të tjera mohuese **nuk..fare, pa..as**, mohimi është i përbërë. P.sh.:

Besa **nuk** e zgjidhi **fare** detyrën.

Shoferi frenoi **pa as** më të voglën vështirësi.

FJALIA DËSHIRORE POHORE DHE MOHORE

Fjalja dëshirore pohore shërben për të shprehur dëshirën që të ndodhë diçka. P.sh.:

– Ah sikur të kem një kompjuter!

- Ju këndoftë zemra, o bijtë e mi! – uroi xha Miti nga fundi i zemrës.

- Qofshi gjithmonë të gëzuar, o djemtë e mi.

Foljet e fjalive dëshirore përdoren zakonisht në mënyrën dëshirore (**këndoftë, qofshi**), por edhe në mënyrën lidhore (**të kem**).

Fjalja dëshirore mohore shërben për të shprehur dëshirën që të mos ndodhë diçka. P.sh:

– Ah, sikur të mos vinte në dasmë!

- Mos e dhëntë zoti!

Mos ardh të kurrë!

MBANI MEND

Pjesëza **mos** vihet para foljes në mënyrën dëshirore (**Mos** shkofsh i gjallë!) dhe pas fjalëzës (pjesëzës) **të** të foljes në mënyrën lidhore (**Të mos** shkosh).

Në fund të fjalive dëshirore pohore dhe mohore vihet pikquditje (!).

FJALIA NXITËSE POHORE DHE MOHORE

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni se ç'shpreshin ato. Në ç'mënyrë e kanë foljen kallëzues.

Më ndihmo pak, të lutem.

Ejani nesër për drekë te ne, - e ftoi motra.
Dil përjashta! – i bërtiti mësuesi.
Të nisemi menjëherë.

Këto janë fjali nxitëse pohore.

Fjali nxitëse pohore janë ato fjali që shërbejnë **për të nxitur dikë** që të zbatojë një urdhër, një këshillë, një kërkesë a një lutje.

Foljen - kallëzuesin e kanë zakonisht në **mënyrën urdhërore**, por edhe në mënyrën lidhore.

Fjalitë nxitëse mohore shërbejnë për të nxitur dikë që të mos kryejë një veprim të caktuar. Para foljes-kallëzues gjithmonë përdoret pjesëza mos. P.sh.:

- **Mos** u vono, se nisemi.
- **Mos** bëj zhurmë, se fle gjyshi.
- **Mos** shko atje.
- **Të mos** shkosh atje.

Edhe fjalitë nxitëse mohore, si ato pohoret foljet i kanë në mënyrën urdhërore e më rallë edhe në mënyrën lidhore.

FJALITË PYETËSE POHORE DHE MOHORE

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni përse shërbejnë ato.

- A i doni përrallat?
- A nuk e zgjidhe ende detyrën?
- A vilet rrushi në vjeshtë?
- Mos do të vish tek unë nesër?

Fjalitë e mësipërme janë fjali pyetëse.

Fjali pyetëse janë ato që shërbejnë **për të pyetur** për diçka që nuk e dimë. Edhe këto mund të jenë **pohore** dhe **mohore**, të **pjeshme** dhe **tërësore**.

Fjalja pyetëse **tërësore** shërben për të pyetur për diçka që **nuk e dimë në mënyrë të plotë** ose për t'u siguruar për vërtetësinë e një fakti që nuk e njohim. Kësaj fjalie mund t'i përgjigjemi me **po** ose **jo** ose me ndonjë fjalë tjetër e barasvlershme me to, si **sigurisht**, **pa dyshim**, **aspak**, **në asnjë mënyrë** etj.

Përgjigjuni fjalive të mësipërme me **po** ose **jo**.

Fjalja pyetëse e pjeshme shërben për të bërë një pyetje që nuk lidhet me

veprimin e foljes, por me kryefjalën, kallëzuesin, kundrinorin apo me një rrethanor.
Psh.:

Kush reciton bukur? (-Besimi)

Si është koha sot? (-e mirë)

Kur do të shkoni në teatër? (- të dielën)

Ç'shkruan Fisniku? (-një letër)

Në fund të fjalisë pyetëse vihet pikëpyetje.

MBANI MEND

Fjalja është një bashkim fjalësh a një fjalë e vetme që shpreh një kumtim dhe mbaron me një pushim të gjatë.

Fjalitë sipas llojit të kumtimit mund të jenë: dëftore, dëshirore, nxitëse dhe pyetëse.

Të gjitha këto mund të jenë pohore dhe mohore, ndërsa fjalitë pyetëse mund të jenë tërësore ose të pjesshme.

Në fund të fjalive dëftore dhe nxitëse vihet pikë(.).

Në fund të fjalive dëshirore dhe të fjalive nxitëse që shprehin një urdhër të prerë vihet pikëçuditje (!).

Në fund të fjalive pyetëse vihet pikëpyetje (?).

Kur theksojmë ndonjë ndjenjë të fuqishme emocionale në fund të të gjitha këtyre fjalive vëmë pikëpyetje dhe pikëçuditje: - Vërtet ti je përgjigjur ashtu ?! S'je kënaqur me notën?!

Ushtrime

1.Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe thoni cilat janë të thjeshta e cilat janë të përbëra.

Nxënësit shkojnë në bibliotekë. Atje lexojnë libra të ndryshme. Dje ishte shumë nxehtë. Megjithëse mesdita kishte kaluar , vapa ishte e padurueshme.

2.Në shembujt e mëposhtëm dalloni fjalitë dëftore, nxitëse, dëshirore dhe pyetëse.

Ruajeni pasurinë e shkollës!

Mos e shkelni barin e parkut!

Punën e sotme mos e lër për nesër.

I kujt je ti, mor bir?

Qofsh i nderuar gjithmonë!

FJALIA E PËRBËRË

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni nga sa folje kanë ato. Vëreni fjalitë nën a) dhe nën b).

a) Po, e **dua** detin.

Deti është si një **nënë** zemërgjerë.

Mallkimi i nënës **të zë**.

b) Mua deti kurrë s'më **ka mallkuar**, se unë nuk **jam zemëruar** me të...

Mora një levrek të madh nga ata që **kisha nxjerrë**, i **çava** barkun dhe i **futa** brenda një dinamit të tërë.

Tri fjalitë e mësipërme, nën a) janë fjali të thjeshta, sepse kanë vetëm nga një folje (kallëzues) në një nga mënyrat vetore, e cila shërben si bërthamë e fjalisë, por që të trija kumtojnë një përmbajtje të plotë e të pavarur me intonacion të përfunduar. Ndërkaq, fjalitë nën b) janë të përbëra, sepse secila fjali ka më shumë se një folje në një nga mënyrat vetore.

Fjalìa e thjeshtë apo pjesë e fjalisë së përbërë quhet ajo që ka vetëm një folje në një nga gjashtë mënyrat vetore: dëftore, lidhore, dëshirore, kushtore, habitore dhe urdhërore, ndërkaq format e pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores e mohores nuk mund të jenë bërthama fjalie dhe si të tilla nuk formojnë as fjali, as pjesë të fjalisë së përbërë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.

MBANI MEND

Fjalìa e thjeshtë është ajo pjesë e fjalisë që ka vetëm **një folje** në një nga 6 mënyrat vetore: **mënyra dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore, habitore dhe urdhërore**. Ndërkaq format e **pashtjelluara të pjesores, paskajores, përcjellores e mohores nuk mund të jenë bërthama fjalie** dhe si të tilla nuk formojnë as fjali, as pjesë të fjalisë, por mund të shërbejnë vetëm si gjymtyrë fjalie.

Fjalìa e përbërë quhet ajo fjali e cila përbëhet të paktën nga dy ose më shumë pjesë fjalish (ka dy e më shumë folje) në një nga mënyrat vetore.

Fjalitë e përbëra janë dy llojesh: a) fjali të përbëra me bashkërenditje dhe b) fjali të përbëra me nënrenditje.

FJALIA E PËRBËRË ME BASHKËRENDITJE DHE FJALIA E PËRBËRË ME NËNRENDITJE

T'i analizojmë fjalitë e përbëra.

1. **Mora** frymë thellë **dhe** me shpejtësinë dhe forcën e predhës **u krodha** në thellësi.

2. Mua deti kurrë s'më **ka mallkuar**, **se** unë nuk **jam zemëruar** me të...

Që të dyja fjalitë janë fjali të përbëra, sepse kanë nga dy folje në mënyrën dëftore dhe që të dyja kanë intonacion të përfunduar. Po ku shihet ndryshimi ndërmjet tyre ?

Në fjalinë e parë, që të dyja pjesët janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe mund të përdoren edhe më vete, si fjali të thjeshta: *Mora frymë thellë. Me shpejtësinë dhe forcën e predhës u krodha në thellësi.*

Të përdorura si pjesë të një fjalie të përbërë, ato lidhen me lidhëzën bashkërenditëse **dhe**. Kjo quhet fjali e përbërë me bashkërenditje.

Kjo fjali e përbërë përbëhet nga **dy pjesë të pavarura**.

Në fjalinë e dytë, pjesët nuk janë të pavarura nga njëra - tjetra dhe nuk mund të përdoret secila si fjali e thjeshtë, prandaj kjo fjali quhet **fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur**. Pjesa e parë e fjalisë që mund të qëndrojë më vete është pjesë kryesore, kurse pjesa e dytë është pjesë e varur ose pjesë e nënrenditur.

Në këtë fjali pjesa kryesore është: *Mua deti s'më ka mallkuar*, kurse pjesa e nënrenditur *se unë nuk jam zemëruar me të*.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dallohen nga ato me nënrenditje edhe në pikëpamje të përdorimit të lidhëzave. Fjalitë me bashkërenditje nuk mund të fillojnë me lidhëz, ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje mund të fillojnë edhe me një lidhëz nënrenditëse. P.sh.: Dhe me shpejtësinë dhe forcën e predhës u krodha në thellësi.mora frymë thellë, nuk mund të fillojë kështu.

Pjesët e bashkërenditura kanë vend të caktuar në fjalinë e përbërë dhe ato nuk mund të futen në mes të pjesës tjetër, kurse pjesët e nënrenditura mund të futen para dhe pas pjesës kryesore.

Para se të bëjë mjaltin, bleta bën dyllin.

Bleta, **para se të bëjë mjaltin**, bën dyllin.

LLOJET E FJALIVE TË PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE

Një budalla hedh një gur në lumë dhe njëqind të mençur s'mund ta nxjerrin. Ose nisemi tani, ose nuk shkojmë fare. Fjala e keqe të verbon, kurse fjala e mirë të shëron.

Mësoj shumë, prandaj kaloj mirë.

Të gjitha fjalitë e mësipërme janë fjali të përbëra me bashkërenditje, të cilat dallohen si për nga kuptimi ashtu edhe për nga mjetet e lidhjes.

Kështu, sipas marrëdhënieve që vendosen në mes të pjesëve në fjalitë e përbëra me bashkërenditje dallojmë këto lloje fjalish:

1. **Fjali të përbëra me bashkërenditje shtuese**, që përbëhen prej dy a më shumë pjesësh dhe bashkohen me lidhëzat **bashkërenditëse shtuese: e, edhe, dhe, edhe – edhe, as – as, jo vetëm...por edhe**. P.sh.: **As nuk erdhi në dasmë, as nuk na lajmëroi.**

Jo vetëm që nuk shkoi në punë, por as nuk u paraqit fare.

Blerina edhe mëson rregullisht edhe merret me sport.

2. **Fjali të përbëra me bashkërenditje veçuese**, që shprehin veprime nga të cilët mund të realizohet vetëm njëri prej tyre. Ato bashkohen me lidhëzat **bashkërenditëse: ose, o, apo, a, ose...ose, ja**. P.sh.: **O mëso si duhet, o lëri studimet. Ja të punojmë siç duhet, ja të pushojmë. Do rrish, apo do të shkosh?**

Pjesët e fjalive që bashkohen me lidhëzat e përsëritura ndahen me presje.

3. **Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërsjore** janë fjali që shprehin veprime që kundërshtojnë njëri-tjetrin. Pjesët e tyre bashkohen me lidhëzat **bashkërenditëse: po, por, mirëpo, kurse, megjithatë, megjithkëtë, ndërsa etj.**

Unë e lëshoj, por s'më lëshon ai. Romanin e lexova një herë, po s'e kuptova mirë.


E ëma e kishte dërguar të birin te një usta për të mësuar zanatin, mirëpo ustai nuk ia kishte mësuar as gjysmën e zanatit.

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje kundërsjore ndahen me presje (,).

4. **Fjali të përbëra me bashkërenditje përmbyllëse**, ku pjesët e dyta shprehin përfundimin e asaj që është thënë në pjesën e parë dhe bashkohen me lidhëzat **bashkërenditëse përmbyllëse: andaj, prandaj, ndaj, pra**.

Ai mësoi tepër, prandaj u lodh shumë. Unë do të hap një shtëpi të re, pra dua të blej ca mobilje.

Skematikisht fjalitë e përbëra me bashkërenditje që bashkohen me anë të lidhëzave, na paraqiten kështu:



MBANI MEND

Fjalitë mund të jenë të thjeshta dhe të përbëra.

Fjalitë **e thjeshta** kanë vetëm **një folje** në njërën nga mënyrat vetore, ndërsa fjalitë e përbëra kanë **dy** ose **më shumë folje** në njërën nga mënyrat vetore.

Fjalitë **e përbëra** me bashkërenditje përbëhen nga **dy pjesë të pavarura**, ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje përbëhen nga **një pjesë kryesore** dhe nga **një pjesë e nënrenditur**.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje janë :

Fjalitë shtuese të cilat bashkohen me lidhëzat **e, dhe, edhe, edhe..edhe, as, jo vetëm ...por edhe.;**

Fjalitë veçuese bashkohen me lidhëzat **ose, o, apo, a, ose...ose;**

Fjalitë kundërshtore bashkohen me lidhëzat: **po, por, mirëpo, kurse** etj., dhe

Fjalitë përmyllëse që bashkohen me lidhëza përmyllëse: **prandaj, andaj, ndaj, pra.**

Ushtrime

1.Dalloni fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra dhe tregoni cilat janë me bashkërenditje e cilat me nënrenditje

Punëtorët kishin ngrënë darkë dhe po pushonin.

Meqë ishte ftohtë ata ndiznin edhe zjarr.

Afroheshin rreth zjarrit dhe bisedonin.

Një djalë i vogël u ndal para një librarie dhe atje takoi një shoqe të klasës.

Kur arrita në vendlindje, të gjithë më pritën me gëzim.

Dheu mëmë ka qenë i shtrenjtë për jetë për shqiptarët, andaj jani Vretoja krijoi fjalën e bukur “mëmëdhe ...”.

2.Nga fjalitë e thjeshta krijoni fjali të përbëra me bashkërenditje shtuese dhe kundërshtore. Shkruani fjalitë e formuara

Drini i Zi kishte veshur një cipë akulli. Nën cipën e akullt rridhnin ujërat.

Erdhën ditët të ngrohta. Kumbullat çelën lule.

Mos prit të të kërkojë shoku. Kërkoje ti atë.

Kishte kaluar mesnata. Mua nuk më flihej.

3.Shkruani nga dy fjali të përbëra me bashkërenditje veçuese dhe përmyllëse.

FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITUR

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni prej sa pjesësh janë përbërë ato. A mund të qëndrojnë më vete po t'i ndajmë ato në fjali të thjeshta? Vëreni lidhëzat dhe mjetet lidhëse të pjesëve të nënrenditura.

Agroni dalloi Teutën, që zvarritej përpara tij.

Fyellin e mësoi nga një bari, që kulloste dhentë buzë lumit në vendlindjen e tij.

Klaudi e kuptoi se djaloshi kishte një fyell të ri.

Vajzës nuk i kujtohej dita kur kishte dalë në fotografi.

Që atë ditë që u nda nga Tana, nuk i qeshi buza.

Njeriu që gënjen të lë në mes të udhës.

Nga shembujt e mësipërm shihet se pjesët e fjalive të përbëra nuk janë të një vlere, por njëra e plotëson tjetrën. Fjalitë e shkruara me shkronja të zeza lidhen me fjalitë kryesore me anë të lidhëzave të ndryshme nënrenditëse dhe kryejnë po ato funksione që kryejnë **gjymtyrët plotësuese në fjalinë e thjeshtë**; d.m.th. funksionin e **përcaktorit, kundrinorit, rrethanorit** etj.


Fjali të përbëra me nënrenditje janë ato që të paktën përbëhen prej dy pjesësh, nga të cilat njëra është kryesore (e pavarur), ndërsa tjetra e nënrenditur apo e varur nga kryesorja.

Fjalitë e nënrenditura lidhen me kryesoren:

a) me anë të lidhëzave të ndryshme nënrenditëse: **se, që, si, posi, me gjithëse** etj.

b) me **fjalë lidhëse- me përemra lidhorë dhe me disa ndajfolje lidhore: që, cili, cila, ku, kur** etj. dhe sipas funksionit që kryejnë, dallohen disa lloje pjesësh të nënrenditura, si: pjesë përcaktore ffilluese, kohore, vendore, shkakore, kushtore, lejore, rrjedhimore etj.

Skema më e zakonshme e fjalive të përbëra me pjesë të nënrenditura është kjo:



1. Fjalía e përbërë me pjesë të nënrenditur ffilluese

Vëreni pjesët e nënrenditura të fjalive të përbëra. Me se lidhen ato me pjesët kryesore dhe ç'funksion kryejnë?

Dihet se (që) Toka rrotullohet rreth Diellit.

Nuk më kujtohet mirë se me cilin aeroplan udhëtuam për në Amerikë.

E dimë të gjithë se lumi Vardar derdhet në detin Egje.

Puna është që Besniku s'ka për të pranuar një kusht të tillë.

Valonit i pëlqen të luajë .

Pjesët e nënrenditura janë lidhur me kryesoren me lidhëzat ffilluese se dhe që dhe quhen pjesë të nënrenditura ffilluese. Ato kryejnë funksionin e kryefjalës ose të kundrinorit të drejtë, prandaj quhen **fjali ffilluese kryefjalore**, siç janë fjalitë 1 dhe 2 të cilave mund t'ua bëjmë pyetjet: Ç?, Cila?, Cili?, si p.sh.: Ç'dihet? Rrotullimi i Tokës rreth diellit (kryefjalë) ose fjali ffilluese kundrinore të cilën mund ta gjejmë me pyetjet: Ç?, Kë, Cilën, etj. si p.sh. në fjalinë 3: Kë (Ç)cilën?, e dimë të gjithë? - se lumi Vardar, derdhet në detin Egje. (= derrdhjen e Vardarit në detin Egje). Pra, pjesa e nënrenditur kryen funksionin e kundrinorit të drejtë.

2. Fjalía e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore

Lexoni fjalitë e mëposhtme . Ç'funksion kryejnë pjesët e nënrenditura në fjalinë e përbërë. Me ç'mjete lidhen ato me kryesoren?

Fyellin e mësoi nga një bari, që kulloste dhentë buzë lumit.

Njeriu që vetëm për vete punon, është si një dru që pemë s'lëshon.

Njeriu që gënjen të lë në baltë.

Ohri është një qytet në të cilin shëtitet me kënaqësi.

Pjesët e shkruara me shkronja të zeza janë pjesë të nënrenditura përcaktore dhe lidhen me **paraprijësit** e pjesëve kryesore (një bari, njeriu, një qytet) me përemra lidhorë që, i cili, e cila, të cilin ose mund të lidhen edhe me fjalë lidhëse **ku, kur, nga** që përdoren si përemra lidhorë. P.sh.: Vetura u ndal para derës së madhe nga doli një mjek.

Pjesa e nënrenditur përcaktore kryen po atë funksion që e kryen edhe përcaktori në fjalinë e thjeshtë. P.sh.: Njeriu që gënjen , të lë në baltë. Fjala që përcaktohet nga pjesa kryesore quhet paraprijës.

MBANI MEND

Përemri lidhor **që** përdoret në formë të ngurosur vetëm në rasën emërore dhe kallëzore, ndërsa përemrat **i cili, e cila** përdoren në të gjitha rasat pa parafjalë dhe me parafjalë.

Pjesa përcaktore bashkohet edhe me lidhëzat fthilluese **se** dhe **që**. P.sh.: Lajmi se (që) do të shpërndahet misri, doli nga zemra e dheut.

Ushtrime

Analizoni fjalitë e përbëra, dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur. Dukej fshati që shtrihej nga maja e pllajës e gjer buzë xhadesë së automobilave. Shiu i imët që kishte nisur u shpeshtua.

Askush nuk besonte që lumi të vërshonte atë ditë.

Uji i liqenit kaltërosh, që rrethonte ishullin e vogël, po nanuritej nën rrezet e diellit të ngrohtë.

Nuk e sheh si i janë skuqur sytë nga leximi me dritë të dobët.

FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITUR RRETHANORE

1.Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur vendore.

Ata qëndruan aty **ku udha ndahej për në mëhallën e mësipërme**.

Gjuha shkon **ku dhemb dhëmbi**.

Ngado që të hedhësh sytë, sheh vetëm dëborë.

Fëmija kaloi **nga ishte prishur gardhi**.

Altini, **kudo që të shkonte**, i binte fyellit.

Nga këto fjali, pjesa e nënrenditur tregon vendin ku kryhet veprimi i shprehur nga folja e pjesës kryesore. Pjesa e nënrenditur vendore mund të qëndrojë **në fillim, në mes ose në fund** të pjesës kryesore.

Pjesa e nënrenditur vendore kryen funksionin e rrethanorit të vendit dhe gjendet me pyetjet **Ku? Nga?**. Ajo bashkohet me pjesën kryesore me lidhëzat nënrenditëse vendore **ku, nga, tek si** dhe me shprehjet lidhëzore **kudo që, ngado që, tek do që** etj.

MBANI MEND

Kur pjesa e nënrenditur vendore ndodhet përpara pjesës kryesore, ajo ndahet gjithmonë me presje: Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku. Po ashtu kur futet në mes të gjymtyrëve të pjesës kryesore vihet midis dy presjesh: Peri, **ku është i hollë**, atje këputet.

Kur pjesa e nënrenditur vendore vjen pas pjesës kryesore nuk ndahet me presje.

2. Fjalitë e përbërë me pjesë të nënrenditur kohore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e nënrenditura të shkruara me shkronja të zeza. Ç'funksion kryejnë ato?

Kur turbullohet, atëherë kullohet.

Në mëngjes, **kur u zgjua plaka prej gjumit**, pa që shtrati i Mitit ishte bosh.

Kur erdhi arsimtari, të gjithë ishim në klasë.

Hekuri rrihet **sa është i nxehtë**.

Që kur ka ardhur si drejtor, punët shkojnë mirë.

Fjalitë e mësipërme janë fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura kohore.

Pjesa e nënrenditur kohore kryen në fjalinë e përbërë një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të kohës në fjalinë e thjeshtë dhe tregon kohën kur kryhet veprimi i shprehur nga folja e pjesës kryesore.

U përgjigjet pyetjeve: **Kur?**, **Që kur?**, **Deri kur?** etj. Pjesa e nënrenditur kohore mund të plotësojë rrethanorin e kohës. Psh.: Vjollcën e takova dje, kur kthehesha nga shkolla. Pjesa e nënrenditur kohore lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore **kur**, **që kur**, **sa**, **derisa**, **tek**, **si**, **pasi**, **sapo**, **porsa** etj.

MBANI MEND

Pjesa e nënrenditur kohore kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të kohës në fjalinë e thjeshtë. Ajo mund të zërë të tria pozicionet: para, pas dhe në mes të kryesores.

- Kur ndodhet para pjesës kryesore ndahet me presje: **Kur hahen qentë**, i ha ujku dhentë.

- Kur ndodhet në mes vihet ndërmjet dy presjeve: Bleta, **para se ta bëjë mjaltin**, e bën dyllin.

Kur vjen pas kryesores nuk ndahet me presje: Hekuri rrihet **sa është i nxehtë**.

Lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse kohore.

Ushtrime

Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur të këtyre fjalive të përbëra dhe tregoni llojin e tyre.

Ku e ke punën, shtro gunën.

Mos e lëndo ku i dhemb.

Ruaje zogun sa e ke në dorë.

Në mbrëmje, kur dielli i purpurt iu afrua majës së Bjeshkëve të Nemura, djemtë shkuan në kampin e skiatorëve.

Vëllai erdhi atëherë kur nuk e prisnin .

Vrapoi me shpejtësi derisa u zhdruk thellë në pyll.

Më poshtë janë shënuar lidhëzat e nënrenditura kohore dhe vendore dhe pjesa kryesore. Plotësoni pjesën e nënrenditur.

Ku.....vete gjuha.

Ku....., atje shkonte.

Ngado qëkëndonte.

Kur , çelin lulet.

Para se..... i bëj detyrat.

Pasibujku e mbjell farën.

3. Fjalitë e përbërë me pjesë të nënrenditur shkakore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni ato të shkruara me shkronja të zeza.

E lëvdoi se është **tamam burrë**, mburrej gjyshja.

Nuk fjeti gjyshi, **sepse fëmijët bënë zhurmë**.

Ardiani u gëzua shumë **që e takoi Artanin**.

Meqenëse ishte vjeshtë, puna mbeti për verën e motit të afërm.

Pjesa e nënrenditur shkakore tregon shkakun ose arsyen e kryerjes ose të moskryerjes së një veprimi. Ajo lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave nënrenditëse shkakore: **se, sepse, ngaqë, për shkak se, për arsye se, meqë, me qenë se, përderisa** etj. U përgjigjet pyetjeve: **Përse?, Për ç'arsye?, Për ç'shkak?** etj.

Pjesa e nënrenditur shkakore që bashkohet me kryesoren me lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore: **që, se, sepse, për arsye se, nga shkak se** përdoren gjithnjë pas pjesës kryesore. P.sh.: Sytë i ishin skuqur **ngaqë s'e zinte gjumi**. Nuk i pëlqente, **vetëm sepse nuk i shkonte pas qejfit**.

Kur pjesa e nënrenditur shkakore bashkohet me lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore: **meqë, meqenëqë, meqenëse** përdoren në tri pozicione: **Meqë ishte dimër**, ne binim herët në shtrat. **Ne binim herët në shtrat, meqë ishte dimër**. **Ne, meqë ishte dimër**, binim herët në shtrat.

4. Fjalìa e përbërë me pjesë të nënrenditur qëllimore

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e shkruara me shkronja të zeza. Ç'funksion kryejnë ato?

Babai punon shumë që fëmijët të jenë të lumtur.

Që të mos i shprishnim qetësinë plakut edhe anekdotat i tregonin me zë të ulët.

Erdha me qëllim që t'i them të tëra në sy.

Në fjalitë e mësipërme pjesët e shkruara me shkronja të zeza janë pjesë të nënrenditura qëllimore.

Pjesa e nënrenditur qëllimore kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethorit të qëllimit në fjalinë e thjeshtë: tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i shprehur i pjesës kryesore dhe u përgjigjet pyetjeve: **Përse?, Me ç'qëllim?** Pjesa e nënrenditur qëllimore bashkohet me pjesën kryesore me lidhëzat qëllimore: **që, me qëllim që, në mënyrë që**. P.sh.: **Fliste me zë të ulët që të mos i pengonte të tjerët.**

Shpesh pjesa e nënrenditur qëllimore bashkohet me kryesoren edhe pa lidhëz, përkatësisht vetëm me foljen **në mënyrën lidhore**. P.sh.: **Mërgimtarët çdo vit vijnë ta vizitojnë vendlindjen dhe të çmallen me të afërmit.**

Rendi i zakonshëm i pjesëve në fjalinë e përbërë me pjesë qëllimore është: në fillim vihet pjesa kryesore dhe **pas saj pjesa e nënrenditur**. P.sh.: **Loriku shkoi ta thërrasë Valdetin**. Por pjesa e nënrenditur qëllimore vihet edhe para edhe në mes të pjesës kryesore. P.sh.: **Që të mos vonohej**, u ngrit shumë herët. **Besmiri, që ta dëgjonin të gjithë**, bërtiti me zë të lartë.

5. Fjalìa e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni pjesët e nënrenditura.

Në qoftë se ke mësuar, do ta kalosh klasën.

Po të mos jesh mirë, po rri me ty.

Sikur të më ketë besuar, do ta kemi më lehtë.

Më falni, po fëmijës, **po s'qau**, nuk i japin të pija.

Ajo s'do të kishte ardhur në spital, **po të mos më kishte ndodhur aksidenti.**

Pjesa e nënrenditur kushtore është ajo pjesë që tregon **kushtin**, nga përmbushja e të cilit varet realizimi ose mosrealizimi i asj që thuhet në pjesën kryesore. Pjesa e nënrenditur kushtore bashkohet me pjesën kryesore në dy mënyra:

- me lidhëza nënrenditëse kushtore: **në, në qoftë se, nëse, po, po që se, sikur, kur** etj. P.sh.: **Nëse** vjen edhe ti, do të shkojmë në dasmë.
- pa lidhëz në mënyrën lidhore: S'fluturonte zogu, **të mos kishte** krahë.

Ushtrime

1. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur të këtyre fjalive të përbëra.

Ç'funksion kryen pjesa e nënrenditur?

Pelikanët kanë tërhequr vëmendjen e njeriut qysh në kohët më të lashta, sepse janë shpendë me pamje dhe cilësi të çuditshme.

Ngaqë po shkrinte dëbora, lumi sillte shumë ujë.

Gazetari shkoi aty që të merrte të dhëna për kapacitetin e ndërmarrjes.

Gjyshi i ftoi fëmijët brenda, t'i gostiste me nga një çokollatë dhe fruta.

Po të kishte frikë bujku nga krimbat në arë, nuk do të mbillte kurrë farë.

Ta kisha pranë shtëpinë, do të punoja këtu.

Po i fryve tymit, do të djegin sytë.

2. Shkruani tri fjali me pjesë të nënrenditur kushtore duke përdorur lidhëzat: **nëse, në qoftë se, po që se.**

6. Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur mënyrore

Analizoni fjalitë e mëposhtme. Ç'funksion kryen pjesa e nënrenditur?

Ashtu si erdhën, ashtu u zhdukën.

Zemra i rrihte **sikur kërkonte të dilte nga gjoksi.**

Si bëfsh, gjeç.

Ta duash dhe ta nderosh, **ashtu si të ka hije.**

Pjesa e nënrenditur mënyrore kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethororit të mënyrës në fjalinë e thjeshtë. Ajo tregon mënyrën si kryhet veprimi për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore. Pjesa e nënrenditur mënyrore bashkohet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse mënyrore: **si, siç, ashtu si, ashtu siç, sikur** etj., dhe u përgjigjet pyetjeve: **Si?, Qysh?, Në ç'mënyrë?**. Po këtyre

pyetjeve u përgjigjet edhe rrethanori i mënyrës.

Pjesa e nënrenditur mënyrore, në pjesën më të madhe, përdoret pas pjesës kryesore. Psh.: Erdha me qëllim që të ndihmoj.

Rrallë futet edhe në mes: Ato, **si të shohin**, bëjnë.

Pjesa e nënrenditur mënyrore kur vihet para kryesores ndahet rregullisht me presje. Psh.: **Ashtu si ju kujtoja**, ashtu ju gjeta.

Edhe kur vjen pas kryesores ndahet me presje.

7. Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore

Analizoni fjalitë e mëposhtme. Dalloni pjesën kryesore dhe atë të nënrenditur. Ç'funktion kryen pjesa e nënrenditur?

Miqtë i dua aq sa më **duan**.

Sa më shumë u afroheshim pemëve, aq më të heshtura bëheshin ato.

Ai doli nga shtëpia më i mërzhitur, **se ç'kishte qenë**, kur kishte hyrë.

Fjalët e tij përhapeshin për ditë, **siç përhapet drita e diellit në një ditë të bukur**.

Pjesët e shkruara me shkronja të zeza janë pjesë të nënrenditura krahasore.

Pjesa e nënrenditur krahasore është ajo pjesë që shërben për të krahasuar një veprim a një dukuri me një veprim a dukuri tjetër. Psh: Ata kaluan më mirë **nga ç'pritinin**.

Pjesa e nënrenditur krahasore mund të tregojë barazi dhe pabarazi.

Pjesa e nënrenditur **krahasore e barazisë** fillon me lidhëzën **sa dhe aq sa dhe** zakonisht qëndron para **kryesores** dhe ndahet me presje. Rrallë mund të futet në mes.

Pjesa e nënrenditur **e pabarazisë** fillon me një nga lidhëzat: **se, sesa, nga, nga sa**, qëndron pas kryesores dhe rrallë mund të futet edhe në mes. Psh: **Aq sa** punon, aq fiton.

8. Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur sasiore

Analizoni shembujt e mëposhtëm dhe vëreni pjesët e fjalive të shkruara me shkronja të zeza.

Vrapova **sa munda**.

Mate hapin, **sa ke vrapin**.

Ai ishte lodhur aq shumë, **saqë nuk mund të ngrihej nga vendi**.

Pjesë sasiore quhet ajo pjesë e nënrenditur që tregon se në ç'masë ose sasi kryhet veprimi i shprehur në pjesën kryesore. Ajo kryen një funksion të ngjashëm me atë të rrethanorit të sasisë në fjalinë e thjeshtë.

Pjesa e nënrenditur sasiore lidhet me pjesën kryesore me anë të lidhëzave

nënrenditëse sasiore: **sa, saqë, aq sa** dhe i përgjigjet pyetjes **sa**. P.sh.: Merrni sa të keni qejf.

Pjesa sasiore ka vend të ngulitur, vjen pas pjesës kryesore dhe nuk ndahet me presje.

MBANI MEND

Pjesa e **nënrenditur mënyrore** tregon mënyrën si kryhet veprimi për të cilën bëhet fjalë në fjalinë kryesore. Ajo bashkohet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse: **si, siç, ashtu si, ashtu siç, sikur**, dhe mund të zërë të tri pozicionet e mundshme në fjali.

Pjesa e **nënrenditur krahasore** shërben për të krahasuar një veprim a një dukuri, me një veprim a një a dukuri tjetër. Pjesa e nënrenditur krahasore mund të tregojë barazi dhe lidhet me kryesoren, me lidhëzat: **sa dhe aq sa** dhe pabarazi e cila lidhet me kryesoren me lidhëzat: **se, sesa, nga, nga sa** dhe qëndron zakonisht pas pjesës kryesore.

Pjesa e **nënrenditur sasiore** tregon në ç' masë ose sasi kryhet veprimi a gjendja për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore. Ajo lidhet me pjesën kryesore me lidhëzat: **sa, saqë, aq sa** dhe qëndron gjithnjë pas pjesës kryesore.

Ushtrime

1. Analizoni fjalitë e përbëra, gjeni pjesët e nënrenditura dhe thoni llojin e tyre. Lisat fishkëllenin sikur të tallëshin me dimrin.

Pylli e priti dëborën, siç e presin vogëlushët nënën.

Mbillet fara, si të jetë ara.

Mësuesi dukej më i ri nga ç' ishte në të vërtetë.

Më mirë të vdesim si burra, sesa të rrojmë të gjunjëzuar.

Aq sa e përmbajtur ishte Teuta, aq ters ishte Lirika.

2. Plotësoni fjalitë me një pjesë të nënrenditur sasiore:

Babi punoi aq shumë (**sa**) ...

Hëngra sa ...

Bekimi nuk ishte aq i ri (**sa**) ...

3. Shkruani nga dy fjali të përbëra me:

pjesë të nënrenditur krahasore,

pjesë të nënrenditur kohore.

FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITUR RRJEDHIMORE

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni ç` funksion kryejnë fjalitë e shkruara me shkronja të zeza:

Stadiumi nuk nxinte më, **kështu që** mjaft sportdashës mbetën jashtë.
Ishte një situatë e tillë, **që** askush s´e kursente veten.
Ulërijti njëherë **sa u tund** pylli.

Pjesa e nënrenditur rrjedhimore tregon rrjedhimin a pasojën e një veprimi a të një ngjarjeje për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore. Pjesa e nënrenditur rrjedhimore lidhet me kryesoren me lidhëzat nënrenditëse: **kështu që, që, sa, saqë**. P.sh.: Ata njerëz kanë bërë diçka, **që janë mbledhur ashtu grumbull**.

FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITUR LEJORE

Analizoni fjalitë e mëposhtme dhe tregoni ç` funksion kryejnë pjesët e nënrenditura.

Megjithëse rruga ishte e largët dhe e vështirë, asnjë nga shokët tanë nuk u tremb.

Kushdo që të ishte, fjalët e nënës do ta preknin thellë.
Sado i zoti që të jesh, do të kesh nevojë për ndihmën e shokëve.

Pjesa e nënrenditur lejore tregon një veprim i cili pritej ta pengonte kryerjen e veprimit të shprehur në pjesën kryesore, por nuk arrin ta pengojë dhe lejon që të kryhet.

Pjesa e nënrenditur lejore bashkohet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse: **megjithëse, megjithëqë, ndonëse, sado që, sido që, edhe sikur, edhe pse** etj., si dhe me përemrat: **kushdo, cilido, çfarëdo** etj.

Pjesa e nënrenditur lejore më shpesh përdoret para pjesës kryesore, por ndonjëherë përdoret edhe pas saj ose të futet në mes të gjymtyrëve të saj. P.sh.: Gënjeshtari, **sado mjeshtri të ketë**, mbetet gënjeshtar.

MBANI MEND

Pjesa e nënrenditur rrjedhimore tregon rrjedhimin a pasojën e një veprimi a ngjarjeje për të cilën bëhet fjale në pjesën kryesore. Pjesa e nënrenditur rrjedhimore lidhet me kryesoren me lidhëzat nënrenditëse: **kështu që, që, sa, saqë.**

Pjesa e nënrenditur lejore tregon një veprim i cili pritej ta pengonte kryerjen e veprimit të shprehur në pjesën kryesore por nuk arrin ta pengojë dhe lejon që të kryhet.

Pjesa e nënrenditur lejore bashkohet me kryesoren me anë të lidhëzave nënrenditëse: **megjithëse, megjithëqë, ndonëse, sado që, sido që, edhe sikur, edhe pse** etj., si dhe me përemrat: **kushdo, cilido, çfarëdo** etj.

Ushtrime

1. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur.

Ata ndejtën tërë natën, kështu që nuk fjetën asnjë orë.

Ishte situata e tillë që askush s' e kursente veten.

Dhoma ishte mbushur plot, aq sa të zihej fryma.

Ndonëse e kishte shkuar tërë jetën në beteja, Skënderbeu ishte plagosur vetëm një herë në shpatull.

2. Dalloni pjesën kryesore dhe pjesën e nënrenditur dhe thoni ç'lloj është kjo e fundit.

Kjo veper, ndonëse është shkruar 450 vjet më parë, nuk e ka humbur aspak rëndësinë e saj.

Gënjeshtra, sado ta fshehësh, do të dalë në dritë.

I pihej vazhdimisht ujë, megjithëse i kishte lagur buzët kushedi sa herë nëpër burime.

Edhe pse kanë kaluar kaq vjet, akoma nuk e kam harruar.

3. Shkruani nga dy fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur rrjedhimore dhe lejore.

FJALORI DHE STILI

STILI I LIGJËRIMIT

Rikujtohuni!

Si mund të komunikojmë njëri me tjetrin?

Si komunikojmë kur jemi afër njëri-tjetrit e si kur ndodhemi larg.

Njeriu si qenie më e përsosur shoqërore ka nevojë që të komunikojë me njëri-tjetrin. Komunikimi bëhet me gojë dhe me shkrim varësisht nga situatat e ndryshme.

Komunikimi me gojë realizohet zakonisht në mes dy bashkëbiseduesve, por ndonjëherë mund të marrin pjesë edhe më shumë, të cilët ndodhen afër.

Komunikimi me shkrim realizohet në një anë me shkrim, e në anë tjetër me anë të leximit.

Bashkëbiseduesit ndodhen larg njëri-tjetrit dhe mund të mos njihen fare.

Gjuha ndryshon sipas situatës së komunikimit, e cila e kushtëzon mënyrën e të folurit ose të të shkruarit. Ndryshe flasim me njerëzit në familje, me prindërit, ndryshe me shokët dhe ndryshe kur ndodhemi në situata të ndryshme shoqërore.

Nëse gjatë komunikimit njerëzit shprehin mendimet, vlerësimet, ndjenjat dhe përshtypjet e veta në gjuhën e gjallë të jetës së përditshme, atëherë themi se kemi përdorur ligjërimin bisedor.

Ligjërimi bisedor

Ligjërimi bisedor nuk ka kufizime të rrepta gjuhësore, fjalët dhe fjalitë shqiptohen me shkurtime, përdoren fjali me bashkërenditje, përsëriten fjalë e shprehje të gatshme si: **domethënë, demek, që thua ti** etj.

Përdoren më pak fjalë dialektore a krahinore dhe është variant që merr gjuha

standarde, sidomos kur përdoret në biseda të lira p.sh.: Mjaft llomotite!. Qepe se na e çave kokën!. Ti s'mendon për të tjerët.

Ligjërimi i shkujdesur

Ligjërimi i shkujdesur përdoret nga një grup njerëzish ku bëjnë pjesë folës të profesioneve e të krahinave të ndryshme, të cilët për arsye të ndryshme arsimore e kulturore e shkelin dhe e shtrembërojnë normën standarde duke përdorur shprehje të ndryshme. Në këtë ligjërim hasen shpesh edhe huazime nga gjuhët e tjera e sidomos huazime orientale ose turqizma si dhe shprehje që lidhen me një profesion, si p.sh.: lojtarët në lojërat e ndryshme përdorin edhe shprehjet si p.sh.: tifozi i flaktë, hape lojën etj.

Ligjërimi libror

Ligjërimi libror karakterizohet me fjalë të zgjedhura dhe me radhitje të duhur sintaksore të fjalëve dhe të fjalive sipas rregullave gramatikore.

Parapëlqehen trajtat joveprorë të foljeve dhe ndërtimet me përcjellore.

Përdoren fjali me nërenditje dhe me lidhëza të ndryshme nënrenditëse. P.sh.: Të parët u futën në betejë qentë e tyre, që u ishin vënë pas sikur kishin nuhatur sherrin e ri.

Ushtime

Dalloni llojet e ligjërimeve në shembujt e mëposhtëm:

a) Nuse moj, një gotë ujë!

Po, o babagysh: Ti sikur do ta lije këtë të flamosur duhan!...Ty të mbyti kolla o baba! – Ashtu është, moj bijë e babait, po ja që është ves dhe nuk heq dot dorë prej atij!.

b) Ti more mistrec, ke guxuar të vesh emrin tim në ato shkarravinat e tua, hë?

More kastravec, more karagjoz që më bëre të më skuqet faqja sot në kafene...Bëre, ç'bëre, të mos të të shoh më të merresh me maskarallëqe të tilla! More vesh?.

c) Ajo ditë shiu agoi vonë. Kurora e pishës ishte zhdukur në mjegull dhe kjo pamje shyte i bëri Shpresës një përshtypje të çuditshme, një përshtypje ankthi dhe

çlirimi... Aq e fortë qe përshtypja, sa ajo vështroi anës, mos e shihte përdhe. Nuk gjeti veçse disa boça të ronitura, që i kishte shkëputur tufani dhe kishin mbushur oborrin.

STILI FUNKSIONAL

Lexoni tekstet e mëposhtme dhe vëreni dallimet që ekzistojnë.

1. Terri u derdh, e një rigë e praruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngri poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet. Çdo gjë është strukur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit.

2. Çfarëdo komunikimi masiv (reklama, gazetaria, politika) është një lojë shkëmbimesh dhe ndikimesh në të gjitha mënyrat (autoritet, joshje, pedagogji, shantazh, bashkëpunim) ndërmjet tre aktorëve ortakë, kurse në rastin e reklamës, ndërmjet njoftuesit-dhënës, “atij që flet” (prodhuesi, fabrikanti, agjencia e reklamës), objektit-referim, “sendit” për të cilin flitet (prodhimi, objekti, shërbimi ose marka) dhe publikut.

3. Ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal.

Neni 1

Në çdo komunë, bashki, rreth organizohet dhe funksionon pushteti lokal. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal bazohet në parimet e vetëqeverisjes, autonomisë lokale, të ligjshmërisë dhe të zgjedhshmërisë.

4. Dhe për intelektualin, siç thotë dikush, demokraci është ai institucion ku asnjëri nuk ndiqet për fjalën e shprehur, për t'i vënë fjalës grackë; demokraci është ai podium, ku nuk përkulen para idhujve; demokraci është ai sistem, ku nuk zemërohen me talentet; demokraci është ai shesh, ku nuk ndalohet humori...

Po t'i analizojmë tekstet e mësipërme do të shohim se në to janë përdorur mjete gjuhësore të veçanta. Secili prej tyre i takon një stili të veçantë. Ata dallohen nga fjalori, fjalitë që përdorin, ndërtimet karakteristike etj.

Stili është zgjedhja e mjeteve të gjuhës dhe lidhja e tyre në përputhje me fushën e veprimtarisë dhe në përshtatje me përmbajtjen që ato sjellin.

Në bazë të përdorimit të mjeteve gjuhësore të veçanta në gjuhën e sotme letrare shqipe dallohen katër stile:

1. **Stili i letërsisë artistike**- që përfshin të gjitha krijimet artistike me anë të fjalës (krijmtaria popullore dhe artistike dhe nëndarjet e saj prozë, poezi dhe dramë). Ky stil synon të shfaqë dashurinë ndaj fjalës së bukur artistike.

Karakteristikë është përdorimi i fjalëve me ngjyrim emocional e sidomos i figurave të shumta letrare në poezi (shih shembullin e mësipërm). Nga pikëpamja sintaksore stili i letërsisë artistike dallohet me përdorimet e llojeve të ndryshme të fjalive të përbëra, me ose pa lidhëza, të ligjëratës së drejtë.

2. **Stili shkencor – teknik** – përfshin shkrimet shkencore e teknike: **artikuj, studime, tekste mësimore, recenzime, kritika, referate** etj. Informacioni paraqitet i vërtetë, prandaj tani mungojnë fjalët me kuptim të figurshëm.

3. **Stili politiko – shoqëror** – përfshin **fjalimet, raportet, shkrimet e gazetave, revistave, materialet e radiotelevizionit** etj. Ky stil përdor më shumë fjalë të fushës politiko-shoqërore si: **parti, zhvillim, mbledhje, demokraci, program, konkurrencë**.

4. **Stili administrativo – juridik**- përfshin dokumentet e ndryshme zyrtare (**vërtetime, akte, rregullore, shkresa, kërkesa**). Veçori këtij stili është se gjuha ka funksion kumtues. Tëni i teksteve të kësaj fushe është i përmbajtur dhe korrekt.

KËRKIMI I FJALËVE NË FJALOR

Për të pasuruar gjuhën tonë dhe për të saktësuar kuptimin e fjalëve që i dimë ose nuk jemi aq të sigurt në kuptimin e tyre, përdorim fjalorin.

Në fjalor e gjejmë shpjegimin e fjalëve aty për aty.

GJETJA E FJALËVE NË FJALOR

Për t'i gjetur sa më lehtë e sa më shpejt fjalët në fjalor duhet patjetër ta dimë alfabetin e gjuhës, sepse fjalët në fjalor janë rreshtuar (renditur) sipas rendit alfabetik.

Po kështu duhet të dimë së në krye të çdo faqeje gjenden dy fjalë që quhen **fjalë drejtuese**. Në anën e majtë është fjala e parë drejtuese e faqes, ndërsa në të djathtën fjala e fundit e kësaj faqeje. Psh.:

SIGURI~SIGURUES

Përveç fjalëve drejtuese janë shënuar edhe të gjitha fjalët titull që fillojnë me si dhe që shpjegohen me fjalë të tjera. Psh.:

SIGURI, ~A f.sh., ~, ~Të. 1. Të qenët jashtë çdo rreziku dhe të papriture; gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur, sigurim. *Siguria shoqërore. Siguria në punë. Ruajtja e lirisë dhe e sigurisë. Kërcënimet e imperializmit kundër sigurisë së popujve. Mungesë sigurie.*

2.Vërtetësia e plotë e diçkaje; mungesa e çdo dyshimi në lidhje me diçka; bindja e plotë se diçka është e vërtetë, e përpiktë a e drejtë. *Dibet (nuk dibet) me siguri. Me siguri matematike me siguri të plotë.*

3.Besimi në diçka; bindja e plotë a besimi i patundur për t'i dalë në krye një pune ose se gjithçka do të shkojë mirë, ashtu siç duhet, siç parashikohet, siç dëshirohet.

Siguria në të ardhmen (në ditën e nesërme). Siguria në vetvete. Ndjenja e sigurisë. Flet me siguri. Do të vijë me siguri (do të vijë patjetër, jam plotësisht i bindur që do të vijë).

4.Të qenët i sigurt, pa lëkundje e mëdyshje në veprim. *Siguria e lëvizjeve të duarve. Punon me siguri.*

SIGURIM, ~I *m.sh.* ~E, ~ET. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve SIGUROJ, SIGUROHEM.

Sigurim nga zjarri. Sigurimi i lëndëve të para. Sigurimi i lirisë dhe i pavarësisë. Sigurimi i numrit të nxënësve. Sigurimi i bukës në vend. Sigurimi i shtëpisë(i gjësë së gjallë). Masa (rregulla) të sigurimit. Instituti shtetëror i arkave të kursimit dhe i sigurimeve. Brez sigurimi. Kllapë sigurimi.

2. Tërësia e masave që merren për t'u mbrojtur nga rreziqet e fatkeqësitë në punë. *Sigurimi teknik.*

3. Organ për të mbrojtur rendin e një shteti nga veprimtaria e armiqve dhe nga keqbërësit e tjerë. *Sigurimi i shtetit.*

4. *kryes. sb.* Fjalët që thotë dikush për ta bindur një tjetër se gjithçka është e vërtetë ose ashtu siç e paraqit ai. *Megjithë sigurimet e tij, nuk doli ashtu.*

SIGURISHT *ndajf.* 1. Në mënyrë të sigurt, me bindje të plotë, pa dyshim, pa tjetër. *Sigurisht që e di. Sigurisht që e ka marrë vesh.*

2. *si fj. e ndërm.* Pa dyshim, kuptohet vetvetiu. Ju, sigurisht, jeni marrë vesh me të.

3. *si pj.* Përdoret për të bërë një pohim pa lënë asnjë dyshim; po, patjetër. – Do ta bëjë? – Sigurisht.

SIGURUES, ~E *mb.* 1. Që merret me sigurimin e jetës e të sigurisë në raste fatkeqësish të papritura. 2. *Përd. i em.* sipas kuptimit të mbiemrit.

Meqë shumë fjalë kanë më tepër se një kuptim në fjalor jepen edhe kuptimet e prejardhura 1,2,3 etj. Për këtë shih fjalën e mësipërme e mësipërme SIGURI, ~A f.sh. ~, ~të. Më poshtë po sjellim shembull fjalën:

BANDILL, ~I *m.sh.* ~Ë, ~ET *bised.* 1. djalë i ri e i pashëm; djalë i këndshëm, i afrueshëm e i qeshur. *Të ka nëna bandill! Mori një bandill.*

2. *sbak.* Djalë i ri që do një vajzë, i dashuri i zemrës. *E priste bandilli.*

3. *keq. tall.* Djalë që bredh pas qejfeve e pas vajzave; ai që mbahet më të madh e hiqet si trim, por që në të vërtetë është i zbrazët. *Turmë bandillësh. A kapën atë bandill?*

Në fjalor, përveç kuptimeve leksikore jepen edhe shënime gramatikore për të shënuar pjesën e ligjëratës së cilës i përket fjala. P.sh.: sigurisht, pranë kësaj fjale përdoret shkurtesa *ndajf.* që tregon se fjala e dhënë është ndajfolje.

Më poshtë po shënojmë disa pjesë të ligjëratës.

Ja si shënohen disa pjesë të ligjëratës:

mbiemri - *mb.*

përemri - *përem.*

parafjala – *parafj.*

lidhëza – *lidh.*

pasthirma – *pasth.*

Po kështu, në fjalor shënohen edhe disa veçori gramatikore të emrave (gjinia, numri, trajta): *m.* – gjinia mashkullore, *f.* – gjinia femërore, *sb.* – numri shumës etj.

Përveç se në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, këto shënime jepen edhe në Fjalorin Drejtshkrimor të Gjuhës Shqipe, nga i cili mësojmë si duhet të shkruhen drejt fjalët.

Ushtrime

Gjeni kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të fjalëve të mëposhtme në Fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe: çamçakëz, fëmijë, kala, lindje, dhe vëreni me çfarë shkronjash janë dhënë fjalët **titull**.

Fjalët e poezisë : “Dhe pranvera erdhi” të Migjenit radhitni sipas rendit alfabetik. Me ndihmën e fjalorit dhe të arsimtarit shpjegoni kuptimin e tyre.

DREJTSHKRIM

Përdorimi i drejtë i trajtave të shkurtra dhe i nyjes së përparme

Trajtat e shkurtra dhe bashkimi i trajtave të shkurtra.

Kur kemi bërë fjalë për përemrat vetorë kemi theksuar se ata përveç trajtave të plota, kanë trajta të shkurtra dhe trajta të bashkuara.

Trajtat **m’i**, **t’i**, shkruhen me apostrof. P.sh.: **M’i** dha librat (fletoret, lapsat etj.)

T’i dha librat (fletoret, lapsat etj.).

Vetëm trajtat **na e**, **na i** shkruhen ndaras. P.sh.: **Na e** dha librin (fletoren, lapsin etj.).

Na i dha librat (fletoret, lapsat etj.).

Por shpeshherë si në gjuhën e folur, ashtu edhe në të shkruar, vihen re përdorime të gabuara të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara të përemrave vetorë.

Kështu që pranë disa foljesh me kuptim kalimtar të zhdrejtë (që pranojnë si kundrinor një emër në rasën dhanore) përdoret krahas trajtës së shkurtër të përemrit vetor në dhanore edhe trajta e shkurtër në kallëzore: **ia** arrij qëllimit, **ia** nis (filloj) punës, **ia** pëlças gazit, **i** kris vrapit etj. Përdorimi i trajtës së bashkuar **ia** (i+e) në këta togëfjalësia përbën normë, kurse përdorimi vetëm i trajtës së shkurtër në dhanore: **i** arrita qëllimit, **i** dha vrapit, përbën shkelje norme.

Më poshtë janë dhënë fjali ku trajtat e shkurtra janë përdorur gabim dhe drejt.

Analizoni fjalitë dhe tregoni në cilat fjali janë përdorur drejt trajtat e përemrave.

- | | |
|---|--|
| 1. a) Ai i tha atyre, por s'e dëgjuan. | b) Ai u tha atyre, por s'e dëgjuan. |
| 2. a) Ai ia dha librat atyre. | b) Ai ua dha librat atyre. |
| 3. a) U thashë juve, por s'më kuptuat. | b) Ju thashë juve, por s'më kuptuat. |
| 4. a) Ua dhashë juve. | b) Jua dhashë juve. |
| 5. a) Ju dhashë atyre. | b) U dhashë atyre. |
| 6. a) Jua dhashë atyre. | b) Ua dhashë atyre. |

Nyjat e përparme

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni fjalëzat e shkruara me shkronja të zeza. Albana është nxënëse e klasës së gjashtë.

Ajo vishet bukur.

Ajo mban një bluzë të bukur.

Kur e vesh bluzën e kuqe, duket edhe më e bukur.

Në fjalitë e mësipërme fjalëzat **i**, **e**, **së**, **të**, janë nyja të përparme. Nyjat e përparëme përdoren para emrave në rasën gjinore si dhe para mbiemrave të njëjshëm dhe disa përemrave pronorë.

Kur një emër i rasës gjinore vjen pas një emri tjetër në rasën gjinore a dhanore njëjës të pashquar, shkruhet me nyjën e përparme të pavarësisht nga gjinia që ka emri para tij.

Psh.: Ja dhashë librin një shoku të fëmijërisë.

Kjo është diploma e një studenteje të Fakultetit Filologjik.

Kur pas një emri femëror në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore të shquar njëjës vjen një emër tjetër në rasën gjinore, ai merr nyjen së kur përcakton drejtpërdrejt këtë emër. P.sh.: Ky është libri i shoqes së klasës.

Artani është i vëllai i shoqes së klasës sime.

Kur emri i dytë nuk e përcakton drejtpërdejt këtë emër, ai merr nyjen të dhe jo së.

Ky është vëllai i shoqes sime të klasës.

Artani është vëllai i shoqes sime të klasës.

Kujdes duhet të tregojmë kur një emër në rasën gjinore përcakton jo një emër, por gjithë grupin emëror: Akademia e Shkencave e Maqedonisë dhe jo Akademia e Shkencave të Maqedonisë p.sh.: Akademia e Shkencave e Maqedonisë do të jetë organizatore e një simpoziumi të rëndësishëm.

Kur ndeshen dy nyja së në rasën gjinore të emrave të nyjshëm, atëherë nyja e parë së zëvendësohet me të. P.sh.: Fjalës të së motrës nuk ia vuri veshin. Po kthehet prej shtëpisë të së bijës. Kërkesat tona i përgjigjen detyrës të së sotmes e të së ardhmes.

Ushtrime

Gjeni nyjat e përdorura gabim. Shkruajini si duhet.

Ajo i ngjan figurës së të Bukurës së Dheut.

Po kthehej prej shtëpisë së të bijës.

Hartimi i nxënësve së të gjashtës klasë ishte në nivel.

Shkrimi i datave

Kur komunikojmë me shkrim, domethënë kur bëjmë detyrat e shtëpisë ose kur shkruajmë një letër për t'ia dërguar dikujt ose një shkresë zyrtare duhet të shkruajmë datën. Ka disa mënyra për shkrimin e datës:

muaji shënohet me fjalë:

20 nëntor 2008

muaji shënohet me shifra arabe dhe ndahet nga data e viti me pikë.

20.11.2008

muaji shënohet me shifra romake dhe ndahet nga data e viti me pikë.

20.XI.2008

- Kur shkruajmë vendin ku shkruhet ose botohet diçka , atë e ndajmë nga data ose viti përkatës me presje:

Shkup, 2008

Shkup, më 30 gusht 2008

- Kur shkruhen data të festave të ndryshme zyrtare, muaji shkruhet me shkronjë të madhe:

1 Maji, 11 Tetori etj.

Ushtrime

Shkruani datën kur keni lindur në të tri mënyrat që mësuat.

Shkruajini një letër të shkurtër shokut ose shoqes që keni larg.



PASQYRA E LËNDËS

ATDHEU – N. Frashëri	7
NINULLA – popullore	9
TI JE YLL E TI JE DRITË – popullore	11
BUKURINË E BALLIT –popullore	12
MËMA – Asdreni	13
SI LINDI HIMNI KOMBËTAR “FLAMURIT PRANË TË BASHKUAR” – Lasgush Poradeci	16
“Rreth flamurit të përbashkuar” – Asdreni	18
O DASHURIA IME! - Pjetër Bogdani	20
GËRZHETA – popullore	25
BIJ TË SULIT - Xhorxh GORDON BAJRONI	28
GOCA E KAÇANIKUT - Milto S.Gurra	29
SKËNDERBEU	33
ROBINSONI NË ISHULL DHE “PESHORJA” E TIJ... ..	36
TË URTIT E RRUGËS - Hivzi Sulejmani	39
ZONJA RINË ARBËRESHA - Mitrush Kuteli	42
...DHE FENIKSI PËRSËRI FLUTUROI - Agim Vinca	45
PLAKU ZEMËRBARDHË - Arif Demolli	46
RINISË - Esad Mekuli	49
ASKUSH NUK DI TË LEXOJË NË FSHAT - Qamil Batalli	51
KLITHMA - Anton Pashku	53
HAPMA DERËN ZONJA MËMË -Vorea Ujko	55
DASMA - Ismail Kadare	57
LAMTUMIRË! - Gjergj Fishta	60
VILHELM TELI - J. Fridrih Shiler	62
LULEVE QË VALVIT ERA - Jeronim de Rada	65
FJALA JONË - Rrahman Dedaj	67
SHKODRA - Marin Barleti	69
GJITHË E VESHUR NË TË ZEZA - Popullore arbëreshe	72
KËNGA E DHOQINËS –	74
KUR QESHIN FËMIJËT - Musa Vyshka	76
HAPË DERËN VËLLA!... - Rene Filiombi	79
PËRSHENDETJA - Franc PRESHERN	80
PËRMBYTJA - Fatmir Gjata	81
NATË DIMRI - V. Jani	83
DEBUTIMI IM NË BURGTEATËR - Aleksandër Moisiu	85
LOTËT E HAJRISË - Nazmi Rrahmani	87
FARKËTARI I FSHATIT - H. U. Longfelou	90
FAJTORI - La Fonteni	92
PULËBARDHA - Dritëro Agolli	94
VAJE – A. Çajupi	96
UJKU DHE QENGJI - Naim Frashëri	98
DRENUSHA DHE PJERGULLA - Nonda Bulka	100
PËRLESHJA ME PESHKAQENIN - Petro Marko	101

E DI NJË FJALË PREJ GURI - Azem Shkreli	104
MËNGJESI - Omar Khajami	106
VËLLAZËRI E INTERES - Kristo Floqi	107
PESHA E DHEUT - Nexhat Mustafa	109
KUR NISA TË SHKRUAJ VARGJE - Dhori Qiriazzi	113
I BURGOSURI DHE LIBRAT - Orhan Qemal	114
RREZJA NË LITAR - Enver Gjerqeku	115
DHE PRANVERA ERDHI - Migjeni	117
DIMNI - Ndre MJEDA	119
HOXHA TAHSIN – Sami Frashëri	121
RREGULLA MIRËSJELLJEJE – Jani Vreto	124
PËR SA TOKË KA NEVOJË NJERIU – Leon Tolstoi	127
VRULL - Zef Serembe	131
POLIFONISTËT - Luan Starova	133
KËNGË – Hivzi Sulejmani	137
DOKTORI – Petro Marko	139
THIRRJE NGA NËNTOKA – Eqrem Basha	141
FATET – Ali Podrimja	142
THEMRA E AKILIT – B. Blushi	144
NË VERI - Ramiz Kelmendi	146
BIBLIOTEKA –	149
INTRENETI –	150
DISKUTIMI –	151
NJOFTIMI –	153

GJUHA SHQIPE DHE VJETËRSIA E SAJ	155
KLASAT E FJALËVE	157
Fjalët e ndryshueshme	157
Fjalët e pandryshueshme	158
GRUPI EMËROR	161
TRAJTA E EMRIT	162
PËRCAKTORËT	167
Emri	168
Mbiemri	169
Përemri	170
SHKALLËT E MBIEMRIT DHE TË NDAJFOLJES	172
PËREMRRAT VETORË DHE TRAJTAT E SHKURTRA	174
Përemri vetor	176
Përemri vetvetor	178
Përemrat lidhorë	179
Përemrat dëftorë	180
Përemrat pronorë	181
Premrat e pyetës	184
Përemrat e pacaktuar	185
FJALËT E PREJARDHURA	188

Fjalët e përbëra	190
Fjalët e përngjitura	191
Familja e fjalëve	191
FOLJA, KASIFIKIMI I FOLJEVE NË ZGJEDHIME	193
Foljet e parregullta	194
Format veprorë dhe joveprorë të foljeve	196
Foljet pavetore	198
Mënyra dëftore	199
FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES	204
FJALIA E THJESHTË	207
Funksionet gramatikore	208
RRETHANORËT DHE LLOJET E TYRE	213
Rrethanori i kohës	213
Rrethanori i vendit	214
Rrethanori i shkakut	216
Rrethanori i qëllimit	216
Rrethanori i mënyrës	217
Rrethanori i sasisë	218
LLOJET(TIPAT E FJALIVE)	220
Fjalitë dëftore, pohore dhe mohore	221
Fjalitë dëshirore, pohore dhe mohore	222
Fjalitë nxitëse pohore dhe mohore	222
Fjalitë pyetëse pohore dhe mohore	223
FJALA E PËRBËRË	225
Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje	226
FJALIA E PËRBËRË ME PJESË TË NËNRENDITUR	229
FJALORI DHE STILI	240
KËRKIMI I FJALËVE NË FJALOR	244
DREJTSHKRIMI	246
Shkrimi i datave	248